



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18, 19 DHE 25 KORRIK 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18.,19. I 25 JULA 2013. GODINE**

**KORRIK - JUL
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kimikate,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i propozimit për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e tetë (8) projektligjeve që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media,
11. Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtares në Komisionin për Integritet Evropian,
12. Debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, sipas kërkesës së deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o zvaničnim praznicima u Republici Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o hemikalijama,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za zapošljavanje u Republici Kosova,
7. Razmatranje predloga o odstupanju od Poslovnika Skupštine za razmatranje osam (8) nacrta zakona koji se odnose na ispunjavanju kriterijuma za liberalizaciju viza,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Kosovskoj agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
9. Razmatranje konačnog izveštaja Anketne parlamentarne Komisije,
10. Formiranje Ad hoc komisije za izbor jednog člana Nezavisne Komisije za medije,
11. Predlog PG Pokreta “Vetëvendosje” o zamenjivanju članice u Komisiji za evropske integracije,
12. Parlamentarna debata o istraživanju i osudi ratnih zločina, uloga EULEX-a, Vlade Kosova i period tranzicije, prema zahtevu poslanika Kurtan Kajtazi, podržan od poslanika potpisnika.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministër dhe ministër i Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka kërkuar deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Pas zhvillimit të një varg proceseve të rëndësishme për shtetin e ri të Kosovës, është radha për dy prioritete: funksionimi i ligjit dhe plani ‘mareshal’ për Kosovën. I pari për ta rritur besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit dhe i dyti për ta rritur mirëqenien e tyre në vendin e vetë. Ky plan të elaborohet nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për zhvillimin afatshkurtër e afatmesëm.

Lidershipi i shteteve mike do të duhej të bindej për krijimin e këtij plani, i cili do ta forcojë konsolidimin e shtetit të Kosovës. Tipar dallues i popullit tonë është përkushtimi në punë dhe mirënjohja ndaj miqve. Plan i ‘mareshal’ në çdo aspekt kërkon më pak sesa kosto të projekteve të mëparshme për vendin tonë, ndërsa në perspektivë e përgatit Kosovën për integritet euroatlantike.

Ekipi i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë do të duhej të orientohej në dy projekte strategjike: gjysmën për projekte infrastrukturë kombëtare në Termocentralin ‘Kosova e Re’ në energjinë e rinovueshme në autostrada dhe hekurudha, ndërsa gjysma tjetër për projekte të iniciativave private.

Këto projekte do ta zvogëlonin dukshëm papunësinë në Kosovë, duke e zhvilluar ekonominë e vogël dhe të mesme me një koncentrim kryesisht në sektorin prodhues, duke i kushtëzuar përfituesit e programeve për kohë të caktuara, për monitorim dhe konsulencë të obligueshme me donatorin në zhvillimin e projekteve biznesore, ndërsa Buxheti i Kosovës vazhdon me mbështetje të projekteve deritashme në infrastrukturën lokale dhe në projekte të tjera nivel vendi.

Nëse kjo Qeveri nuk gëzon besim të plotë për këtë mbështetje duhet të krijohet një koalicion i gjerë i unitetit me subjekte që janë dëshmuar për lidhshmëri institucionale. Ky

koalicion duhet të jetë i paalternativë, edhe pas zgjedhjeve të ardhshme. Udhëheqja e tij të mbetet nga subjekti që fiton më së shumti besueshmëri në zgjedhjet e rregullta.

Nëse nuk fillojmë me programe për ta ndalur këtë krizë ekonomike, nuk mund ta kontrollojmë krizën sociale, kulturore, demografike, të emigrimit dhe rrjedhimisht inercionin e pashmangshëm ciklik të koncentruar në goditjet e fizibilitetit politik.

Në këtë dekadë, veçanërisht duhet të mbizotërojë doemos programi i zhvillimit ekonomik. Nëpër këto procese që po kalojmë me shumë sfida, edhe sikur të ishim djep i demokracisë, nuk do të duhej të toleronim vullnete aventuriere kapricioze që prodhojnë pragmatizëm stihik, në emër të sistemit të ri të vlerave, duke proklamuar koncepte autentike, as kurrfarë utopish të tjera, sikur as kultivim të mentalitetit të abuzimit institucional dhe në asnjë moment zbehjen e funksionimit të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lirie Kajtazi.

LIRIE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qeveritar,

Vërejtjet tona që nga fillimi për joseriozitetin e kësaj Qeverie për bisedime të ashtuquajtura teknike, e që fund e krye janë politike dhe mosrenditja e temave sipas rëndësisë që kanë, për çdo ditë i vërteton koha.

Këto bisedime tekniko-politike, pavarësisht rezultatit të tyre në tavolinë, në jetën praktike qytetarëve tanë brenda kufijve të Kosovës dhe atyre të mbetur jashtë kufijve të saj, veçanërisht atyre në Luginën e Preshevës, vetëm sa i kanë shtuar vështirësitë, kur kihet parasysh se Lugina e Preshevës është rajoni më i varfër në Serbi.

Në vend se atyre t'ua lehtësojmë komunikimin me Kosovën, kjo Qeveri u ka vendosur edhe taksën hyrëse. Edhe pse Kuvendi ka vendosur ndryshe, ajo as që mendon që ta largojë këtë taksë dhe ta korrigjojë veten në këtë drejtim dhe ajo që sot duam të theksojmë si Lidhje Demokratike e Kosovës, me çka është dashur të merret delegacioni i Kosovës në këto bisedime, është edhe ai i zonave kufitare, ku xhandarmëria serbe u shkakton probleme banorëve të këtyre anëve, të cilët jetojnë në pronat dhe në shtëpitë e veta.

Sado që pala serbe mundohet që ta vendosë në rrafshin e problemeve teknike, ky problem është thjesht politik dhe natyrisht se i qëllimshëm. Hyrja e kohëpaskohshme e xhandarmërisë serbe në rajonin e Karaçevës është kryekëput provokim i kësaj popullate dhe presion që ata të shpërngulen nga kjo pjesë. Cenimi i territorit të Kosovës nga xhandarmëria serbe është permanent, mirëpo në rajonin e Karaçevës kjo raportohet nga popullata, kurse në rajonet tjera, ku është arritur qëllimi i shpërnguljes së popullatës nuk ka mbetur kush të ankohet, kështu që normalisht që duhet vëmendje e Qeverisë aty ku nuk kemi njerëz të ketë përkujdesje të Qeverisë.

Këtu edhe lulëzon kontrabanda, gjë që ndoshta edhe i konvenon qeverisjes 'Thaçi'. Ky problem është shumë serioz dhe i takon Qeverisë të merret më seriozisht me të. Ne mendojmë që kryeministri, para se ta bëjë komunë Hasin për ta ruajtur Prizrenin nga votat e LDK-së, duhet seriozisht të merret me atë, të cilën shteti serb e ruan vazhdimisht edhe në Kushtetutën e vet - cenimin e tërësisë territoriale të Kosovës, e me këtë edhe i shqetëson qytetarët çdo ditë.

Nuk mjafton të kërkohen letra nga distanca, siç ndodhi ditë më parë nga kryenegociatorja Tahiri, por është përgjegjësi morale, nëse ekziston pak e tillë, që të shkohet dhe të shihen për së afërmi shqetësimet e vazhdueshme të popullatës së Karaçevës dhe të banorëve tjerë të vijave kufitare, para se ata të jenë shpërngulur të gjithë, siç ka ndodhur edhe me dhjetëra-mijëra banorë shqiptarë në vijat kufitare dhe ata të mbetur andej. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën. Në emër të grupit? Mirë!

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Sot kur Qeverisë sonë i janë harxhuar të gjitha premtimet dhe asfalti e ka shteruar buxhetin, kryeministri i është kthyer kartës së fundit elektorale që i ka mbetur në dorë, e kjo është krijimi i komunave të reja.

Tash janë zgjedhjet lokale në nëntor, prandaj premtimi që po e mbizotëron fushatën e parakohshme zgjedhore qeveritare është për krijimin e komunave pa fund.

Kur erdhi kjo Qeveri në pushtet, Kosova i kishte 30 komuna. Tash aktualisht i kemi 38 komuna, me 4 komuna të reja që i ka premtuar Qeveria, numri i komunave po shkon në 42 dhe siç ia ka nisur kjo Qeveri do të përfundojmë me mbi 50 komuna, vetëm e vetëm që ajo të mbetet në pushtet.

Në njërën anë kjo Qeveri zmbapset dhe dështon në pikat kryesore për sovranitetin e Kosovës, kurse në anën tjetër krijon edhe më shumë komuna. Pra, në vend që ta ndërtojme një republikë të fortë, ne po krijojmë shtet të komunave. Për kryeministrin tonë nuk është problemi më i madh hyrja e xhandarmërisë serbe në Karaçevë, por se si t'ua mbushë mendjen qytetarëve të Kosovës për t'ua marrë votat nëpërmjet krijimit të komunave të reja.

Së pari është shumë e gabueshme që komuna të shihet vetëm si projekt elektorale kur të afrohen zgjedhjet lokale, e jo si një nevojë e qytetarëve të Kosovës.

Së dyti, nuk është aspak demokratike dhe shenjë e një politike qytetëruese që njerëzve t'ua ofrosh komunën vetëm në shkëmbim të votave. Kjo është politikë e mbrapshtë.

Qytetarët e Kosovës sot nuk e kanë hall numrin e komunave, por mungesën e punësimit dhe të zhvillimit ekonomik. Kjo është arsyeja që mijëra kosovarë në muaj ua mësyjnë ilegalisht vendeve të zhvilluara të Evropës. Dhe, përderisa njerëzit nuk kanë para,

Qeveria thotë se do t'i dënojë me nga 7 500 euro nëse i kap ata të dëshpëruar që duan ta marrin botën me sy për t'i mbajtur familjet e tyre.

Meqë Qeveria nuk ka vizion ekonomik se si t'ia zgjidhë problemet ekzistenciale shumicës së popullit në Kosovë, asaj i ka mbetur vetëm krijimi i komunave të reja. Por, komuna e re nuk krijon fabrika, e as vende të reja të punës për popullin. Kjo Qeveri i koncepton komunitat e reja vetëm në një funksion të caktuar. Komuna është hapje e vendeve të reja të punës për partinë në pushtet dhe ajo aty synon t'i punësojë militantët e vet dhe të gjithë ata që janë të gatshëm t'ia japin votën. Këto janë komuna të votave të partisë në pushtet.

Shikuar nga aspekti ekonomik, kjo është po ashtu një strategji pa vend, sepse nëpërmjet kësaj lakmie elektorale, në fund të fundit, krejt çka po ndodh është fryrja e Administratës së shtetit dhe mbingarkesa e funksioneve të pavarura të shtetit me militantë partiakë. Pra, shteti i udhëhequr prej këtij pushteti edhe po harxhon gjithnjë e më shumë, edhe po bëhet gjithnjë e më shumë partiak, e gjithnjë e më pak profesional.

Por, për qytetarët shumicë, punësimi nuk po rritet dhe jeta e tyre kryesisht nuk po përmirësohet në aspektin social dhe ekonomik, e kjo është arsyeja pse politika e kësaj Qeverie po e krijon një mjedis të atillë jetësor, ashtu që për shumicën e njerëzve qëllimi kryesor është bërë që ta lëshojnë atdheun e tyre.

Shtrohet pyetja: Pse njerëzit po ia mësyjnë Zvicrës, për shembull. Qytetarët tanë po ia mësyjnë Zvicrës, sepse vetë po jetojnë në mjerimin social, kurse politikanët qeveritarë po jetojnë mbi milionat e korrupsionit.

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Duke pas parasysh që tani në universitetet e Kosovës është i hapur afati për provimin pranues, kërkoj nga Administrata e universiteteve, në përgjithësi, që të kenë konsideratë ndaj qytetarëve të Luginës së Preshevës dhe t'u krijojnë atyre përparësi në aplikimin për t'u pranuar në Universitetin e Prishtinës.

Duke pasur parasysh që ata e kalojnë kufirin dhe i paguajnë taksat administrative dhe kjo është një barrë, kërkoj nga Universiteti i Kosovës që asnjëherë të mos lejojë që qytetarët e Luginës së Preshevës të kthehen në Preshevë dhe të vijnë të nesërmen prapë vetëm sa për të aplikuar në një drejtim të caktuar në fakultetet e ndryshme.

Për fund, e kam edhe një çështje tjetër. Dua ta përshëndes iniciativën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e komunave të reja në Kosovë, duke marrë parasysh që duhet të jemi sa më afër qytetarëve me shërbimet e tyre dhe qytetarët e Republikës së Kosovës të mos kenë nevojë që të çohen në syfyër për të shkuar dhe për ta

regjistruar emrin për ta marrë një certifikatë, ose një ekstrat të lindjes, apo të vdekjes, siç e dëshmuar pamjet televizive mbrëmë në lajmet e televizioneve tona në Kosovë.

Prandaj, unë e përshëndes këtë akt dhe gjithashtu përshëndes edhe konstruktivitetin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në këtë drejtim.

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën. Nuk është lajmëruar. E as kartelë s'ka. Unë e kam të shkruar, por ai duhet të lajmërohet. Imri, e ke fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Dua ta shpreh shqetësimin tim lidhur me trendin e migrimit të rinisë kosovare, e jashtëzakonisht shqetësimi edhe më i madh rritet kur dëgjon deklaratat e zyrtarëve të lartë qeveritarë lidhur me këtë dukuri.

Deklaratat e zyrtarëve të lartë qeveritarë me mesazhe të qarta sanksionuese ndaj të gjithë atyre që ia mësyjnë jashtë vendit, rrugëve ilegale për të kërkuar një jetë më të mirë, janë deklarata irituese dhe qasje joserioze ndaj kësaj dukurie.

Migrimet masive zakonisht janë pasojë e luftërave, e konflikteve, e trazirave, e varfërisë, e gjendjeve socio-ekonomike etj. Në Kosovë, muajve të fundit ka një trend të shtuar të ikjes të rinisë kosovare jashtë vendit, kryesisht nëpërmjet rrugëve ilegale. Cili është shkaku i kësaj pasaje në rastin tonë?

Zyrtarët qeveritarë, në vend se të punojnë për krijimin e kushteve për mirëqenie sociale të qytetarëve, ata paralajmërojnë masa administrative e policore dhe i fajësojnë qytetarët hallexhinj dhe prodhojnë fajtorë trafikantë. Qeverisja e tanishme, jo që nuk ka bërë asgjë për hapjen e perspektivës zhvillimore në vend, por me këtë logjikë qeverisëse po e mban në geto vendin. Sundimi i rendit dhe i ligjit është në nivelin më të ulët, krimi i organizuar dhe korrupsioni po arrijnë nivele rekorde, nepotizmi, papunësia, varfëria, ngufatja e biznesit nga tallja, haraçi dhe shumë skandale të tjera për ditë e më shumë po e vrasin shpresën e qytetarëve kosovarë për një jetë më të mirë, sidomos të atyre të papunë dhe të rinisë.

Koha e fjalimeve të thata nuk e ushqen më askënd, nuk e ndal më askënd nga synimi për t'i përmbushur nevojat e jetës gjetiu. Nuk i nxit më ndjenjat e atdhedashurisë dhe, tek e fundit, kërcënimet me dënime nuk e frikësojnë dhe nuk e ndalojnë askënd.

Numri i qytetarëve kosovarë që po ikin nga vendi, e sidomos...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Përveç se datën e zgjedhjeve lokale në Kosovë na e caktoi Daçiçi, ai tashmë ka filluar të vendosë për organizimin e zgjedhjeve në pjesën e veriut të vendit tonë.

Realizimin e kërkesave të tij po ia mundësojnë edhe institucionet tona që me Kushtetutë konsiderohen si të pavarura. Njëri nga këto institucione është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Fillimisht, kryesuesja e KQZ-së, verbërisht dhe përulësisht, duke iu përgjigjur urdhrave të Edita Tahirit, u bë pjesë e dialogut politik dhe ky ishte cenimi më i rëndë që i është bërë pavarësisë së këtij institucioni.

Pas këtyre vizitave në Bruksel, zonja Valdete Daka e ka shpërndarë një dokument te anëtarët e KQZ-së, që ajo e ka cilësuar si konfidencial, të cilin ajo e ka prezantuar si konkluzione të arritura nëpërmjet të cilave i jepen detyra organizative dhe operative OSBE-së, detyra këto që janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj si përgjegjësi të KQZ-së.

Shkeljet nuk ndalojnë me kaq. Ajo, duke përdorur presionin dhe shantazhin, i ka detyruar dy zyrtarë komunalë të komunave në veri të vendit që t'i lëshojnë postet e tyre. Dhe, vetëm dy ditë pas këtij vendimi janë caktuar kundërligjshëm dhe pa kurrfarë procedure 4 zyrtarë komunalë zgjedhorë në katër komuna në veri të vendit në përzgjedhjen e të cilëve kanë qenë të përfshirë kryesuesja me disa anëtarë të KQZ-së, që tashmë janë bërë pjesë e këtyre shkeljeve kushtetuese dhe ligjore, e edhe me ndihmën e disa eksponentëve lokalë të OSBE-së që vazhdojnë ta sfidojnë pavarësinë e KQZ-së.

Zelli i këtij grupi për ta dëmtuar shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe nëpërkëmbur institucionin e KQZ-së ka vazhduar edhe dje, kur nga OSBE-ja janë sjellë lista të gatshme pa kurrfarë kriteresh me persona që nuk dihen kush janë dhe nga vijnë, e të cilët janë caktuar si anëtarë të KKZ-së për këto komuna, derisa Ligji për zgjedhje, neni 67, i përcakton qartë kriteret dhe mënyrat e përcaktimit të nominimeve për anëtarë të KKZ-së.

Gjithashtu, po dje, kryesuesja e KQZ-së, publikisht, nëpërmjet medieve, e tha një të pavërtetë tjetër në lidhje me dokumentet e vlefshme për të votuar. Ajo u përpoq që të spekulojë, duke thënë se edhe dokumentet e shteteve tjera mund të jenë të vlefshme për të votuar.

Unë e pyes zonjën Daka se ku jeton, në Republikën e Kosovës, apo në Serbi? Ku një gjyqtare e citon ligjin në këtë mënyrë, sikur ne të mos ishim shtet po tokë e askujt, atëherë paramendoni se çfarë drejtësie ka ndarë ajo deri më tani.

Këto janë vetëm disa nga veprimet që dëshmojnë se KQZ-ja ka rënë në tërësi nën kontrollin e Qeverisë dhe që pavarësia institucionale e këtij institucioni tashmë është dhunuar nga ata që do të duhej ta mbronin.

Me një strukturë të tillë nënshtruese ndaj Qeverisë dhe ndaj dialogut politik nuk mund të priten as zgjedhje të lira, e as demokratike. Mbase ky është treguesi më i mirë se ku fshihet krimi zgjedhor.

Lëvizja “Vetëvendosje” i kundërshton ashpër këto veprime të kundërligjshme dhe të kundërkushtetuese të anëtarëve të KQZ-së dhe kryesueses dhe tërheq...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

E mora fjalën për të parë se ka filluar një fushatë, e cila është bukur e hershme, e sidomos sa u përket premtimeve të kryeministrit edhe në ato që s’i ka realizuar, madje duke u thirrur se ka bërë investime të mëdha. E kam fjalën për Komunën e Gjilanit, meqë thotë se ka investuar 90 milionë.

90 milionë të investuara në Komunën e Gjilanit nuk janë, vetëm nëse janë në partneritetin publiko-privat që mund ta ketë dikush, ose që mund të jetë pjesë e një propagande, e cila qytetarëve të Gjilanit nuk mund t’u shitet, sepse ata s’po i shohin këta 90 milionë investime. Madje, as kryetari i Komunës së Gjilanit, i cili në vazhdimësi është ankuar për buxhet, se është shkelur Komuna e Gjilanit, duke mos lëshuar mjete të cilat kanë qenë të planifikuara, duke e rrezikuar po ashtu edhe biznesin dhe ndërmarrjet private, të cilave Qeveria u ka borxh e nuk po ua kryen atë.

Po ashtu, premtimet të cilat janë dhënë edhe në të kaluarën, edhe për autostrada, edhe për hekurudha, edhe për investime të tilla, që as në ëndërr nuk po i shohim atje, është një propagandë vërtetë jo e dinjitetshme, sepse nëse duhet qytetarëve të Preshevës, Medvegjës, Bujanocit t’u garantohej lëvizja e lirë, të kenë autostradë, të kenë investime të tilla, le ta kryejë obligimin që e ka para Parlamentit të Kosovës dhe para qytetarëve të Kosovës kryeministri, i cili duhet ta realizojë rezolutën, e cila është votuar në këtë Parlament, për heqjen e taksave qytetarëve të Luginës së Preshevës, për hapjen e zyrave, për ato angazhime, të cilat janë të Ekzekutivit në bazë të detyrave të marra nga ky Parlament.

Prandaj, më mirë është edhe ta shikojnë kufirin në Karaçevë, edhe disa elemente tjera, të cilat janë me interes kombëtar, e jo interesa të ngushta politike, të cilat vërtet nuk i hanë më qytetarët e Gjilanit, e as të asaj ane. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë.

Sot do t’i diskutoj dy probleme shqetësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës. Çështja e parë ka të bëjë me rritjen e numrit të aksidenteve me fatalitet. Me gjithë investimet në infrastrukturë rrugore, përmirësimit të kualitetit të rrugëve tona, ekspertët e fushës së komunikacionit, rritjen e numrit të aksidenteve me fatalitet e shpjegojnë si

pasojë e mospërshtatjes së shpejtësisë dhe ngarkesës në komunikacion, si pasojë e kolonave të gjata.

Kolonat e gjata në sezonin e verës janë shndërruar në dukuri dhe kur këtyre u shtohen edhe kolonat e gjata të dasmorëve, atëherë kjo përbën një lëvizje vërtetë shqetësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës në komunikacion.

Unë uroj që të ketë sa më shumë gëzime në familjet kosovare, por kjo nuk bën të shndërrohet në shqetësim për qytetarët e tjerë. Kolonat e gjata të dasmorëve po rritin tollovi në komunikacion dhe po paraqesin problem serioz për lëvizjen e lirë dhe të sigurt të qytetarëve.

Kërkoj nga institucionet përgjegjëse që ta rritin vigjilencën për një kontroll më të rreptë në komunikacion, për evitimin e aksidenteve me fatalitet. Për zgjidhjen e këtij problemi, mendoj që Ministria e Punëve të Brendshme, bashkë me Policinë e Kosovës, duhet ta organizojë një debat të gjerë publik.

Të nderuar deputetë,
Çështja e dytë ka të bëjë me problemin e dukurisë së të shtënave me armë zjarri nëpër ahengje. Kjo dukuri ka marrë shumë jetë njerëzish. Shumë ahengje nga gëzimi janë shndërruar në pikëllim dhe me gjithë angazhimin e Policisë së Kosovës, ky problem vazhdon të jetë i pranishëm dhe i pandalshëm.

Andaj, duke e njohur traditën dhe mentalitetin e popullit tonë, problemi i të shtënave me armë zjarri në ahengje duhet të zgjidhet në mënyrë ligjore, duke mbrojtur dhe siguruar jetën e çdo qytetari dhe duke eliminuar të shtënat në ajër me armë zjarri me plumba vdekjeprurës.

Ligji aktual nuk po i përshtatet mentalitetit dhe traditës së popullit tonë, andaj mendoj se ky problem mund të zgjidhet duke e plotësuar legjislacionin, duke i rritur ndëshkime për të shtëna me armë zjarri me plumba vdekjeprurës, por duke i legalizuar të shtënat me armë me gaz, pa plumba dhe këtë me njoftim dhe leje të organeve përgjegjëse.

Problemi i të shtënave me armë zjarri dhe ai i kolonave të gjata, 14 vjet pas luftës përbën një problem në vete. Prandaj, mendoj që Ministria e Punëve të Brendshme, bashkë me Policinë e Kosovës, duhet ta organizojnë një debat të gjerë publik për zgjidhjen e këtyre dy problemeve dhe evitimin e rrezikut për jetën e qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Tanimë është e qartë se Kosova në mënyrë të vazhdueshme po pëson rënie dhe atë, si në aspektin politik, edhe ekonomik, e për këtë mendoj që pajtohem, qoftë hapur, qoftë intymisht.

Ikja e madhe nga Kosova e dëshmon këtë. E tani, i bie të qartësojmë se cila është pikë më e lartë se kjo e tanishmja, pasi kur themi “rënie”, i bie të kemi pas vetes një pikë më të lartë.

Zotërinj,

Me keqardhje duhet të them se si fryt i politikës së sotme, pikë e lartë për të shkuarën e Kosovës i bie të jenë vitet e ish-Jugosllavisë. Pra, na sollët në këtë gjendje që qytetari kur ta kujtojë Jugosllavinë, t’i harrojë vuajtjet dhe nga represioni i atij shteti, e të thotë së paku “atëherë ishim më mirë”.

As kjo gjë nuk i falet sot Qeverisë. Ishin pak, disa vite të viteve të ‘70-ta, kur Kosova e pati një rritje të shpejtë në zhvillim. Një hapësirë e vogël politike e krijuar dhe një popull vital prodhoi, bëri një zhvillim, si në ekonomi, si në dije, edhe në rezistencë. Zhvillimi i këtyre viteve filloi nga “Trepça”. Investimet e qëlluara në rritje të kapaciteteve të saj sollën në mënyrë zinxhirore rritje ekonomike dhe rritje të investimeve edhe në fushat tjera.

“Trepça” ishte themeli i kësaj rritjeje, ndonëse edhe në këtë situatë eksploatohet dhe madje nga puna e saj ndërtohet edhe jashtë Kosovës, kudo më shumë se në Kosovë. Këto vite ndërtuan edhe kushte që rezistenca jonë të marrë trajtë dhe rrugë më të qartë. Pak hapësirë politike solli zhvillim, e zhvillimi solli më shumë vetëdije politike. E sot, Kosova e vazhdon rënien e saj, si në aspektin politik, edhe në atë ekonomik.

“Trepça”, bashkë me të. Në vend se të shkojë drejtë rivitalizimit, ajo po shkon drejt shitjes. Nëse hapësira e krijuar politike i hapi rrugë “Trepçës” dikur, sot rrudhja e hapësirës politike e shpie atë drejt shitjes, e shitja e shpie Kosovën drejt varësisë së përhershme.

Koncesionet me negociata me Serbinë e braktisin “Trepçën”, e me këtë edhe të ardhmen. Politikë kjo e filluar nga UNMIK-u, kur tokat dhe fabrikat bëhen leckë tregu, dhe e vazhduar nga Qeveria drejt shkatërrimit të çdo potenciali shtetndërtues në Kosovë. “Trepça” sot po shkon drejt shitjes, e jo drejt rivitalizimit, pasi edhe Kosova me këtë politikë po shkon drejt degradimit, e jo drejt shtetndërtimit.

Prandaj, e tërë kjo politikë duhet ndryshuar rrënjësisht, duhet ndalur dhe të fillojë nga e reja drejt shtetndërtimit pra, kundër degradimit që sot po e kemi, duke i kthyer qytetarët tanë brenda dhe duke mos krijuar kushte që ata ta braktisin vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më të lajmëruar. Urdhëro! Keni të drejtë, veç tani mund të nxitni debat. Fjalën e ka ministrja Vlorë Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Vetëm një sqarim, jo për replikë. E kam thënë në të gjitha prezantimet e mia ditëve të fundit që jemi shumë të vetëdijshëm që azili dhe migrimi ilegal nuk është shkak, por

është pasojë. Është pasojë e kushteve të vështira në të cilat jetojnë shumë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, jam shumë e vetëdijshme për problemet e mëdha që i ka shteti ynë i ri. Këto janë probleme kronike, të cilat janë akumuluar me dekada dhe nuk mund të zgjidhen as për një javë, as për një muaj, e as për një mandat. Por, jo për të hyrë dhe për të dhënë shpjegime për arsyet që kanë prodhuar këtë gjendje, unë dua të korrektoj disa deklarata që u thanë këtu.

E para, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i ndëshkon financiarisht migruesit ilegalë. Janë vendet, anëtare të Bashkimit Evropian, janë vendet anëtare të zonës Shengen, që i kanë rregullat e tyre, nëpërmjet të cilave i trajtojnë migruesit ilegalë. Ka masa financiare dhe ka masa ndëshkimore administrative.

Pra, nuk është Qeveria e Republikës së Kosovës, por janë vendet anëtare të Bashkimit Evropian që i kanë rregullat e tyre, nëpërmjet të cilave i trajtojnë migruesit ilegalë. Dhe, po ashtu, edhe nga kjo foltore, ne duhet ta themi qartë që me gjithë vështirësitë, me gjithë sfidat që i kemi si shtet, azili më nuk është opsion. Shtetasve të Republikës së Kosovës, me gjithë vështirësitë me të cilat ballafaqohemi ne, nuk u jepet më as azil ekonomik, as azil politik, e asnjë formë tjetër e azilit si rezultat i politikave të diskriminimit. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Koha për pyetje parlamentare është e kufizuar në 60 minuta. Janë të parashtruara 6 pyetje. Fillojmë me pyetjen e parë: Deputetja Albanë Fetoshi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Zëvendëskryeministri nuk është i pranishëm. Urdhëro!

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse zëvendëskryeministri ishte këtu, do të ishte mirë që ai të qëndronte në sallë dhe të përgjigjej në pyetje për shkak se këtë pyetje zëvendëskryeministrit ia kam drejtuar edhe në seancën e kaluar.

Mirëpo, zëvendëskryeministri në momentin kur përfundoi pyetja u gjend në sallë, kështu që konsideroj se do të duhej të vinte dhe të përgjigjej në pyetjet e deputetëve.

Pyetja ime ka të bëjë me ndërmarrjen “Marketingu”, punëtorët e së cilës u dëbuan dhunshëm në vitet e ‘90-ta nga objekti i tyre. Padrejtësia po vazhdon ende, sepse Qeveria e Kosovës në mënyrë të paligjshme vazhdon ta uzurpojë hapësirën të kësaj ndërmarrjeje marketingu. Pra, në atë ndërmarrje janë të vendosura prokuroritë dhe KQZ-ja. Të mos harroj ta cek se kur ata janë larguar në mënyrë të dhunshme në vitet e ‘90-ta, pas asaj periudhe aty është vendosur misioni i OSBE-së, dhe më e keqja e kësaj është se ai mision

u ka paguar qira ndërmarrjeve të Serbisë, me gjithë faktin që ai objekt i takonte kësaj ndërmarrjeje marketingu.

Pyetja për zëvendëskryeministrin, edhe një herë po e përsëris, është se pse hapësirat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme nuk po u kthehen punëtorëve të kompanisë “Marketingu”? Po e cek edhe një herë, do të duhej që zëvendëskryeministri të ishte në sallë dhe të përgjigjej në këtë pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, urdhëro!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Zoti ministër, në bazë të neneve 42, 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura dhe Oda Ekonomike e Kosovës, që ka filluar të zbatohet nga 1 janar 2005, punëtorët që i kanë 30 vjet punë kanë të drejtë në shpërblimin jubilar në lartësi të dy pagave bazë, të cilat është i obliguar t’i paguajë punëdhënësi i fundit, si dhe kompensimet shtesë sipas nenit 42 dhe 44.

Kjo e drejtë shfrytëzohet pa probleme në komunat tjera në Kosovë. Në Komunën e Gjilanit, pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate kolektive, vetëm nga fusha e arsimit janë pensionuar mbi 100 punëtorë. Të drejtën që ua garanton Kontrata Kolektive e kanë shfrytëzuar vetëm 20 nga të pensionuarit.

Është për t’u habitur se disa të punësuar në vitin 2008 nuk e kanë shfrytëzuar ende këtë të drejtë, kurse disa të punësuar në vitin 2012 i kanë marrë shpërblimet jubilarë. Është konstatuar se të gjitha rastet e fituara kanë kaluar nëpër gjykatë, pasi Komuna nuk i kryen obligimet në mënyrë të rregullt.

Po ashtu, është konstatuar se në disa raste kur vendoset pozitivisht, Komuna ka reaguar, kurse për disa raste është ankuar, e kjo ka ndikuar që të pensionuarit të mos i marrin paratë që u takojnë. Ka raste kur gjykata për raste të njëjta merr vendime të ndryshme.

Zoti ministër,

Cili është roli i ministrisë që ju drejtoni për këtë çështje dhe si e komentoni ju këtë shkelje të së drejtës së pensionistëve dhe a keni ndërmend të ndërhyni në këtë çështje pas këtij njoftimi tani?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala!

Poštovani predsedniče,

Poštovani ministri, dame i gospodo,

Narodni poslanici

Gospodin Aljiu,

Kao što znate, ove odredbe kolektivnog ugovora koji se vi pomenuli su potpisane 2004. godine, i samim tim taj opšti kolektivni ugovor je bio sklopljen na osnovu člana 6 pravilnika br. 2001/27 o osnovnom Zakonu na radu na Kosovu.

Samim tim je stavljen van snage Uredba UNMIK-a 2001/27 o osnovnom Zakonu rada Kosova do 8. oktobra 2001. godine. Tako da je ovaj ugovor samim tim datim momentima bio potpisan između tri osnovna predstavnika, Savez nezavisnih sindikata Kosova, Privredna komora i Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu.

Ali, Zakon, odnosno kolektivni ugovor koji je potpisan tad, i sve uredbe koje se tiču prava radnika i njihovo zastupanje su samim usvajanjem Zakona o radu koji desio 2010. godine stavljen je van snage, što znači da jedini validni dokument u ovom smislu je Zakon o radu koji utvrđuje i u većoj meri je mnogo opširniji bolji nego što je bila ta neka uredba i taj kolektivni ugovor.

A druga stvar je onako i dajem informaciju da kolektivni ugovori se u načelu uglavnom potpisuje na period od tri godine, tako da računajući 2004, kada je bio potpisan taj kolektivni ugovor, verovatno bi trebalo da došlo vreme da više puta analiziramo i revidiramo, a pored toga, kao što mi čekujemo, najbitnija stvar da Zakon o radu u mnogo većoj meri obuhvata ceo taj deo oko prava radnika.

Nova Informacija je da mi smo već na socioekonomskom savetu već više puta razmatrali kolektivni ugovor. Mi smo napravili neke procene koje bi trebali da taj kolektivni ugovor bi koštao 8 miliona samo za onaj sektor koji mi mamu u absolutnu nadležno, odnosno vladin sektor, što znači da bi verovatno ako bi se kolektivni ugovor usvajao, to bi koštalo još nekih možda dva puta više zbog privatnog sektora.

Mi smo jednim draftom predložili u Ministarstvo finansija, ali odgovore još nemamo, što znači da nismo mi odustali od kolektivnog ugovora, nego da ćemo raditi na njemu.

A što se tiče ovi slučajevi koji ste pomenuli vi u Gnjilanu za određene slučajeve gde su oni isplaćeni na osnovu ovog kolektivnog ugovora, vi znate da mi u rad suda ne može umešati. Koliko ja znam, jedan određeni broj je dobio to pravo, a već...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

LIBURN ALIU: Po, pikërisht këtu është çështja. Si është e mundur që në mënyrë selektive, disa në vitin 2012 të marrin, e disa të tjerë të mos marrin? Pra, nëse nuk është në fuqi, atëherë do të duhej të mos ishte në fuqi për të gjithë.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Kao što sam rekao, stvarno mi nemamo prava, ni moralnog, ni institucionalnog da se mešamo u rad suda. Prema tome, izvinjavam što kažem, ali neko tamo određeni sud ili sudija misli da neko mogli da dobiju neki ne, ja to stvarno ne znam, ali u suštini ja vam kažem šta je u načelu najpravičnije. Najpravičnije je da ta uredba je van snage, a kako to tumače određeni sudovi ili sudija, ja stvarno ne znam. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama i ka dy pyetje. Pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin Kuçi, i cili nuk është i pranishëm, kurse pyetja e dytë është për ministrin Bajram Rexhepi.

E ke fjalën, deputete.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Po e filloj me zotin Rexhepi, ndërkohë të lutem, ftojë ministrin Kuçi, i cili është në kafe.

Kompania e pastrimit që përkujdeset për Ministrinë e Punëve të Brendshme, por edhe për disa ministri të tjera, ka së paku pesë muaj që nuk i paguan me asnjë cent punëtorët që i pastrojnë ministrinë. Kompania në fjalë, punëtorët të cilët ju i shihni çdo ditë nëpër zyrat e ministrisë, zoti ministër, si fajtorë për këtë fakt e ka lënë Qeverinë e Kosovës, për shkak se ajo nuk i ka paguar me kohë paratë e tenderëve të fituar.

Prandaj, pyetja ime për ju është: A jeni në dijeni të kësaj shkeljeje shumë të rëndë të drejtave të punëtorëve, nëse po çfarë keni ndërmarrë ju si ministër për ta zgjidhur këtë problem, pasi kur kompanitë private guxojnë t'i shfrytëzojnë punëtorët e thjeshtë në mënyrë të tillë brenda institucioneve shtetërore, imagjinoni se si i trajtojnë ata jashtë tyre?

KRYETARI: Ministër Rexhepi, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Lama,

Fillimisht më lejoni t'ju njoftoj që pagesat për kompaninë "Delfini", e cila e ka fituar kontratën për mirëmbajtje të objekteve, ku janë të vendosura stafi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në komunat ku i kemi qendrat komunale të regjistrimit civil dhe qendrat komunale të regjistrimit të automjeteve, janë të proceduara, pra të paguara deri në muajin prill të këtij viti, të vitit 2013 dhe në disa raste kemi kryer obligimet financiare edhe për muajin maj ndaj kompanisë.

Megjithatë, pagesat për muajin maj dhe qershor nuk janë procesuar, ngase kemi pranuar me shkrim një vërejtje nga Thesari të datës 14.6.2013, në të cilën theksohet se kompania në fjalë ka problem me ATK-në, pra ka borxhe ndaj ATK-së. Rrjedhimisht, pagesat të cilat ne i kemi proceduar për këtë kompani përmes bankave komerciale janë kthyer në Thesar.

Më lejoni të theksoj që për shkak të këtyre vështirësive edhe ne si Ministri kemi probleme në raportim financiar. Tutje, ne kemi vërejtur edhe ndryshime të shpeshta të llogarisë bankare dhe numrit fiskal dhe nga mesi i muajit të shkuar kemi kontaktuar edhe me menaxherin e kontratës dhe kemi kërkuar që të zgjidhet ky problem në mënyrë që të jemi të sigurt që llogaria është valide. Ne ende nuk kemi pranuar asnjë përgjigje për këtë çështje.

Megjithatë, ne si Ministri kemi një kujdes të shtuar në procedimin e këtyre pagesave. Problemi qëndron tek kompania e cila ofron shërbime dhe në bazë të kompetencave që i kemi, kemi ngritur shqetësimet tona dhe kemi kërkuar zgjidhjen e këtij problemi. Kështu qëndron situata me shlyerjen e obligimeve financiare nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ndërsa, sa i përket pjesës së dytë të pyetjes, që ka të bëjë me pagesat ndaj punëtorëve, besoj se kjo është një pyetje që duhet adresuar në ministrinë tjetër, konkretisht në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, se Ministria e Punëve të Brendshme nuk mund të interferojë në këtë fushë.

KRYETARI: Deputete Alma, a ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po, faleminderit!

Zoti ministër, ju falënderoj për përgjigjen! E sinqertë do të thosha, por në lidhje me faktin, sepse unë ua kam shtruar juve këtë pyetje për pagesat e punëtorëve, nuk është se nuk i di kompetencat, por është çështje morale. Domethënë, punëtorët të cilët diskriminohen, punëtorët që punojnë brenda institucioneve të Kosovës dhe diskriminohen. Çfarë do të themi pastaj për punëtorët të cilët punojnë jashtë institucioneve të Kosovës, kur një kompani private guxon të bëjë një gjë të tillë brenda institucioneve, pavarësisht se ata janë të punësuar te kompania, mendoj se ka një problem shumë të madh moral këtu në raport me shtetin e Kosovës.

Natyrisht se duhet që Inspektorati i Punës të merret me këto kompani, por mendoj që secila Ministri që punëson kompani të tilla, duhet të mendohet mirë se kur t' u japë tenderët të mendohet mirë se cilave kompani po ua jep ato tenderë, cila është e shkuara e tyre? Prandaj, ne kemi të drejtë të marrim në mbrojtje të drejtat e punëtorëve.

Sot unë jam shumë e shqetësuar se ata punëtorë kanë ardhur dhe janë ankuar tek unë dhe kanë thënë që nuk paguhen, prandaj kjo është çështje e Qeverisë, e ministrisë suaj, apo e ndonjë Ministrie...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë e kuptoj shumë drejt çështjen morale, mirëpo baza ligjore është diçka tjetër.

Natyrish, që duhet të shikohen kompanitë të cilat nuk janë të përgjegjshme në kryerjen e detyrave të tyre me rastin e konkurrimit. Mirëpo, ju them që edhe nuk ke bazë ligjore që t'ua ndërpresësh kontratën, se në gjyq e fiton 100% lëndën për arsyen se ashtu është e rregulluar. Ndërsa, me të vërtetë edhe neve na vjen keq, them edhe një të dhënë, që të gjithë ata punëtorë, pavarësisht që nuk paguhen me rregull nga kompania, e kryejnë detyrën në mënyrë shumë të ndershme dhe ne jemi të kënaqur me punën që e bëjnë, mirëpo këto janë çështje ligjore që ne nuk mund t'i ndryshojmë.

KRYETARI: Pyetje tjera... dy pyetje i ka deputetja. A do ta parashtrosh pyetjen për zëvendëskryeministrin, ministrin e Drejtësisë? Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do ta parashtroj pyetjen edhe pse zëvendëskryeministri ose ministri i Drejtësisë nuk është këtu.

Ditët e fundit mediet kanë raportuar se në gjykatat e Kosovës nuk respektohet Ligji për përdorimin e simboleve zyrtare. Kështu, gjykatat e ndryshme në Kosovë nuk e përdorin fare logon e Republikës së Kosovës në dokumentet e tyre, përfshirë edhe aktvendimet gjyqësore.

Kjo praktikë i bën shumë joserioze ato gjykata dhe gjyqtarë, që veprojnë në këtë mënyrë dhe nga ana tjetër është shkelje e vetë Ligjit për respektimin e simboleve zyrtare, përkatësisht nenit 11 të tij. Prandaj, pyetja ime është kjo:

A është në dijeni Ministria e Drejtësisë për këtë shkelje të ligjit, a është

e vërtetë se një urdhër me gojë, për të mos përdorur logo zyrtare është dhënë nga Gjykata Supreme dhe cila është logjika pas këtij urdhri?

Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu ka dy pyetje për ministrat Rexhepi dhe Agani. Zgjidhe parashtrimin e pyetjeve.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Së pari pyetjen për ministrin e nderuar Rexhepi. Muajve të fundit është rritur numri i aksidenteve me fatalitet dhe kjo është shqetësuese për të gjithë. Pas investimeve të theksuara në infrastrukturën rrugore, përmirësimit të kualitetit të rrugëve tona ekspertët e fushës së komunikacionit rritjen e numrit të aksidenteve me fatalitet e shpjegojnë si pasojë e mospërshtatjes së shpejtësisë dhe ngarkesave në komunikacion, si pasojë e kolonave të gjata.

Pyetja ka të bëjë: Çfarë hapash ka ndërmarrë Ministria, që siguria në trafik të jetë më e madhe?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Haxhiu,

Është shumë e vërtetë që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 është në përgjithësi i rritur numri i aksidenteve dhe me fatalitet. Përkundër kësaj, Policia e Kosovës ka zhvilluar një sërë aktivitete policore operative në bashkëpunim edhe me institucionet tjera relevante për ofrimin e sigurisë së pjesëmarrësve në komunikacion.

Gjithsej në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 Policia e Kosovës ka zhvilluar 64 plane operative, me qëllim të ofrimit të sigurisë për pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor në vend duke përfshirë mosrespektimin e kufizimeve të shpejtësisë, lëvizjen e makinerive bujqësore në rrugët e Kosovës, drejtimi i mjetit motorik pa regjistrim, sezoni veror 2013, që është plan operativ, i cili është në proces të implementimit dhe operacione tjera.

Në bashkëpunim me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale janë realizuar disa aktivitete me qëllim të ngritjes së sigurisë në fushën e komunikacionit rrugor. Gjithashtu, për ofrimin e standardeve evropiane Policia e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet e tjera ka hartuar raportin evropian të aksidentit, i cili është në implementim nga muaji prill i këtij viti 2013.

Policia e Kosovës, përkatësisht Divizioni i Komunikacionit Rrugor, punën e vet për vitin 2013 e mbështet në planin zhvillimor strategjik të Policisë së Kosovës për vitet 2011-2015. Edhe pse statistikat flasin për një rritje të aksidenteve në përgjithësi e në veçanti të atyre me fatalitet, ne megjithatë jemi të përkushtuar që veturat përfundimisht t'i heqim nga shkaktarët e vdekjes në Kosovë. Ndër shkaktarët kryesor të aksidenteve gjatë kësaj periudhe siç e përmendët, edhe ju, edhe ekspertët, është mosadaptimi i shpejtësive konform rrugëve që i kemi në dispozicion, manipulimi i pasigurt me automjet, mos mbajtja e distancës në mes të automjeteve, kyçjet e pasigurta në rrugë kryesore, tejkalimet e pasigurta e tjerë.

Dhe, mund të them edhe një diçka që na përsëritet. Gjatë kohës së verës, kur është numri i shtuar i automjeteve për shkak të ardhjes së bashkëqytetarëve nga diaspora, numri i aksidenteve rritet edhe për shkak të ngarkimit të trafikut, por njëkohësisht edhe për shkak të shpejtësive, që jam shumë i bindur se në vendet ku ata jetojnë i respektojnë rregullat e komunikacionit dhe shpeshherë këtu ndodh, që absolutisht nuk i përmbahen.

Një problem tjetër është çështja e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputet?

BEKIM HAXHIU: Po, i nderuar kryetar.

I nderuar ministër,

Jemi dëshmitarë të javës së fundit edhe të mbylljes së aksit rrugor nga Stacioni i Autobusëve në Prishtinë, deri tek rrethi. Kjo çështje po përbën një problem për qytetarët e Republikës së Kosovës. E dimë se investimet janë të domosdoshme dhe të nevojshme

kudo në Kosovë, mirëpo komuna e Prishtinës përpara se të vendosë për mbylljen e këtij aksi rrugor, a ka bërë një konsultim shtesë me Ministrinë e Punëve të Brendshme me Ministrinë e Infrastrukturës, përpara se të krijohet një tollovi mu në kohën e qarkullimit më të madh të qytetarëve? A ka mundur që kjo, një mbyllje e këtij aksi rrugor të bëhet në një periudhë më të hershme kohore, apo gjithsesi është dashur që mu në mesin e verës, në qarkullimin më të madh që kjo rrugë të mbyllet dhe të krijohet vërtetë një problem shqetësues për qytetarët?

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë desha vetëm të përfundoj fjalinë e mëparshme. Është çështja e ligjit, ku një numër i madh i vozitësve nuk e paguajnë gjobën, por kërkojnë që lënda t'u shkojë në gjyq. Dhe, dihet cili është afati i asaj lënde, që ndoshta nuk thirret asnjëherë ose nuk ekzekutohet asnjëherë, shkon me dy-tri vjet, prandaj ata janë shumë të bindur që nuk do të kenë ndëshkim, prandaj edhe nuk i respektojnë.

Ndërsa, sa i përket se a ka mundur Ministria e Punës së Brendshme e ka vetëm atë pjesën, që Policia e trafikut t'i orientojë, të lehtësojë nëpër këto rrugë alternative, ndërsa për format se si, është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër Agani,

Furnizimi me barna nga lista esenciale vazhdon të jetë problem edhe më tutje. Ministria e Shëndetësisë do të duhej që të plotësonte furnizimin me barna nga lista esenciale 100% për nevojat e pacientëve. Buxheti për këtë është ndarë me kohë, andaj është shqetësuese mungesa e barnave nga lista esenciale.

Çfarë hapash ka ndërmarrë Ministria, që furnizimi me barna të jetë 100% nga lista esenciale, i nderuar ministër?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Haxhiu,

Në këtë pyetje dhe të ngjashme jam përgjigjur disa herë para Parlamentit, por kjo definitivisht nuk e zvogëlon rëndësinë e pyetjes, sepse problemet janë të vazhdueshme në këtë aspekt dhe me siguri se meriton që të adresohet edhe shpesh edhe në këtë vend.

Shkaqet për këtë gjendje mund t'i klasifikojmë në tri rrafshë. Rrafshi i parë është rrafshi financiar, rrafshi i dytë është rrafshi menaxherial dhe rrafshi i tretë është rrafshi sistemor.

Ju e dini mirë se buxheti për shëndetësi në Republikën e Kosovës është 1,85% nga GDP-ja. Kjo e përbën buxhetin më të ulët në rajon, ku kjo përqindje është rreth 5%, ndërsa në shtetet e Bashkësisë Evropiane shkon deri në 10%.

Problemet shëndetësore të popullatës janë të ngjashme në mos më të mëdha, përveç faktit se kemi të bëjmë me një popullatë të re, i cili është një element pozitiv në këtë aspekt. Nëse nisemi nga shifrat krahasuese në rajonin, buxheti për sektorin farmaceutik ishte dashur të jetë 60-70 milionë euro. Buxheti për këtë sektor në Kosovë në vitin 2013 ka qenë 21 milionë euro, pra se paku tri herë më pak se sa ai që është në rajon.

Megjithatë, në vitet në vijim çdo vit është bërë një përmirësim në këtë aspekt dhe ky buxhet është rritur. Për shembull, në vitin 2013 është rritur për 4 milionë nga 17 milionë në 21 milionë. Si rezultat i kësaj për shembull, e kemi këtë realitet se derisa në vitin 2008 për barna për citostatikë, për sëmundje malinje nga buxheti i Kosovës janë ndarë 500 mijë euro, në vitin 2012 janë ndarë më shumë se 5 milionë euro. Këtë diferencë përpara e kanë paguar qytetarët e Kosovës, sot e paguan Qeveria e vendit. Problemet megjithatë nuk janë ekskluzivisht financiare, ka edhe probleme menaxheriale, ka të bëjë edhe me politikën e planifikimit dhe furnizimit me barna dhe në këtë aspekt kemi ndërmarrë masa radikale të them ashtu dhe mu dje e kam nënshkruar kategorizimin e listës esenciale të barnave, e cila është kategorizuar sipas metodologjisë të ashtuquajtur VEN, në barna vitale, esenciale dhe të domosdoshme sipas metodologjisë së Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Me këtë kategorizim ne do të sigurojmë që barnat nga lista vitale e listës esenciale në vlerë prej rreth 22 milionë euro, të furnizohen pra me këto barna dhe material harxhues të furnizohen të gjitha institucionet shëndetësore sa më shumë që është e mundur dhe t'i afrohem edhe mbulimit 100%.

Për pjesën tjetër të barnave në grupin e dytë dhe të tretë do të sillemi në pajtim me mundësitë financiare që i kemi si dhe stoqet që i kemi në dispozicion, por zgjidhja përfundimtare e këtij problemi është zgjidhja sistemore dhe kjo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Faleminderit që je përgjigjur shpesh për këtë pyetje në Kuvend, i nderuar ministër, uroj që për këtë problem të mos përgjigjesh më në Kuvend, mirëpo të zgjidhet në terren.

I nderuar ministër,

Përkundër hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të shëndetësisë, përmes të cilit është promovuar reforma në sistemin shëndetësor, gjendja në terren nuk po duket hiç premtuese. QKUK-ja ka humbur statusin e institucionit terciar, ka kohë që është shndërruar në tip të Spitalit rajonal të Prishtinës, prandaj, i nderuar ministër, mendoj që do të ishte me rëndësi që

Qendra Klinike Universitare aktuale të legalizohej si spital rajonal i Prishtinës, ndërsa propozoj që Ministria e Shëndetësisë të fillojë planin për hartimin e një qendre të re klinike universitare, e cila do të ishte në funksion terciar sipas ligjit dhe e cila do të kishte një bashkëpunim të mirëfilltë edhe me Fakultetin e Mjekësisë dhe do të ishte vërtetë në shërbim të qytetarëve të Republikës.

Sot, aktualisht Qendra Klinike Universitare e kryen funksionin e Spitalit rajonal të Prishtinës.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vetëm ta mbaroj fjalinë që e thashë. Do të thotë, zgjidhjet e problemeve dhe vështirësive sistemore do të vijnë me momentin e miratimit të Ligjit sigurimeve shëndetësore në Kuvend të Kosovës dhe themelimit të Fondit të sigurimeve shëndetësore, i cili do të mundësojë ngritjen e dukshme të bazës financiare të shëndetësisë dhe me këtë menjëherë edhe futjen e të gjitha barnave, materialit harxhues në pakon themelore të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket çështjes që e ngritëm sa i përket Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe furnizimit me barna dhe material harxhues, desha të referohem në pyetjen që e patët fillimisht, dua t'ju informoj se vetëm për gjashtëmujorin e parë Ministria e Shëndetësisë ka dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, produkte farmaceutike dhe material shpenzues në vlerë prej 5 162 529 euro, që paraqet 1/4-ën e gjithë buxhetit për shëndetësinë e Kosovës, pra 7 spitalet rajonale dhe 38 qendra kryesore të mjekësisë familjare.

Sa i përket çështjes së Spitalit Rajonal dhe Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, unë e jam përgjigjur edhe në këtë pyetje në këtë Kuvend, por prapë po e përsëris, politika e Ministrisë së Shëndetësisë është ndërtimi i Qendrës Klinike Universitare Emergjente, për të cilën është duke u krijuar edhe korniza financiare në vlerë prej 30 milionë euro. Kjo qendër planifikohet të ndërtohet brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të ofrojë shërbime të nivelit tretësor, në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Mjekësisë, natyrisht në atë ndërlidhje. Ndërsa, kapacitetet tjera të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës të jenë në shfrytëzim si Spital rajonal për qytetin e Prishtinës. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, sipas nenit 45 të Rregullores.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

A ka vërejtje ndokush në këtë procesverbal? Nëse jo, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar plenare.

Të pranishëm i kemi 93 deputetë.

Të nderuar deputetë, pika shtatë e rendit të ditës, do të thotë Kryesia sipas Rregullores duhet të bëjë shmangie nga Rregullorja, duke u bazuar në nenin 84.

7. Shqyrtimi i propozimit për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e tetë (8) projektligjeve që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave

Pika shtatë ka të bëjë me 8 ligjet që janë propozuar. Pra, kemi Shqyrtimin e propozimit për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e tetë projektligjeve që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave.

Ne duhet të votojmë me 2/3-at e deputetëve të pranishëm për futjen e këtyre pikave në rend të ditës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kush nuk ka kartelë me ngritje të dorës.

Për, sa janë? Për: 67. Kundër me ngritje të dorës janë: 18. 18 me 67 plus një... 19

Megjithatë hyn në rend të ditës me 2/3-at e... 67 me 19. edhe 20 po ta numërojmë prapë shkon me 2/3-at.

Na duhet një votim formal që nga pika e shtatë e rendit të ditës fillojmë me pikën e katërt të rendit të ditës të këtyre projektligjeve.

Kush është për? Shumica absolute.

Kundër? Do të thotë me shumicën e votave fillojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

Në bazë të vendimit të mbledhjes së sotme plenare, për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, vazhdojmë me procedimin e projektligjeve si në vijim:

Fillojmë me shqyrtimin e parë të projektligjit për të huajt.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Fjalën e ka ministri Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,
Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për të huajt, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për të huajt është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013. Projektligji për të huajt është i harmonizuar me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon kushtet dhe procedurat e hyrjes, lëvizjes, pajisjes me vizë, leje qëndrimit afatshkurtër, leje qëndrimit të përkohshëm, leje qëndrimit të përhershëm, punësimin e të huajve në Republikën e Kosovës, si dhe largimin e tyre nga territori i Republikës së Kosovës.

Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria e Financave, Ministria e Integrimeve Evropiane, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me *acquis communautaire*. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë të Republikës së Kosovës, me qëllim të plotësimit të kriterëve për liberalizim të vizave, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji.

Të them se ky është edhe një amendamentim dhe inkorporim i rekomandimeve, që kanë ardhur nga Komisioni Evropian për proces të liberalizimit të vizave. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri, Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për të huajt është analizuar në Komision është aprovuar pas shqyrtimit që i kemi bërë dhe tani shkojmë në përpunim të ligjit, në mënyrë që të kalojë në leximin e dytë në seancën pasuese. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për Kabinetin,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar ligjin në fjalë dhe duke marrë parasysh fushën që rregullon ky ligj, duke marrë parasysh që rregullon edhe në dimension të ri tani në shtetin tonë në shtetin tonë në aplikimin e vizave dhe krijimin e sistemit informativ të vizave, si dhe hyrjen, qarkullimin, qasjen, largimin për të huaj dhe mënyrën e punësimit dhe pajisjen me dokumente për të huaj edhe Grupi Parlamentar ia jep vizën për të kaluar në lexim të dytë dhe do të japim kontributin tonë gjatë punës në Komision.

KRYETARI: Në emër Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike e ka fjalën deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Përshendetje për kolegët deputetë dhe Kabinetin qeveritar!

Hapësira kohore ka qenë shumë e shkurtër për t'i shqyrtuar këto projektligj në mënyrë të detajuar, sepse e dimë se si kanë ardhur dhe si u shmangëm prej Rregullores për t'i votuar tani, mirëpo si Grup Parlamentar i LDK-së do ta japim votën për t'u miratuar ky projektligj dhe për të vazhduar më tutje në komisione për tu shqyrtuar në mënyrë më të detajueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit "Vetëvendosje" e ka fjalën deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Sjellja e një grupi projektligjesh me emergjencë të tillë në Kuvendin e Kosovës ka krijuar një jo efikasitet edhe të njerëzve të përfshirë në këtë rast edhe të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për shkak se të hënën kanë ardhur këto projektligje në Komision, në të njëjtën ditë kur është mbajtur edhe shqyrtimi i këtyre projektligjeve.

Njëkohësisht, ne do të donim që ta japim kontributin tonë në analizimin real, në analizimin e hollësishëm të këtyre projektligjeve, duke i vlerësuar si projektligje të rëndësishme dhe po ashtu procesin e liberalizimit të vizave duke e vlerësuar si proces i rëndësishëm për Kosovën. Por, asnjëri nga ne nuk ka mundur as nuk ka pasur kohën e mjaftueshme që t'i analizojë, t'i përpunojë dhe t'i rekomandojë ndryshimet e mundshme në këto projektligje.

Pra, vetvetiu vjen një pyetje, pse me kaq emergjencë dhe ne nuk e kemi kuptuar pse me kaq emergjencë sillen këto projektligje në Kuvendin e Kosovës, respektivisht për t'u proceduar përmes Komisionit në seancë?

Dhe, nëse paskan qenë kaq emergjente, pse nuk janë sjell më herët këto projektligje, por edhe nëse kanë ardhur tani nuk e kuptojmë akoma pse duhet me kaq nguti dhe kaq emergjencë ne t'i procedojmë këto projektligje? Do të donim që vërtet përgjigjen pozitive ta prisnim në shtator, për liberalizimin e vizave, por duket që nuk e kemi në shtator përgjigjen për liberalizimin e vizave, që ne të ngutemi kaq shpejt e shpejt. Dhe, nuk do të duhej që puna e Kuvendit të përputhej me vizita të ndryshme. Edhe procedimi i projektligjit të përputhej me vizita të ndryshme dhe ne t'i raportojmë dikujt, që "ja e bëmë këtë një ditë para se të vish ti apo në të njëjtën ditë kur të vish ti", për shkak se me duket që ky iu ka përshtatur edhe vizitës së mirëpritur të zotit Stefan Fyle sot këtu.

Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që ne nuk duam të kontribuojmë, ne duam të kontribuojmë shumë në procesin e liberalizimit të vizave, vetëm se kjo nguti neve nuk na krijon komoditet që të kontribuojmë për liberalizimin e vizave dhe nuk do të duhej asnjëherë të ishim lojtarë të tillë me paketa ligjesh të ardhura në Kuvendin e Kosovës, për shkak se Kosova dhe Kuvendi i Kosovës ka kohë, pra ka kohën e mjaftueshme në të ardhmen e

shpejt, që t'i procedojë në mënyrë të rregullt dhe në procedura të rregullta këto projektligje.

Prandaj, ne votuam kundër edhe shmangies së Rregullores, ne votuam kundër edhe sjelljes së kësaj pike, jo pse votuam kundër këtyre projektligjeve, por për shkak se ne mendojmë që procedurat e rregullta do ta bënë punën tonë shumë më të shëndoshë për procedimin e këtyre projektligjeve.

Ne përderisa për të qenë parimor, ne na duhet të përmbahemi nga vota jonë, për procedimin e shpejtë, jo për ligjin por për procedimin e shpejt të këtyre projektligjeve, prandaj Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do kohë të mjaftueshme, që të japë kontributin e saj.

Normalisht, në aspektin hipotetik nëse kalon ky leximin e parë, ne do të japim kontributin tonë në mes dy leximeve, por procedura e shpejtë nuk e bën që ne të japim kontributin tonë të mjaftueshëm në këto ligje.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Aleanca ka votuar edhe për shmangie dhe do të flas për të gjitha ligjet, disa fjalë t'i them. Do t'i votojë edhe ligjet në lexim të parë dhe do të provojmë që të punojmë sa më shumë që të jetë e mundur në mes të leximit të parë dhe të dytë, do të thotë nëpër komisione.

Sidoqoftë, duhet thënë disa fjalë për të gjitha këto projektligje. Mendoj se problem është koha e sjelljes. U përmend këtu edhe nga disa deputetë tjerë dhe çështja ka të bëjë me atë se nuk po mbërrin Qeveria e Kosovës, që të planifikojë që të mos ketë nevojë që të bëjmë shmangie. Të mos harrojmë se nëse Kuvendi shpesh bën shmangie për kalim të ligjeve e shpenzon njëfarë krediti të vet që e ka. Do të thotë shmangia shndërrohet në diçka normale, e që nuk duhet të jetë rasti, do të thotë nuk duhet të ndodhë që të na ndodhin shmangiet kësisoj.

Në bazë të asaj që ne e dimë, është se ligjet kanë qëndruar në Qeveri të Kosovës për një kohë, do të thotë nuk kanë ardhur më herët.

Çështja tjetër është se është e qartë se është mirë që Kuvendi po i procedon këto projektligje dhe është mirë që ka një bashkërendim në mes forcave politike dhe është mirë që Kosova nuk po shkon rrugës së disa vendeve të tjera në rajon, kur proceset e mëdha bllokohen për shkak të luftës politike. Por, po them se në Qeverinë e Kosovës duhet të ketë kujdes, që të mos e shndërrojmë shmangien në normë në Kuvendin e Kosovës, për shkak se nuk ka nevojë.

Çështja tjetër është, se është tepër e qartë prapë se ligjet e këtyre llojeve edhe vendet tjera i harmonizojnë me Komisionin Evropian dhe gjithmonë ka afate, është prapë e vërtetë, mirëpo mua po më duket se miratimi i këtyre ligjeve i cili po duket se do të ndodhë dhe ne do t'i votojmë, duhet thënë qartë se nuk do të sjellë liberalizim të vizave as në shtator,

as në tetor, për shkak se kur po i rrisim pritjet te qytetarët e Kosovës, atëherë edhe zhgënjimi po është më i madh.

Ma merr mendja që duhet treguar se edhe pse i kalojmë këto ligje, nuk do të ketë liberalizim shpejt, është gabim për t' i rritur pritjet. Dhe, rritja e pritjeve për shkak të zgjedhjeve është diçka që mund t' i kushtojë Kosovës. Mendoj se duhet pikësëpari Qeveria të tregojë qartë se me kalimin e këtyre ligjeve nuk do të ketë diçka të jashtëzakonshme për shkak se nëse bëhet për zgjedhje kjo, nëse vetëm për zgjedhje rriten pritjet, po ju garantoj se zhgënjimi do të jetë tepër i madh dhe kjo gjithmonë po na kushton si vend, po na mbushen autobusët mandej për vende tjera. Edhe kjo është një prej arsyeve pse mbushen autobusët. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, Kabinetin qeveritar!

Përshëndetje për deputetët!

Duke marrë parasysh se sot kemi në lexim të parë tetë projektligje, të cilat besoj dhe shpresoj se do të gjejnë zbatueshmërinë, ne si Koalicion për Kosovë të Re dhamë edhe mendimin tonë që të kemi shmangie nga rendi i ditës dhe kemi shqyrtuar Projektligjin për të huajt, duke marrë parasysh se të gjitha vendet e rajonit bashkëpunojnë me Komisionin Evropian për çështjen e projektligjeve dhe çështjen e liberalizimit të vizave. Mirëpo, në efekt ne do t' i japim mbështetje këtij projektligji dhe ministrit në zbatueshmëri të këtij projektligji për të huajt, mirëpo në efekt kemi shumë punë deri te çështja e liberalizimit të vizave.

Shpresoj që ky ligj në bazë të vlerësimit të ndikimit financiar, thotë se Projektligji për të huajt krijon obligime buxhetore, por njëherit krijon të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në efekt, ne e përkrahim projektligjin edhe njëherë potencoj, mirëpo shpresojmë që ky projektligj të gjejë zbatueshmëri në praktikë dhe të kemi një mundësi më të mirë, ndoshta edhe për qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka kryetari Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani članovi vlade,

Kolege,

I poslanički klub Samostalne liberalne stranke razmatrao je ovaj zakon i kad uzmemo u obzir važnost ovog zakona, mi ćemo danas glasati za ovaj zakon u načelu, a kroz adekvatne komisije ćemo dati svoj doprinos da i u drugom čitanju usvojimo ovaj zakon da svi građani Kosova budu zadovoljni usvajanjem ovog zakona. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, nënkryetari Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedniče!

I Parlamentarna grupa “6+” smatra da je ovaj nacrt-zakona jako bitan za samu državu, tako da će Parlamentarna grupa “6+” podržati i glasati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Zajednička Budućnost, Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predesdniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” je razmatrala Nacrt zakona, s obzirom da se radi o veoma bitnom i značajnom zakonu mi ćemo ovaj zakon podržati, jer omogućava ubrzan proces liberalizacije viza. Zahvaljujem!

KRYETARI: Një sqarim po dëshirën ta bëjë ministrja e Integrimeve, Vlora Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

Zoti kryeministër,

Shumë të respektuar deputetë,

Vetëm një sqarim për të gjithë deputetët që ngritën si shqetësim shmangien nga Rregullorja dhe mungesën e planifikimit adekuat nga ana e strategjisë për këto projektligje.

Ju e dini, që në shkurt Komisioni Evropian pat publikuar raportin e parë mbi përmbushjen e kriterëve të udhërrëfyesit. Dhe, Qeveria e Republikës së Kosovës, në fund të muajit shkurt ka pranuar nga Komisioni Evropian listën e ligjeve që duhet ndryshuar në mënyrë që të përmbushet pakoja legislative e domosdoshme për procesin e liberalizimit të vizave.

Qeveria e Republikës së Kosovës, qysh në muajin mars ia ka dorëzuar Komisionit Evropian ligjet e amendamentuara. Pra, këtu bëhet fjalë për plotësim-ndryshme dhe është vetëm një ligj i ri që i vjen Kuvendit të Kosovës dhe këto ligje kanë qëndruar deri më 1 korrik në Bruksel.

Pra, nuk ka qenë mungesë planifikimi nga ana jonë, por thjesht shqyrtimi i tyre në Bruksel ka marrë shumë më shumë kohë, seç kemi pritur ne. Menjëherë, pasi kemi pranuar rekomandimet e Komisionit Evropian, ne i kemi kaluar ligjet në Qeveri dhe i kemi sjell në Kuvendin e Kosovës.

Po e ri përsëris edhe ne do të dëshironim që këto ligje të kishin ardhur në muajin maj apo prill në Kuvend, mirëpo shqyrtimi i tyre në Komisionin Evropian ka marrë më shumë kohë seç është dashur dhe po ashtu, plotësimi i pakos legislative nuk nënkupton përmbushjen e të gjitha kriterëve për liberalizimin e vizave, ka ende shumë kriterë të cilat ne duhet t'i përmbushim, por me këto ligje ne përmbushim atë që quhet pako legislative. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e deputetëve. Po, deputetët s'janë paraqitur për diskutim.

Vazhdojmë me votimin në parim të projektligjit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! Prania fizike është 80 deputetë, me elektronikë 96.

Konstatoj se me 61 vota për, 2 kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për të huajt.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Kuptohet, afati është i përsheptuar.

Vazhdojmë me projektligjin e dytë:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azilin

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Fjalën e ka ministri Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Parlamentit!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për azil, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për azil është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Hartimi i këtij projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, azilantëve, si dhe të personave, të cilëve u është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga

Ministria e Integrimit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me 'acquis communautaire'.

Të nderuar,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji.

Dhe, vetëm një sqarim. Edhe ky është një projektligj, meqë kemi pasur ligjin ekzistues dhe janë inkorporuar rekomandimet e dala nga Komisioni Evropian dhe meqenëse ministrja e Integrimeve Evropiane e bëri shpjegimin, ndiej obligim që në momentin kur kanë ardhur rekomandimet nga 1 korriku, Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti Ligjor, grupet punuese që kanë qenë të formuara më parë, me punë shtesë edhe gjatë vikendit, për 4-5 ditë, i ka inkorporuar të gjitha këto. Prandaj, te ne nuk kanë qëndruar gjatë dhe janë proceduar menjëherë në Qeveri. Pra, gjithë vonesa ka qenë për shkak se janë pritur gjatë nga Komisioni Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për azilin sikur edhe ligjet tjera të cilat janë ofruar në komision për t'u shqyrtuar në lexim të parë, i ka dhënë vizën, në mënyrë që të kemi sa më shpejt përmbyshje të kërkesave për liberalizimin e vizave dhe për ta standardizuar funksionimin institucional të vendit.

Por, konsideroj se kjo ngutje mund të shkaktojë edhe probleme, të cilat edhe në të kaluarën janë të evidentuara, sepse para se të kërkojmë që të kemi projektligje me masivitet, ne duhet më shumë duhet të përkushtohemi që të kemi projektligje të rregulluara me cilësi.

Prandaj, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim e përkrahim Projektligjin për azilin.

(Drejtim e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Deklaratat e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Për PDK-në, deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për azilin dhe e mbështet fuqishëm, prandaj i ftoj edhe deputetë të tjerë që ta votojnë këtë projektligj, që pastaj ta japim kontributin tonë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e LDK-së, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të pranishmit,

Projektligjin për azil e kemi shqyrtuar në atë mënyrë siç e prezantova edhe ligjin e mëhershëm. Mirëpo, nuk do të doja të hyja në detaje, sepse nuk hyra as në projektligjin e parë, por më nxiti reagimi i ministres dhe sjellja e këtyre ligjeve në mënyrë të përshtatshme në komision dhe në seancë si projektligje që duhet të miratohen si nevojë për ta shpejtuar procesin e liberalizimit të vizave.

Ky proces është i premtuar nga kryeministri shumë herët, bile edhe me data të caktuara kohore, apo periudha të caktuara kohore, ai 15-mujori famoz që ishte para 2-3 vjetëve. Ndoshta zonja Çitaku vazhdimisht nëpër media thotë se ‘ju garantoj, qytetarë të nderuar, ju siguroj qytetarë të nderuar se do të lëvizim lirshëm në Evropë në periudha të caktuara kohore’. Më duket që jeni vetëdijësuar edhe më nuk po përmendni data të caktuara, sepse ky proces po shihet që nuk është as afër finalizimit.

Sidoqoftë, projektligji në fjalë ka kosto shtesë buxhetore dhe thuhet në opinionin e Departamentit të Buxhetit se Ministria e Punëve të Brendshme duhet të bëjë kursime në buxhetin e saj, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet e implementimit, apo të ekzekutimit të këtij projektligji.

Andaj, zoti ministër, gati të gjitha këto projektligje jua ngarkojnë juve, ministrisë, kursimet dhe duhet të keni kujdes në shpenzimin e parasë që është përcaktuar për ministrinë tuaj.

Ne si Grup Parlamentar do ta përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Për grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nëse jemi vonuar, e unë e pranoj që jemi vonuar edhe për shkaqe dhe arsye edhe të Brukselit, dakord, por nuk e kemi të ditur nëse jemi vonë, nëse jemi vonuar, cila është arsyeja për t’u ngutur tani për shkak se vërtet nuk e kemi një prag - datë, që ne duhet patjetër t’i kalojmë këto ligje dhe t’i përmbahemi asaj agjende të shpejtë të procesit të liberalizimit të vizave. Mua do të më vinte mirë të ishte kështu.

Por, edhe një herë po përsëris se ngutja kaq e madhe nuk i bën këto ligje më të mira të mundshme. Ne duam që këto ligje t’i kemi më së miri të përpunuara, të trajtuara dhe të procedohen në Kuvend, por kjo nguti nuk e garanton në gjë të tillë.

Shumica e këtyre ligjeve, siç kanë ardhur këtu, kanë kaluar ose janë miratuar në këtë legjislaturë, brenda kësaj legjislature, dhe këto ligje i kemi kaluar ne të njëjtët deputetë në dy vjetët e kaluara, shumicën, madje shumë prej tyre edhe më të rëndësishme.

Njëkohësisht ka pasur edhe Komision, Komisioni për Integritet dhe Komisioni për harmonizimin e Ligjeve në Bashkimin Evropian nuk ka bërë vërejtje çfarë po bëjmë tani.

Edhe një herë e themi se një riciklim i tillë kaq i shpejtë i këtyre projektligjeve, një sjellje kaq e shpejtë e këtyre projektligjeve në procedura të shpejta, me tejkalim dhe me shmangie të procedurave nuk mendoj që ne na bën ta japim kontributin tonë më të mirë. Ne duam të kontribuojmë dhe vërtet këto ligje, pasi e kanë një ndjeshmëri të tillë, të jenë më së mirë të përpunuara, e një gjë të tillë nuk e garanton kjo procedurë. Jo këta njerëz, jo këto komisione, por procedura nuk e garanton një gjë të tillë dhe sikur në ligjin paraprak, edhe në këtë ligj ne do të donim të kemi kohë më të mirë që të jemi të bindur, që të dimë se çka po votojmë, çka po përsheptomë dhe çka po riciklojmë edhe një herë në Kuvendin e Kosovës, gjë që nuk do të duhej të ishte praktikë e mirë.

E dimë që këtë praktikë e ka sjellë plani i Ahtisarit kur ka ardhur edhe në legjislatura tjera, por nuk është praktikë e mirë që do të duhej ta aprovonim për agjenda, qoftë në këtë rast edhe politike, ndoshta edhe të tjera. Nuk e di pse.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi! Për Koalicionin Kosova e Re, shefja e Grupit, Myzeje Selmani e ka fjalën.

MYZEJE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!
Edhe Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për azil dhe duke pasur parasysh se ne duhet t'i japim mbështetje kësaj pakoje të projektligjeve, besojmë dhe shpresojmë shumë që gjatë amendamentimit për çdo mungesë që ka mundur të jetë gjatë draftimit të projektligjit të kalohet.

Në parim, e përkrahim projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Selmani! Për Grupin SLS, deputeti Sasha Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala predjedavajući!
I Zakon o azilu je razmatrala Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke, i mi ćemo i ovaj Zakon podržati u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predjedavajući!
I Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je Nacrt zakona o azilu i glasaćemo za njega. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin ‘ZB’, Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” razmatrala je Nacrt zakona o azilu. Svesni smo da je ovo zakon kao deo paketa zakona, za koji smo

čuli objašnjenje od ministara. Kroz rad u komisijama mi ćemo dati doprinos na poboljšanju ovog Zakona. Na ovom čitanju mi ćemo ga podržati. Zahvaljujem.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi deputetë të tjerë që duan të flasin për shqyrtimin e parë në parim të Projektligjit për aliz.

Ju njoftoj që në sallë janë 63 deputetë.

Kërkoj nga teknika dhe deputetët të bëhen gati për votim. E votojmë në parim këtë projektligj. Votojmë tash!

Konstatoj se me 51 vota për, 2 kundër dhe 9 abstenime, Kuvendi e miratoi Projektligjin për azil në shqyrtimin e parë në parim. Faleminderit!

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në ligjin e tretë:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shtetësinë e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin.

Fjalën e ka ministri i Brendshëm, Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit, Kryeministër, Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë, Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për shtetësinë e Kosovës, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për shtetësinë e Kosovës është hartuar duke u bazuar në parimin dhe programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Hartimi i këtij projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Arsyet për hartimin e këtij projektligji janë se me këtë ligj përcaktohen mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullohen çështjet tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integritetit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me ‘acquis communautaire’.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin e këtij projektligji në parim.

Edhe ky është një ligj që ka qenë ekzistues dhe i kemi inkorporuar rekomandimet e ardhura nga Komisioni Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Projektligjin për shtetësinë e Kosovës Komisioni e ka shqyrtuar në parim dhe ia ka dhënë vizën që të përpunohet në mënyrë që të kalojë edhe në leximin e dytë.

Po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Isufi! Deklarimet e grupeve parlamentare. Për Grupin e PDK-së, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Besoj që shumica e këtyre ligjeve kanë ekzistuar, mirëpo janë duke u bërë inkorporimet e direktivave të Komisionit Evropian, edhe të kodit të Shengenit, një grup ligjesh këto që e rregullojnë një dimension të caktuar, dimensionin pikërisht të problematikave të kufirit dhe mënyrës së qarkullimit të qytetarëve përgjatë kufirit, në kufi e andej.

Këto ligje ne jemi duke i aprovuar për interes dhe të mirë të Kosovës se Komisioni Evropian edhe Bashkimi Evropian nuk kanë ndonjë farë interesi prej këtyre.

Edhe Ligji për shtetësinë është një ligj që me inkorporimet e propozimeve prej Komisionit Evropian besoj që e merr formën e një ligji, që nuk bie ndesh me ligjet tjera dhe e rregullon në mënyrë harmonike këtë fushëlëmi, duke i marrë për bazë edhe ligjet tjera.

Andaj, Grupi Parlamentar i partisë sonë propozon që ta votojmë në parim dhe kontributin do ta japim në punën e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Zoti kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pasi me këtë ligj përcaktohen mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Kosovës dhe rregullohen çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës, ne grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim projektligjin në parim dhe do të vazhdojmë ta japim kontributin deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Quni. Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Natyrisht që në këtë situatë për të cilën folën disa deputetë, pra të shmangies së Rregullores dhe të kohës së pamjaftueshme për trajtimin e ligjeve, është vështirë të flasim për ligjet të cilat po i trajtojmë. U pa edhe këtu që shumë pak deputetë madje po flasin për ligjet, ose po thonë që po do ta miratojmë për shkak se është në interes të Kosovës, ose po thonë që nuk e kemi lexuar fare.

Kjo është e qartë që ky Kuvend në këtë rast është disi i shndërruar në një makinë votash, e jo në Kuvend të mirëfilltë që trajton ligje dhe i diskuton ato.

Pra, po ligjet, mbase janë edhe në interes të Kosovës, mirëpo përmbajtja e ligjeve po ashtu duhet shqyrtuar me shumë kujdes, sepse forma e ligjit mund të jetë në interes, por përmbajtja mund të mos të jetë në interes. Kjo është shumë e rëndësishme që ta kemi si mundësi ne si Kuvend t’i diskutojmë këto çështje.

Por, këtu e kemi një rast eklatant të asaj të një çështjeje që është ngritur nga disa teoricienë që i analizojnë marrëdhëniet ndërmjet një vendi që aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, ta zëmë, dhe institucioneve të Bashkimit Evropian.

Pra, në vend se debati politik të bëhet i brendshëm, ndërmjet qytetarëve, përfaqësuesve të qytetarëve dhe Ekzekutivit, debati përjashtohet. Pra, politika bëhet e jashtme, sepse shndërrohet në debat ndërmjet institucioneve, Ekzekutivit në këtë rast, dhe Bashkimit Evropian, dhe është rast i anashkalimit apo zhvendosjes së debatit diku jashtë, e jo brenda Kosovës, dhe në Kosovë pastaj vjen ky debat i kodifikuar në ligje, si një çështje e kryer. Pra, thuhet që jemi marrë vesh me Komisionin Evropian dhe tash kjo, pak a shumë, i lë pamundësi Kuvendit që t’i ndryshojë këto ligje, sepse qenkan marrë vesh diku jashtë. Pra,

është e njëjtë me atë që na është thënë për dialogun me Serbinë, vetëm se këtu është për çështje tjera.

Dhe, është rast eklatant, pra i përbrendësimit të jashtësisë, i një politike të jashtme që bëhet politikë e brendshme e Kosovës, dhe e tërë kjo nën vallon e interesit të qytetarëve dhe interesit të Kosovës, në përgjithësi.

Është e qartë që këto po bëhen edhe për shkak se po vjen Fule sot, dhe mendoj që nuk ka nevojë askush të na thotë që nuk është ashtu. Sepse, këto ligje po i konvenojnë Qeverisë një farë mënyre, ose miratimi i këtyre ligjeve, që thotë 'ja jemi duke përparuar edhe ne në procesin e liberalizimit të vizave, sepse i miratuam këto ligje të cilat i kemi dakorduar me Komisionin Evropian'. Pra, është njëlloj maskimi i gjendjes së mjerë që po ndodh në Kosovë, ose tentim maskimi.

Njëjtë sikur viteve të '70-ta dhe të '80-ta, kur planifikohej vizita e kryetarit të atëhershëm të Jugosllavisë, Tito, në Kosovë, që i maskonim me disa lule nëpër ballkone dhe kur detyroheshin institucionet e atëhershme të vendosin tepihë të kuq për të treguar sesi edhe Kosova paska përparuar. E njëjta gjë është edhe këtu, veç tani nuk po vendosim tepihë të kuq, sepse ata i kemi përherë, por po vendosim ligje që e maskojnë këtë gjendje.

I tërë procesi i liberalizimit të vizave dhe procesi madhor përmbi të, pra i integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, është shndërruar nga kjo Qeveri nëpërmjet retorikës politike që e përdor kjo në mitë. Pra, i ka dy elemente shumë të rëndësishme, që i ka miti. Në njërin anë thuhet që nuk ka alternativë dhe miti është pikërisht ai që nuk ka alternativë.

Por, nuk ka një të vërtetë tjetër që e konteston mitin. Miti është mit për shkak se është e vërteta absolute, e pakontestuar. Pra, që nuk e ka, si të them, antitezën e vet, në mënyrë që ta vlerësojë vërtetësinë e mitit. Edhe këtu ky proces pikërisht ashtu po trajtohet nga Qeveria e Kosovës dhe kryesisht nga diskursi politik që e kemi në jetën publike në Kosovë.

Dhe, në anën tjetër, është shndërruar në një premtim religjioz për botën e përtejme. Pra, e keni vërejtur që sa herë ngremë tema për gjendjen ekonomike të qytetarëve të Kosovës, gjendjen sociale dhe mjerimin social që e ka kapluar vendin, Qeveria e Kosovës fillon të flasë për liberalizimin e vizave dhe për rrugëtimin e sigurt dhe të pakontestuar të Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Pra, thuhet që sa më shumë të heqim në këtë botë, më të mirë do të jemi dhe më shumë do të kemi përfitime në botën tjetër, që është bota e përtejme, bota e BE-së.

Pra, BE-ja na është shndërruar në zëvendësim për nevojat edhe të drejtat që duhet t'i kemi sot, dhe kjo mënyrë e trajtimit të këtij procesi të skajshëm politik, që është proces i cili drejtohet nga interesat, në mënyrë religjioze vetëm sa e vështirëson procesin si të tillë.

Pra, kur thotë ministrja Çitaku që nuk do të ndodhë këtë apo atë muaj, ajo pa harron që thotë që me këtë proces dhe me këtë mënyrë qysh e trajton Qeveria e Kosovës këtë proces nuk do të ndodhë kurrë. Jo që nuk do të ndodhë pas 2-3 muajve, se atë e dinë të gjithë, por nuk do të ndodhë kurrë.

Dhe, rrjedhimisht, kjo nguti e trajtimit dhe miratimit të këtyre ligjeve është vetëm e vetëm sa për t'ia dhënë edhe një shpresë, një iluzion qytetarit të Kosovës se e nesërmja do të jetë më e mirë, e nesërmja kur të vdesim, pra kur të shkojmë në Bashkimin Evropian.

Po ashtu, ministrja Çitaku tha që gjendja ekonomike është shkaku. Pra, qenka e vetëdijshme Qeveria, dhe besoj që është vetëdijshme natyrisht, që gjendja ekonomike na qenka shkaku, e azili është pasojë, pra që azili nuk është shkak.

Mirëpo, këtu u harrua të thuhet edhe një gjë. Është edhe një mënyrë e trajtimit të gjendjes ekonomike si një lloj miti, si një lloj e dhëne natyrore, e cila na ka ardhur kështu dhe të cilën nuk mund ta ndryshojmë. Pra, nuk mund të thuhet që gjendja ekonomike është shkak, për shkak se edhe gjendja ekonomike e ka një shkak. E ku është ky shkaku, kjo është gjendja më e rëndësishme, e shkaku natyrisht është te politikat ekonomike të kësaj Qeverie, të cilat po e fundosin Kosovën në aspektin ekonomik, politik, social e të tjera. Pra, shkaku nuk është gjendja ekonomike, sepse gjendja ekonomike shkaktohet nga dështimet e kësaj Qeverie, apo nga politikat e gabuara të kësaj Qeverie që e ka sjellë popullin e Kosovës në këtë gjendje, të cilit i premtohet liberalizimi i vizave.

Edhe një gjë, mendoj se duhet të jenë shumë të sinqertët përfaqësuesit e Ekzekutivit, e veçanërisht zonja Çitaku, meqenëse është bartëse e këtij procesi, pra të liberalizimi i vizave. T'u tregohet qytetarëve të Kosovës se edhe me liberalizim të vizave, të nesërmen e liberalizimit të vizave, pra të nesërmen e vdekjes dhe botës së përtejme, gjendja nuk do të jetë më e mirë ekonomikisht. Edhe liberalizimi i vizave nuk garanton punësim në Evropë dhe kjo duhet të jetë shumë qartë e thënë për shkak se po përdoret për ta kamufluar këtë të vërtetë.

Dhe, po ashtu një e vërtetë tjetër, të gjithë e dimë që Bashkimi Evropian është duke e trajtuar seriozisht mundësinë e heqjes së liberalizimit të vizave për disa vende të rajonit, të cilat e kanë fituar këtë para dy dhe para tre vjetëve.

Dhe, në këtë kohë, kur po vihen në diskutim vendet të cilat tashmë i kanë vizat e liberalizuara, Qeveria e Kosovës u premtun për çdo ditë qytetarëve të Kosovës se do të ketë liberalizim të vizave shumë shpejt.

Pra, mendoj që sinqeriteti me qytetarët e Kosovës do të ishte minimumi etik politik i kësaj Qeverie, të cilën kjo nuk po mund ta realizojë dot. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e morëm pëlqimin. Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovën e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për shtetësinë e Kosovës. Konsiderojmë se është projektligj i rëndësisë së veçantë, sepse ka të bëjë me fitimin, humbjen dhe rifitimin e shtetësisë.

Andaj të njëjtin e përkrahim dhe do ta japim kontributin deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit SLS, deputeti Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslani članovi vlade,

Dragi kolege,

I ovaj Zakon za državljanstvu, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala. Mi smatramo da je ovaj Zakon veoma važan za Srpsku zajednicu, tako da ćemo posebno obratiti pažnju na ovaj Zakon i dati svoj maksimalni doprinos u odgovarajućim komisijama između dva čitanja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin ‘ZB’, Milivoje Stojanoviq e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” je razmatrala Nacrt zakona o državljanstvu. Svesni smo značaj ovog zakona. Kao i ostale poslaničke grupe, podržaćemo ovaj Nacrt zakona na ovom čitanju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

S obzirom da se radi o jednom jakom važnom zakonu, i Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je ovaj Nacrt zakona o državljanstvu, tako da ćemo podržati i glasati ovaj Zakon i daćemo svoj doprinos na drugo čitanje. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Tash fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, ndërsa i ftoj deputetët të hyjnë në sallë.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Zoti kryeministër,

Natyrish, si të gjithë deputetët tjerë, e përshëndes progresin relacionin me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e konsideroj një rëndësie të veçantë dhe e mbështes çdo përpjekje në këtë funksion.

Po kjo na vë edhe para një obligimi që s'do duhej trajtuar vetëm si kusht për t'u afruar me Evropën, e për t'u bërë pjesë e saj, por edhe si një nevojë jona imanente e procesit demokratizimit dhe e evropianizimit. Sa herë instrumentalizojmë, mendoj që e dëmtojmë këtë proces.

Kjo nënkupton edhe një funksionim demokratik të institucioneve, veçanërisht të Parlamentit të Kosovës, dhe në këtë kuadër edhe në ligjvënien, që është veprimtaria kryesore e këtij trupi.

Na duhen ligjet që janë sjellë dhe unë në parim i mbështes. Na duhet edhe harmonizimi më i mirë i legjislacionit tonë me 'acquis communautaire', me standardet evropiane dhe natyrish që e mbështes. Por, a po e bëjmë gjithmonë ashtu siç duhet? Mendoj se këtu duhet ndalemi pak.

Funksionimi demokratik nënkupton edhe shqyrtimin, madje përpara kësaj hartimin e duhur të ligjeve dhe hartimin duke e angazhuar përvojën potenciale që e kemi, dhe relacionin e duhur ndërmjet institucioneve. Kjo po na mungon në vazhdimësi.

Për më tepër, siç e thanë edhe parafolësit, është bërë praktikë që të gjitha ligjet që janë të kësaj rëndësie të kalohen në një procedurë paradoksalisht të lëndueshme demokratike. Me procedurë të përshpejtuar, pa pasur nevojë, me shmangie të procedurave, pa pasur nevojë, dhe pikërisht këto ligje që do të duhej të na disiplinonin në qasjen tonë institucionale, e kanë prodhuar një fenomen të relativizmit të procedurave në Kuvend, jo vetëm për këtë grup të ligjeve, por në përgjithësi në ligjvënien dhe në veprimtarinë e Kuvendit.

Pse e bëjmë këtë? Mendoj që duhet ta ndalojmë. Ka këtu nga pak politikë dhe kjo lëndon. Nëse krijohet përshtypja se ky Kuvend nuk është i pjekur sa duhet për të kaluar diçka që i duhet vendit dhe duhet tash me marifete, me do farë akrobacish të bëhet, kjo më së pari nuk është e vërtetë, e dyta, edhe po të jetë e vërtetë, s'është korrekte.

Prandaj, angazhohem që në të ardhmen të respektohen procedurat, të krijohet mundësia e qasjes aktive, kreative, produktive të deputetëve dhe të atyre që i përfaqësojnë. Kanë edhe ata çka thonë.

Kurse në të vërtetë ligjet që i kemi përpara janë punuar mirë. Në parim mendoj që mund të kalohen, por kanë lëshime të shumta, zonja e zotërinj. Nuk do të ishte mirë t'i kalojmë se 'janë nën rrogosin e një farë statusi të veçantë, diplomatik, po na vëzhgojnë miqtë, prandaj, o burra, le të mos ketë diskutim'. Mendoj që kjo duhet të braktisur njëherë e përgjithmonë.

Për shembull, po marr diçka që është elementare. Ne e kemi bërë një standard këtu si bëhen ligjet. Nuk u janë përmbajtur gjithmonë këtij standardi. Pse këto duhen të jenë përjashtim? Kemi thënë, për shembull, diçka që është edhe shumë formale, që gjuhët të jenë të njëjta. Pse duhet të jetë në një gjuhë një kuptim tjetër, në një gjuhë tjetër?

Për shembull, kemi thënë që në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën serbe, te përkufizimet të hiqet shprehja ‘nënkuptohet’ (podrazumeva). Nuk ka në ligje nënkuptime, por ka kuptime. Në anglisht është mirë, pse të mos jetë edhe në shqip dhe pse të mos i korrigjojmë këto, zonja e zotërinj.

Edhe Ligji për shtetësinë, ku desha të ndalem pak më shumë, ka vërejtje të shumta të këtilla, duke përfshirë edhe këto që i thashë.

Për shembull, te përkufizimet, anëtari i familjes thuhet e ka kuptimin ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për azil. Çka do të thotë kjo? Një ligj përkufizimin e bën në bazë të një përkufizimi që e ka bërë një ligj tjetër, i cili s’ka të bëjë me familjen. Jo Ligji për familjen, po Ligji për azilin, dhe tash gjykatësi, deputeti duhet ta gjejë atë ligj për të parë çka është menduar dhe kur ta gjejë do ta shohë që nuk është e saktë. Dhe, shembuj të tillë ka shumë.

Por, janë edhe disa çështje që mendoj se duhen rishikuar, sidomos rreth kriterëve për shtetësinë, që janë liberalizuar së tepërmi. Është ndoshta në përputhje me konceptin tonë për shtetësinë e Kosovës, është shumë e brishtë, shumë e papeshë disi, shumë joserioze, dhe procesi i shtetësisë po trajtohet në këtë mënyrë. Mendoj që duhet konsoliduar. Ose, ka kriterë dhe pastaj ka dispozita që i relativizojnë, i përjashtojnë ato, dhe kjo krijon mundësi abuzimi. Mendoj që kjo nuk duhet lejuar.

Por, veçanërisht, për mendimin tim, do të duhej ndalur, zonja dhe zotërinj, te neni 32, te regjistrimi i përcaktimit të shtetësisë, i cili thekson tekstualisht: “Gjithë personat, të cilët më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës, konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë”. Ne e kemi pasur këtë histori edhe përpara. Por, kemi pasur disa rrethana që kanë detyruar ndoshta që edhe t’i gëlltitet diçka që nuk do të duhej gëlltitur.

Por, gjithmonë është shtruar pyetja dhe kurrë nuk është marrë përgjigjja e duhur, e pse pikërisht 1 janar 1998? Pse ta zëmë jo një periudhë, një datë e mëhershme, kur ka pasur shumë të dëbuar nga Kosova që e kanë dëmtuar pozicionin e tyre qytetar karshi vendit të tyre, Kosovës. Kurse pikërisht në atë periudhë kemi pasur edhe flukse kolonësh në Kosovë që janë sjellë me qëllime politike e diskriminuese të ndërrimit të strukturës etnike. Nuk jam për qasje restriktive, jam për mirëkuptim ndaj të gjithëve, por duke e përfshirë edhe popullatën shumicë, kurse kjo zakonisht po ndodh që pikërisht në kurriz të saj të bëhen shumë shkelje. Nuk mund të ketë diskriminim mbi baza të tilla.

Ose, në paragrafin 5, të këtij neni: “Organi kompetent i përcakton me akt nënligjor kriteret në bazë të të cilave vërtetohet procedimi i shtetësisë së Republikës Federative të

Jugosllavisë”, dhe kjo bëhet, thuhet në paragrafin vijues, “duke përdorëurkriteret e parapara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13, e të tjera”. Na kthen kjo dispozitë e ligjit përsëri te Rregullorja e vitit 2000, kurse në të vërtetë ky ligj i ndryshon gjitha të tjerat, por në këtë rast i referohet Rregullores së UNMIK-ut. A nuk është non sens, zonja e zotërinj.

Prandaj, për të mos zgjatur më shumë, angazhohem që ligjin ta mbështetim në parim, por ta lexojmë, ta shqyrtojmë, ta korrigjojmë, ta saktësojmë, ta harmonizojmë me standardet evropiane dhe si të tillë ta miratojmë dhe ta bëjmë që të jetë vërtet, jo vetëm deklarativisht, në përputhje me ato që janë fryma dhe shkronja ‘acquis communautaire’. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk ka deputetë të tjerë që e kanë kërkuar fjalën për Projektligjin për shtetësinë e Kosovës në shqyrtim të parë.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për shtetësinë e Kosovës.

Në sallë i kemi 72 deputetë. Ju ftoj që të votojmë për projektligjin. Votojmë tash!

Konstatoj se me 58 vota për, me 10 abstenime dhe asnjë kundër, me shumicë votash pra, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shtetësinë e Kosovës.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë te ligji i katërt:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Fjalën e ka ministri i Brendshëm, Bajram Rexhepi. Urdhëro!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

I vetmi nga kjo pako e 6 ligjeve që i takojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme është projektligji i ri, i cili del edhe nga strategjia për luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Hartimi i këtij projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet ligjore, të cilat janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Arsyet për hartimin e këtij projektligji janë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë ligj të veçantë, i cili e ka rregulluar këtë çështje në Republikën e Kosovës dhe po ashtu edhe në përmbushjen e kriterëve të kërkuar nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave.

Ky projektligj do ta forcojë edhe më tej kornizën aktuale ligjore në këtë fushë dhe njëkohësisht do t'u sigurojë institucioneve përkatëse përgjegjëse ta parandalojmë dhe luftojnë trafikimin me njerëz dhe t'u ofrojmë ndihmë dhe mbrojtje adekuate viktimave të trafikimit me njerëz, në pajtim të plotë me standardet e Bashkimit Evropian.

Për këtë projektligj janë pranuar deklaratat financiare nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integritetit Evropiane, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me 'acquis communautaire'.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë të Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zotëri ministër Rexhepi! E hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji. Fjalën e merr kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së sigurisë të Kosovës, zotëri Ahmet Isufi

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz e kemi shqyrtuar në komision dhe kemi konsideruar se meqë është një projektligj mjaft i ndjeshëm, të bëhet një përpunim sa më i mirë, në mënyrë që edhe vërejtjet dhe sugjerimet që jepen nga deputetët t'i marrin parasysh dhe ta kemi një projektligj të zbatueshëm.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahim projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Isufi!

Tash i kemi deklarinimet e përfaqësuesve ose shefave të grupeve parlamentare. Për Grupin e PDK-së, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Besoj që është potez i qëlluar hartimi i këtij projektligji, ligj ky i cili me siguri do ta ngre kualitetin e koordinimit të aktiviteteve për pjesën parandaluese të luftimit të këtij lloj krimi, por gjithashtu edhe në pjesën ndëshkuese, posaçërisht, dhe luftuese. Gjithashtu ka pasur mangësi në drejtimin e rritjes së kualitetit të përkujdesjes për viktimat e trafikimit dhe besoj se me aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji do të mundësohet ngritja e kualitetit dhe standardeve të jetës dhe përkujdesjes për viktimat e trafikimit, andaj grupi ynë parlamentar në parim është për pro.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta përkrahë në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, sepse e shoh si një ligj shumë të ndjeshëm dhe shumë të rëndësishëm, andaj vota jonë do të jetë për miratim në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetja Krasniqi! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Së paku ky ligj, madje meqë është ligj i ri, nuk është një ligj me plotësim-ndryshim, do të duhej ta kishte kohën e mjaftueshme për ta bërë amendamentimin, për t’i bërë rekomandimet, për ta bërë trajtimin sa më mirë që të jetë e mundur. Por, sidoqoftë, zoti nënkryetar, ju po vëreni që këto ligje po kalojnë ashtu edhe në paketë, por sidoqoftë po kalojnë në një procedurë që së paku do t’u mundësonte deputetëve të debatojnë dhe po e vëreni që asnjëri nga deputetët nuk po debaton.

Nuk po debatojnë për shkak se nuk e kanë lexuar. Nuk e kanë lexuar për shkak se nuk kanë pasur kohë. Prandaj, nëse këta nuk debatojnë, nuk kanë faj. Kështu që, aq më tepër kur ky ligj, siç thashë, është si ligj i ri dhe do të duhej ta kishte kohën e mjaftueshme. Edhe një herë dua ta rikonfirmoj që ne nuk po përmbahemi, nuk po abstenojmë nga përbërja e ligjeve, por po abstenojmë, po përmbahemi nga procedurat e praktikuara padrejtësisht në këtë seancë dhe, normalisht, siç thashë, edhe në ligjin e mëhershëm, nëse ky ligj eventualisht e kalon, e siç po duket do të kalojë, ne do ta japim kontributin tonë nëpër komisione dhe po ashtu Lëvizja “Vetëvendosje” do ta japë kontributin në grupin punues, që e ka përcaktuar tashmë Komisioni për Siguri, Mbikëqyrje të FSK-së dhe Punë të Brendshme. Kështu që edhe kësaj radhe, në këtë projektligj ne përmbahemi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi! AKK-ja e ka dhënë pëlqimin nëpërmjet shefit të Komisionit Funkcional. Për Koalicionin për Kosovën e Re, shefja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. E përgëzoj ministrin për ardhjen e këtij projektligji të ri për arsye se trafikimi i qenieve njerëzore është shkelja e të drejtave themelore të njeriut dhe shpresoj shumë që ky projektligj, së bashku me shumë ministri të tjera, të cilat do të jenë pjesë e implementimit të tij, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, e Kulturës, Rinisë, Sportit, Prokuroria e Kosovës, Gjyqësori, OJQ-të, që ta japin kontributin e tyre që ky projektligj, pas amendamentit të dytë, të zbatohet për arsye se është i një rëndësie të veçantë.

Edhe një herë theksoj se e përgëzoj ministrin që e ka sjellë këtë projektligj të ri dhe do t'ia japim votën pro në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Selmani! Për Grupin Parlamentar “6+”, Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je Nacrt zakona o sprečavanju i suzbijanju trgovine ljudima i zaštiti žrtava trgovine, tako da ćemo doprinos dati dalje u komisiji, i glasaćemo za.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar ‘ZB’, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine potpredsedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” je pažljivo razmatrala Nacrt zakona i uzimajući u obzir značajne ovog Nacrta zakona, podržavamo usvajanje u načelu istog, i radom u parlamentarnoj komisijama daćemo svoj doprinos, kako bi se usvojio. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar SLS, Saša Milosavljević e ka fjalën.

SAŠA MNILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I SLS je razmotrila ovaj Nacrt zakona i podržaćemo isti u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shkurtimisht, për shkak se ky projektligj është definitivisht njëri prej më të rëndësishmëve për një varg arsyes. Edhe për arsye krejt të ndjeshme ose ndjeshmërisë humane, njerëzore, edhe për shkak të kriterëve ose standardeve, të cilat duhet t'i

plotësojmë si vend, edhe për shkak të asaj se ne jemi dëshmitarë të një vale të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore të të gjitha llojeve.

Është tepër me rëndësi, pos kalimit të këtij draftligji, do të thotë kthehet në ligj, për të cilin e përhëndes dhe besoj se është tepër mirë që po bëhet ligj për këtë çështje. Është tepër me rëndësi për ta parë formën ose rritjen e përgjegjësisë në implementimin e ligjit, por jo vetëm në implementimin strikt të tij, por në implementimin e asaj që do të duhej të jetë njëri prej prioriteteve kryesore të Qeverisë së Kosovës në këtë fushë. Është tepër me rëndësi të shihet bashkëpunimi bilateral me shtetet e ndryshme, edhe shtetet e rajonit, por po ashtu edhe me shtetet tjera.

Të mos harrojmë se në këtë logjikë do të duhej që edhe këta fëmijë të gjorë që i shohim nëpër rrugët e Prishtinës dhe në krejt Kosovën, të cilët realisht nëse e shohim burimin se si vijnë, shihet që është trafikim dhe në të njëjtën kohë detyrohen të punojnë, qoftë duke i pastruar xhamat nëpër vetura nëpër rrugë, qoftë duke kërkuar lëmshë, qoftë duke bërë gjëra tjera. Këto janë tepër të rëndësishme për t'i parë se si duhet të implementohen, ose të parandalohen, ose edhe të luftohen, nëpërmjet bashkëpunimit bilateral.

Normalisht që bashkëpunimi me organizata ose bashkëpunimi multilateral është tepër i rëndësishëm, por ka nevojë që përgjegjësia në luftimin e kësaj dukurie - trafikimi me qenie njerëzore, të jetë e nivelit edhe më të lartë sesa e kemi parë deri tash.

Është e qartë, se ka një aktivitet në Ministrinë e Brendshme, por besoj se ky aktivitet duhet të rritet edhe për nga niveli, dhe besoj që vetë ministri duhet të jetë në krye të këtij procesi për shkak se është një prej temave më të ndjeshme, edhe humane, por po ashtu është edhe ligjore, ose shtetërore, të cilat duhet t'i kalojmë.

Dhe elementi i dytë, ose pjesa e dytë, që ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave, dhe mbrojtja e viktimave nuk është e lehtë. Ligji i qartëson shumë elemente dhe në parim besoj se përmbajtja është në rregull, por mbrojtja e viktimave është diçka shumë më shumë sesa mund një ministri të bëjë, qoftë Ministria e Rendit, ose e Punëve të Brendshme, qoftë agjencitë brenda ministrisë. Kjo kërkon pastaj bashkëpunimin e ministrive tjera, por po ashtu kërkon bashkëpunim edhe me shtete dhe me organizata të ndryshme.

Prandaj, po e inkurajoj edhe Qeverinë, edhe Ministrinë e Brendshme, por edhe ministrinë tjera, që rolin tepër të madh t'ia japin mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk ka të tjerë deputetë që e kanë kërkuar fjalën që të flasin në parim. Të pranishëm janë 70 deputetë.

Do ta votojmë projektligjin në parim. Votojmë, tash!

Konstatoj se me 52 vota janë për, 9 abstenime, nuk ka asnjë kundër. Pra, Kuvendi shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar në miratim në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Është ministri Bajram Rexhepi. Urdhëro!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Hartimi i këtij ligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Arsyet për hartimin e këtij projektligji qëndrojnë në faktin se me këtë projektligj rregullohet bashkëpunimi, detyrat, përgjegjësitë, masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar.

Për këtë projektligj janë pranuar deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integriteteve Evropiane, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me 'acquis communautaire'.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, faleminderit! E rinisim debatin për projektligjin, debatin në parim.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi, e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe ky projektligj, i cili ka ardhur në Komision për t'u shqyrtuar, është shqyrtuar me kujdes dhe meqë kemi punë edhe më tutje për të bërë brenda komisionit, unë nuk dua të ju marr shumë kohë rreth vërejtjeve që mund t'i kemi, por këto i kërkoj nga deputetët të cilët do të angazhohen dhe i lus të gjithë që me amendamentimet që do të bëhen, të na mundësojnë që Komisioni të mund ta kryejë punën e vet, edhe pse ishin vërejtjet për procedurën e shpejtë që po e bëjmë.

Atëherë edhe në emër të Grupit Parlamentar, e aprovojmë në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Isufi. Tani grupet parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Ky është njëri prej ligjeve që me siguri do të rregullojë dhe lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të autoriteteve, të cilat marrin pjesë në menaxhimin e integruar të kufijve, do thotë është një bashkëpunim dhe bashkërendim obligues dhe e ligjëson atë bashkëpunim, e jo bazuar në marrëveshjet e deritashme, që në formë të marrëveshjeve instrumentet e shtetit tonë janë obliguar për të ndihmuar dhe, në anën tjetër ta përkrahin, dhe besoj se është në prej ligjeve më të qëlluara për të mundur që kontrolli i kufijve, mbikëqyrja kufijve, por edhe menaxhimi i vet kufijve, të jetë në nivelin e standardeve të kërkuara dhe të nevojshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta përkrahim në parim projektligjin që ka për qëllim rregullimin ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar t'i përmbushim në mënyrën e duhur, efikase dhe efektive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Edhe ashtu problemet me menaxhimin e integruar të kufijve ndërmjet Kosovës dhe shteteve fqinjë, sidomos në këtë rast me Serbinë, vazhdon të jetë njëri ndër problemet që i ka Kosova. Mostrajtimi i duhur i këtij projektligji do ta pengonte një proces, të cilin tashmë institucionet e Kosovës dhe Kosova e ka nisur në fushën e

menaxhimit të integruar të kufijve, një proces shumë i brishtë dhe që nuk po duket që po ecën mirë.

Në të kundërtën, trajtimi i mirë i këtij projektligji do ta mundësonte ose do ta ndihmonte këtë proces, një proces dhe një punë shumë e madhe e institucioneve të Kosovës, e institucioneve të sigurisë së Kosovës për menaxhimin integruar të kufijve, ndonëse ky proces ka kaluar një fazë të konsiderueshme të mirë të menaxhimit të integruar të kufijve me Shqipërinë dhe Maqedoninë, por kjo ka ndodhur pasi është bërë demarkacioni i kufijve, sidomos me Maqedoninë, i cili ka qenë i kontestuar, nuk po bëhet një gjë të tillë për arsye të ngjashme ndoshta me Malin e Zi, por mos-hetimi i duhur ose trajtimi i shpejtë nuk do ta ndihmonte këtë proces dhe bashkëpunimi i institucioneve, në këtë rast, nuk do ta kishin një pistë të mirë, siç do të ishte një ligj shumë i mirë në këtë rast, të cilin ne po e trajtojmë me nguti.

Pra, ngutja e garanton të kundërtën, ngutja garanton edhe më tutje keqmenaxhimin ose menaxhimin jo të duhur të kufijve.

Sa për ilustrim, deputetët do të duhej të merreshim edhe konkretisht me nenet e veçanta të këtij projektligji dhe do të doja ta fokusoja sidomos kreun 2, nenin 5, dhe kreun 5, nenin 17, dhe do ta shihni se sa e ndjeshme është kjo çështje, dhe sa do të duhet ne ta trajtonim këtë çështje me komunitetin në kohë të duhur dhe në të njëjtën kohë edhe në këtë projektligj ne përmbahemi për shkak të procedurave, e jo tërësisht edhe për shkak të përmbajtjes që ka.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet. Për Grupin Parlamentar për Kosovën e Re, deputetja Suzan Novobërdali e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Koalicioni për Kosovën e Re në parim do ta përkrahë këtë projektligj dhe kontributin do ta japim në komisionin përkatës.

KRYESUESI: Për Grupin Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën..

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “6+” podržace Nacrt zakona o menadžiranju granica. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Së pari i thërras deputetët që të vijnë në sallë dhe tutje për grupin ‘ZB’, fjalën e merr Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala potpredsedniče!

Polaznička grupa “Zajednička Budućnost” podržava u načelu usvajanje Zakona o menadžiranju granicama.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! I ftoj deputetët të hyjnë në sallë për të votuar.

(Ndërprerje e incizimit)

Në sallë i kemi 68 deputetë. Bëhemi gati për votimin e Projektligjit për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhim e integrim të kufirit. Votojmë tash!

Konstatoj se me 53 vota për, 8 abstenime, pra me shumicë votash kalon në lexim të parë Projektligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufijve.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojmë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin.

Si gjithëherë sot, ministri Bajram Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BARJAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket Ministrisë së Punëve të Brendshme, me projektligje me këtë e përfundojmë.

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Projektligji është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Hartimi i këtij projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon evitimin e konfuzioneve terminologjike, e që përfshin kontrollimin kufitar, mbikëqyrjen kufitare, zonën e pikës së kalimit kufitar dhe kontrollimin në vijën e dytë.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integriteteve Evropiane, me të cilin vërtetohet pajtueshmëria me 'acquis communautaire'.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Rexhepi! Kryetari i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Si Komision, ne e kemi shqyrtuar edhe këtë projektligj në vazhden e projektligjeve që kanë ardhur në paketë dhe do të mundohemi që t'i përpunojmë këto projektligje, të cilat vërtet mundësojnë një funksionim më të mirë institucional, por njëkohësisht që përveç angazhimit tonë në komision, do të mundohemi që edhe në implementim të shohim se sa po zbatohen këto ligje, sepse do të përkushtohemi si komision edhe në zbatimin e tyre.

Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar e përkrahim edhe këtë projektligj duke ditur rëndësinë e tij dhe po e shoh se komisioni këto ditë paska shumë punë për shkak pikërisht se Qeveria na ka ngutur, e ne do të ngutemi edhe ta bëjmë një kontroll demokratik ashtu si duhet në implementimin e këtyre ligjeve.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit Funksional. Deklarimet e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi i Partisë Demokratike e përkrah këtë projektligj, por me këtë rast dua ta përsërisht delegacionin e Baden-Winter Bergut, i cili ka ardhur në vizitë pune dhe është në mesin tonë, që ka ardhur me qëllim binjakëzimi me dy shkolla të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Natyrisht i thërras të gjithë deputetë t'i përsërisht mysafirët nga Gjermania. Përsëritet! Faleminderit, zoti Lladrovci. Për Grupin Parlamentar atë LDK-së, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryesues!

Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ne do t'i evitojmë konfuzionet terminologjike që përfshijnë kontrollin kufitar, kontrollin në pikat kufitare, mbikëqyrjen kufitare, kontrollet minimale, kontrollet e plota dhe kontrollin me vijën e dytë.

Prandaj ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta përkrahim këtë projektligj në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Quni. Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror të Kosovës është një detyrë e pakryer e Qeverisë së Kosovës, ose një detyrë e kryer keq, madje nganjëherë dhe moskujdesi i duhur ndaj këtij projektligji garanton dështimin në këtë fushë, ku Qeveria e Kosovës ka dështuar shumë herë, sidomos në një fushë të caktuar, në një territor të caktuar në vazhdimësi.

E shoh këtu edhe mosgatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për ta bërë një gjë të tillë, prandaj edhe për këtë projektligj ne do të duhej ta kishim vërtet kohën e duhur për ta dhënë kontributin tonë që ta kemi vërtetë një ligj sa më të mirë, një ligj sa më funksional, i cili do ta mbulonte menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shtetërorë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Selimi. Për Koalicionin për Kosovën e Re, Suzan Novobërdali e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALI: Faleminderit, kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe të njëjtin do ta përkrahë, natyrisht kontributin tonë do ta japim në komision deri në leximin e dytë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem predsedavajući!

Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je Nacrt zakona o izmeni i dopuni o kontroli nadgledanja državne granice. Glasaćemo i podržati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet. Për Grupin Parlamentar ‘ZB’, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine potpredsedniče!

I poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržavaće u načelu usvajanje Nacrt zakona o kontroli državne granice.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk ka të tjerë që kërkojnë të japin deklarata, apo ta diskutojnë në parim këtë projektligj, ndaj ju thërras që të bëhemi gati që ta votojmë. Votojmë tash!

Votimi, me 60 vota nuk ka kaluar. Votohet edhe një herë, sepse pa 61 vota nuk vlen, ju këtë e dini. Atëherë, nëse jeni këtu koncentrohuni, përqendrohuni dhe votoni. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 67 deputetë. Për votojnë 56, abstenojnë 9. Konstatohet se Ligji kalon me shumicë, me 56 vota. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve shtetërorë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komision Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë të Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Këtë ligj, në emër të Qeverisë, para deputetëve e paraqet ministri Beqaj. Urdhëroni!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike është hartuar nga Ministria e Financave si pjesë e programit legjislativ për 2013, por njëkohësisht nevoja për amendamentim të këtij ligji ka dalë edhe nga rekomandimet e Komisionit Evropian si pjesë e raportit për liberalizimin e vizave.

Projektligji adreson disa çështje kryesore lidhur me funksionimin e subjekteve politike dhe janë tri çështje, të cilat janë të një rëndësie të veçantë, që unë do të doja t'i theksoj. Sot është auditimi i raporteve financiare. Me qëllim të ngritjes së nivelit të llogaridhënies, propozon ndryshime në sistemin e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike.

Në këtë drejtim, Ministria e Financave para vetes ka pasur dy opsione të rekomanduara nga Komisioni Evropian, e para që ta bartë përgjegjësinë e auditimit tek Auditori i Përgjithshëm dhe, e dyta, që Kuvendi ta përzgjedhë një listë të auditorëve të licencuar për auditimin e subjekteve politike. Ne e kemi rekomanduar opsionin e dytë, meqë kemi konsideruar se u përshtatet më mirë rrethanave dhe legjislacioneve në fuqi.

Dispozitat ndëshkimore në pajtim me rekomandimet që dalin nga dokumentet relevante ndërkombëtare specifikojnë dispozitat ndëshkimore për subjektet politike që i shkelin dispozitat e ligjit. Deri më tani ndëshkimet kanë qenë të paspecifikuara dhe kanë lënë një hapësirë të madhe për interpretim, ndërsa tani ato janë të specifikuara.

Dhe, çështja e tretë që e adreson ligji është definicioni më gjithëpërfshirës sa u përket donacioneve dhe donatorëve. Dispozitat e projektligjit e zgjerojnë bazën e donatorëve të ndaluar për financimin e subjekteve politike dhe me qëllim të shmangies të praktikave korruptive, ato vendosin edhe afate kohore trevjeçare për subjektet që e kanë fituar kontratën nga institucionet që të mos e kenë të drejtën të jenë donatorë të subjekteve politike.

Duhet theksuar se gjatë proceseve të hartimit të projektligjit, Ministria e Financave i ka marrë parasysh dokumentet relevante të Këshillit të Evropës që e rregullojnë këtë fushë, si dhe praktikën më të mira evropiane dhe rajonale në fushën e financimit të subjekteve politike. Gjithashtu, gjatë kësaj faze, Ministria e Financave është konsultuar me aktorët relevantë që preken nga ky rregullim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjektet politike dhe institucionet tjera të nevojshme.

Përveç këtyre, Ministria e Financave ka pranuar komente dhe sugjerime nga Komisioni Evropian, ku janë adresuar kryesisht çështjet e theksuara më lart që lidhen me transparencën e financimit të subjekteve politike, rritjen e nivelit të llogaridhënies, ndryshimin e sistemit të auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike.

Të gjitha këto komente janë inkorporuar në këtë projektligj, prandaj duke marrë parasysh se ky projektligj është në skemën apo në listën e ligjeve të cilat kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, ju ftoj ta votoni sot në parim dhe, në ndërkohë, ndërmjet dy leximeve, ligji mund të pasurohet edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetarja e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë nenit 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 15 korrik, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe e ka përkrahur këtë projektligj, si dhe ka rekomanduar që Kuvendi ta miratojë Projektligjin për plotësim-ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike.

Gjatë mbledhjes së komisionit ka asistuar edhe ministri i Financave si sponsorizues i projektligjit dhe janë ngritur shumë çështje, të cilat kanë pasur të bëjnë edhe me auditimin, edhe me ndëshkrimin, edhe me llogaridhënien. Anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë ngrehur shqetësimet e tyre rreth mënyrës së amendamentimit. Ministri i ka dhënë sqarimet e duhura. Ne e kemi miratuar këtë projektligj në komision dhe në Kuvend gjatë vitit 2011 dhe të gjithë anëtarët e komisionit janë të njoftuar dhe të plotësimit-ndryshimeve që janë bërë atje. I kemi edhe rekomandimet, të cilat i ka dhënë Komisioni Evropian dhe dua të besoj shumë që do të kemi mundësi që t'i bëjmë plotësimit- ndryshimet, të cilat janë të nevojshme dhe të cilat nuk bien në kundërshtim me rekomandimet, të cilat i ka dhënë Komisioni Evropian.

Prandaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa rekomandoj që të miratohet në parim dhe ne të punojmë më tutje. Nëse më lejohet, zoti kryesues, e kisha dhënë edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë demokratike.

Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin dhe e ka vlerësuar si një ligj që i rregullon shumë çështje që kanë të bëjnë me financimin e subjekteve politike dhe ka rekomanduar që të miratohet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit, Safete Hadërgjonaj, e cila e dha edhe mendimin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Atëherë, për grupin parlamentar atë LDK-së, fjalën e paraqet Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar projektligjin dhe në parim e përkrah atë në miratim. Dua të them që unë besoj se ky ligj është dashur të shqyrtohet në një atmosferë pak më të relaksuar, apo në një afat më të gjatë, në mënyrë që problemet që ekzistojnë në financimin e partive politike të shqyrtohen pak më thellë.

Në këtë rast do të ndalem vetëm në dy dispozita, të cilat ligjin e bëjnë vështirë të aplikueshëm dhe me siguri se të gjitha partitë politike do të kenë problem në zbatimin e atyre dy dispozitave. E para ka të bëjë me përkufizimin e ri të donacioneve, me ç'rast si donacion nënkuptohet edhe blerja e një malli apo e një shërbimi, me një çmim më të lirë se të tregut.

Është jashtëzakonisht vështirë të themi edhe në kontrollet që i kryen Administrata Tatimore e Kosovës për bizneset e ndryshme të vërtetojnë çmimin e tregut, e lëre më një auditor të merret me vërtetimin apo me përcaktimit e çmimit të tregut për një shërbim apo për një mall që e ka blerë një parti politike.

Çështja tjetër ka të bëjë me dispozitat e shpenzimeve për kandidatët. Çdo parti politike besoj se ka problem në mbledhjen e shpenzimeve, të cilat i bëjnë kandidatët për deputetë apo për këshilltarë komunalë gjatë fushatës zgjedhore. Unë nuk besoj se kjo është zgjidhja më e mirë që të gjithë deputetët, apo partia politike të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për shpenzimet e deputetëve.

Do të duhej që me dispozita të përcaktohet nëse një kandidat për deputet, apo për këshilltar komunal, nuk paraqet raport në parti, apo drejtpërdrejt nuk e paraqet raportin në KQZ, ai të jetë përgjegjës për shpenzimet që i ka kryer, e jo sikur është paraparë në ligj që partia të gjobitet apo të jetë përgjegjëse për shpenzimet e një deputeti për shkak se në anën praktike partia e ka të pamundshme t'i përcjellë të gjitha shpenzimet që mund t'i bëjnë kandidatët për deputetë gjatë fushatës së tyre zgjedhore.

Është edhe një çështje që nuk është përfshirë, çështja ka të bëjë me zëvendësimin e mjeteve themelore të partive politike. Ligji aktual nuk e rregullon mënyrën e zëvendësimit të mjeteve themelore. Në mënyrë jashtëzakonisht, të themi, në mënyrë shumë indirekte me rregulla të KQZ-së është e përcaktuar, por duhet të jetë me ligj e

përcaktuar që partia të ketë mundësi t'i shesë mjetet themelore dhe t'i blejë mjetet themelore, nëse ato mjete themelore, të themi, vjetrohen apo thjesht për arsye të ndryshme një parti, një subjekt politik dëshiron t'i tjetërsojë ato dhe t'i zëvendësojë me të reja.

Megjithatë, natyrisht se LDK-ja do ta votojë në parim projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zharku! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket ligjit për financimin e subjekteve politike, sigurisht që ky ligj i rregullon disa çështje që në ligjin paraprak nuk kanë qenë të rregulluara, pra i vendos disa kufizime, mirëpo sigurisht që Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i ka edhe disa vërejtje sa i përket këtij ligji dhe amendamenteve brenda këtij ligji.

Pra, në radhë të parë kemi vërejtje sa i përket çështjes së auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve politike. E tha këtu edhe ministri që i kemi pasur dy rekomandime nga Bashkimi Evropian, njëri ka qenë që subjektet politike t'i auditojë auditori i përgjithshëm dhe tjetra që kjo të bëhet përmes Kuvendit. Mendoj që në hartimin e ligjit kur e ka bërë Qeveria është dashur që këtë kompetencë t'ia lë auditorit të përgjithshëm, sepse ashtu si i auditon të gjitha organet tjera ishte dashur që t'i auditojë edhe subjektet politike, për shkak se nuk ka kuptim që auditimin e subjekteve politike ose përzgjedhjen e auditorëve për auditimin e pasqyrave financiare të subjekteve politike ta bëjë një komision i Kuvendit, që në këtë rast thuhet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nuk ka kuptim që vetë partitë politike të bëjnë përzgjedhjen e auditorit që donë t'i auditojë raportet financiare të atyre subjekteve politike. Domethënë kjo është vërejtja kryesore.

Do të ndalemi edhe te çështja e donacioneve. Është qëndrim i Lëvizjes “Vetëvendosje” që këto të hiqen fare nga Ligji për financimin e subjekteve politike për shkak se lihet shumë hapësirë për keqpërdorime të fondeve. Nëse ka nevojë të rritet edhe fondi për subjektet politike nga buxheti i Republikës së Kosovës, mirëpo nuk konsiderojmë se donacionet duhet të futen këtu për shkak se nuk po janë të kontrollueshme dhe po keqpërdoren nga partitë e ndryshme politike, më së shumti këtu mund të them nga partia që është në pushtet.

Mandej, edhe një vërejtje tjetër, te një nen i Ligjit për financimin e subjekteve politike, ku thuhet se në rast se vërehet se fitimi i mandatit është si rezultat i keqpërdorimit të fondeve do të duhej që kandidatit t'i merret mandati, mirëpo nuk është e precizuar mirë në ligj, sepse aty thotë që në rast se vërehet që ka keqpërdorim të fondeve, atëherë kandidatit mund edhe t'i merret mandati. Mendoj se në ligj nuk duhet të lihen hapësira të tilla për interpretime të ndryshme për shkak se nëse vërehet që ka keqpërdorime të fondeve, në rast të fitimit të mandatit ishte dashur që të shkruhet saktësisht se kandidatit duhet t'i merret mandati, mirëpo mund t'i merret mandati ky po lë hapësira të ndryshme për interpretime të ndryshme.

Këto janë disa nga vërejtjet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” sa i përket Ligjit për financimin e subjekteve politike. Sigurisht që kontributin tonë do ta japim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! I nderuar zoti nënkryetar, Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra, Kolegë deputetë, Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim këtë projektligj, por i ka edhe vërejtjet e veta dhe unë do të ndalem në disa vërejtje.

Duke mos e përsëritur zotin Zhargu i cili i dha disa vërejtje substanciale, sidomos tek donacionet dhe te mbulimi i shpenzimeve, unë do të thosha që ky projektligj ka të metat edhe tani pse ka ardhur. Dhe, shpresoj që ligji i parë ka qenë shumë më i mirë se sa ligji i dytë që është ndryshuar dhe me siguri do të jetë edhe më i mirë se sa ky i treti që po e ndryshojmë.

E para thuhet që është i harmonizuar me praktikat më të mira të BE-s dhe e dyta na ka ardhur me praktikat më të mira të BE-s dhe e treta, më të mira me praktikat, tash s’po di a është e para më e mira a është kjo e treta.

Unë besoj që do të kemi shumë vështirë ta zbatojmë këtë ligji për arsye se këtu financimi i subjekteve politike bëhet në bazë të numrit të deputetëve dhe një grup parlamentar i merr 1 milion, ndërsa një grup që e ka 1 deputet i merr 30 mijë dhe për të dashur për të funksionuar në bazë të menaxhimit publik të financave duhet krejt këto mjete një subjekt i vogël për të paguar njerëz që udhëheqin kontabilitet dhe menaxhojnë dhe nuk do të dalin mirë para auditorit.

Unë besoj që Komisioni Qendror Zgjedhor duhet t’i ngrejë kapacitetet e veta, të mos i lejojë edhe partitë politike të gabojnë, por t’i mësojë në disa vërejtjet e veta dhe me siguri që raportet financiare do të ishin më të mira. Unë në asnjë vend të Bashkimit Evropian nuk di që auditorët t’i qesë ndonjë komision parlamentar, por atë e bën ja Komisioni Qendror Zgjedhor, ja Kuvendi ose ndonjë institucion tjetër dhe jo Komisioni për Mbikëqyrje Financiare, qëllimi i të cilit është të mbikëqyrë pasqyrat e audituara.

Prandaj, këto janë ato vërejtjet dhe shpresoj se gjatë leximit të dytë Komisioni Funkcional - Komisioni për Buxhet do t’i japë disa vërejtje të veta. Sidomos, vërejtjet më të mëdha janë te dënimet, për arsye se dënohet si një subjekt i madh që merr mbi 1 milion euro, si një subjekt i vogël që i merr 30 mijë euro. Do të thotë do të ketë mundësi që ndonjë subjekt i vogël do t’i merren krejt parat për demokratizim se dënimet janë shumë të mëdha, ndërsa subjektet e mëdha që i bëjnë edhe shkeljet më të mëdha, do të dënohen me shuma shumë simbolike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Neziraj! Për KKR-në, fjalën e ka deputetja Sevdije Lama

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Hvala!

Nakon razmatranje Nacrti zakona o finansiranju političkih partija, Parlamentarna grupa “6+” je odlučila da da svoj glas za usvajanje istog u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin ‘ZB’, deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine potpredsjedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” pažljivo je razmatrala Nacrt zakona i uzimajući u obzir značaj ovog nacrti zakona za rad političkih subjekta na Kosovu, podržavamo usvajanje u načelu istog i radom u parlamentarnim komisijama daćemo svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet!

Kemi tash deputetët që donë të marrin pjesë në debat. Deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Kolegë deputetë,

Desha të kyçem vetëm rreth dilemave që u ngritën nga përfaqësuesit e “Vetëvendosjes” dhe të Aleancës rreth autoritetit, i cili do të duhej të bëjë auditimin e pasqyrave.

Realisht, Zyra e Auditorit Gjeneral është institucion i pavarur e cila e bën auditimin e gjitha institucioneve qeveritare dhe të kompanive publike.

Komisioni për Mbikëqyrje e Financave Publike nuk bën asnjë auditim. Është një keqkuptim që është keqkuptuar këtu. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në bashkëpunim me stafin menaxherial të Kuvendit zgjedh kompaninë përmes një procesi të konkurrencës, e cila do ta auditojë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo është logjika që është dhënë edhe në rastin konkret, pra të përzgjedhjes së një kompanie të pavarur të auditimit e cila do ta bëjë këtë rast këtë fond. Pra, çdo shmangie tjetër realisht do të sjell më shumë konflikt interesi se kjo procedurë që është përpunuar kështu.

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet Sadriu! Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pa dyshim që ky projektligj krahasuar me Ligjin aktual ka përmirësime të dukshme dhe janë marrë parasysh shumë vërejtje të cilat në fakt herën e kaluar i kemi ngritur, por nuk u morën parasysh.

Si do që të jetë, nuk është mirë që vërejtjet të cilat janë dhënë edhe nga deputetët, atëherë nuk u morën parasysh, por dua që patjetër t'ia tërheqë veshin Komisioni Evropian Qeverisë që të marrë vesh.

Si do që të jetë unë nuk e kam parë në projektligj nëse janë konsultuar organizatat e shoqërisë civile dhe ndoshta ministri mund të na e sqarojë këtë, sepse nuk e pashë se kjo procedurë ka ndodhur dhe shumë organizata të shoqërisë civile kanë pasur vërejtje thelbësore.

Si do që të jetë, unë kam disa vërejtje, edhe pse thashë, është përmirësuar projektligji. Së pari, disa prej gjobave vazhdojnë të jenë të ulëta. Mendoj që gjobat kur partitë politike nuk e respektojnë ligjin duhet të jenë më të larta, sepse raporti ndërmjet mosrespektimit ose thyerjes së ligjit dhe dënimeve vazhdon të jetë qesharak në disa raste.

Aktiviteti funksional i OJQ-ve të lidhura me partitë politike mendoj që duhet sqaruar edhe më tutje çfarë përfshin, sepse në projektligj është shumë, shumë i paqartë çfarë janë këto OJQ, si bashkëpunojnë e tjera.

Po kështu mendoj se procedura e auditimit duhet rishikuar në mënyrë që përgjegjësitë të jenë më të qarta dhe të mos ketë konflikte interesi me të KQZ-së dhe Autorit të Përgjithshëm për paratë të cilat jepen nga fondi i Kuvendit.

Një vërejtje tjetër është se unë mendoj që duhet të thuhet në mënyrë taksative që partitë politike të ndajnë buxhetin në mënyrë proporcionale për të dyja gjinitë, sepse jemi dëshmitarë të gjithë që në fushatat elektorale gratë vazhdojnë të jenë më të diskriminuara dhe nuk përfitojnë nga fondi i partive politike.

E di se shumë kush mund të mos pajtohet me këtë, mirëpo ky është një realitet i pamohueshëm dhe besoj që kjo praktikë duhet të marrë fund një herë e përgjithmonë. Askush të mos sillet si i pari i shtëpisë, por të ndahen në mënyrë proporcionale edhe fondet, sepse fushata elektorale, financimi i fushatës elektorale është një nga bazat e fitores, kështu që le t'i themi stop këtij lloji diskriminimi.

Një vërejtje tjetër që unë e kam, është në lidhje me buxhetin që e ndan Kuvendi për partitë politike në bazë të numrit të ulëseve ose përqindjes së partive politike, mendoj që duhet të ketë një përqindje e cila ndahet pikërisht me këtë projektligj për të ndihmuar ose që u alokohet deputetëve në mënyrë të drejtpërdrejtë që ata të kenë ekspertizë. Në fakt, një nga problemet më të mëdha që vuan Kuvendi i Kosovës është mungesa e ekspertizës së deputetëve. Kemi pasur rastin të vizitojmë shumë parlamente dhe nuk mund të gjejmë asnjë Parlament të vetëm në vendet e zhvilluara ku deputetët nuk kanë absolutisht asnjë lloj ekspertize dhe punojnë kështu, siç punojmë ne.

Gjithsesi këto janë disa vërejtje të vogla, të cilat unë do t'i kthej në amendamente dhe shpresoj që të përkrahen në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Lama! E fundit si deputete, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritësish ardhjen e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e financimit të subjekteve politike të ndryshuara e të plotësuar, mirëpo prapëseprapë unë jam e mendimit me kolegun Xhevdet nga AAK-ja që mesa po më duket në këtë projektligj prapëseprapë do të kemi probleme tjera dhe çështja e financimit të subjekteve politike, çështja e auditimit më mirë të kishte ngelur ndoshta të vetë KQZ-ja që në këtë rast është ajo që organizon zgjedhjet dhe ajo i licencën partitë politike, mirëpo në efekt çështja e kontabilitetit në secilën pjesë të një subjekti politik do të jetë një ngarkesë e madhe dhe nuk e di sa e secilës degë të një subjekti politik do të jetë një ngarkesë e madhe dhe besoj se prapëseprapë nuk do të jetë ajo çfarë në efekt kërkohet.

Ne mund t'i japim ministër edhe rekomandimet direkt si Grup parlamentar, mirëpo kërkoj nga ju që këtu të deklaroni a do të ketë mundësi që të ketë edhe një plotësim, ndoshta po në këto rekomandime të cilat i paraqitën këta deputetë në këtë seancë plenare.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që kanë kërkuar fjalën e të diskutojnë për këtë projektligj në parim, në lexim të parë.

Në sallë i kemi 65 deputetë. Ju lutem të bëhemi gati që të votojmë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-174 për financimin e subjekteve politike të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-058 dhe votojmë tash.

Me 54 vota për, 7 abstenime pra me shumicë votash Kuvendi miratoi në parim këtë projektligj.

Ngarkohet komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë te ligji i fundit i kësaj pakete ligjesh:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funksional nuk e ka shqyrtuar projektligjin.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendin ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin.

Pra, kemi parasysh vetëm një moment zoti zëvendëskryeministër dhe ju zotërinj deputetë, në këtë rast Komisioni nuk e ka shqyrtuar, pra nuk ka mendim as për as kundër.

Ju tërheq vëmendjen që tash vendimin duhet ta marrë Kuvendi, sepse me rregull duhet ky Komision ta ketë një mendim, ta ketë për ose kundër, që nuk e pengon Kuvendin ta shqyrtojë ligjin.

Mundësia është kjo. Ky komision të japë një mendim të vetin, ta thotë një po ose një jo, në mënyrë që të vazhdojmë, ose nëse Komisioni nuk ka as po as jo, atëherë ky Kuvendi duhet të marrë vendim për shqyrtim të parë për shkak të procedurave të këtij projektligji.

A ka ndonjë koment Komisioni, Komisioni Funksional në këtë rast që është Komisioni i Ligjeve. Arben Gashi, kryetar i Komisionit të Ligjeve. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Komisionit i është kërkuar që ta trajtojë me procedurë të shpejtuar këtë projektligj. Ligji ka ardhur ditën e hënë në orën 10 në Komision dhe është kërkuar që të futet në rend të ditës në orën 12. Ky ligj është një ligj voluminoz dhe i rëndësishëm dhe Komisioni ynë nuk ka shprehur gatishmërinë që ta trajtojë me urgjencë për arsye që ka llogaritur se mund brenda këtij sesiioni pranveror ky ligj të shqyrtohet, trajtohet dhe të kalojë.

Duhet t'i kemi parasysh edhe disa elemente. Ky ligj është trajtuar me të njëjtën procedurë të ngutshme edhe vitin e kaluar. Kuvendi ka marrë vendim dhe prapë tash me rekomandim të Komisionit Evropian edhe vjet ka qenë i njëjti arsyetim sikur që kur rekomandon Komisioni Evropian të shqyrtohet. Është shqyrtuar vitin e kaluar, nuk i paska plotësuar standardet, tash po shqyrtohet prapë me urgjencë, nuk e di se a do t'i plotësojë standardet, sepse Komisioni nuk e ka trajtuar.

Mirëpo, duhet të kemi parasysh edhe një element tjetër. Në vërejtjet kryesore që Komisioni Evropian i jep për Kuvendin e Kosovës është anashkalimi i Rregullores. Kuvendi sot ka vendosur me vullnetin e vet ta anashkalojë Rregulloren, kjo do të reflektohet në Raportin e Progresit, normalisht dhe do të jetë një shkelje e radhës e cila do të evidentohet si negativitet për Kosovën. Kuvendi ka vendosur dhe prapë i mbetet seancës të vendosë sepse Komisioni....

(Ndërhyrje e Adem Grabovcit)

Adem, ti s'ke nevojë të flasësh hiç, jam duke folur unë.

(Adem Grabovci: Po veç mos fol pa lidhje se është e papranueshme.)

Nuk je ti këtu të më kallëzosh mua a flas unë me lidhje a pa lidhje. Pa lidhje po flet vetë.

KRYESUESI: Zoti deputet, vazhdo dhe kur ta kryesh kushdo e merr fjalën, por mos dialogoni në atë formë. Urdhëro, vazhdo Arben!

ARBEN GASHI: Komisioni nuk e ka trajtuar, e ka në rend dite ditën e hënë dhe ditën e hënë vendos. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Arsim Bajrami. Urdhëro Arsim!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Është e vërtetë që është kërkuar diskutimi i këtij projektligji edhe në Komision, por Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë, por ne e votuam shmangien nga rregullat e procedurës që s'ka asnjë pengesë që të diskutohet dhe Komisioni do ta marrë në shqyrtim me rastin e leximit të dytë të këtij ligji.

KRYESUESI: Unë mendoj që duhet të votohet edhe një herë, shmangie është votuar që të gjitha këto ligje nëse formalisht i plotësojnë kushtet shkurtohet koha. Në këtë rast e kemi një element plus, prandaj për të qenë korrekt me materien, me substancën, me ligjin, me Kuvendin e me opinionin unë kërkoj megjithatë që ky Kuvend të votojë a të shqyrtohet ky ligj. Sot në Kuvend mund të votojë Kuvendi, është detyrë e tij nëse do për pa pasur mendim të komisionit të ligjeve ku je edhe ti, më duket. Kështu që unë kisha thënë që kjo është rruga, përndryshe s'ka udhë tjetër.

Unë ju thërras, në sallë janë 68 deputet, Kuvendi le të deklarohej a mendon se Kuvendi duhet të vazhdojë të trajtohet në lexim të parë ky ligj, edhe pse Komisioni Funkcional para leximit të parë, nuk ka mendim. Unë ju thashë, ju mund të shprehni mendim, por ju mendim s'po keni. Kështu që ju thërras që të votojmë për këtë a jam i qartë, që të trajtojë në lexim të parë Kuvendi Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale ndonëse nuk kemi një mendim të Komisionit të Ligjeve. Votojmë tash.

Janë 72 këtu. Pra, me 13 vota kundër, me 53 vota për dhe me 4 abstenime, Kuvendi jep të drejtë që të vazhdojë trajtimi i këtij ligji në lexim të parë. E thërras ministrin e Drejtësisë, besoj dhe zëvendëskryeministrin Kuçi që ta paraqesë para deputetëve këtë projektligj. Urdhëroni!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Natyrisht më lejoni në fillim të shpreh admirimin tim për një qasje pozitive që ka Kuvendi i Kosovës që dallon prej shumë kuvendeve tjera që janë aspirante për anëtarësim në BE, që krijohet shumë shpejt konsensusi që ka të bëjë me integrimet në Unionin Evropian.

Natyrisht, edhe sa i përket këtij projektligji besoj se nënkryetari i Kuvendit bëri mirë që e kënaqi kuptimin e asaj rregullore që mos me lënë dilema, por në kuptimin juridik

ndërkombëtar një institucion që ka mundësi të bëjë më shumë mund të bëjë edhe më pak dhe Kuvendi i Kosovës mund të bëjë më shumë se sa një komision.

Ajo çka dua të them është se ky projektligj paraqet ndryshimin e Ligjit numër 04/L-031 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale me qëllim që të luftojë mundësinë e krimit të organizuar dhe dukurive tjera negative përmes kërimit dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar duke avancuar praktikën e deritanishme në këtë fushë, por njëkohësisht edhe duke i ngritur praktikën më të mira evropiane.

Natyrisht që në punën e këtij projektligji janë vënë në pah gjendja relevante e cila ka të bëjë me zhvillimet aktuale në Kosovë, me shtetet përreth nesh, në veçanti bashkëpunimin e Kosovës në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale me shtetet anëtare të BE-së.

Më lejoni të theksoj se përmes këtij projektligji janë amendamentuar dhe plotësuar çështjet që kanë të bëjnë në veçanti në ekstradimin e personave, me çështje të bartjes së dosjeve penale në fushën e hetimeve të përbashkëta dhe po ashtu edhe me rregullat tjera që mundësojnë këtë bashkëpunim.

Unë dua të theksoj se ky bashkëpunim tanimë e plotëson shumë më mirë dhe e fuqizon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe mundëson një bashkëpunim edhe më të mirë me shtetet anëtare të BE-s, por edhe me shtetet tjera. Ju ftoj që ta miratojmë në parim dhe e ftoj Komisionin dhe të tjerët të japin mendimet e tyre pozitive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, Kuçi. Tash e hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji. Në emër të Komisionit nëse e do fjalën kush? Urdhëro Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Nuk kam çka të them në emër të Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë! Në emër të Komisionit. Atëherë, kërkoj mendimet në emër të grupeve parlamentare. Për Grupin e PDK-së nuk ka deri tash. Për Grupin e LDK-së nuk ka deri tash. Për Grupin e “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Vërtet është shqetësuese se si po bëhet shqyrtimi i projektligjeve që janë të domosdoshme për interesin e qytetarëve në këtë Kuvend. Pra, me këtë rast po degradon edhe roli i Kuvendit në hartimin apo përpilimin e legjislacionit. Pra, ashtu siç u tha, për dallim nga projektligjet tjera që u shqyrtuan më herët, ky projektligj nuk ka kaluar në Komisionin për Legjislacion, pra Komisioni për Legjislacion nuk e ka shqyrtuar të njëjtin dhe shmangia nga Rregullorja e Punës që u bë më herët nuk do të duhej asnjëherë të bëhej për veprime cilësore, por nëse bëhet atëherë kjo do të duhej të ndodhte vetëm shmangie nga procedurat formale.

Pra, shmangia për çështje përmbajtësore të projektligjit është shkelje e Rregullores së Punës.

E dyta, Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar ky Kuvend e ka kaluar në vitin 2011, pra në tetor të vitit 2011 dhe në vend që të kemi një plotësim-ndryshim të ligjit aktual, neve po na sillet një projektligj i ri në tërësi. Tash po del që kur Qeveria apo ministri i Drejtësisë ka thënë që ai projektligj ose ligj është në përputhje të plotë me ‘acquis communautaire’, paska qenë e pavërtetë.

E dyta, në memorandum shpjegues thuhet që ky projektligj është përpiluar në bashkëpunim me shoqërinë civile. Dhe, unë ia bëj me dije ministrit të Drejtësisë që kjo është e pa vërtetë pasi që nuk kam gjetur përfaqësues të shoqërisë civile gjatë këtyre ditëve që kanë marrë pjesë në këto grupe punuese, madje ata as që kanë qenë në dijeni për përpilimin e një projektligji të tillë.

Sa i përket pra projektligjit kemi hasur në shumë vërejtje, si teknike ashtu edhe përmbajtjesore, pra ka shumë paqartësi ndërmjet dispozitave ligjore, shumë kundërthënie ndërmjet tyre dhe shumë hapësira interpretimi. Pra, hapësira të shumta interpretimi, si për shembull nenin 8 thuhet se vendi i kryerjes së veprës penale pra ekstradimi mund të mos lejohet për vepra penale të kryera pjesërisht në territorin e Republikës së Kosovës.

Mendoj që nuk duhet të lejojmë terme të tilla meqë do të kemi vështirësi në implementim. Pra, ekstradimi ose nuk lejohet për vepra penale të kryera pjesërisht në territorin e Republikës së Kosovës, ose lejohet. Pra, janë dy gjëra.

Në nenin 14 thuhet se ekstradimi refuzohet nëse vepra penale për të cilën paraqitet kërkesa është vepër penale politike, mirëpo edhe në ligjin aktual dhe edhe në këtë projektligj nuk i kemi të specifikuar qartë se për cilat vepra penale politike bëhet fjalë, apo vepra penale ushtarake siç thuhet në projektligjin. Pra, këto paqartësi ekzistojnë edhe në ligjin aktual.

Një çështje tjetër që vazhdon të mbetet shqetësim është si ekstradohen qytetarët nga vendet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Pra, së fundi kemi pasur rastin e të dyshuarit për vrasjen e Diana Kastratit, i cili u arrestua në Valencia të Spanjës dhe më pas u lirua dhe ne nuk dimë ndonjë veprim konkret që e ka ndërmarrë Ministria e Drejtësisë sa i përket ekstradimit të atij personi për gjykim në Kosovë. Dhe së fundi, ekstradimi për krime të luftës, pra nuk kemi asnjë dispozitë ligjore që e specifikon ose definon procedimin e ekstradimit me rastin e krimeve të luftës që janë kryer në Kosovë.

Në fund, ne nuk mund të votojmë këtë projektligj për shkak edhe të procedurave që po shkelen, procedurave të Rregullores së Kuvendit, mirëpo edhe për shkak se kemi vërejtje teknike e përmbajtjesore të cilat sigurisht se do t'i adresojmë në Komisionin për Legjislacion dhe shpresoj se ne do të kemi kohë sipas Rregullores, pra dy muaj, që t'i bëjmë këto amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Haxhiu! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, shefi i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumë shkurt! Ashtu siç e votuam për shmangie, do ta votojmë këtë projektligj në parim. Sidoqoftë duhet një eko për atë se si ka shkuar procedura në Komision.

E vërteta është se të gjithë kur flasim në Kuvend, themi grupi e ka shqyrtuar, grupi e ka lexuar, e vërteta është që jo vetëm në Kuvendin e Kosovës, por në të gjitha kuvendet e botës janë anëtarët e Komisionit ata që e lexojnë ligjin, jo krejt grupi, ai ligj ku bien për shkak se është gjë normale, nuk kanë kohë deputetët t'i lexojnë të gjitha ligjet dhe kjo është arsyeja pse ka komisione. Anëtarët e Komisionit e lexojnë, jo krejt grupi dhe atëherë ka rekomandim, qoftë për grupin, qoftë prej grupit për anëtarin.

Dhe kjo është arsyeja kryesore pse nuk është shqyrtuar në Komision për Legjislacion se ditën e hënë nuk kanë pasur kohë ta lexojnë as anëtarët e Komisionit, që do të thotë për ta dhënë një opinion për seancën plenare pa e lexuar hiq, se atë ditë ka ardhur, domethënë edhe nga një orë para mbledhjes së Komisionit.

Sidoqoftë, mendojmë se duhet të kalojë ligji. Do ta japim votën për projektligjin dhe shpresojmë se do të jetë punë serioze gjatë shqyrtimit në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini! Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

Më fal Behar, një moment. Le të vijmë në sallë deputetët, të mos japin deklaratatë të forta, por le të vijmë, të kthehen në sallë, sepse kanë për të votuar.

BEHAR SELIMI: Faleminderit!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji do të votohet nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në parim. Bile për më tepër, ne jemi të gatshëm ta votojmë përfundimisht, jo vetëm parimisht duke i pasur parasysh interesat e mëdha të proceseve të integritetit, duke pasur parasysh se është fjala për një projektligj i cili nuk është i ri, është vetëm i amendamentuar dhe kushdo që ka pasur përkushtim ka mund pak a shumë ta lexojë dhe të krijojë përshtypjen e vet.

E sa i përket Komisionit për Legjislacion, në mbledhjen e fundit unë jam munduar të ketë konsensus dhe mirëkuptim prej kolegëve tjerë në emër të proceseve të integritetit, megjithatë s'e kam gjetur këtë mirëkuptim, në ndërkohë që ne votuam për shmangie të procedurës dhe unë mendoj që Rregullorja kur thotë: "shmangie nga Rregullorja" e përfshinë procesin që nga momenti që vjen projektligji në Kuvend e deri në momentin që aprovohet përfundimisht. Prandaj, unë mendoj që edhe votimi për shmangie nga Rregullorja ka qenë në rregull dhe megjithatë, e përligjëm me një votim të ri, kjo i bie të nxjerrësh "kime në ve", dhe megjithatë ne mendojmë se ky projektligj thëllon bashkëpunimin tonë ndërkombëtar në fushën e çështjeve penale dhe e faktorizon akoma më shumë shtetin e ri të Kosovës.

Prandaj, ne do ta votojmë në parim dhe jemi të gatshëm sa më parë që të takohemi në Komisionin për Legjislacion dhe ta diskutojmë e votojmë përfundimisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Selimi! Për KKR-në, Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Edhe Koalicioni për Kosovë të Re, në parim e përkrah këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zotërinj deputetë, me lejen tuaj, meqë s'kam dikë që më ndihmon, unë dua t'i them megjithatë dy fjalë nga kjo foltore. Pra, me lejen tuaj, se do të dilja atje.

(Ndërhyrje)

Jo, është rregull. Unë e mora lejen tuaj, me rregull. Unë kisha nevojë t'i them dy fjalë, por jam vetëm këtu, dhe dua ta bëjë prej këtu tash.

Më së pari, pajtohem me thënien, më duket në fillim e ka thënë Ardiani, mënyra tjetër dhe tjerët, që shmangia është një mundësi, por nuk duhet të bëhet normë. Dhe, po e them këtë, jam i detyruar, sepse është tema për të cilën unë kam diskutuar gjatë në Kryesi rreth kësaj shmangie, duke pas menduar që për këto probleme koha humbet ose fitohet. Nuk humbet ose fitohet me lëvizje të afatit. Dhe unë kujtoja që ky afat kohor që plotësohet të hënën nuk fitonim gjë nëse bëjmë leximin e parë të hënën, që nuk kërkon shmangie dhe prej të hënës e tutje e kishim gjithë fundin e muajit që ta bëjmë leximin e dytë, sepse për lexim të dytë me Rregulloren nuk ka kufi të poshtëm e të jashtëm, por thuhet brenda dy muajsh.

Po kjo ka kaluar, unë e thashë për parimësi për t'u ditur çka është menduar. Dhe ky intensifikim i punës po më jap pak të drejtë mua sot se të gjithë po thonë që ne po i kalojmë në parim, kemi vullnet, Kuvendi ka vullnet të jashtëzakonshëm që detyrat legislative t'i kryejë për një funksion karshi liberalizimit të vizave, por të gjithë po thonë që ka punë shumë e duhet të lexohet, që i bie që ka mund të lexohet me këtë kohë edhe në lexim të parë, jo vetëm në dytin dhe që do ta fitojnë kohën.

Unë thashë, koha fitohet me punë, jo me lëvizje afatesh. Se pati thënë Shtrausi në vitet e '80-ta, në Tiranë pati shkuar për t'u ndihmuar dhe në fund u end nja një javë ditë, në fund u kthye s'bëri gjë dhe në fund tha: ngadalë, ju shqiptarët e keni një fjalë popullore "Koha është ar", por ju aq shumë po rrini, domethënë ju keni ar sa të doni, keni dukat".

Dhe në këtë rast, ne kohën e kemi, është puna e intensifikimit. Nëse merren detyra dhe bëhet intensifikimi në punë, edhe këto ligje lexohen.

Dhe, e fundit për sa i përket kësaj që unë kërkova të votohen, unë i drejtohem deputetit Selimi. Jo, votimi i parë ka qenë që të shkurtohet koha për trajtime në lexim të parë të gjitha ligjeve. Ky ka qenë specifikum, sepse këtu preket procedurë brenda një ligji. Të tjerat, të gjitha e kishin një mendim të Komisionit funksional, por e kishin, por kanë mund ta kenë edhe kundër. Në këtë rast nuk kishim mendim, dhe unë jo që e kam kaluar, por e kam respektuar strikt Rregulloren dhe ju si deputetë dhe ju thatë po dhe ju vendosët.

Kjo është që kisha detyrim ta them para jush dhe publikisht. Dhe, edhe një venerim të fundit, pasi i pata tri, dhe të katërtin. Kjo puna e formulimeve – praktikat më të mira evropiane, harrojeni. Më së pari, as s'i di dikush të gjitha praktikat evropiane, as s'i di cilat janë të mira e që janë të këqija, se s'jemi ne të japim mendime të tilla.

Dhe, formulimin e famshëm, që janë të gjitha në pajtime të asquis communautaire, kjo është pak gërditësh se edhe këto, krejt këto variante merrni procesverbalet e vitit të kaluar, secilave u kemi thënë janë në pajtim me asquis communautaire. Këto janë ligje që pak a shumë po bëhen në bashkëpunim, unë kisha thënë, jemi përpjekur t'i hartojnë në bashkëpunim. Bile për këtë punë para se të votojmë, kisha pasur dëshirë ta ndiejë, nëse ka dëshirë, propozuesi i ligjit po se po, por unë desha edhe ministrja e Integritetit edhe kryetari i Komisionit të Integritetit. Faleminderit! E ka fjalën ministri, dhe zëvendëskryeministri!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit! Më lejoni që disa shqetësime që u ngritën këtu të tentoj të jap përgjigje shumë shkurt.

E para, pse nuk është amendamentim, por është ligj i ri, natyrisht nëse e shohim përmbajtjen, zonja Haxhiu, do ta shohim shumë qartë se 60% e përmbajtjes ka ndryshuar dhe juridikisht nëse ndryshon mbi 50% nuk mund të quhet amendamentim, por ligj i ri.

E dyta, përmendet viti 2011. Po ju them që jeta është më evolutive se aktet juridike dhe besoj se këtë e kemi mësuar edhe në Fakultet Juridik, bashkë. Por ajo çka dua të them që ne duhet të kemi parasysh sa herë që ndryshon koha, ndryshojnë rrethanat, duhet t'i ndryshojmë edhe ligjet.

E treta që përmendet shoqërinë civile, unë besoj që në Ministrinë time të gjitha ligjet, edhe prokurimi publik bëhet me shoqërinë civile. Ajo pjesë e shoqërisë civile që koketon me ty ose me mua nuk besoj që e ka ... shoqërinë civile, janë diçka tjetër, por në cilindo rast besoj se nuk jeni zëdhënës e shoqërisë civile.

Sa i përket çështjeve që i përmendet për ekstradim, duhet të them që është ultra profesionale dhe nuk e kuptojnë të gjithë, por ajo çka dua të them ekstradimi për vepra politike dhe tjerat duhet të krahasohen me Kod Penal, se ky ligj nuk është Kod Penal dhe atë që e lidhët me krimet e luftës, po ua them edhe një fjali, çështja e ekstradimit është kompetencë e organeve gjyqësore të vendit tonë deri në Gjykatë Supreme dhe e ministrit të Drejtësisë. Ne jemi të vetëdijshëm për veprime të tilla.

Dhe, rastin që e përmendet, kam dhënë përgjigje dhe besoj se e keni dëgjuar edhe ju, rastin e Diana Kastratit. Personi i kërkuar nga ne, me kërkesë tonën është vënë në Interpol. Kemi dërguar letër në Ministrinë e Drejtësisë së Spanjës. Kemi kërkuar nga EULEX-i dhe kemi pasur takim për këtë çështje. Spanja nuk e njeh Republikën e Kosovës, rrjedhimisht as Ministrinë e Drejtësisë. Bile, kam qenë fleksibil, kam thënë që bën edhe përmes UNMIK-ut, vetëm të ekstradohet. Të gjithë personat që kanë kryer vepra penale në Kosovë do të punojmë që t'i kthejmë para drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë. Nuk kemi të tjerë që donë të flasin.

Tash do ta votojmë Projektligjin në shqyrtimin e parë, pra në parim – Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Në sallë i kemi 71 deputetë. Thërras deputetët të bëhen gati dhe tekniken e të votojmë, dhe votojmë tash:

Me 56 vota për, 2 kundër dhe 11 abstenime, që i bie me shumicë votash, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Ngarkohen Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Të nderuar deputetë, tash kjo seancë e paradrekës mbaron. E kemi një seancë në orën 15:30. Ju falënderoj për bashkëpunim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën.
Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Mahir Yagcillar, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj synohet që të rregullohen festat zyrtare dhe të zvogëlohen ditët e pushimit në Republikën e Kosovës.

Ndryshimet e propozuara me këtë projektligj janë se nëse festat zyrtare bien ditën e shtunë ose të diel, pushimi nuk bartet në ditët pasardhëse të punës, përveç rasteve kur

festat janë nga pikat F, G, H, I, J, K të nenit 2.1 të Ligjit bazik, pastaj 9 maji - Dita e Evropës, largohet nga lista e festave zyrtare dhe me aprovimin e Projektligjit, 9 Maji nuk do të jetë ditë pushimi.

Me dispozitat e këtij projektligji, Qeveria e Republikës së Kosovës në raste të veçanta, me vendim mund t'i caktojë ditët e pushimit për administratën shtetërore.

Të nderuar deputetë, ju informoj se me kërkesën e Grupit punues për Legjislacion pranë Këshillit Konsultativ për Komunitete në Zyrën e Presidencës, në Projektligji është inkorporuar edhe propozimi që si ditë memoriale të jenë edhe 24 Qershori - Dita e egjiptianëve, 25 Qershori - Dita e kroatëve dhe 21 Maji - Dita e malazezve.

Këto kërkesa janë bazuar në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Projektligji është në pajtim me Kushtetutën, është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës të Qeverisë dhe është hartuar në formë dhe strukturë siç është paraparë me aktet ligjore.

Projektligji përmban gjithsej 7 nene dhe nuk ka elemente diskriminuese.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete buxhetore të parapara edhe në Deklaratën financiare për koston e projektligjit.

Të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni këtë projektligj në leximin e parë, duke besuar se në procedurat e shqyrtimit në komisionet parlamentare do të plotësohet edhe me propozimet tjera eventuale që ligji të jetë sa më i kompletuar dhe më efikas sa i përket implementimit. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, me ç'rast ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve ose në emër të grupeve parlamentare, por ministri tha nuk është diskriminues, ligji ka edhe diskriminim pozitiv, ka edhe diskriminim negativ. Mendoj që duhet ta shikojmë se ku është pozitiv e ku është negativ, por duhet të ndryshohet.

Në emër të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën? Fjalën e ka Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka diskutuar Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës dhe sigurisht që amendamentet e shtuara në nene do t'i përkrahë për shtimin e festave, ku përfshihet pra propozimi për shtimin e tri ditëve memoriale, siç janë 24 qershori Dita e egjiptianëve, 25 qershori Dita e kroatëve dhe 21 maji- Dita e malazezve.

Gjithashtu e mbështesim edhe largimin e 9 majit si ditë e Evropës e cila më parë është shënuar me pushim nga puna, e po ashtu edhe ditët e festave zyrtare kur bien në ditën e shtunë dhe të diel që nuk do të zëvendësohen tash e tutje, por do të ketë punë, me përjashtim të festave të Bajramit të Madh, Bajramit të Vogël, Krishtlindjeve katolike, Krishtlindjeve ortodokse, Pashkët katolike, pashkët ortodokse. Pra, nëse bien në ditën e diel, këto do të barten në ditën pasardhëse.

Mirëpo, Grupi ynë Parlamentar në vazhdim të punës, në fazën e mëtutjeshme, do të dalë me propozime që në festat zyrtare të futet edhe 28 Nëntori- Dita e Flamurit dhe me këtë akt vetëm dot ë përligjet një dëshirë e komunitetit shumicë në vendin tonë.

Ne kontributin do ta vazhdojmë pra në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministër,

Edhe në kuadër të Komisionit Funksional, por edhe në kuadër të Grupit Parlamentar, ne e kemi shqyrtuar dhe sot në parim ia japim mbështetjen këtij projektligji, ndërsa disa ide që i kemi si Grup Parlamentar, e që kanë dalë sot gjatë diskutimit, ne do të provojmë që t'i implementojmë. Do të bashkëpunojmë edhe me të tjerët në mënyrë që t'i implementojmë edhe disa ide, sidomos të disa datave që kanë krijuar obligim në gjenerata që ne t'i trajtojmë në mënyrë meritore. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “Vetëvendosja”, Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Është e ditur se çdo shoqëri e ka sistemin e saj të festave, për më tepër ato shprehin karakterin e një shoqërie, hartën e orientimit të saj dhe simbolet e adhurimit. Pra, asnjë shoqëri nuk mund të jetojë pa një sistem të tillë të festave.

Prandaj, festat nuk janë thjesht vetëm ditë jo të zakonshme, me të cilat synohet të ndërpritet rrjedha drejtvizore e ditëve monotone të një viti, por ato mbartin një kuptim shumë më të thellë social, psikologjik dhe vleror. Në këtë mënyrë ato mund të kenë funksione të dukshme e të padukshme brenda një konteksti shoqëror. Me këtë rast funksionet e dukshme mund të jenë ato që njihen dhe synohen nga pjesëmarrësit e një

lloji të veçantë veprimtarie, kurse funksionet e padukshme mund të kenë rolin e nxitjes së përforcimit të unitetit si dhe solidaritetit të një shoqërie.

Dhe mbi këtë kontekst social teorik duhet të analizuar dhe vlerësuar edhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës të cilin aktualisht po e diskutojmë.

Mirëpo, mënyra se si aktualisht ndryshon ky ligj krijon shumë paqartësi, sepse edhe pas këtij plotësim-ndryshimi përsëri 28 Nëntori nuk shndërrohet në festë shtetërore, por ajo mbetet vetëm si ditë memoriale së bashku me ditë tjera memoriale, ashtu edhe siç ka qenë më parë, por se tani këtij neni i shtohen edhe ditë tjera memoriale sikur 24 Qershori - Dita e egjiptianëve, 25 qershori Dita e kroatëve dhe 21 maji - Dita e malazezve. Pra, një datë me kuptime të shumëfishta kombëtare e cila funksionin kryesor dikur e ka pasur në mobilizimin politik e shoqëror rreth kauzës kombëtare dhe ka qenë e vetmja vlerë e solidaritetit tonë kombëtar, tani në shtetin tonë të pavarur multietnik e neoliberal përkufizohet vetëm si një datë memoriale për t'u konsumuar zyrtarisht vetëm simbolikisht, fakt ky të cilin pretendojmë se do ta ndryshojmë me anë të amendamenteve.

Është interesant tjetër të vihet në pah se po ashtu me këtë ndryshim- plotësim të ligjit tani pika E e nenit 2 të këtij ligji fshihet, me ç'rast 9 maji Dita e Evropës tash e tutje nuk do të jetë festë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Por ajo që nxit mëdyshje lidhur me këtë ndryshim dhe arsyetim ka të bëjë me faktin se kjo datë të paktën nuk mbartet as tek neni 5 që të mbetet si ditë përkujtimore. Dhe, 9 Maji nuk duhet harruar faktin se krahas Ditës së Evropës është edhe Dita e kapitullimit të fashizmit objektiv historik në Evropë. Pra, 9 Maji për Evropën është ditë e fitores së lirisë kundër robërisë, është ditë e emancipimit popullor kundër shtypjes fashiste, është ditë e barazisë mes popujve dhe barazisë brenda shteteve kundër primatit imperialist dhe eksploatimit të egër. 9 Maji për Evropën është një ditë e vetëvendosjes kundër perandorisë së imponimit nga jashtë dhe është absurde se si relativizohet tash me këtë ndryshim kjo festë. Edhe nëse mund të mos jetë ditë pushimi, të paktën ajo duhet të bartet si ditë përkujtimore.

Ndërkaq, ato ndryshimet e tjera që po ashtu mbesin problematike kanë të bëjnë me ndryshimet që prekin nenin 2, ku thuhet se kur ditët e festave zyrtare sikur pikat F, G, H, I, J të ligjit bien ditën e diel, ditë pushimi janë ditët pasardhëse të punës. Këto pika i mbulojnë festat fetare. Atëherë ky ndryshim lë të kuptohet se pikat tjera, nëse bien ditën e diel, nuk do të festohen në ditët pasuese. Këto janë pikat A, B, C dhe D, sikurse janë viti i ri, Dita e pavarësisë së Republikës së Kosovës 17 Shkurti, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës 9 prilli dhe Dita Ndërkombëtare e Punës, 1 Maji, datë kjo veçanërisht ditën kur u miratua ky projektligj në Qeveri u zhvillua një fushatë absurde kundër saj për ta aprovuar si festë zyrtare. Por 1 maji duhet pasur parasysh se si datë duhet të shërbejë sot më shumë se kurrë në një moment mobilizimi dhe solidarizimi si për punëtorët dhe ata që janë në kërkim të punës në Kosovë, sepse ata kanë nevojë për organizim të drejtë e parimor dhe për analizë të thuktë të konditave të tyre dhe perspektivave të zhvillimit.

Sot më shumë se kur ata kanë nevojë të rindërtojnë sindikatat e shkatërruara prej masave dhe reformave neoliberale apo të delitigjimuara nga një pushtet politik korruptiv.

Prandaj, që ky projektligj të bëhet i pranueshëm ka nevojë të amendamentohet e përmirësohet në aspektet e tija fundamentale në mënyrë që festat në këtë shoqëri që me të vërtetë të shndërrohen në datat e solidaritetit e të funksionalitetit e jo në datat e atomizmit dhe të disfunksionalitetit shoqëror dhe politik. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë.

Ne pajtohemi në parim për ta kaluar këtë projektligj, sepse janë bërë disa ndryshime jo aq të mëdha sa është pretenduar nga disa prej ministrave, është hequr një ditë që gjithë qytetarët e Kosovës e dinë që ne kemi pushuar kur nuk e kemi ditur as arsyen pse po pushojmë.

Megjithatë janë bërë disa ndryshime shumë të vogla, ne i kemi disa propozime si grup parlamentar i Aleancës. Unë po përmend vetëm një prej propozimeve, propozojmë që do të jetë, duke iu bashkangjitur edhe grupeve parlamentare domethënë PDK-së dhe “Vetëvendosjes” për 28 Nëntorin, një propozim tjetër i joni është që të kemi edhe një ditë memoriale bamirësisë e cila do të jetë 5 shtatori. Unë sugjeroj që arsyetimin për këtë ditë ta japim në Komisionin Funksional gjatë punës në këtë Komision.

Pra, për ta pasuruar këtë propozim ndryshim të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë këtë projektligj. Ne i përkrahim edhe ndryshimet të cilat janë bërë në këtë projektligj, mirëpo kërkojmë që 28 Nëntori- Dita e shqiptarëve të njihet si festë zyrtare në republikën e Kosovës.

Gjithashtu kemi edhe disa propozime të tjera, mirëpo ato do t'i diskutojmë edhe me kolegët tanë në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” dhe komunitetet turk, boshnjak dhe rom e përkrahin ndryshimplotësimin e Ligjit për festat zyrtare. Natyrisht që me këtë ligj jepet mundësia që edhe komunitetet jo shumicë të kenë ditët memoriale apo ditët e tyre që festojnë dhe ligji na lejon të shënojmë ose t'i festojmë ditët e komuniteteve, por atë ditë që e festojmë festat tona kemi kërkesën dhe do të japim propozim në Komision që në ditët e komuniteteve së

paku në arsimim të ketë ditë të lirë për atë komunitet, i cili e feston festën e vet dhe mos të zhvillohet procesi mësimor atë ditë për shkak që ne me një anë e festojmë ditën tonë po me një anë zhvillohet arsimimi dhe nuk mund të festojmë pa fëmijët, pa nxënësit, pa rininë.

Pra, e përkrahim, edhe në Komision do të përkrahim edhe kërkesat nga komunitetet tjera, sidomos kërkesën e komunitetit shumicë, por kemi edhe ne disa kërkesa dhe besojmë që për këto do të punojmë dhe do ta amendamentojmë në Komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, fjalën e ka deputeti Milivoje Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Zahvaljujem predsedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržaoe Nacrt zakona o izmeni i dopuni o zvaničnim praznicima, svoj doprinos daće kroz rad u Komisiji. Zahvaljujem!

KRYETARI: Tani fjala është për nënkryetarin e Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Është një ligj padyshim i rëndësishëm, po mund t’ju them është një ligj me shumë pak nene e me më shumë dysi brenda një formulimi është pak e vështirë ta gjesh. Ata që po thonë që kanë punuar shumë për ndryshimin e ligjit dhe kanë parë nevojën është dashur të jenë shumë më të saktë e shumë më preciz se ka shumë dysi të pastudiuara nëse lexohet ligji prej nenit të parë e në të fundit dalin një grumbull pikëpyetjesh.

Po ajo që unë dua të theksoj duhet ta them menjëherë që të mos harrohen, sepse do të flas edhe për sende të tjera.

Në një, mendoj që duhet të jetë formulim i qartë i saktë: festat fetare që bëhen festa kombëtare ose festa shtetërore po i quajmë ne dhe festat shtetërore, të gjitha, të gjitha me rend festohen ditën kur bie, qoftë e hënë, qoftë e diel, qoftë e shtunë, s’ka përjashtime dhe kjo është e thjeshtë dhe është konkrete dhe kjo i bie ajo që ka pas thënë Qeveria se na u kanë bërë shumë festa e po kalojnë ditët e pushimit e të papushimit e po shumëzohen egal, barabartë të gjitha festat kombëtare ose shtetërore të Kosovës festohen ditën që bien. Në rafshin të shtunën festohen të shtunën, të dielën, dielën, të hënë të hënë e të tjera. Kjo është nën një.

Nën dy, te festat shtetërore ose nacionale të Kosovës, si doni quani dikush thotë shtet, dikush nacion në kuptimin e shtetit duhet të hyjë si festë zyrtare pa tjetër 28 Nëntori - Dita e flamurit ose Dita e shqiptarëve si doni quani. Prej Skënderbeut deri te Ismail Qemali dhe mbas Ismail Qemalit gjithsecila datë e rëndësishme që ka identifikuar ndodhitë, ngjarjet me peshë për identitetin shqiptar lidhen me këtë datë më 28 Nëntor dhe është totalisht e paarsyeshme që një vend ku shumicën e popullit të atij vendit tash s’po e cilësoj me nacion, sepse te neni 2, thuhet, janë këto kritere. Te neni 2, ekzistues thuhet

kjo gjë, thotë: Duke pasur parasysh respektimin e historisë, kulturës dhe traditave të popullit, e pra nëse respektohet sipas dy, njëshit që është në ligj, historia, tradita de kultura e shqiptarëve 28 Nëntori - Dita e flamurit popullorçe i thonë ose Dita e shqiptarëve duhet të jetë festë shtetërore ose kombëtare, merrni cilindo përkufizim në Kosovë dhe menjëherë këtu dua të precizoj.

Unë pajtohem që të gjitha etnitetet ose minoritetet ose le ta zgjidhin ata si të donë emrin e vet, t'i kenë ditët përkujtimore dhe unë nuk kam kurrëgjë kundër ditëve përkujtimore, po le të bëhemi një herë konkret, le të bëhemi të qartë, të mos bëhemi hipokritë në të menduar, nuk është në Kosovë njësoj si Dita e shqiptarëve si Dita e kroatëve, po e zë, nuk është, sepse jemi mbi 90%, kultura, trashëgimia, identiteti etj. nuk janë njësojë, respekt është që atij ia bën ditën e, jo vetëm kroatëve, por edhe tetë të tjerëve dhe dy që thuhet që do të bëhen për serbët dhe një shumës që mbetet e padefinuar që thotë kryetarja me të tjerë do t'i zëvendësojë.

Pra, te ditët përkujtimore ekzistojnë 10 deri tash kanë mundësi që të bëhen plot, sepse ne i dëgjuam këtu edhe sot diskutimet dikush propozoi dhe është normale, sepse është çelur, nuk është vendosur asgjë.

Atëherë te festat nacionale ose shtetërore thashë duhet të jetë, ka mundësi edhe thjeshtësimi, edhe te festat nacionale. Unë këtu nuk dua të hyjë tutje se ajo që është ditë po thuhet Dita e Kushtetutës.

Shiko, unë nuk di kjo puna e Ditës së Kushtetutës ka për t'u bërë problem se bëhet shumë variabile cila, se këtu ka qenë një kushtetutë edhe në vitin '91 edhe ju them që s'ka qenë për kohën më e keqe se kjo e mëvonshme. Kështu që unë po tutem që e ndërrojnë si shpejtë këtë e tani çka festojmë, festojmë veç si simbol që kemi bërë Kushtetutë, por unë po ju them që ka pasur edhe më herët. Pra, kur bëhen këto festa nëse nuk doni t'i ndërroni për ditë, atëherë duhet fundament.

Dhe, unë dhe një herë po e përsëris, zoti kryetar dhe kolegë të nderuar, që këtë që po e them unë nuk ka arsye të mos ta mbështesin gjithë deputetët shqiptarë tash po them dhe gjithë të minoriteteve, sepse janë të nderuar të gjithë.

Unë e pyeta për shembull deputetin pse është filan feste e boshnjakëve dhe ai më tha se më interesonte motivi, pse e kanë zgjedhur atë ditë? Tha, po se atë ditë na është kthyer emri boshnjak. Bravo! Ata e kanë motivin e emrit të nacionit të vet, mirë e kanë motivimin. Hajde le ta pranojnë të gjithë këta motivimin shqiptar që s'ka identitet kulturor, historik, etnik, shqiptar pa një 28 Nëntor. Dhe unë pres që ata do ta votojnë të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!
Përsëritje zëvendëskryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Trajtojmë Projektligjin për festat zyrtare. Këtë ligj ne e kemi miratuar në kohën e paketës së Ahtisarit të shpalljes së pavarësisë dhe i shpallëm disa nga festat zyrtare që e cenuan dhe bënë diskriminim negativ në raport me shumicën e popullatës edhe popullsisë në Kosovë, shqiptarët.

Për mua ka qenë edhe atëherë edhe sot është mos hyrja në pikën e Projektligjit Dita e 28 Nëntorit është një diskriminim negativ nga Qeveria që i vjen Kuvendit të miratojmë për festat zyrtare.

Ne nuk jemi kundër asnjë feste, por jemi për të gjitha festat por festa e 28 Nëntori është festë e shumicës absolute shqiptarëve në Kosovë dhe kombit shqiptarë, prandaj edhe këtu duhet ta ketë vendin e vetë si festë zyrtare, si festë shtetërore dhe festë kombëtare.

Unë kam propozuar edhe amendament që t'ia drejtoj Komisionit që merret me këtë çështje, por në çështjet e ligjeve është edhe një paradoks gjithë bota demokratike apo Evropa punon në ditët e 1 Majit, ne kemi festë. Ne si shtet ndryshojmë nga gjithë Evropa dhe tentojmë të hyjmë në Evropë. Prandaj edhe kjo pika d) e nenit 2, mendoj që është festë zyrtare kjo duhet të hiqet sepse nuk ka arsye të jetë.

Po ashtu edhe fjalën e profesorit Sabri Hamiti që tha po edhe Dita e Kushtetutës nuk është një arsye e fortë që të jetë si festë ose si ditë zyrtare.

Prandaj, të gjitha festat tjera që prezantojnë pakicat apo minoritetet janë festa të cilët ne duhet t'i përshëndetim dhe festat e reja që kanë ardhur për kroatët, malazezët por festa e shqiptarëve, kombit shqiptar 28 Nëntori është festë shtetërore dhe duhet të jetë pjesë e këtij ligji, përndryshe ne jemi pa identitet, jemi pa kulturë, jemi pa traditë, jemi në formën e vullnetarizmit me antiligjin. Prandaj, duhet që Kuvendi ta votoj dhe ta vë festë zyrtare shtetërore ditën e 28 Nëntorit Ditën e shqiptarëve, Ditën e Flamurit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ndoshta pa dashtë me i përsërit të tjera ne kemi mundësinë edhe në Komision të bisedojmë dhe Grupi Parlamentar i LDK-së dha mendimin e vetë. Megjithatë gjërat që duhet të respektohen bën edhe të përsëriten, kjo ka të bëjë ë me festën e 28 Nëntorit, ngase ky shtet ka identitet dhe ajo e cila bie ndesh me nenin 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me lajicitetin këtij shteti e që me favorizime që ju jepet festave fetare, në njëfarë forme e cenon lajicitetin e shtetit prandaj duhet të kihet parasysh që nuk mund të favorizohen në raport me festat zyrtare që mendoj gjatë amendamentimit do të shikohet me kujdes në punën e Komisionit. Këtë e kisha. Faleminderit!

KRYTARI: Fjalën e ka deputeti Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsjedniče!

Kolege poslanici,

U celosti podržavam izmenu i dopunu Zakona o zvaničnim praznicima u potpunosti se slažem sa poslasticima nevećinskih zajednica e zahtevam od Komisije za javnu administraciju da učenici i profesori budu oslobođeni školske nastave toga dana kada se slave nacionalni praznici određenih zajednica, konkretno mislim na nacionalni dan Bošnjaka Kosova. Zahvaljujem se.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit i nderuari kryetar i Kosovës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky ka qenë njëri nga ligjet që ka pasur nevojë që të plotësohet dhe të ndryshohet. Në këtë ligj orari i punës, kushtimisht i shtohen deri në 6 ditë pune me këtë ligj ne do të jemi më konkurrent, janë hequr kushtimisht 6 festa të cilat mund të vijnë në ditët e diele, këto janë festat fetare të cilat po ashtu respektohen.

Ky ligj e përmirëson mundësinë që Kosova të bëhet konkurrent në tregun e lirë botëror të punës, të bëhet favorizuese për investimet e kapitalit të huaj këtu edhe u jep mundësi punëtorëve publik që ta rrisin përvojën edhe të jenë efikas në ofrimin e shërbimeve për qytetarët tanë. Në këtë Kuvend duhet sa më shpejtë të vijë edhe Ligji i punës për shkak se edhe aty duhet të ndryshohet dhe të plotësohet shumë çka me qëllim që së bashku me këtë ligj, ne t'i shtojmë vendit tonë ditët e punës që të mos jenë vetëm 195 ditë pune, por të jenë si në gjithë Evropën, 225 deri në 230 ditë pune. Kjo ndoshta për një pjesë të shërbyesve civil nuk do të jetë mirë por ata që janë të papunë do të jetë shumë mirë sepse do të shtohet interesimi i të huajve që të vijnë të investojnë në vendin tonë dhe ata ta gjejnë vendin e tyre të punës dhe ta krijojnë me mirëqenien e tyre dhe të krijojnë mundësi të punës si gjithë të tjerëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Unë dëshiroj shumë shkurtë të theksoj se kam pritur pak më shumë nga ky ndryshim i ligjit, domethënë se është bërë vetëm një hap, një gjysmë hapi të them ashtu, ka ende mundësi që të racionalizohen. Unë mendoj se në përgjithësi, në qoftë se festa bie në ditët e pushimit, nuk duhet të zgjatet në ditët e punës, kjo e para. E dyta, ditët e pushimit për festat që i përkasin një komunitetit janë karakteristike për atë komunitet, nuk ka nevojë që të zbatohen në të gjitha komunitetet. Nuk punojnë pjesëtarët e atij komuniteti edhe pushojnë pjesëtarët e atij komuniteti. Nuk ka nevojë që ne të kemi pushim të gjithëmbarshtëm dhe mendoj se në leximin e dytë mund të bëhen amendamente me të cilat ky ligj duhet të bëhet edhe më racional. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë e mbështes nismën për të ndryshuar Ligjin ekzistues, mbështes edhe propozimet që u thanë dhe meqë jemi në shqyrtim në parim, dua vetëm të insistoj që gjatë amendamentimit të shfrytëzohen përvojat e vendeve tjera dhe të mos shkojmë prej një skaji në skajin tjetër. Ajo që i mungon ligjit tonë është ndarja e festave siç është në shumicën e vendeve, në festa të karakterit ndërkombëtar, në festa të karakterit kombëtar, në festat që janë shtetërore dhe në festa të tjera dhe pastaj zgjidhje të jenë konform me karakterin, natyrën e tyre.

Duke ruajtur atë që e thanë disa diskutues që të mos bëjmë një zgjidhje për një komunitet që pastaj i mohohet një komuniteti tjetër. Për shembull ose për një festë që i mohohet festës tjetër. Nëse lejohet që të zhvendoset dita e festës prej ditës të shtunës të dielës, për festat afetare. Shtrohet çështja: cila është logjika që një festë që mund të jetë e rëndësishme së veçantë, e karakterit tjetër, ajo megjithatë të mos zhvendoset. Nuk është kjo punë për të pushuar vetëm, por praktikisht pamundësohet festa nëse ajo edhe bëhet në të njëjtën ditë të punës. Unë jam për t'i racionalizuar këto dhe mendoj që racionalizimi duhet të bëhet gjatë amendamentimit duke i kategorizuar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kohëve të fundit është quar mjaftë pluhur se kemi shumë festa të shoqëruara me shumë ditë të lira pune që shkaktojnë ngecje në punë se sidomos në administratë, prandaj është paraqitur nevoja për plotësim-ndryshim të këtij ligji në mënyrë që të reduktohet numri i ditëve të pushimit nga puna. Në fakt shtrohet pyetja se a punon administrata dhe çdo institucion tjetër shtetëror në mënyrë efikase gjatë ditëve dhe orarit të tyre të punës? Unë personalisht ka dyshime, prandaj mbetet të shohim se ky reduktim sa kemi mundur ta bëjmë i ditëve të pushimit, sa do të ndikojë në rritjen e efikasitetit të punës në institucionet tona. Ndërkohë dëshiroj që në emër të Lëvizjes për Bashkim, gjithashtu të kërkoj që 28 Nëntori të shënohet si festë shtetërore dhe të ketë ditë pushimi. Për rëndësinë e kësaj date për popullatën shumicë të vendit tonë mendoj se është e tepërt të diskutohet, vetëm ta kujtojmë 28 Nëntorin që shkoi dhe ato pamje në kujtesën tonë, mendoj se flasin vetë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është mirë që sot po diskutojmë për këtë ligj dhe Qeveria na ka sjell dhe i ka bërë disa ndryshime, mund t'i quaj të vogla dhe gjatë leximit të këtij projektligji, vërejtja se nuk ka asnjë datë të veçantë për dëshmorët. Duke pasur parasysh këtë fakt, unë sot i nderuar kryetar dhe të nderuar kolegë deputetë, e propozoj që data 6 mars të jetë Dita e dëshmorëve. Kjo datë edhe ashtu shënohet në Republikën e Kosovës duke bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe shënohet me aktivitete tjera, por për fat të keq ende nuk është festë zyrtare, prandaj propozoj që data 6 mars të jetë Ditë e dëshmorëve, sepse kjo

datë është bazamenti i lirisë së Kosovës po në këtë datë kanë filluar rrënjët e lirisë së Kosovës.

Unë kërkoj nga Komisioni përkatës që ta përfshijë amendamentin tim, propozimin tim si amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çdo vit me 28 Nëntor, Qeveria e Kosovës ua uron të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, 28 Nëntorin Ditën e flamurit kombëtar. Dita e shqiptarëve, ky është përcaktimi institucional që festa e pavarësisë të Shqipërisë, e njohur edhe si festa e flamurit, ka gjetur në librin e festave memoriale të Republikës së Kosovës. Nuk e pati nderin as këtë herë të futej as në listën e festave zyrtare, listë në të cilën rreshtohen të gjitha llojet e festave fetare Bajram e Ramazan, krishtlindje e pashkë, katolike e ortodokse apo të vetë Dita e Evropës, që këtë herë do të fshihet. Shikoni çfarë absurdi, shqiptarët e Kosovës mund ta festojnë ditën e Evropës, por jo atë që vetë e quajtën Dita e shqiptarëve, e ngjashme kjo me absurdin tjetër edhe më të madh, kombet e Evropës mund të bashkohen, por shqiptarët nuk duhet as të ëndërrojnë bashkimin e kombit. Por lë t'i kthehem serish festës së flamurit.

Natyrisht, Prishtina çdo 28 Nëntor vishet kuq e zi. E veshin qytetarët e Kosovës, sepse kjo tashmë është një festë e ndaluar. Ka një rregull psikologjik, të cilin e parafrazon shumë bukur shkrimtari amerikan Mark Twen: “Sa më shumë t'i ndalosh gjërat, aq më popullore ato bëhen”.

Çështja është, se a e kanë luksin shqiptarët e Kosovës të lejojnë që festat kombëtare të shndërrohen sërish në sub-kulturë, ashtu sikurse kanë qenë në vitet e regjimit serb? Në sociologji, antropologji apo studime kulturore si sub-kulturë konsiderohet një grup njerëzish që kanë një kulturë, mund të jetë e ndryshme dhe e fshehur, e cila i diferencon ata nga një kulturë më e gjerë, të cilës i takojnë.

Cilësi që e përcaktojnë një sub-kulturë mund të jenë gjuhësore, fetare, politike, seksuale, gjeografike apo një kombinim faktorësh. Në Kosovë është e qartë, ato janë politike.

Dhe, duke u nisur nga ky përcaktim Dita e shqiptarëve ka një vlerë të zvogëluar në raport me Ditën e flamurit të Kosovës, edhe pse ky është një flamur që u prodhua për shkak të nevojës politike dhe diplomatike. Ditët e sakrificës së familjes Jashari 5 - 7 mars, kanë një vlerë të zvogëluar në krahasim me bashkëjetesën multietnike në bazë të asaj çfarë thuhet në këtë projektligj.

Pra, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës po shkojnë më tej asaj që iu është kërkuar si kompromis, po shkojnë drejt mohimit të vetvetes. Askush nuk do t'i ndalojë shqiptarët e Kosovës ta mbajnë flamurin, sikurse ndalohen për shembull ata në Luginën e Preshevës

apo edhe në Maqedoni herë pas here, por çështja është tek mohimi institucional. E të mohosh institucionalisht, do të thotë të shndërrohesh në subkulturë.

Nuk besoj që është luftuar në këtë vend për të shndërruar vlerat kombëtare në subkulturë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Jam munduar me kujdes ta lexoj ligjin, mirëpo bashkëfolësit ezauruan shumë vërejtje të cilat besoj që do të plotësohen në leximin e dytë dhe të cilat kanë vend edhe kanë bazë për t'u shtuar dhe për t'u plotësuar duke filluar nga 28 Nëntori, i cili tejkalon interesin tonë personal, duke vlerësuar lart edhe identitetin tonë kombëtar, pa e fshehur para askujt.

Prandaj kjo është e pakontestueshme, që 28 Nëntori të mos zërë vend në festat tona të rëndësishme kombëtare, sepse pavarësisht të gjitha veprimeve politike dhe pozicionit juridik që ka Kosova, ne sot kemi edhe një monitorim ndërkombëtar, por nuk mund të bëjmë qejfin që të humbim edhe identitetin tonë kombëtar komplet dhe të bëjmë eksperimente me vetveten.

Njëra ndër festat tjera të cilat unë mendoj, meqë janë radhitur shumë festa, është me rëndësi që të futet edhe si festë zyrtare edhe Dita e lumturimit të Nënë Terezës. Ajo i tejkalon hapat fetarë apo vlerësimin fetarë sa është e ngritur lartë në aspektin humanitar ndërkombëtar dhe është një shqiptare e cila është me nacionalitet dhe 19 Nëntori duhet të shpallet si festë, mendoj festë e cila duhet të shënohet nga ne dhe të vlerësohet në leximin e dytë në një amendament nga Komisioni, i cili besoj do të gjejë kohë ta vlerësojë pse kjo bëhet në atë mënyrë, si 19 Nëntori - Dita e Lumturimit të Nënë Terezës.

Besoj në leximin e dytë do të japim edhe si vërejtje në amendamentimet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Nuk po dua të përsëris ato që thanë kolegët tjerë deputetë, por unë po dua të përmend, më vjen mirë që kam mundësinë që ky ligj ka ardhur në plotësim-ndryshim. Ky është njëri nga ligjet e Pakos së Ahtisarit, është njëri nga ligjet e kompromiseve të mëdha, por të domosdoshme për rrugëtimin e Kosovës në atë kohë dhe tani jemi në fazën kur ne kemi mundësi të bëjmë plotësime dhe ndryshime të ligjeve të tjera jo vetëm të këtij ligji.

Projektligji për festat zyrtare në kohën kur është miratuar në Pakon e Ahtisarit ka qenë njëri ndër projektligjet, të cilat kanë hasur në rezistencën e deputetëve të këtij Kuvendi dhe unë kam qenë njëra nga deputetet që nuk e kam votuar në atë kohë, mu për shkak se

festat e 28 Nëntorit që lidhet qetësisht me identitetin e shqiptarëve nuk është përfshirë atëherë dhe tani u përmend nga shumica e grupeve parlamentare se duhet të përfshihet kjo festë dhe për mua është edhe një tjetër çështje e rëndësishme, siç e përmendi edhe kolegja nga LDK-ja, Liria, është një pikëpyetje e madhe se a e cenon laicitetin festat fetare që janë futur në këtë ligj e që bien në kundërshtim me Kushtetutën, me nenin që thotë që Kosova është një shtet laik.

Unë jam kundër numrit të madh të festave, sepse ne si Kosovë kemi nevojë ende për të punuar shumë dhe ndoshta duhet të gjejmë ndonjë model, të festojmë duke punuar dhe të jenë festa të veçanta, të cilat vërtet duhet të pushohet dhe të festohet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Gjithashtu edhe unë e kam lexuar Ligjin për festat zyrtare në Kosovë dhe me të vërtetë nuk është bërë ndonjë ndryshim i madh nga ligji paraprak, por konsideroj që me riamendamentimin ose me shqyrtimin e tij në Komisionin përkatës do të kemi mundësi që të japim kontributin tonë si deputetë.

Gjithashtu dua të mbështes fuqishëm kërkesën që festë zyrtare në Kosovë të jetë edhe 28 Nëntori, duke pas parasysh që u përmend nga parafolësit tanë, nga nënkryetari i Kuvendit, që jemi shumicë në Kosovë dhe duke marrë këtë fakt për bazë, pavarësisht sa duam të jemi tolerantë dhe të respektuar, mendoj se nuk mund të jemi tolerantë ndaj askujt dhe ta respektojmë askënd, nëse në parim nuk e respektojmë vetveten.

Dhe, mendoj që është një moment i fundit që kjo festë të jetë zyrtare në Kosovë dhe ne si deputetë të mos lëshojmë rastin që ky moment të na ikë. Gjithashtu, më lejoni që të solidarizohem ose thjeshtë të mbështes edhe kërkesën që e dha kolegja jonë Valbona Dibra, që 6 Marsi të jetë si Ditë e Dëshmorëve në Kosovë, duke marrë parasysh që edhe 14 vjet pas luftës Kosova e shënon ende nuk e ka një datë të caktuar të dëshmorëve dhe ende nuk festohet zyrtarisht kjo festë.

Gjithashtu, në Ligjin për festat duhet të jetë e qartë që në ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe në datat e veçanta të Kosovës, të jenë sa më të zbatueshme dhe nëse është festë, atëherë me të vërtetë të jetë festë, sepse nga institucionet shpeshherë del një laramani dhe nuk vërehet se çka faktikisht po feston Kosova dhe shteti jonë. Faleminderit!

Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi e ka fjalën.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Mendoj që shpeshherë po thirrëmi në dokumentin e presidentit Ahtisari. Unë mendoj që me disa votime që i kemi bërë në Kuvend, ky dokument është tejkaluar dhe mund të thirrëmi në një dokument tjetër, ai është i harxhuar.

Megjithatë, pasi jemi te ky ligj që ka të bëjë me festat dhe mendoj që është një ligj që i vendos disa norma, pasi që unë nuk jam pjesë e Komisionit, dëshiroj të kontribuoj dhe t'ju ndihmoj, nëse Komisioni do ta marrë parasysh.

Edhe pse në praktikën tonë festat gjithnjë kuptohen si pushim, si mospunë, unë mendoj që duhet ta ndryshojmë logjikën pak dhe duhet të mësohemi të festojmë edhe duke punuar dhe, kurrë nuk ia prish bukurinë festës edhe pse ne zyrtarët edhe në ditë festash realisht nuk kemi festë. Por megjithatë është pjesa tjetër, që e ka atë festën.

Duhet të zbatohet një normë për të gjitha festat. Festat le të festohen, qofshin shtetërore, qofshin fetare, qofshin ndërkombëtare në atë ditë që bien dhe jo të vazhdohet çdo festë edhe një festë tjetër, t'i bëjmë nga dy e tri bashkë. Mendoj që kjo duhet të jetë një standard për të gjitha festat. Është e pakuptimtë që ne të flasim për një dy-tri festa në mënyrën siç na është imponuar të flasim. Nëse këtu jemi përfaqësues të qytetarëve dhe përfaqësojmë vullnetin e tyre, atëherë ka pushuar çdo arsye që 28 Nëntori të mos jetë festë kryesore e kombit shqiptar, kudo që është ai, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi, në Turqi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Evropë, është festë kombëtare dhe ne kështu duhet ta ndjejmë. Nuk kemi nevojë të na vijë keq prej askujt. Dhe kjo festë duhet të jetë “në ballë të oxhakut” e pastaj vijnë edhe të tjerat, se të tjerat ka edhe kush tjetër t'i festojë.

Çështje tjetër, që mendoj se duhet ta shikojë Komisioni, është çështja e 5, 6 dhe e 7 marsit. Kjo mund të jetë një Ditë e Dëshmorëve e përcaktuar, por unë konsideroj që duhet të jetë, atë traditën që e ka krijuar kjo festë 5, 6 dhe 7 marsit. Kurrë nuk e prishë bukurinë e saj nëse edhe punohet edhe nderohet. Është një obligim i të gjithë neve që jemi këtu dhe i atyre që s'janë këtu, për të pasur një nderim të veçantë. Këtu kanë hyrë edhe festat tjera dhe që është mirë të shënohen dhe të përkujtohen, jo të gjitha për të ndenjur mos punuar, por mund të festojmë edhe duke punuar.

Konsideroj që i kemi hyrë në hak edhe një komuniteti tjetër në Kosovë. Dhe, një komunitet tjetër, që vërtet në historinë tonë ka një rol të veçantë dhe se ka pasur një rol të veçantë. Është fjala për bektashinjtë. Dhe, pasi që janë të gjitha këto festa të grupeve të ndryshme fetare dhe etnike, unë mendoj që edhe bektashinjtë e Kosovës duhet ta kenë një datë të shënuar, qoftë si datë që përkujtohet.

Dhe, natyrisht jam që edhe një datë përkujtuese, por jo datë për të pushuar, por datë për të festuar mund të jetë edhe 5 shtatori. Gjithnjë ne duhet të shikojmë që festat të jenë të standardeve. Nuk jemi të parët ne si shtet as si Republikë e as si Kuvend, që po e bëjmë një ligj, po thirrëmi në standarde. Atëherë, po e marrim një ligj më standard që ekziston në Bashkimin Evropian, ku ne në grupin e shteteve të Bashkimit Evropian, ku ne po synojmë të shikojmë, ta marrim një standard edhe ta zbatojmë atë standard.

Edhe njëherë po e përsëris, nuk ka asnjë arsye që festat fetare të vazhdojnë, atë ditë që bien - festohen, edhe festat shtetërore edhe festat ndërkombëtare dhe këtë mënyrë jemi, konsideroj tamam edhe me ligjin, por edhe me kërkesat që i kanë qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit. Faleminderit!

Drejtimit e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë do t'u bashkëngjitëm të gjithëve që debatuan dhe unë i përcolla nga jashtë, lidhur me amendamentimin e Ligjit për festat shtetërore në Kosovë.

Kujtoj se ky ligj që vjen me propozime nuk është i plotë dhe në një mënyrë të shkakton një revoltë, sepse edhe ligji si ligj i pakos së Ahtisaarit e kishte këtë natyrë, neve ai na shkaktoi shqetësim, sepse nuk e pamë vetveten në mesin, si popull shumicë nuk e pamë vetveten në mesin e festave, domethënë nuk e pat ditën tonë më të shënuar e që është Dita e Flamurit ose 28 Nëntori, si festë e madhe, ku në çdo kohë edhe atëherë kur ishim të penguar dhe të ndjekur ne e festuam.

Unë nuk mund të pajtohem që bëjmë një ndryshim dhe në këtë ndryshim të këtij ligji të mos jemi ata që të ndryshojnë, pra të shënojmë edhe 28 Nëntorin si festë e flamurit, sepse ajo festohet gjithandej. Me këtë flamur ranë dëshmorët në të gjitha luftërat, me këtë flamur udhëhoqi luftën edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe nuk kam shumë për të shtuar nga këto fjalë që u thanë, ky flamur e bashkon popullin shqiptar kudo që ndodhet.

Dhe, është festa më e madhe, kujtoj është festë më e madhe se sa festat fetare në Kosovë, të cilat jo secili mund t'i festojë, sepse festat fetare është mirë të ndahen ata që e festojnë Bajramin dhe ata që i festojnë festat tjera siç u përmendën këtu.

Sigurisht, se do të ketë amendamentim për 28 Nëntorin dhe besoj që deputetët e Parlamentit të Kosovës më në fund do të marrin guximin që festa mbi festat ta quajnë këtë ditë.

Unë gjithashtu e kam të paqartë pse fshihet 9 Maji- Dita kundër fashizmit. Ne nuk kemi qenë popull dhe nuk jemi popull që kemi qenë në anën e fashizmit dhe tani domethënë e heqim këtë ditë. Kjo nuk na ka hije, sepse jemi për integritet evropian dhe jemi në krahun e popullit antifashist. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe diskutuesi i fundit për këtë çështje, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar,

Unë në këtë temë do të rezervohem për arsye të respektit për kolegët ngaqë e ezauruan këtë temë dhe unë të gjitha idetë dhe propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit

për festat zyrtare do t'i dorëzoj me shkrim në sekretari dhe kësaj radhe nuk do të përsëris shumë nga kolegët e mi, të cilët i kishin pothuaj të njëjtat ide.

Dhe, sidomos paraqitja e zotit Kryetar të Kuvendit me të cilin ndoshta për perspektivën na ndajnë konceptet, por për të kaluarën, e sidomos për Ligjin për festat zyrtare e kemi një edukim dhe një formim pothuaj të përafërt dhe nuk mund t'ju shtoj asnjë gjë, përveç se që do të bëj renditjen e propozimeve dhe ideve për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo. Nuk kemi kuorum për të votuar, vazhdojmë me pikën e radhës:

14. Shqyrtimi i parë për Projektligjin për kimikate

Dhe pastaj vazhdojmë nesër. Shqyrtimi i parë për Projektligjin për kimikate. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit, Dardan Gashi.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit,

Me Projektligjin për kimikate synohet të arrihet një administrim i mirë dhe i efektshëm i kimikateve në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj ndër tjera rregullon: vendosjen në treg të substancave dhe përzierjeve të rrezikshme si dhe përcaktimin e mënyrës së kontrollit të tyre, përcaktimin dhe vlerësimin e rreziqeve që mund të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e njeriut dhe mjedisit, shqyrtimi dhe lëshimin e lejeve për qarkullimin, trajtimin dhe përdorimin e kimikateve dhe mbajtjen e regjistrit të kimikateve, regjistri i personave fizikë dhe juridikë që tregtojnë dhe përdorin kimikate, kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin, eksportin dhe transitin e kimikateve të rrezikshme.

Ky ligj po ashtu përcakton kushtet për vendosjen në treg të detergjenteve, lëshimin e lejeve dhe mbajtjen e regjistrit të detergjenteve.

Sipas këtij projektligji Ministria me akt nënligjor themelon Zyrën Informative për Ndihmë, e cila informon dhe jep këshilla për prodhuesit, importuesit, furnizuesit, përdoruesit dhe çdo palë tjetër të interesuar në lidhje me përgjegjësi dhe detyrimet e tyre sipas këtij projektligji.

Deputetë të nderuar,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji ju ftoj që ta votoni këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjala është për kryetarin e Komisionit Funksional, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministër, zëvendëskryeministër,

Komisioni Funkcional për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 56, paragrafi i 2, të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime.

Komisioni pas shqyrtimit të Projektligjit për kimikate e vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ju rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë.

Me këtë ligj vendi ynë është më afër me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe përfshirja në këtë ligj të disa standardeve e bën të mundur qarkullimin e mallrave edhe të vendit tonë me vendet e Bashkimit Evropian.

Ky ligj ka për qëllim definimin e procedurave për administrimin dhe menaxhimin e saktë të kimikateve, të cilat janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin. Personat fizikë dhe juridikë obligohen që të nxjerrin në treg kimikatat e rrezikshme që këtë punë ta bëjnë pas klasifikimit të tyre sipas disa pozitave të këtij ligji dhe përcaktimi të kushteve për vendosjen e tyre në treg duke i ndjekur të gjitha procedurat që i obligon ky ligj.

Ligji e përcakton përgjegjësit e autoritetit kompetentë për zbatim dhe monitorim të tij. Me miratimin edhe të Ligjit për inspektoratin mjedisor i cili do të vijë shpejtë këtu për t'u lexuar për herë të dytë po e përafrojnë mbylljen edhe të kësaj hallke ligjore dhe e cila do të shërbejë shumë mirë për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit. Ky është edhe rekomandim i Komisionit Evropian, i dalë nga Raporti i Progresit.

Grupi ynë parlamentar ka disa vërejtje sa i përket afateve të hartimit të strategjisë për menaxhimin e kimikateve, që është paraparë të hartohet për 3 vjet, domethënë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Po ashtu, ne nuk jemi dakord edhe për miratimin e planit kombëtar të sigurisë nga kimikatat, i cili është paraparë të jetë në një afat prej katër vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Po ashtu, nuk kemi vërejtje edhe për miratimin e akteve nënligjore për të cilat është paraparë një afat pesëvjeçar nga data e aprovimit të këtij ligji. Mendojmë që këto afate mund të shkurtohen dhe nuk është në rregull që të shkojnë kaq gjatë.

Ne do të përpiqemi që këtë gjë ta rregullojmë përmes propozimeve që do t'i bëjmë në Komision.

Pas këtyre vërejtjeve, Partia Demokratike e Kosovës mendon që në parim ky projektligj ia vlen të kalojë, ndërsa punët tjera do t'i bëjmë bashkë me Komisionin . Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta mbështes.

Një vërejtje ose kërkesë, sa i përket deklaratës financiare, nuk është vetëm ky ligj por janë edhe ligjet tjera, një pjesë bukur e madhe ligjesh që vijnë në komisionin tonë, Komisionin për Mjedis dhe Bujqësi. Janë disa ligje për të cilat kanë kosto shtesë buxhetore, njëkohësisht kërkohen edhe staf shtesë i ri, prandaj do të ishte mirë që kësaj radhe do të thotë të kihet parasysh kur sponzorizuesi e sjell projektligjin në Parlament, të kihet parasysh që deklarata financiare të jetë e pranueshme, sepse nëse ka kosto shtesë atëherë këto ligje nuk po janë të implementueshme dhe kjo është e paraparë me Rregulloren e Parlamentit.

Përndryshe, ne në parim e mbështesim dhe do të kërkojmë plotësim ndryshimin e amendamenteve do të thotë gjatë hartimit të leximit të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin për kimiketet. Gjatë shqyrtimit nuk kemi hasur në ndonjë vërejtje përmbajtësore, andaj të njëjtin edhe ne do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputetja Time Kadriaj e ka fjalën.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është menaxhimi i drejtë i kimikateve të rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut të mundshëm nga kimiketet, të cilat mund të ndikojnë, të shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

Ligji për kimikate kryesisht trajton dhe rregullon procedurat për regjistrimin e kimikateve, notifikimin, klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme.

Ky ligj, në fakt është një ligj i rëndësishëm së veçantë edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta votojmë në parim.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovën e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar! Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI: “6+”, SLS-ja nuk ka. “Zajednička Budućnost” nuk është lajmëruar.

Atëherë, vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 18 korrik 2013
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 18 korrik 2013.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Po, meqë do të kemi votime dhe ato regjistrohen me elektronikë, unë ju lus që të konstatojmë praninë në mënyrë elektronike. Deputetë dhe regji, bëhuni gati!

Votojmë tash. Prania elektronike thotë 59. A është dikush që ...

Ju lus edhe një herë për prani elektronike. I prekni ato, susta, pulla! Votoni tash.

Shikoni, të pranishëm janë 64 fizikisht e psiqikisht, ndërsa këtu me elektronikë janë 59. Edhe t’ju jap shpjegimin pse. Tash po hyjmë në votime dhe në votime që janë specifike, që kërkojnë 61 vota dhe që kërkojnë edhe 13 vota specifike, prandaj keni kujdes pse po e kërkoj këtë.

Vazhdojmë punën.

Vazhdojmë me pikat e mbetura të rendit të ditës në vijim:

- Diskutimet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Këto diskutime kanë mbaruar dje pasdite. Unë tash ju tërheq vërejtjen dhe vëmendjen se për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Ky është neni 81, paragrafi 1, pika 1 e Kushtetutës. Pra, kërkohet për të kaluar ligji normalisht, 61 vota “për”, nga deputetët e Kuvendit dhe 13 vota “për” nga deputetët e komuniteteve pakicë.

Unë besoj që është e qartë. Është kuptuar çka. Atëherë, e vë në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës. 66 deputetë janë. Votojmë tash.

Kemi 62 vota për, 1 abstenim dhe 1 kundër. Ne nuk e shënuam rezultatin, një kusht ka kaluar, se 62 vota kanë votuar për. Atëherë, duhet të pritët pas regjistrimit ta japim rezultatin në bazë të Kushtetutës.

Kalojmë te votimi në parim i Projektligjit për kimikate. Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e djeshme, në mbledhje janë të pranishëm 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Me 61 vota për, me 3 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 04/ L- 197 për kimikate.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Këtu do të duhej që ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq ta paraqesë në Kuvend projektligjin. Kush e ka marrë për detyrë prej Qeverisë këtë punë? Domethënë, Qeveria nuk është e përgatitur që ta paraqesë para deputetëve projektligjin.

Po, po normalisht kjo shkoi, s’kemi çka të bisedojmë, por a i morët ato rezultate?

Tash e kam rezultatin për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës. Pra, kanë votuar për 62 deputetë dhe kanë votuar për 10 deputetë të minoriteteve, domethënë nuk e kemi 13-shin e kërkuar.

Kështu që ligji nuk ka kaluar. Shkojmë tutje:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni Funksional për Legjislacion ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë me përjashtim të nenit 6, paragrafi 2 për të cilin ka propozuar një amendament për miratim. Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Legjislacion, zoti Arben Gashi, që ta arsyetojë raportin e Komisionit Funksional me rekomandime. Urdhëro, zoti deputet.

ARBEN GASHI: Faleminderit! I nderuar nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4.3. 2013 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronës dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e këtij projektligji.

Komisioni ka vlerësuar se nenet 6.2, 7.1, 8.2, 9.1, 16.8, 25.2, 25.3, 25.4 dhe neni 29.1 të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës janë në kundërshtim me amendamentin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 5 të Ligjit për ndryshime dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Kuvendi, në mbledhjen plenare të mbajtur, më datën 19 mars 2013, e ka miratuar në parim projektligjin përkundër rekomandimit negativ të Komisionit dhe e kanë kërkuar Komisionit për Legjislacion si Komision Funksional që në afatin prej 2 muajve ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Komisioni për Legjislacion duke vepruar në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 04/ V-554 të datës 19 mars 2013, në mbledhjen e mbajtur, më 29. 4. 2013 ka pasur në shqyrtim projektligjin. Në këtë mbledhje deputeti i PDK-së Behar Selimi, ka propozuar që të formohet një grup punues që ta shqyrtojë dhe amendamentojë projektligjin. Propozimi për formimin e një grupi punues u hodh në votim me ç' rast 4 vota ishin për, 4 kundër dhe nuk u miratua, prandaj Komisioni për Legjislacion nuk e ka përkrahur propozimin e deputetit Selimi dhe i rekomandon seancës të mos e aprovojë këtë ligj, sepse po e përsëris, bien në kundërshtim me nenet: 6.2, 7.1, 8.2, 9.1, 16.8, 25.2, 25.3, 25.4, dhe neni 29.1 i këtij ligji janë në kundërshtim me amendamentin 22 të Kushtetutës së Republikës

së Kosovës dhe me nenin 5 të Projektligjit për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit për Legjislacion!

Dua të dëgjoj mendimin e kryetarëve të komisioneve të tjera që kanë shfaqur mendim për të. Komisioni për Buxhet, kush e do fjalën? Fjalën e ka Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 57, paragrafi 1 dhe 8 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin me rekomandime për projektligjin për Agjencinë Kosovare dhe ka analizuar edhe projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka formuar një grup punues, i cili ka analizuar në tërësi projektligjin dhe ka ardhur në përfundim që projektligji nuk përmban implikime buxhetore me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 6. Rekomandimi i grupit punues është analizuar me kujdes në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe është miratuar propozimi që të rekomandohet, që neni 6, paragrafi 7 të riformulohet si në vijim:

- Anëtarët e Bordit marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhjet e bordit, kompensimi i anëtarëve të bordit caktohet me Ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë, deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë kompensimi i anëtarëve të bordit caktohet nga Kuvendi më rastin e miratimit të buxhetit të agjencisë.

Komisioni për Buxhet me këtë plotësim-ndryshim, të cilin i ka bërë këtij projektligji e ka miratuar me konstatimin se ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa!

Në emër të Komisionit për të Drejta, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, a e do kush fjalën? Nuk e do.

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian, e do kush fjalën? Nuk e do. Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Nuk kam të bëj me këtë çështje, kam të bëj me votimin paraprak dhe kërkoj që edhe njëherë të shqyrtohet baza kushtetuese e atij votimi dhe konstatimit se ligji nuk kalon, për shkak se në bazë të nenit 81, ky ligj kalon me shumicën e përgjithshme të deputetëve të pranishëm dhe shumicën e deputetëve që mbajnë ulëse të rezervuara dhe që janë të pranishëm.

Duhet të konstatohet në procesverbal sa deputetë të komuniteteve pakicë kanë qenë të pranishëm në votim dhe nga ai numër që ka votuar duhet parë a kanë votuar më tepër se gjysma? Pra, duhet ta precizojë sekretaria këtë çështje sepse kërkesa e Kushtetutës është për numrin e pranishëm të deputetëve të pakicave, jo për numrin 13 që ju e theksuat. Duhet të shikohet procesi, sa kanë votuar, ata që kanë abstenuar nuk hyjnë në këtë votim. Vetëm votat që kanë votuar ndahen përgjysmë dhe nëse ka pasur më shumë se gjysma, ligji kalon në leximin e parë.

KRYESUESI: E kam parasysht, por ne hymë në pikën tjetër. Do t'i kthehemi, nuk është problem. Ajo është punë interpretimi, votat janë saktë, siç kanë votuar janë të sakta. Interpretimin le ta bëjë ligji, s'e bëjë unë. Domethënë, nëse është ashtu, le të interpretohet ashtu.

Zotërinj deputetë,

Rreth këtij ligji për të cilin po bisedojmë, kemi një situatë që duhet ta zgjidhë Kuvendi. Është një ligj që është kthyer, debatuar, është rikthyer. Për shkak të dallimeve në rekomandimet e komisioneve parlamentare, së pari duhet të deklarohemi për propozimin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion.

Nëse miratohet propozimi i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, konsiderohet se Projektligji për Agjencinë Kosovare për KrahAsim dhe Verifikim të Pronës, nuk është miratuar dhe tutje s'kemi çfarë të bisedojmë.

Pra, e hedh në votim kërkesën e Komisionit Legjislativ që ky ligj në bazë të arsyetimit të tyre që është jokushtetues, domethënë që e...

(Ndërhyrje nga salla)

Pra t'i sqarojmë sendet, mos i ngatërmoni sendet. Pra, kërkesa e Komisionit për Legjislacion është që ligji të kthehet, për shkak se është ligj që e shkel Kushtetutën. Albulena Haxhiu e do fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne qysh në fillim kemi qenë kundër këtij projektligji edhe për shkak të përmbajtjes së tij kriminele, mirëpo edhe për shkak se i njëjti është kundërkushtetues dhe është mirë që Komisioni për Legjislacion në këtë projektligj ka vlerësuar kushtetutshmërinë e tij, meqë nuk ka ndodhur kështu edhe me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Madje, anëtarët e Komisionit për Legjislacion thoshin se nuk është përgjegjësi e Komisionit për Legjislacion që të vlerësojë kushtetutshmërinë. Dhe, këtu po del që pikërisht është përgjegjësi e Komisionit për Legjislacion që të vlerësojë kushtetutshmërinë e një projektligji dhe është për t'u përshëndetur vendimi apo rekomandimi i Komisionit për Legjislacion.

Pra, ne si subjekt politik jemi kundër këtij projektligji meqë i njëjti është rrjedhojë dhe e formalizon pranimin kriminal që librat kadastral t'i mbajë Serbia. Pra, pas tërë atij pompoziteti të përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë, me këtë projektligj po tentohet që të themelohet një Agjenci e cila formalisht do të jetë në kontroll të plotë nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian. Pra, shumica e anëtarëve të bordit të sekretarisë dhe të komisioneve do të emërohen drejtpërdrejtë nga PSBE-ja dhe shtrohet pyetja këtu, se prej nga e merr mandatin PSBE-ja, që të emërojë funksionarë ekzekutiv në Kosovë. Pra, kjo është kundërkushtetuese.

Pra, është e paprecedent për një shtet që të mos ketë regjistrin historik të evoluimit kadastral. Me këtë aranzhim të kompletimit të regjistrit kadastral shqiptarët rrezikojnë që prapë t'u merren pronat e tyre, të cilat i kanë blerë dhe paguar më shumë se një herë.

Andaj, kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që këtë projektligj mos ta votojë edhe për shkak të përmbajtjes së tij, mirëpo edhe për shkak se i njëjti është kundërkushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Armend Zemaj e do fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka theksuar nevojën që duhet të ekzistojë Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës duke marrë parasysh keqpërdorimin e pronës publike dhe shoqërore që ka ndodhur në Kosovën e pasluftës dhe vazhdon të ndodhë.

Dhe, për këtë kemi qenë të bindur se mandati i Agjencisë së tanishme apo transformimi duhet të bëhet, por jo duke shkelur Kushtetutën dhe ligjet të cilat janë në fuqi.

Ne e përkrahim rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL, si komision kryesor dhe njëherësh tërheqim vërejtjen, se nëse ky ligj kalon në këtë formë, ne duhet të marrim iniciativën kushtetuese dhe mandatin e deputetit, kështu që ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Atëherë, unë kërkoj numrin, sa janë të pranishëm, të lutem! Kërkoj praninë me elektronikë, ju lutem! Prania me elektronikë, tash.

Kemi prani me elektronikë 61, prani tjetër 66. Unë i thërras deputetët dhe teknikën që të bëhemi gati. Votojmë rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, që ky ligj t'i kthehet Qeverisë së Republikës ose sponsoruesit, për shkak se shkel rregullat e Kushtetutës.

Votojmë tash!

Me 29 vota për, 35 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon propozimi i Komisionit për Legjislacion.

Atëherë, na mbetet që ta procedojmë tutje, sepse kështu e thotë rregulla parlamentare, ndonëse votimi ish i ngushtë dhe kontestimi është i madh. Kontestimi që shkel Kushtetutën, tash le ta merr Parlamenti mbi vete logjikën e arsytimit...

(Debat nga salla)

Behar Selimi e ka kërkuar fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne në Komisionin për Legjislacion nuk patëm gjetur mirëkuptim që të krijojmë një grup punues për ta bërë ligjin më të kushtetutshëm. Dhe, kolegët e Komisionit për Ligje nuk kanë treguar vullnet për t'i hyrë fare ndryshimit, ndërkohë, që e kanë pasur të qartë se ligji është shumë i rëndësishëm për vendin. Ligjin nëse e thjeshtësojmë na mundëson marrjen e dokumenteve kadastrale, që vijnë përmes EULEX-it, përmes Brukselit, ndryshe nuk na jepen.

Megjithatë, edhe përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në Komision i kanë pasur dilemat e veta dhe kemi ardhur në një situatë çfarë jemi. Ne kemi pasur edhe atëherë amendamente të gatshme. Po e përsëris, për ta bërë të kushtetutshëm, por nuk kanë pasur vullnet kolegët tjerë të bisedojnë, të formojnë grupe punuese, siç e do rendi dhe rregulli.

Prandaj, nëse lejoni ju si Kuvend unë i kam tri amendamente këtu të cilat mund t'ua lexoj dhe me të cilat jam shumë i sigurt që ky ligj nuk ka më asnjë dilemë, karshi Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk ka dilemë që ky ligj ka probleme kushtetuese, për shkak se më 22 amendamentet që janë në fuqi ne kemi përfunduar mbikëqyrjen ndërkombëtare dhe i kemi limituar edhe emërimet ndërkombëtare.

Komisioni Kushtetues e ka udhëhequr këtë proces dhe ne në mënyrë taksative kemi cekur se nuk ka emërimet të reja ndërkombëtare pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare, kurse emërimet që kanë qenë në fuqi ato shuhën dhe nuk ripërtërihen.

Ne kemi pasur një grup punues brenda Komisionit ku edhe unë kam qenë në atë grup dhe kemi pasur dy ose tri takime me përfaqësuesit e Qeverisë dhe kemi kërkuar që ata ta rishikojnë ligjin në mënyrë që ligji të mos kërkojë ndryshime kushtetuese të reja. Duke qenë se ligji ka probleme serioze kushtetuese, unë po jap një propozim që ligji të rikthehet në Komisionin për Legjislacion edhe njëherë. E di që ndoshta proceduralisht ka probleme, që të bëjmë përpjekje edhe njëherë ta sanojmë këtë ligj me përfaqësuesit e Qeverisë, në mënyrë që ky ligj të mos ketë probleme kushtetuese.

Ashtu siç është ai nënkupton emërimet të reja në këtë agjenci, që nuk parashihen me 22 amendamentet që i kanë dhënë fund mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe nuk vlerësoj se është interes i këtij Kuvendi që të miratojë ligje që bien drejtpërdrejtë ndesh me amendamentet kushtetuese, apo me projektin e përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, po duam të sillemi në rreth atij Komisioni. Ne e patëm mendimin e Komisionit dhe zoti Arsim Bajrami, pikërisht i ra kësaj pike që s'është kushtetues. Mua më mbetet ajo që mund të bëhet dhe, unë po propozoj, Qeveria është këtu, zëvendëskryeministri është këtu. Në çdo moment Qeveria mund ta tërheqë variantin i cili është në diskutim edhe në këtë moment dhe unë besoj që është në dorën e Qeverisë ta tërheqë dhe të punojë edhe me Komisionin dhe me gjithë të tjerët. Të gjitha udhët tjera janë udhë...

Urdhëro, zëvendëskryeministri, ministri i Drejtësisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që edhe Qeveria e Kosovës është e interesuar që të ketë një ligj, i cili jo vetëm që ka shumicën e asaj që është paraparë edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit, por që ka një konsensus të gjerë edhe politik, ngase ka ndikim të tillë. E pash edhe nga konstatimet e anëtarëve të Kuvendit, deputet profesor Bajrami që ka nevojë të ketë edhe një rishqyrtim, zotit Selimi dhe të tjerët. Por, ajo çka dua ta them: një - jemi të gatshëm që të marrim pjesë prapë në punën e Komisionit, të japim vërejtjet dhe sugjerimet tona, por për kolegialitet po e them, a shkelet Kushtetuta apo jo vetëm një institucion e tregon- Gjykata Kushtetuese e jo ne secili veç e veç. Faleminderit!

Pra, ne tërhiqemi dhe shkojmë në Komision për rishqyrtim.

KRYESUESI: Qysh është propozimi konkret?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Propozimi ynë konkret është që të tërhiqet dhe të shkojë në Komision, bashkë me Qeverinë, t'i bëjmë përmirësimet adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju dëgjuat ofertën e fundit të Qeverisë. Arben urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj se ky ligj është në Komision prej datës 4 mars 2013 dhe Komisioni nuk ka arritur ta zgjidhë këtë problem për shkak të qëndrimeve të kundërta të anëtarëve të Komisionit.

Për t'u zgjidhur çështja thjesht dhe shpejtë nëse janë të interesuar për ta zgjidhur, ligji mund të tërhiqet nga Qeveria, ministri ta riprocedojë ligjin në Kuvend dhe Kuvendi ta zgjidhë këtë problem.

Përndryshe, mendoj që do të mbesim në rrethin vicioz dhe prapë të vazhdojmë me të njëjtat probleme. Është prej marsit ky ligj që sillet nëpër Kuvend dhe nuk po arrin të kalojë. Ministri, nëse e tërheq ligjin, mirë, nëse jo, me votat që i ka PDK-ja në Kuvend e kalon një ligj që është me përmbajtje të fortë antikushtetuese, neve tjerëve na mbetet ta plotësojmë dëshirën e ministrit, ta dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese dhe pastaj Gjykata vendos a është.

Ne kemi dhënë vlerësim dhe kemi rekomanduar që të mos aprovohet. PDK-ja me aleatë mund ta kalojë, ne tjerët mbesim ose e dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese ose shohim veprimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Shikoni, është e qartë që mendimi i Komisionit u votua dhe ne nuk kemi arsye në kuptimin votimit elektronik, nëse Kuvendi merret vesh me Qeverinë që t'i kthehet Qeverisë ky ligj, pas gjithë këtyre diskutimeve është në dorën tuaj. Këtu më nuk ka çka shpjegohet.

Po, pra, sepse ne jemi në procedurë, unë mund t'ju thërras edhe njëherë të votoni, por çka të votoni, s'keni çka të votoni ju thatë që ia latë Qeverisë në dorë. Qeveria në çdo moment e ka të drejtën ta tërheqë, të bashkëpunojë, ta ripunojë, ta sjellë. Kjo është, urdhëro zoti zëvendës.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, nënkryetar edhe njëherë për mundësinë dhe sqarimin.

Natyrisht që edhe Qeveria po e them tash jam jashtëzakonisht i kujdesshëm që nuk dëshirojmë ta prishim konsensusin politik për çështje të tilla. E tërheqim në Qeveri, do ta kthejmë prapë bashkë me ju do ta punojmë në mënyrë më të mirë të mundur. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit!

Formalisht, tash ju lus ta ngrisim dorën për propozimin e Qeverisë formalisht. Pra, ligji tërhiqet dhe ripunohet në Qeveri. Faleminderit!

Tani erdhi ministri, e kthejmë pikën. Tash e kemi ministrin, na e paraqet ligjin:

16. Shqyrtimin i parë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëro, ministër.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine potpredsedniče!

Poštovani zameniče premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Organizovanje i funkcionisanje javnih službi za zapošljavanje je regionalni proces kroz koji je prošla većina zemalja u Regionu. Na organizovanju i funkcionisanju javnih službi za zapošljavanje u skladu sa najboljim i najnaprednijim evropskim... praksama odnosima institucijama za zapošljavanje.

To je praksa zemalja članica Evropske Unije i zemalja koje žele da se učlanjuju da bi se institucije koje se bave izradom politike zapošljavanja i profesionalnog osposobljavanja razlikovali od institucija koje se bave sprovođenjem politike zapošljavanja i profesionalnog osposobljavanja.

Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite odnosno department za rad i zapošljavanje je odgovoran za izradu i sprovođenje politike zapošljavanja i osposobljavanja. Dakle, izrada i sprovođenje politike zapošljavanja obavlja se od strane departmenta za rad i zapošljavanje. Takođe, za Nacrt zakona o organizovanju i funkcionisanju za javnih službi za zapošljavanje. Ova praksa se očekuje u izmeni na tome da izrada politike zapošljavanja i osposobljavanja i takođe da se dalje obavlja od departmenta za rad i zapošljavanje, koja postoji u okviru Ministarstva za rad, dok sprovođenje politika zapošljavanja i profesionalnog osposobljavanja će se obavljati u jednoj od posebnih institucija kao što je predviđeno, znači od strane Agencije.

Osnovni cilj donošenja ovog zakona je da reguliše, da osnuje, da organizuje funkcionisanje dužnosti, odgovornosti i finansiranje Agencije za zapošljavanje. Agencija koja će funkcionisati kao nezavisni organ Ministarstva za rad sa statusom pravnog lica, na osnovu Zakona o državnoj upravi.

Što se tiče organizacione strukture agencije, nacrt zakona je utvrđen da se sastoji od:

- sedište agencije,
- opštinskih kancelarija za zapošljavanje,
- centri za profesionalno osposobljavanje,
- savetodavni odbor, i
- generalni direktor.

Generalni direktor agencije će rukovoditi centralno kancelarijom, koja će biti imenovana prema zakonodavnom sistemu na snazi za imenovanje visokih civilnih službenika i dok se organizacionom strukturom i sistematizacijom radnih mesta u agenciji sprovođiti prema pravilniku o unutrašnjem organizovanju i sistematizaciji radnih mesta, koja je u skladu sa Pravilnikom Vlade o standardima za unutrašnje organizovanje i sistematizaciju radnih mesta.

Poštovani poslanici,

Nacrt zakona će razmotriti niz važnih pitanja posebno rešavanja pitanja kao što su:

1. Organizovanje agencije, počevši od centralne agencije, opštinskih kancelarija za zapošljavanje, regionalnih centara za osposobljavanje i savetodavnog odbora.

2. Takođe dužnost i odgovornost je agencije povezanost između agencija i Ministarstva za Rad, kao i

3. Licenciranje nejavnih ustanova.

U odnosu na povezanost između ministarstva za rad i agencije treba istaći da je izrada politika zapošljavanja iz profesionalnog osposobljavanja će se vršiti od strane Ministarstva za rad, dok samo sprovođenje će biti deo uloge agencije.

Saradnja koja se odnosi na unutrašnjem nivou sa ministarstvom i obrazovanja i nacionalnog autoriteta za kvalifikacije, takođe i spoljnim nivou koji se odnosi na međunarodnu saradnju.

Buđet agencije gde se navode objašnjenja, specifikacija i buđet agencije.

Prelazne odredbe, gde se navode objašnjenja o osoblju koje se očekuje da bude prebačeno u direktorijat za rad u agenciji.

Usvajanje ovog nacrtu zakona će se uspostaviti odgovarajući pravni osnov za organizovanje i funkcionisanje javnih službi za zapošljavanje na Kosovu, u cilju usklađivanja ponuda i tražnja na tržištu, rada nudećih kvalitetnih usluge vezanih za posredovanje, zapošljavanje, profesionalno osposobljavanje, karierno vođenje i savetovanje pri zapošljavanju.

To su bile uvodne informacije čisto da bih vas informisao šta je u načelu, šta bi trebalo da predstavlja formiranje ove agencije. Mi smo dugo analizirali ovo i shvatili smo da praksa regionalna praksa i svetska praksa nalaže da agencije ovakve vrste postoje i da one bi trebalo da funkcionišu.

Naravno agencija će biti pod direktnom upravom ministra i Ministarstva za rad ali će imati jednu autonomnu oblast, u kojima će moći da radi što se tiče samog zapošljavanja.

Očekujemo da će rezultati biti vidni u periodu posle kreiranja agencije, ali naravno svaki od procesa takve vrste treba jednu određenu podršku, koja će verovatno vremenom biti uspostavljena i kroz rad same Vlade. Pozivam vas da usvojite zakon i hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Më lejoni që para se të hap edhe njëherë rreth votimit që patëm për listat për festa.

Ne e patëm një prononcim të kolegut Bajrami, mua më mbetet ta ripërsëris çka thotë Kushtetuta: “kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë, neni 81, paragrafi 1, pika 1, e Kushtetutës, amendamenti 2.” Sipas kësaj, kërkohet minimumi 61 vota “për” nga deputetët e Kuvendit dhe 13 vota “për” nga deputetët e komuniteteve shumicë. Kaq!

Kush mendon që nuk është ky rezultat Kushtetues, le t'i drejtohet me votim Kushtetutës dhe mbaron diskutimi. Kalojmë tutje, kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2013, shqyrtoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit në Komision, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54, të Rregullores së Kuvendit dhe rekomandojmë Kuvendit për miratim në parim.

KRYESUESI: Në radhë është fjala për përfaqësuesit ose shefat e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së e ka fjalën deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës dhe e përkrahim në parim, por megjithatë kemi disa vërejtje.

Ky projektligj do të funksionojë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe mendojmë se në projektligji duhet të definohet qartë kompetencat e Departamentit përkatës të punësimit në Ministri dhe Agjencisë të Punësimit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, te përkufizimet për shembull flitet për zyrat e punësimit dhe Zyrën qendrore të punësimit, paragrafi 1.18 dhe paragrafi 1.21.

Derisa në nenet e mëtutjeshme sqarohen dhe definohen detyrat dhe obligimet e zyrave të punësimit, askund nuk përmenden detyrat dhe obligimet e Qendrës së punësimit.

Gjithashtu, kemi edhe vërejtje tjera për arsye se kemi edhe implikime buxhetore në këtë projektligj, por meqenëse thuhet që projektligji do të hyjë në fuqi në vitin 2015, ne si grup parlamentar e përkrahim në parim këtë projektligj, ndërsa do të jemi shumë të vëmendshëm gjatë fazës së amandamentimit në Komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Mustafa. Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sa i përket Ligjit apo Projektligjit për Agjencinë e Punësimit, vërejtjet që i dha edhe Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e shoh të arsyeshme që ky projektligj duhet të kalojë sot në seancën plenare, duke e pasur parasysh se ka implikime buxhetore, po ashtu kjo agjenci nuk parashihet që të funksionojë deri më vitin 2015.

Pra, cila është ngutja e themelimit të kësaj Agjencie, apo cila është ngutja e kalimit të këtij projektligji në këtë seancë plenare?

Kisha dashur një shpjegim prej ministrit, sepse ministri tha që politika do t'i hartojë tash e tutje kjo Agjenci, ndërsa Departamenti për Punë dhe Punësim që ekziston në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, çfarë detyra do të kryejë ai?

Unë e pyes prapë ministrin se a ka mjaftë kërkesa apo a ka mjaftë hapësirë që kjo Ministri t'u ofrojë njerëzve punë dhe punësim apo cila është arsyeja pse kjo Agjenci sot duhet të kalojë?

Arsyetim tjetër pse Grupi Parlamentar i LDK-së ka vendosur që mos ta përkrahë këtë projektligj është sepse po vijnë disa projektligje të cilat nuk kanë mbulesë buxhetore. Edhe ministri është i informuar se Ministria e tij nuk ka paraparë asnjë cent për implementimin e këtij projektligji as në strategjinë afatmesme të shpenzimeve, po ashtu as në projektimin buxhetor të kësaj Ministrie dhe nuk e shohim të arsyeshme që ky projektligj të kalojë sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes” deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë projektligj dhe kemi bindjen që në punën e Komisionit pastaj do t'i bëjmë ndryshimet e nevojshme, sidomos kur bëhet fjalë për kohën kur do të vihet në funksion kjo Agjenci.

KRYESUESI. Faleminderit, zoti Aliu. Në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Ky projektligj nuk është pjesë e legjislacionit të BE-së, po ashtu ky projektligj ka kosto buxhetore që nuk është paraparë në Buxhetin e Kosovës, por as në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Kërkohen 13 punëtorë për Agjencinë dhe pagesa për seancat e bordit këshill-dhënës të kësaj Agjencie. Edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa për shkak të kostos buxhetore nuk ka rekomanduar kalimin e këtij projektligji.

Qëllimi i këtij projektligji është liria e punës e të drejtave në punë dhe aftësim profesional, të cilat janë të drejta themelore të lirive të njeriut.

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë e Punësimit në Republikën e Kosovës. Procesi i organizimit dhe funksionimi të institucioneve të punësimit, duhet të rregullohet me përputhje, me normat dhe praktikat institucionale ndërkombëtare të punës dhe të shteteve tjera të rajonit.

Praktikë kryesore e këtyre është ndarja e institucioneve të hartimit të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional nga institucionet të cilat zbatojnë politikat e punësimit dhe aftësimit profesional.

Deri tani Departamenti i Punës dhe i Punësimit në Ministrinë e Punës është marrë edhe me hartimin e politikave edhe me zbatimin e këtyre politikave të punësimit e tash, në vazhdim me politika do të merret Departamenti, ndërsa me realizimin e këtyre politikave do të merret Agjencia.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj, në fakt mendojmë që këtu ka përzierje të kompetencave dhe do të abstenojmë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kadriaj! Për Grupin e SLS-së, Fetar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine potpredsednice Skupštine!
Poštovani ministri,
Koleginice, kolege poslanici.

Danas smo u prilici da uredimo oblast kojq se svuda u svetu, Evropi i regionu, pokazala kao dobar i funkcionalan model povezivanja tržišta radne snage i poslodavca. Agencija za zapošljavanje već dugo nije onaj biro za zapošljavanja kojeg se sećaju moje starije kolege, čija je svrha bila da nezaposleni dobiju informaciju koja su radna mesta privremeno ili trajno slobodna.

Danas su agencije za zapošljavanje mesta na kojima se ne zaposlenima pomaže da dobiju šansu za posao, u kojima se vrši edukacija, gde poslodavci i nezaposleni komuniciraju. Posebno agencije za zapošljavanje su mesta preko kojih se najdirektnije vodi politika zapošljavanja.

Za društvo sa ovolikim brojem nezaposlenih ali i društvo sa najmlađom ali i nažalost nedovoljno kvalifikovanom radnom snagom, značaj ovakve agencije je posebno važan. Agencija za zapošljavanje je instrument vlade ne samo za uvid u stanje zaposlenosti na tržištu već i u njen strukturalni sadržaj, na koji može aktivno da utiče.

Dobra i funkcionalna agencija za zapošljavanje više je od servisa za pronalaženje posla i zato je dobro da danas o njoj diskutujemi i ovu oblast uredimo zakonom, koji nam nedostaje. Zakon o Agenciji za zapošljavanje, koji danas donosimo je kao i većina sličnih u Regioni moderan i u praksi primenjuje zakon.

Svojim instrumentima potsticajima ili programima podrške ovakve agencije kreiraju odnos društva prema pojedinim ugroženim kategorijama. Agencija za zapošljavanje ima jednu važnu funkciju koja proizilazi iz same njene prirode a to je socijalni aspekt politike zapošljavanja. Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke ipak ima pojedine primedbe, koje bi zakon učinili boljim i pravednijim.

Radi se zapravo o našim insistiranju da socijalni aspekt Agencije za zapošljavanje prilagodimo ambijentu Kosova. Mi ćemo predložiti nekoliko amandmana kako bi specifičnost Kosova bila utkana u ovaj zakon. Tako mislimo da je neophodno da se u kategoriji takozvanih ranjivih grupa, kako ih definiše zakon, uvrste i povratnici na Kosovo ili interno raseljena lica. Tako bi sistemom podsticaja, edukacija, prekvalifikacija ili samo zapošljavanja dodatno izvršili socijalizaciju i integraciju ovih najugroženijih grupa u kosovsko društvo.

U tom smislu predlažemo da se kancelarije agencije za zapošljavanje otvore i u sredinama sa srpskom većinom, kako bi i njihove posebne potrebe bile uvažene.

Na kraju želim da istaknem da se na žalost isuviše malo pažnje posvećuje ovim temama. Velike politike i bitni procesi u kojima kao parlament učestvujemo ne sme da zamagli značaj ovakvih zakona. Kada me neupućeni ljudi u kosovske prilike pitaju koji je najveći problem kosovskih srba uvek odgovorim da je to nezaposlenost. To je naš najveći problem, ali i problem koji nas povezuje sa drugim zajednicama na Kosovu. Zato moramo da radimo zajedno.

Uostalom zapošljavanje je prva na listi potreba koje građani bez etničke razlike prepoznaju i od vlasti zahtevaju i to mora biti putokaz za sve naše sledeće poslove. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Militiq! Për Grupin ‘ZB’ e ka fjalën Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem potpredsedniče!

Parlamentarna Grupa “Zajdeničkq Budućnost” je takođe analizirala nacrt zakona o Agenciji za zapošljavanje i uzimajući u obzir izuzetnu važnost ovog nacrta zakona mi ćemo podržati u načelu, ukoliko imamo primedbe učestvovaćemo aktivno u dotičnoj komisiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, deputetja Mufera Sinik e ka fjalën.

MUFERA ŞINIK: Teşekkür ederim.

İş bulma Ajansı Yasa Önerisi günümüzde Kosovada bugüne kadar Bakanlık düzeyinde Müdüriyet seviyesinde düzenlenmiştir. Bu Yasa Önerisyle, Ajansın kurulmasıyla uluslararası çalışma örgütü önerileri ve Avrupa Birliği standartlarına ulaşacağına inanmaktayız. İşsizliğe yönelik politikalar yine Bakanlık tarafından planlanacaktır, fakat uygulanması ve takibi kurulacak olan bu Ajans tarafından yapılacaktır. Kosovada yüksek olan işsizlik düzeyi konusunda İşbulma Ajansının önemli bir görev üstleneceği kesindir. İşbulma Ajansı piyasadaki sektörler için uygun ara eleman yetiştirme konusunda uygulamaları yapması beklenmektedir. “6+” Parlamenter Gurubu olarak bu Yasa Önerisini desteklemekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari Kabinet qeveritar.

Themelimi i këtyre agjencive tashmë është bërë dukuri e përhershme nga ana e Qeverisë dhe konsideroj që këto agjenci po themelohen vetëm sa për të rënduar buxhetin e Qeverisë së Republikës Kosovës, sepse efekti siç shihet edhe në prezantimin që e dha edhe ministri po edhe në prezantimin i cili është paraparë ky projektligj ka të bëjë vetëm me punësimin e 13 punëtorëve, do të thotë, mendohet ndoshta në uljen e papunësisë, gjë që kjo gjë është shumë qesharake, sepse vetë në deklaratën buxhetore, do të thotë parashihet që të kemi një buxhet shtesë në vlerë prej 36 mijë e 640 euro dhe njëkohësisht nuk është paraparë në deklaratën financiare nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, thjesht e paraqet se Departamenti për Buxhet vlerëson se nuk ka mundësi buxhetore themelore për themelimin e Agjencisë dhe institucioneve të reja në kuadër të këtij Departamenti.

Përpos kësaj kemi edhe përzierje të kompetencave në kuadër të Ministrisë, sepse ne e dimë shumë mirë që nëse kemi të bëjmë me çështjen e punësimit është i themeluar Departamenti për Punësim në kuadër të Ministrisë dhe po ashtu i kemi entet e punësimit në nivel lokal.

Prandaj, thjesht konsideroj që këtu kemi të bëjmë vetëm me një rëndim të buxhetit dhe një punësim prej 13 vetave dhe asgjë tjetër nuk kemi të bëjmë me këtë projektligj. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Atëherë, nuk kemi më deputetë të tjerë që kërkojnë të diskutojnë për këtë projektligj.

Të pranishëm janë 66 deputetë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tash.

Me 40 vota për, 21 kundër dhe 2 abstenime, pra me shumicë votash Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 04/ L – 205, për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesë raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës:

17. Shqyrtimi i raporti përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar

Komisioni Hetimor Parlamentar, i formuar nga Kuvendi, më 28 mars 2013, në pajtim me nenin 77, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit për hetim parlamentar dhe nenit 69 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së

lirë, njehsorët digjitalë dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast, ka përfunduar punën e vet dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin përfundimtar me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Ftoj kryetarin e Komisionit Hetimor Parlamentar, deputetin Muhamet Mustafa, që të bëjë arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!
Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Komisionit Hetimor Parlamentar për çështjet e faturimit të energjisë elektrike, në muajin janar 2013, problemit të tarifave dhe disa çështjeve të ndërlidhura të prezantoj në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe gjetjet, si dhe rekomandimet e përmbajtura në raportin që keni marrë për këtë pikë të rendit të ditës.

Formimi i këtij komisioni nga ana e Kuvendit të Kosovës u bë në seancën e 28 marsit të këtij viti me propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe në mbështetjet e një grupi tjetër deputetësh.

Komisioni zhvilloi punën e tij në pajtim me vendimet e Kuvendit dhe brenda periudhës tremujore përgatiti raportin përfundimtar, të cilin ju e keni marrë. Raporti është përgatitur në bazë të analizës së një vëllimi të konsiderueshëm të dokumenteve që kemi marrë sipas kërkesës sonë nga institucionet përgjegjëse.

Përveç kësaj, Komisioni ka intervistuar 13 persona përgjegjës, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, 2, në Zyrën e Rregullatorit, 3, në KEK, 5 dhe përfaqësues të konsumatorëve, 2, si dhe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 1.

Gjithashtu, raporti është bazuar edhe në gjetjet e dy ekspertëve të angazhuar për çështje specifike, teknike dhe profesionale. Komisioni në punën e tij në bazë të vendimit të Kuvendit dhe interpretimeve që kemi pasur me rastin e aprovimit të procesit nga kryetari i Kuvendit, u përqendrua në çështjet e faturimit të shpenzimeve të energjisë elektrike, në muajin janar 2013, problemin e tarifave në spektrin më të gjerë dhe kohën e llogaritjes së tarifave të lira, investimet në orëmatësit, përkatësish njehsor digjitalë siç janë quajtur dhe masat të cilat i kanë marrë përfaqësuesit e institucioneve lidhur me këtë çështje.

Çështja e parë, faturimi i energjisë elektrike për muajin janar 2013. Siç dihet në fillim të shkurtit të vitit 2013 u shfaqën pakënaqësi dhe revolta deri në protesta publike të konsumatorëve dhe organizata e shoqërisë civile lidhur me faturat për shpenzimin e energjisë elektrike në janar të vitit 2013.

U paraqitën 3804 ankesa që përbën 1% të konsumatorëve familjarë lidhur me këto fatura dhe ky numër i këtyre ankesave është përafërsisht i njëjtë me ankesat që janë bërë gjatë vitit 2012, në mars dhe në shtator, por është më i lartë se sa ankesat që janë bërë për muajin janar 2012.

Nëse e analizojmë konsumin e faturuar në janar të vitit 2013, del se ai është pothuajse identik me faturimin e konsumit në 2012, është vetëm 0.1% më i vogël, ndërkaq, vlera e faturimit në janar të vitit 2012, pra konsumi në kilovator është identik, por vlera e faturës në janar të vitit 2013 në krahasim me janarin 2012, është më e madhe 9.5% ku ka ndikuar ngritja e çmimit diku 8.9% gjatë vitit 2012, qershor, kurse pjesa tjetër 0.6% pra, që është vlerë më e madhe e faturuar ose rreth 93 mijë euro mund të kenë qenë efekt i situatës specifike që ka pasur të bëjë edhe me pakënaqësitë e konsumatorëve. Mirëpo, pra është një shumë relativisht e vogël.

Shikuar në këtë prizëm, nëse i analizojmë faturimet e muajit janar dhe muajve tjerë 2012 dhe më herët nuk duket se duhet të ketë diçka gjatë këtij muaji, andaj shkaqet e revoltës në janar të këtij viti lidhur me faturimet janë më tepër kombinim i faktorëve të ndryshëm, të cilat Komisioni i ka analizuar në bazë të autorizimeve të tij.

Në bazë të hetimeve tona, ne kemi konkluduar se në problemet e paraqitura në janar kanë ndikuar gabimet teknike në lexim dhe gabimet teknike në futje të të dhënave apo regjistrim të tyre. Kjo dukuri ka qenë prezente gjatë tërë vitit, periudha jo e përputhshme tek disa konsumatorë lidhur me numrin e ditëve të përfshira në lexim dhe ditët kur janë lexuar ata.

Ndërrimet e orëmatësve që kanë krijuar një situatë të re sa i përket tarifës së lirë së konsumit dhe gjithashtu ka pasur ndikim edhe një sistem tarifar në tri blloqe tarifore që do të analizohet më poshtë.

Në bazë të hulumtimeve që ka bërë Komisioni dhe bazuar në ligjet dhe rregulloret ekzistuese, raporteve të komisioneve të formuara në KEK, tek Rregullatori i Energjisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, del se në aspektin normativ teknikisht nuk ka pasur shkelje të procedurave që parashihen lidhur me kohën e leximit dhe faturimit dhe se nuk janë konstatuar gabime me qëllim apo ngritje të çmimeve jashtë atyre të lejuara nga Rregullatori i Energjisë.

Megjithatë ka probleme në komunikimin e KEK-ut me konsumatorë, sepse ndonëse janë marrë masa përcjellëse lidhur me situatën dhe ankesat e krijuara dhe pakënaqësitë e konsumatorëve në janar 2013, duket se analiza e problemeve më herët del se nuk është krijuar një shërbim modern i kujdesit ndaj konsumatorëve. Intervenimet në kërkesa të konsumatorëve janë të ngadalshme, nënçmohet rëndësia e komunikimit me konsumatorë, gjithashtu konsumatorët nuk janë të informuar në mënyrë adekuate për ndryshime në tarifa e sidomos nuk ishin të informuar lidhur me instalimin e orëve të reja, gjë që kanë pasur ndikime të caktuara.

Prandaj, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, përkatësisht operatori i ri i distribuimit, rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit, duhet ta merr shumë seriozisht faktin se 7 deri 10% e konsumatorëve brenda vitit bëjnë ankesa në vlerën e faturave, të cilat kryesisht vijnë për shkak të gabimeve në lexim dhe regjistrim.

Prandaj, Komisioni duke analizuar situatën e ka rekomanduar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe operatorit KEDS, që të marrin masa përkatëse për ta përmirësuar komunikimin, kujdesin dhe transparencën ndaj konsumatorëve dhe aktorëve të interesuar lidhur me strukturën e tarifave dhe për tu siguruar atyre standarde të nevojshme në cilësi dhe sasi të furnizimit me energji elektrike.

Kërkohej që Zyra e Rregullatorit të Energjisë brenda 6 muajve ta informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me masat e ndërmarra nga ana e tij dhe operatorit të Shpërndarjes dhe Furnizimit për mënyrën se si janë adresuar problemet e konstatuara në këtë raport.

Çështja e dytë ka pasur të bëjë me tarifat dhe kohën e llogaritjes. Kriteret bazë, sipas të cilave formohen çmimet, janë vendosur nga Zyra e Rregullatorit me rregulloren për çmimet në vitin 2011. Çmimet përcaktohen në bazë të të ashtuquajturave të ardhurave maksimale të lejuara, që formohen në bazë të kostove të operimit dhe gjenerimit në miniera, termocentrale dhe në pjesë të tjera, duke i shtuar kësaj dhe koeficientin përkatës të humbjeve të lejuara teknike komerciale, kthimin në ekuitet dhe kapital dhe marzhën e fitimit për furnizimin dhe distribuimin, si dhe shpenzimet tjera të lejuara, që është një mori kriteresh me tabelën që e keni në fund të raportit. E shihni se në çmimin që e paguajmë ne për energji elektrike, ndikojnë afro 20 deri 25 komponentë.

Përpos kësaj, fatura që marrin konsumatorët përmbajnë shumë rubrika dhe është shumë e ndërlikuar. Përpos konsumit në tri blloqe, blloku i parë deri në 200, blloku i dytë 200-600 dhe blloku i tretë 600 kilovatë orë e më shumë, përmban edhe dy tarifa ditore, të lartën dhe të ulëtën, dhe dy tarifat sezonale, të verës dhe të dimrit. E tërë kjo e bënë shumë të ndërlikuar procesin e formimit të çmimit dhe faturimit dhe të lëndueshëm dhe jo sa duhet transparent për konsumatorët dhe aktorët tjerë të interesuar.

Nga analiza e konsumit dhe faturimit gjatë vitit 2012 dhe në janar të vitit 2013, flet se konsumatorët që shpenzojnë mbi 600 kilovatë orë, pra konsumatorët e bllokut tarifar 3, mbajnë një barrë të madhe dhe joproporcionale për mbulimin e të ardhurave maksimale të lejuara, që në fakt përfshin edhe mbulimin e dobësive në efikasitet, dobësive në produktivitet dhe menaxhim të KEK-ut, edhe të KEDS-it. Ky grup mban barrë për subvencionimin e çmimeve në dy blloqe tarifore të tjera. Ata gjithashtu mbajnë barrë për mbulimin e humbjeve teknike dhe komerciale dhe faktorëve të tjerë, që ndikojnë në tarifa dhe çmim.

Prandaj, në situatën e krijuar, faturat për këtë grup të konsumatorëve, pra bllokun e tretë, blloku tarifar 3, janë shumë të stërngarkuara.

Pjesa dërmuese e konsumit të energjisë, pra të ardhurat e KEK-ut faturohet me bllokun tarifar 3, afro 60% e të ardhurave të KEK-ut në vitin 2012, kurse në janar të vitit 2013, në këtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe sa minuta të duhen, a të mjaftojnë edhe 5?

...pra, po i them shkurtimisht, do ta deponoj në Kuvend këtë. Unë kam menduar se na kemi kohë që ta paraqesim krejt një fjalë, prandaj e kam përgatitur pak më të gjatë. Do të shkoj më shkurt pra.

Çështja kryesore është se në këtë tarifë, KEK-u i ka realizuar të ardhurat në janar prej kësaj tarife 74%, kurse në vitin 2012 i ka realizuar 76%. Kjo do të thotë se kjo tarifë me të vërtetë i merr faturat e stërngarkuara dhe të fryra.

Çështja tjetër është se në çmim janë, siç thashë, 25 deri në 30 komponentë. Një nga këto është kthimi në ekuitet. Kthimi në ekuitet, sipas Rregullores, përcaktohet nga Rregullatori në bazë të propozimeve në KEK. Mirëpo, sivjet e kemi parë se ka një problem në këtë, për arsye se në kthimin në ekuitet ka ndikuar, domethënë është përzier, në mënyrën që është jashtë Rregullores.

Përveç kësaj, kriteret për formimin e përcaktimit të kthimit në ekuitet nuk janë të qëndrueshme. Vetë fakti se përqindja e kthimit në ekuitet është zvogëluar prej 12-13 në 8, në vitin 2012, dhe afro 6 në vitin 2012, tregon se këtu kemi probleme serioze.

Problemi tjetër ka të bëjë me tarifën e ulët dhe të lartë ditore. Në këtë kuptim konsumatorët, edhe pse kanë të drejtë ta kenë një tarifë të ulët ditore, nuk mund ta shfrytëzojnë për shkak se në kohën kur është përcaktuar koha e kësaj tarife, pra prej orës 22:00, përkatësisht 23:00 verës, nuk mund ta shfrytëzojnë për arsye të mungesës së rrymës. Në anën tjetër, këta e paguajnë pra vetëm çmimin e lartë, që është më i madh sesa do ta paguanin sikur mos të kishin tarifa të ulëta ditore, apo tarifë mesatare.

Çështja tjetër ka të bëjë me problemet e investimeve, të cilat ndikojnë në çmim në mënyrë të konsiderueshme dhe ne e kemi cekur se problemi i investimeve do të duhej të shikohej në mënyrë më ndryshe se që është ky problem për arsye se investimet zakonisht bëhen në bazë të një programi 5-vjeçar, që e aprovon Zyra e Rregullatorit, sipas kërkesës KEK-ut dhe investimeve të KEK-ut, dhe kjo është aprovuar për 5 vjetët e ardhshme. Investimet qysh i ka paraparë KEK-u, i ka trashëguar edhe KEDS-i, përkatësisht tash në pronësi të “Limak”-ut, dhe nuk e kemi një investim shtesë. Në anën tjetër, ne kemi nevojë t’i evitojmë humbjet teknike dhe komerciale.

Prandaj, Komisioni ka menduar dhe ka propozuar që të bisedohet me KEDS-in, që “Limak”-u t’i shpejtojë investimet e premtuara, në mënyrë që ato të kthehen me amortizimin dhe me tarifat që janë lënë për arsye se investimi i këtyre mjeteve për 15 vjet nga amortizimi, edhe tarifat, ashtu siç ka qenë edhe praktika e KEK-ut deri tash, nuk do ta përmirësojnë gjendjen e furnizimit shpejt.

Orët digjitale, ka qenë një çështje që e kemi hetuar dhe kemi konstatuar se te orët digjitale nuk janë udhëhequr praktikat më të mira të menaxhimit. Nuk ka pasur një studim të fizibiliteti. Orët digjitale kanë problem me nivelin e tyre teknologjik, nuk janë të përshtatshme për liberalizimin e tregut dhe nuk mund të lexohen në distancë. Kështu

që kemi kërkuar që për orët digjitale ky projekt të rishqyrtohet dhe këtij projekti t'ia bëjë në auditim të performansës Auditori Gjeneral dhe ta informojë për këtë Kuvendin sa më shpejt.

Çështja tjetër ka qenë e lidhur me masat e ndërmarra nga institucionet dhe bartësit e përgjegjësive publike dhe në situatën e krijuar protestat e kanë sfiduar funksionimin e institucioneve, e posaçërisht të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Komisionit Ndërmintor, Rregullatorit dhe KEK-ut lidhur me realizimin e autorizimeve dhe përgjegjësive të aktorëve të ndryshëm në menaxhimin e situatës, e cila ka koinciduar me kohën kur ZRRE-ja duhet të merrte vendim lidhur me aprovimin apo mosaprovimin e kërkesës për ngritjen e çmimeve.

Lidhur me realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive të institucioneve përkatëse, është ilustrative që Komisioni midis këtyre instruksioneve që ju i keni detajisht në raport. Nga e gjithë kjo pasqyrë e deklarimeve publike dhe korrespondencës ndërmjet bartësve të funksioneve dhe institucioneve kryesore që janë marrë me menaxhimin e situatës së krijuar lidhur me faturimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe dy minuta, ju lutem!

...e energjisë gjatë muajit janar dhe kërkesës për rritje të çmimit të energjisë, Komisioni ka konstatuar se ka pasur deklarime dhe veprime që nuk janë në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve dhe, si të tilla, këto shprehen negativisht në funksionimin e pavarur dhe me kompetencë të plotë të institucioneve përgjegjëse, respektivisht Zyrës së Rregullatorit dhe Bordit të KEK-ut.

Lidhur me këtë, deklaratat publike të ish-Oministrit të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, zotit Beqaj, lidhur me marrjen e vendimeve për çmimet e energjisë elektrike, përqindjen e kthimit në ekuitet dhe në përgjegjësitë e menaxhmentit të KEK-ut dhe masave ndaj tij, nuk kanë qenë në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e tij. Gjithashtu, Bordi i Zyrës së Rregullatorit ka sfiduar me situatën e krijuar pavarësinë dhe mënyrën e realizimit të kompetencave të tij për çmimet dhe mbikëqyrjen e këtij sektori.

Prandaj, Komisioni i ka rekomanduar kryeministrit të Republikës së Kosovës që të ndërmarrë masa përkatëse sipas kompetencave të tij për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit dhe që të evitohen praktikat që ministritë dhe ministrat të involvohen jashtë autorizimeve në fushëveprimin e institucioneve të pavarura në mënyrën që e dëmton forcimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Përveç kësaj, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që të insistojë në zbatimin në përpikëri të kornizës ligjore lidhur me rolin e rregullatorëve, e cila siguron llogaridhënie dhe transparencë, si dhe vlerësim sistematik dhe të rregullt të performansës të bordeve të rregullatorëve.

Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni e ka aprovuar raportin që është para jush, konstatimet e tij dhe rekomandimet me konsensus. Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për angazhim konstruktiv, shërbim profesional dhe të atyre që kanë dhënë dëshmi para Komisionit. Konsiderojmë se konstatimet e Komisionit dhe rekomandimet janë të dobishme për t'i evituar problemet në këtë fushë dhe për të shërbyer më mirë konsumatorët dhe qytetarët e Kosovës. Andaj, ju ftoj që t'i aprovon. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,
Kolegë deputetë,

I nderuar deputet Mustafa,

Unë dua edhe një herë ta falënderoj Kuvendin dhe deputetët të cilët kanë marrë iniciativë për ta hequr një paqartësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse është diskutuar shumë, ka pasur debate profesionale, joprofesionale, me argumente, pa argumente. Mendoj që puna e Komisionit ka treguar që nuk ka pasur asnjë lloj shkeljeje ligjore dhe që realisht ka hapësirë për menaxhim më të mirë nëpër ndërmarrje dhe besoj se kjo ka qenë një punë jashtëzakonisht e rëndësishme që të hiqet kjo dilemë për qytetarët se ka pasur çfarëdo lloj veprimi tendencioz dhe se, siç u tha, edhe nga raportuesit, më shumë protestat kanë qenë të involvuara nga motivet e tjera, sesa nga motivet që kanë të bëjnë me fatura. Ndërsa sa u përket përgjegjësisë, është konstatuar që çdo gjë, çdo veprim është marrë në harmoni me bazën e ligjore.

Unë edhe një herë dua t'i falënderoj të gjithë deputetët që kanë qenë pjesë e Komisionit dhe është një kontribut jashtëzakonisht i rëndësishëm për qartësimin e kësaj çështjeje në raport me qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot po e diskutojmë një çështje shumë të rëndësishme, pakënaqësinë e qytetarëve me faturimin e bërë nga KEK-u për muajin janar 2013. Në Komisionin Hetimor Parlamentar, të formuar për këtë çështje, për tre muaj rresht i kemi shqyrtuar të gjitha shkaqet, të cilat e kanë sjellë situatën e janarit 2013, në pajtim me kompetencat e dhëna nga Ligji për hetimin parlamentar.

Kemi ftuar në cilësinë e dëshmitarit, përfaqësuesit më të lartë të institucioneve respektive, duke filluar nga drejtori menaxhues i KEK-ut, zoti Arben Gjukaj, kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, zoti Enver Halimin, dhe anëtarët e tjerë të Bordit të kësaj zyre,

kryesuesin e Bordit të KEK-ut, zotin Fadil Çitaku, dhe anëtarët e tjerë të Bordit të KEK-ut. Kemi ftuar po ashtu ish-ministrin e Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, zotin Besim Beqaj, përfaqësuesin e shoqatës së “Konsumatori”, zotin Selatin Kaçaniku dhe aktorë të tjerë relevantë, të cilët janë përmendur në raportin final të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Çka kisha dashur të theksoj në këtë rast, është se gjatë shqyrtimit të materialit të pranuar nga KEK-u, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Njësisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike e tjerë, kemi ardhur në konstatimin se situata e janarit 2013 nuk tregon diçka specifike krahasuar me muajt apo periudhën e mëhershme, por situatë pothuaj të ngjashme kemi pasur edhe në vitet paraprake. Pse ka ardhur deri te kjo situatë?

Sipas dëshmive të përfaqësuesve të KEK-ut, ZRRE-së e tjerë, dhe materialeve që i janë nënshtruar hetimit nga Komisioni Hetimor, kemi vërejtur gabime njerëzore të paqëllimshme në lexim, ku ka raste kur në rastin e leximit të orëve është kaluar nga një bllok në një bllok tjetër. Nuk është se është faji i vetëm i KEK-ut. Këtu një pjesë të fajit e kemi edhe ne qytetarët apo konsumatorët e energjisë elektrike. Pse? Sepse, sipas materialit hetimor dhe dëshmive të dhëna nga dëshmitarët në Komisionin Hetimor Parlamentar, inkasantët apo lexuesit e KEK-ut nuk kanë pasur mundësi që për shkak të festave të Vitit të Ri t’i lexojnë orët deri më datën 3, apo edhe më 5 janar.

Arsyeja, sipas dokumenteve ka qenë, sepse kryesisht shtëpitë kanë qenë pa qasje nga lexuesit e KEK-ut. Domethënë, orët janë lexuar me tri deri në pesë ditë vonesë dhe për këtë e kemi situatën e kalimit nga një bllok në bllokun tjetër, e që dihet se kalimi nga një bllok në bllokun tjetër ka ngritje të çmimit për energjinë elektrike të shfrytëzuar, por KEK-u i ka respektuar procedurat e leximit dhe rregulloret në fuqi.

Gjithashtu, vlen të përmendet se hetimet e Komisionit nga institucionet e ndryshme lidhur me këtë çështje dhe nga raportet e tyre nuk kanë mundur t’i dokumentojnë shkeljet e procedurave dhe rregulloreve në fuqi, apo ndryshim të çmimeve nga ato zyrtare, por kjo situatë është shfrytëzuar nga grupet e caktuara për qëllime të caktuara, qoftë ato edhe politike.

Është interesante që të analizohet fakti pse çdo herë po jenë aktorë nipat dhe mbesat e Beogradit dhe djemtë e vajzat e ish-pjesëtarëve të UDB-së.

Organizatorët e këtyre protestave, të cilat po organizohen me qëllim të pengimit të zhvillimeve të proceseve demokratike në shtetin tonë, e patëm rastin që këta aktorë t’i shohim në organizimin e protestave, siç ishin ato kundër faturimit nga KEK-ut, e që rezultoi e pasaktë me përjashtim të vogël të disa gabimeve njerëzore, ose më saktë 0,1% e tyre. Këta aktorë vazhdonin vazhdimin e protestave edhe kundër ratifikimit të marrëveshjes me Serbinë, si dhe së fundi me rastin e amnistisë.

Mirëpo, fatmirësisht, qytetarët e Kosovës i kanë identifikuar këto qëllime dhe këta aktorë në fjalë, ndaj nuk i përkrahu dhe nuk po i përkrah. Nuk po flas për ty Arben, po flas për

publikun. Përjashtoj një numër të vogël të tyre, të cilët kanë pasur mundësi të informohen drejt, por që për momentin nuk dëshiroj të lëshohem më shumë në to, pasi qëllimi i Komisionit ka qenë dhe është mbështetja për qytetarin, në rend të parë.

Ju e dini se ne deputetët, që kemi qenë anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, nuk është se jemi ekspertë të thirrur të energjisë elektrike, prandaj disa nga konstatimet e cekura në raport janë rekomandimet e ekspertëve, që ne si komision i kemi angazhuar në pajtim me Ligjin për hetimin parlamentar.

Lidhur me raportin e ekspertit, kam pasur disa vërejtje, të cilat i kam shprehur edhe në Komision, sidomos lidhur me orët digjitale. Nga ato që i kemi pranuar si dokumente dhe nga vendimi i dëshmitarëve, konkluzionet e ekspertit bien në kundërshtim me to. Eksperti konkludon se orët e tanishme nuk kanë mundësi modifikimi, por ekspertët e KEK-ut dhe specifikacioni i tyre tregojnë se ka mundësi modifikimi dhe njehsorët ekzistues mund të përshtaten. Meqenëse raporti ka pasur unanimitetin e anëtarëve të Komisionit, nuk kam ngulur këmbë të hiqet nga raporti konkludimi i ekspertit, sepse edhe ashtu nuk ka ndonjë ndikim negativ në këtë hetim.

Për fund, e kisha shfrytëzuar rastin t'i falënderoj kolegët deputetë, anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar për bashkëpunimin që kemi pasur. Në raport kemi disa rekomandime që ne si Komision Hetimor me konsensus i kemi aprovuar dhe ju ftoj t'i votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Përpikuni të jeni në rend dite! Në emër të LDK-së, fjalën e ka Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA. I nderuar kryetar!

Qeveri,

Të respektuar deputetë,

Jemi duke diskutuar për raportin e Komisionit Hetimor për faturat e fryra të janarit dhe në fakt patëm mundësi t'i dëgjojmë diskutimet politike edhe çështjet, të cilat aspak nuk kanë të bëjnë me realitetin.

Unë do t'i bie më shkurt dhe të vij aty ku më pak është cekur. Sa i përket pjesës së parë, pjesës së faturimit të energjisë elektrike, është diskutuar dhe është parë që diku 60% e ankesave kanë qenë ankesa, të cilat kanë pasur të bëjnë me gabime njerëzore, por është e çuditshme që prej 380 mijë konsumatorëve të amvisërisë, kur hiqen konsumatorët tjerë, shihet që numri i ankesave, vetëm në vitin 2012, ka qenë 32 194, ndërsa janë trajtuar 380 000 sosh. Domethënë për shkak të këtyre të këtyre protestave dhe për shkak të pakënaqësive janë analizuar edhe 6 000 kërkesa, të cilat janë bartur prej vitit të kaluar. Dhe, në qoftë se 10% të ankesave janë pak, atëherë mendojmë që ne nuk jemi në rregull, që duhet të merren me të vërtetë masa që të përmirësohet mënyra se si faturohet dhe si lexohet dhe si futen shënimet në kompjuter, apo në bazat e shënimeve.

Periudhat e leximit u tregua që kanë qenë diku 3 deri në 5 ditë më të larta, gjë që unë nuk po e shoh aq të rëndësishme, pasi është gabim njerëzor, por në anën tjetër kur flasim për

njehsorët të cilët në shumë vende thuhet se janë njehsorë digjitalë, ndërsa në fakt janë njësorë të thjeshtë elektronikë, atëherë vijnë në pyetje gjërat të cilat tregojnë se pse është rritur çmimi i energjisë elektrike dhe si kanë ndikuar këta njehsorë në rritjen dhe në fryrjen e energjisë elektrike dhe në faturat e konsumatorëve.

Njehsorët e thjeshtë ekonomik, të cilët i kanë zëvendësuar ata elektromekanikë, në fakt nuk kanë asnjë përparësi teknike dhe nuk sjellin asnjë avancim krahasuar me atë të vjetrit, përveç pjesa e tarifës natë-ditë është në gabaritin e brendshëm dhe ku nuk mund të intervenohet nga vetë konsumatori për të ndryshuar orët me të lirë, gjë që paraqet çështje pozitive.

Por, nëse kjo ishte arsyeja e përzgjedhjes së këtyre njehsorëve të thjeshtë elektronikë, në vend të atyre digjitalë, atëherë kjo punë do të mund të korrigjohet vetëm me kontrollin e njësorëve të vjetër, me ribazhdarim dhe me dënimin e personave, të cilët ndërhyjnë në aparaturën e njehsorit elektromekanik, e jo eliminimin e problemit, duke i gjuajtur njësorët e vjetër dhe duke instaluar ata të rinj, pa avantazhe të duhura për të ardhmen.

Sipas analizës, të cilën e morëm, ekspertizës, 39% e njehsorëve mekanikë ishin më të ri se 10 vjet dhe arsyetimi për ndryshim është në qoftë se janë ata mbi 40 vjet, e shihet që diku 40% kanë qenë më të rinj se 10 vjet, gjë e cila nuk e arsyeton menjëherë zëvendësimin e tyre. Prandaj, përzgjedhja e njehsorëve të thjeshtë elektronikë dhe zëvendësimi i atyre të vjetër si rezultat ka pasur shpenzimin e kotë të parasë të konsumatorëve dhe automatikisht ka pasur ndikim në shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike dhe fryrjen e faturave të konsumatorëve. Në fakt, këta njehsorë e pengojnë edhe liberalizimin e tregut të energjisë, që është obligim yni karshi BE-së në vitin 2015, pasi nuk lejojnë identifikimin e operatorëve të rinj potencialë që mund të hyjnë në tregun energjetik të Kosovës.

Arsyeja mund të jetë një tender gjysmak, i cili shumë shpejt duhet të pasojë nga një tender tjetër dhe e gjitha kjo shkon përsëri në barrë të konsumatorëve, të cilët duhet ta paguajnë këtë. Mund të jetë, ndoshta dhe është ndonjë arsye që kanë ndonjë obligim, të cilin ministri nuk na e ka treguar karshi operatorit të ri privat, pasi atij po i sigurohet një terren pa konkurrencë. Sidoqoftë, shihet që është një qasje pa nikoqirllëk ndaj parasë publike dhe ndaj konsumatorit.

Sa u përket tarifave, kryetari i Komisionit tregoi që është sistemi i ndërlikuar i tarifave dhe se këto tarifa duhet të sigurojnë sipas ZRRE-së dhe sipas ligjit një çmim të energjisë elektrike, i cili është i përballueshëm për qytetarët. Por, në anën tjetër, nga analiza e shënimeve dhe ekspertiza dalin përfundimet tjera, të cilat duhet të përmenden.

Gjatë vitit 2012, bllok-tarifa 3 apo bllok-tarifa e dënimit ka paraqitur 58% të konsumit dhe 61% të faturimit, ndërsa në janar të vitit 2013 ka paraqitur 74% të konsumit dhe 76% të faturimit, pra 15% më tepër se në vitin paraprak dhe kjo automatikisht tregon që këto fatura kanë qenë të fryra pikërisht edhe për shkak të bllok-tarifës së dënimit apo të bllok-tarifës numër 3 dhe paraqet arsyen e pakënaqësive të konsumatorëve.

Kjo e dhënë dhe të dhënat tjera nga tabelat dëshmojnë konstatimin se bllok-tarifa B3 në fakt është baza e vjeljes së të hyrave me mbi 75%, e as për së afërmi subvencionimi i bllok-tarifës B1, e cila paraqet vetëm 2 deri në 3%, për të cilën thuhet se është krijuar për t'i ndihmuar familjet me të ardhura të ulëta. Ndërsa, sa i përket çështjes sociale, ne e dimë që Ministria e Punës dhe e Mirëqenies do të duhej ta rregullonte këtë çështje. Konsumatorët, nëpërmjet bllok-tarifës 3, në fakt ngarkohen me humbje teknike, komerciale dhe subvencionim të dy tjerave, dobësi menaxheriale dhe mungesë të efektivitetit të gjithë sistemit elektroenergjetik.

Është interesat të shihet se çmimi mesatar i ponderuar, i faturuar te konsumatorët e përfshirë në bllok-tarifën 3, në janar të vitit 1013, është 9,32 centë për kilovat orë në tarifën dimërore, dhe sipas shënimeve të Eurostatit, shihet se shumë është më i shtrenjtë se çmimi në Bullgari, në Rumani në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Bile kjo paraqet edhe një absurd, duke pasur parasysh se Maqedonia nuk prodhon rrymë, por vetëm importon, e në të njëjtën kohë në Maqedoni energjia elektrike është më e lirë se në Kosovë, e cila vetë e prodhon atë energji. Pra, ma lirë i kushton Maqedonisë blerja e energjisë, se në Kosovë prodhimi i saj.

Në anën tjetër, mendoj që është e vlefshme të përmendet edhe ekuiteti, i cili është paramenduar si përqindje e fitimit, që jep mundësi të investimeve. Dhe ekuiteti është faktor që ndikon në çmimin e rrymës, por pas pakënaqësive ky ekuitet një herë ka rënë në 13, në 8 dhe gjatë këtyre pakënaqësive në 6%, e fitimi prej këtij 6% në fakt është 5 milionë, pra jo i mjaftueshëm. Ajo e cila është brengosëse është që ministri ka deklaruar uljen e ekuitetit, ndonëse këtë e përcakton ZRRE-ja, e jo Qeveria, gjë që paraqet shkelje të kompetencave nga ministri.

Është interesant kontesti ndërmjet ZRRE-së dhe KEK-ut lidhur me 17,9 milionë euro dhe është edhe më interesant të shihet që ky 17,9 milionë euro, ndonëse është në kontest, është urdhëruar t'i kthehet operatorit të ri privat "Çalik&Limak", edhe pse gjyqi apo gjykata ende nuk ka arritur ta përfundojë këtë kontest.

Sa u përket 300 milionëve investime nga të hyrat, e dimë që këto investime të deklaruara nga operatori "Çalik&Limak", në fakt janë investimet të cilat do të vijnë nga konsumatorët dhe deri më tash nuk ka asnjë cent, i cili vjen direkt për të investuar dhe për ta përmirësuar gjendjen në KEDS. Krijohet përshtypja se që nga llogaritja e të ardhurave maksimale të lejuara është planifikuar që operatori i ri ta përgatisë terrenin, jo vetëm me çmim të ulët të shitjes, por edhe me rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe kur kjo u ndalua nga pakënaqësitë, atëherë plani i ndihmës ishte pagesa e parave të paftuara të KEK-ut drejt Distribucionit në vlerë prej 17,9 milionë eurosh.

Është shumë indikative që pikërisht rritja e paralajmëruar e çmimit të energjisë elektrike për 8,9% do t'i kushtonte konsumatorit rreth 17 milionë euro dhe kjo shumë është bukur e afërt me kërkesën e kthimit të 17,9 milionë eurove nga KEK-u në "Çalik&Limak". Kur të kihet parasysh që vetëm për 26 milionë është blerë, atëherë fitohet përshtypja që ata vetëm për 8 milionë e paskan blerë këtë distribucion dhe si i tillë kërkon me të vërtetë një hetim më serioz se ky Komision Hetimor lidhur me transparencën e gjithë procedurës.

Pika e katërt është pika e cila ka të bëjë me masat e ndërmarra nga institucionet dhe bartësit e përgjegjësive publike. Shihet se më 15 prill, atë ditë kur ka qenë debati në seancën parlamentare, ka qenë një frekuencë jashtëzakonisht e shtuar e komunikimit, e kërkesave dhe e shkresave, të cilat kanë rrjedhë ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Deklarata e ish-ministrit të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik me kërkesën për shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të KEK-ut, Arben Gjukaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe 5 minuta, por reduktojeni fjalën!.

TEUTA SAHATQJA: ...nga Bordi i KEK-ut, shiheni transkriptin e mbledhjes së seancës së 15.3.2013, komunikata e MZHE-së, së datës 15.3.2013, numër 36/13, paraqet shkelje të procedurave dhe kompetencave nga ministri Beqaj.

Shkresa e datës 28.2.2013, numër 38, e zotit Ramadan Sejdiu, drejtor i Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, në emër të Komisionit Ndërministror, i drejtohet zotit Fadil Çitaku, kryesuesit të Bordit të drejtorëve të KEK-ut, ku kërkohet në paragrafin e fundit të faqes së parë ndërmarrja e masave të menjëhershme ndaj zyrtarëve të lartë në KEK sh.a. dhe nëpërmjet tyre masa ndaj zyrtarëve të tjerë kompetentë.

Vazhdon shkresa 512, përsëri e së njëjtës datë nga zoti Ramadan Sejdiu, kur i drejtohet ministrit Beqaj dhe konstatohet që Bordi i KEK-ut nuk i ka përmbushur kërkesat e aksionarit për sanimin e gjendjes.

I propozon aksionarit që të ndërmarrë masa ndaj Bordit të drejtorëve të KEK-ut.

Pika tjetër është shkresa e datës përsëri 15 mars, por tash numër 517, me të cilën kërkohet menjëherë të veprohet në marrjen e masave ndaj drejtorit ekzekutiv të KEK-ut sh.a., faqe 2, paragrafi 2.

Është interesante shkresa e 18.3.2013, ku ministri Beqaj kërkon nga ZRRE-ja zvogëlimin e nivelit të kthimit në ekuitet të Qeverisë, në mënyrë që të pengohet ngritja e çmimit të energjisë elektrike. Është pjesa e cila gjendet në raport.

Do të vazhdoj me shkresën e datës 16.3.2013, e drejtorit të Bordit të KEK-ut, zoti Fadil Çitaku, drejtuar zotit Ramadan Sejdiu dhe drejtorit të Njesisë për Monitorim, dhe zotit Enver Halimit, nga ZRRE-ja, ku thotë që rekomandimet për çfarëdo veprimi janë në frymën e përfundimit të suksesshëm të privatizimit dhe çfarëdo veprimi tjetër do të rrezikonte seriozisht transaksionet e privatizimit. Për çka jemi duke folur këtu?

Nga kjo shihet drejtpërdrejt lidhja dhe influenca e veprimeve me procesin e privatizimit.

Në anën tjetër, në shkresën 520 të datës 15 mars thuhet që për mbulimin e humbjeve të KEK-ut, KEK-u ka paraqitur vlerë më të madhe të humbjeve duke e ditë që

“Çalik&Limak” do të fitojë bonuse për uljen e humbjeve dhe çështja e cila përsëri e sjell në dyshim këtë veprim.

Janë edhe mjaft shkresa tjera, të cilat mund të gjenden në raportin e Komisionit Hetimor, e të cilat tregojnë që transparenca dhe mënyra se si është komunikuar dhe të gjitha këto kërkojnë me të vërtetë një hetim pakëz më thelbësor sesa vetëm Komisioni Hetimor Parlamentar.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon aprovimin e rekomandimeve, por kërkon edhe një vëmendje të shtuar dhe një transparençë më të madhe, një auditim të të gjithë këtyre veprimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Rashiq, vendet e ministrave janë tjetërkund! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Që në fillim dua të them që jam plotësisht dakord me atë që e tha deputetja zonja Sahatqija që ky raport i këtij Komisioni Hetimor në gjetjet e tij e ka konstatuar një çështje shumë të rëndësishme, e ajo është që procesi i privatizimit të KEDS-it duhet domosdoshmërisht të hetohet, sepse të gjitha problemet për të cilat po flasim këtu lidhen, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose në mënyrë indirekte me të. Prandaj, ky hetim tregon që na duhet një hetim më i mirëfilltë dhe më i thellë, dhe kjo do të ishte zgjidhja edhe për këtë çështje për të cilën po flasim.

I dëgjova këtu disa herë, deputetët thonë që ata që po flasin në këtë foltore po dalin jashtë rendit të ditës, sepse nuk po folkan për fatura. Të jua përkujtoj edhe një herë që kërkesa fillestare e themelimit të këtij Komisioni Hetimor, edhe pse e ka marrë për bazë revoltën e qytetarëve, pakënaqësitë e qytetarëve, që kishin të bëjnë me faturat e janarit të vitit 2013, ka qenë kërkesë e cila ka kushtëzuar hetimin e kësaj çështjeje dhe të çështjeve të tjera që lidhen me furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në mënyrë që të konstatohet shkaktari i vërtetë i kësaj pakënaqësie, apo shkaktari i vërtetë i faturave të janarit. Dhe, këto kanë qenë të gjitha fushat e energjisë, përfshirë këtu procesin e privatizimit, përfshirë këtu mosndërtimin e largpërçuesit me Shqipërinë, përfshirë edhe aspektet tjera të funksionimit të sistemit energjetik të Kosovës, që do ta kenë domosdoshmërisht ndikimin, nëse jo të drejtpërdrejtë, atëherë të tërthortë në çështjen për të cilën po flasim.

Pra, nuk ka qenë asnjëherë i menduar dhe nuk mund të jetë komision që i heton vetëm faturat e janarit, sepse Komisioni Hetimor nuk është komision i KEK-ut. Pra, nuk mund të merremi me hetimin e gabimeve njerëzore që ka mundur të ndodhin apo të mos ndodhin në faturimin që u është bërë qytetarëve në janar. Kjo do të kishte qenë shumë paradoksale dhe madje keqpërdorim i fondeve publike po të themelohej nga Kuvendi një komision që merret me faturat e muajit të caktuar të furnizimit me energji elektrike.

Për mendimin tim, edhe pse u thanë shumë gjëra këtu, dhe meqenëse po flasim për raportin e njëjtë, tash domosdoshmërisht do të ketë edhe përsëritje të ngritjes së

çështjeve, ky raport i definon shumë qartë katër çështje kryesore apo probleme kryesore që kanë lindur në muajin janar dhe rreth muajit janar.

Dhe, çështja e parë është shtrenjtimi i energjisë elektrike. Pra, u tha këtu që nga hetimi që e ka bërë komisioni është vërtetuar që vërtet gabimet e drejtpërdrejta në faturim nuk kanë qenë të një niveli shumë të lartë, mirëpo çmimi i energjisë elektrike për janar domosdoshmërisht është më i madh po ta krahasojmë, ta zëmë me janarin e vitit të kaluar, gjë që e thotë raporti dhe kjo nënkupton - ajo shtesë, siç e përmendi edhe kryetari i Komisionit, është përafërsisht ekuivalente me rritjen e çmimit të energjisë elektrike që është bërë në muajin qershor të vitit 2012, që nënkupton që duhet të analizojmë pse ka ardhur kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike e ka shkaktuar pakënaqësinë te qytetari për faturën e energjisë elektrike.

Pra, ky çmim, ky shtrenjtim i çmimit të energjisë elektrike është bërë sipas ZRRE-së, duke i marrë parametrat apo kriteret që merren për t'i përcaktuar të hyrat maksimale të lejuara për sistemin e energjisë, në këtë rast për operatorin publik që ka qenë në vitin 2012, edhe furnizimi, edhe distribuimi, edhe gjenerimi, dhe transmissioni.

Tash, duhet ta analizojmë pak këtë çështje edhe në dritën e 17,9 milionë eurove, të cilat pastaj ZRRE-ja ka vendos t'i bartë nga operatori publik në operatorin privat, për shkak se këto dy çështje janë të ndërlidhura. Por, jo që domosdoshmërisht mbulohen vetëm nga raporti i Komisionit Hetimor, por edhe nga raporti i ZRRE-së për vitin 2012 dhe përgjithësisht në intervistimet që i kemi pasur, me aktorët apo përfaqësuesit e institucioneve janë të ndërlidhura me të.

Në vitin 2012 është vendosur që rritja e çmimit të energjisë të jetë për 8,9% për faturat që nisin prej atij muaji dhe që vazhdojnë deri në shqyrtimin tjetër tarifor, shqyrtimi që është dashur të bëhet në prill të vitit 2013.

Dhe, kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike është arsyetuar me të hyrat maksimale të lejuara, që kanë qenë për vitin 2012, diku në 242 milionë euro që janë lejuar.

Dhe, një prej shkaktarëve, sipas ZRRE-së, që e ka shkaktua këtë, ose lejimin e këtyre të hyrave maksimale, ka qenë edhe çmimi për importimin e energjisë elektrike dhe sasia e importit që është projektuar që do të importohet gjatë vitit 2012. Dhe, në fund të vitit 2012, pastaj, sipas ZRRE-së, pas analizimit të vitit 2012, është ardhur në përfundim që KEK-u nuk ka pasur nevojë ta importojë edhe me çmimin e importit të parashikuar sasinë e energjisë elektrike, e cila i është parashikuar gjatë shqyrtimit të faturimit.

Dhe, në këtë shqyrtim të faturimit pastaj po ashtu është ardhur në përfundim që janë diku 17,9 milionë euro, të cilat KEK-u i ka pasur të lejuara më shumë se sa që janë dashur që të operojë gjatë vitit 2012. Dhe, ky është ai 17,9 milionë euro, i cili i bartet tash KEDS-it. Pra, ky dallim ndërmjet parave të faturuara dhe parave, të cilat ka qenë dashur të lejohen, duke i pasur parasysh ato që kanë ndodhur në furnizimin me energji elektrike gjatë vitit 2012.

E dëgjova një reagim të ministrit që nuk i barten KEDS-it. Ministër, ZRRE-ja, ose përfaqësuesit e Bordit të ZRRE-së kanë thënë që këto i barten KEDS-it, pra i barten kompanisë dhe arsyetimi ka qenë që po i kthehen nëpërmjet KEDS-it qytetarit, sepse nuk po shtrenjtohet energjia elektrike në vitin 2013 ashtu siç është paraparë të shtrenjtohet. Pra, ky ka qenë arsyetimi i ZRRE-së. Nëse ju keni diçka, një arsyetim tjetër, apo nëse ju e keni një informatë tjetër për Kuvendin ju kisha lutur ta ndani me Kuvendin, por mos më ndërpritni derisa ta përfundoj, dhe pastaj ndajeni këtë informatë me Kuvendin. Unë po flas për atë që e kanë thënë autoritetet e pavarura, që e rregullojnë fushën.

Tash, ky 17,9 milionë euro që i jepen KEDS-it është dhënë pra me arsyetimin që të mos e shtrenjtojmë energjinë elektrike për vitin 2013, që ka qenë dashur të shtrenjtohet.

Pra, për vitin 2013, KEDS-i, kompania private i ka të hyrat maksimale të lejuara më shumë sesa është lejuar të inkasohen ato nga qytetarët - konsumatorë e Republikës së Kosovës dhe dallimi është 17,9 milionë euro, të cilat kompania i merr nga KEK-u, pra nga kompania publike në formë të parave të gatshme. Në vend se t'i mbledhë pra nga qytetarët, i merr në formë të parave të gatshme dhe kjo tregon që shtrenjtimi i energjisë elektrike që është bërë në vitin 2012 është drejtpërdrejt i lidhur me një projektim të procesit të privatizimit dhe të përfitimit të projektuar të kësaj kompanie për këtë periudhë. Pra, drejtpërdrejt, kjo ka të bëjë me procesin e privatizimit.

Siç e përmendi shumë mirë zonja Sahatqija, siç është parë edhe me shkëmbimet që i kanë pasur institucionet, edhe Ekzekutivi me autoritetet e pavarura, shihet qartë që krejt vendimet që kanë të bëjnë me energjinë elektrike, që prej se është vendosur të privatizohet ky sektor, kanë pasur të bëjnë me krijimin e kushteve për privatizimin e sektorit. Pra, jo në interes të qytetarëve, e as në interes të shtetit të Kosovës, por drejtpërdrejt me një proces të privatizimit dhe kjo dëshmon qartë që duhet të hetohet ky proces i privatizimit për ta kuptuar se çfarë i ka ndodhur Kosovës me të.

Çështja e dytë që ngrihet në raport dhe natyrisht që ndërlidhet edhe me të parën janë ndërhyrjet antiligjore dhe të palejuara të ministrit në punët e autoriteteve të pavarura.

Pra, kur ne po flasim këtu për ta zënë Zyrën e Rregullatorit të Energjisë apo për autoritetet tjera, Qeveria vazhdimisht na thotë se këto janë autoritete, të cilat edhe janë të themeluara, edhe kontrollohen nga Kuvendi, dhe rrjedhimisht kërkoni përgjigje nga ata, mos kërkoni nga ne. Ndërkohë që e vërteta gjatë këtij hetimi po del krejt e kundërta, që në fakt këto kontrollohen drejtpërdrejt, madje edhe shantazhohen nga vetë Ekzekutivi dhe puna e tyre është reflektim i dëshirave e vullnetit të Ekzekutivit, e jo një punë e pavarur e rregullimit të tregut nga një autoritet i pavarur, i cili do të duhej t'i raportonte Kuvendit. Pra, kjo është ndërhyrje, mendoj unë. Vetëm ky element kërkon një ndërhyrje shumë më të vendosur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë që ta garantojmë pavarësinë e këtyre autoriteteve, po që se duam vërtet që Kosova të krijojë mekanizma të funksionimit të një shteti normal, modern, demokratik.

Pra, kjo është ndërhyrje edhe antiligjore dhe është madje antikushtetuese për shkak se këto autoritete, këta rregullatorë janë kategori kushtetuese me Kushtetutën e Republikës

së Kosovës, me të cilët këto vlerësohen të jenë të pavarura. Ndërkohë që ndërhyrjet e ministrit po i bëjnë ato të varura, dhe të varura keq.

Çështja e tretë që u përmend këtu, po dua vetëm ta përmend përciptazi, janë që investimet në KEDS kanë qenë të keq-planifikuara dhe në një aspekt formal të gabuara, por duke i pasur parasysh edhe këto ndërhyrje tjera dhe këtë insistim të ministrit në procesin e privatizimit, atëherë po del që nuk janë të gabuara, por janë dashakeqëse. Pra, janë dashakeqëse, në mënyrë që ta dëmtojnë edhe buxhetin publik të Kosovës, edhe buxhetin e kompanive publike, sepse po shihet që instalimi i këtyre orëve elektronike, njehsorëve elektronikë, në vend se të instalohen ta zëmë njehsorë digjitalë që vërtet do ta përmirësonin kontrollin e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe dy minuta, a të mjaftojnë?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pra, këto orë, përveç që po ia shpenzojnë buxhetit të kompanisë publike mbi 8 milionë euro në momentin kur ajo po privatizohet, edhe po e pamundësojnë në të ardhmen liberalizimin e tregut, apo edhe kontrollin e mirëfilltë të distribuimit edhe të një transparence në faturimin dhe përdorimin e energjisë elektrike, gjë që pastaj jo vetëm që po ia bartim monopolin me momentin e privatizimit, monopolin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, mirëpo me investimin që e ka bërë Qeveria e Kosovës, në fakt po ia garanton këtë monopol, po ia garanton në të ardhmen për shkak se vetë sistemi po ndërtohet në atë mënyrë që pamundëson hyrjen e një operatori të dytë dhe të tretë në treg, gjë që do të nënkuptojë që monopolin privat do ta ketë kompania KEDS-i, dhe kjo në njëfarë mënyre ia jep kontrollin e plotë përmbi shtetin e Kosovës, sepse ia jep kontrollin përmbi furnizimin me energji elektrike të shtetit të Kosovës.

Edhe çështja e katërt, me të cilën dua ta përfundoj, është dëshmuar që blloku tarifor është edhe i gabuar, dhe për më tepër nuk ka qenë në interes të qytetarëve, për shkak se në njërin anë e ka lejuar kros-subvencionimin, gjë që po të bëhej në mënyrë të sinqertë dhe të mirë për interes të qytetarëve nuk do të kishte me qenë çështje e keqe, mirëpo këtu është keqpërdorur për t'i vjedhur qytetarët dhe për ta shtrenjtuar energjinë elektrike, apo çmimin mestar të energjisë elektrike për secilin qytetar, sepse te ajo kategoria, te tarifa e parë, që është kategoria më e ulët, kategoria më e lirë, i kanë lënë vetëm 200 megavatë orë energji elektrike, që dihet shumë qartë dhe shumë saktë që nuk i mjaftojnë asnjë familjeje në kohën e dimrit. Mbase mund t'i mjaftojnë në kohën e verës, por në kohën e dimrit kjo absolutisht nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e çfarëdo kërkesë që mund ta ketë apo nevojë e një familjeje. Dhe, rrjedhimisht, domethënë ky bllok tarifor është lejuar dhe është instaluar si i tillë, vetëm e vetëm sa për t'i rritur çmimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po duket që edhe kur të vijë koha për t'i diskutuar të gjeturat e raportit dhe për t'i votuar rekomandimet kemi platformë për të folur për shkak se është një temë, e cila është jashtëzakonisht e ndjeshme. Është diçka që me të vërtetë po tregon se kemi problem serioz për ta ndërtuar një sistem për ta menaxhuar të paktën një kompani.

Se ka keqpërdorime, edhe në KEK, edhe në KEDS, edhe në ndarje, edhe në gjithçka, mendoj se nuk ka mbetur asnjë njeri në Kosovë që dyshon, absolutisht hiç, prej njësorëve të punëtorëve të KEK-ut, të cilët askush nuk i ka kontrolluar kurrë, e deri te abuzimet shumë të mëdha, të cilat kapin edhe miliona. Të mos flasim për tema të vogla.

Sidoqoftë ,sot në Kuvendin e Kosovës kjo nuk është tema. Tema është raporti i Komisionit Hetimor, është ajo që ne e kemi gjetur kinse si Kuvend dhe mendoj se është mirë pak të ndalemi te kjo. Çka kemi bërë? Për shembull, unë e kam një dilemë personalisht dhe ne e kemi një dilemë: çka bëhet në Kosovë nëse ne e votojmë këtë raport? Çka ndryshon? Dhe, çka bëhet nëse nuk e votojmë raportin, në cilindo variant?

Kjo domethënë që Kuvendi i Kosovës e ka bërë një komision hetimor për t'u marrë me një temë për të cilën nuk është i thirrur as i gatshëm për t'u marrë, as nuk ka kapacitet për këtë.

Mos harroni se për të bërë hetime në këto aspekte, për t'i hetuar çështjet që kanë të bëjnë me kontabilitet, me fatura, me sisteme të komplikuara, njerëzit shkollohen, specializojnë, janë specialistë që mund të merren me këto tema. Tash Kuvendi po del që është një grumbull i specialistëve universalë.

Kuvendi i Kosovës ka pasur mundësi të merret me këtë temë më ndryshe dhe një pjesë të madhe, po e përsëris vetveten këtu çka kam thanë kur kemi vendosur për këtë temë, Kuvendi i Kosovës ka shumë instrumente në dorë, të cilët mund t'i aktivizojë dhe t'i përdorë për shkak se të gjithë ne këtu kemi qenë të brengosur me atë që ka ndodhur me faturat e KEK-ut. E di saktë në biseda me shumë deputetë që edhe shumë prej nesh këtu jemi dëmtuar seriozisht, por është mirë që nuk kemi folur, se si të flasim ne kur dëmtohet dikush që i ka 200 ose 300 euro të hyra në muaj.

Ajo çka dua ta them unë është kjo: E votuam, nuk e votuam ne sot raportin, kurrë nuk do të ndryshojë për shkak se e kemi aktivizuar një instrument tepër të madh të panevojshëm për këtë temë. Ka instrumente të tjera Kuvendi, dhe duhet t'i shfrytëzojë ato instrumente. Kemi komisione, të cilat e dinë saktë çfarë instrumentesh duhet aktivizuar për të pasur rezultat konkret. Kuvendi ka të drejtë të bëjë komisione hetimore. Është e drejtë edhe kushtetuese, edhe ligjore, edhe me Rregulloren të Punës. Krejt në rregull, dhe duhet bërë kur është nevoja. Por, duhet racionalizuar, në mënyrë që të arrihet deri te rezultati.

Problemi ynë është që nuk kemi arritur kurrfarë rezultati. Po ju premtoj që sot, nëse votohen këto rekomandime, presim sa të doni, presim tre muaj, gjashtë muaj, një vit, dhe

do ta shihni cili do të jetë rezultati i këtij komisioni hetimor. Përderisa nëse ishin aktivizuar instrumentet tjera, do të kishte rezultat ndoshta tepër konkret. Fundi i fundit, mendoj se Kuvendi duhet ta shohë edhe bazën ligjore. Duhet ta shohë bazën ligjore dhe në bazë të asaj baze ligjore që e kemi duhet, ta shohë mundësinë për t'i mbrojtur konsumatorët, se është e vërtetë e pamohueshme që ata nuk janë të mbrojtur prej një institucioni deri dje publik.

Domethënë, i ka rrjepur, u tha këtu më përpara, dhe nuk po përsëris, unë po pajtohem me të gjitha ato që i thanë kolegët. Janë rrjepur qytetarët e Kosovës, por ne nuk e gjetëm metodën e saktë për ta parandaluar këtë gjë dhe po më duket që do të vazhdojë dhe kjo është për keqardhje. Ndoshta ne duhet ta vazhdojmë punën edhe t'i gjejmë instrumentet e sakta për ta kryre këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovën e Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përsëritet për dy ministrat dhe deputetët në këtë seancë,

Në rast se e shohim në start raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor, ku thuhet se ai u krijua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbledhjen plenare, të mbajtur më 28 mars 2013, bazuar në kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, të mbështetur nga deputetët tjerë, në pajtim me nenin 77, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 8 të Ligjit për hetim parlamentar dhe nenit 69.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët digjitalë dhe masa të ndërmarra në lidhje me këtë rast, mund të themi se ky komision hetimor është formuar për çështjen e tarifave dhe këto çështjet shtesë nuk e di pse figurojnë këtu.

Në rast se i shohim rekomandimet e Komisionit Hetimor, mund të themi se rekomandimet të cilat janë dhënë në pikën 1, kanë mundur të jepen edhe pa Komision Hetimor, kur dihet se Zyra e Rregullatorit i raporton Kuvendit të Kosovës dhe është organ i pavarur i Kuvendit të Kosovës dhe në rast se në fakt e shohim problemin e faturave të fryra të energjisë për janarin e vitit 2013, atëherë Zyra e Rregullatorit ka treguar mjaft mirë pse ka ndodhur kjo. Dhe, tregon mjaft mirë se këtu është problemi i menaxhmentit të KEK-ut, ku Zyra e Rregullatorit i ka sjellë vendim KEK-ut që të ketë reduktime deri 3% në një vit, ndërsa KEK-u nuk e ka reduktuar këtë 3%, po më 1,4%, që do të thotë se humbjet kanë qenë të mëdha dhe këtu del ajo çështja e 17,9 milionëve të cilat duhet t'i jepen KEDS-it për arsye se KEK-u nuk i ka zvogëluar humbjet dhe tash mbeten nëpër gjykata me këto vendime, a do të vijë te operatori i ri këto para, apo do të shkojnë te KEK-u.

Ndërsa menaxhmenti i KEK-ut është dashur të shkarkohet po nga Bordi i KEK-ut, fjalë të cilën e pati vetë dhënë ministri Besim Beqaj, mirëpo nuk e di sa e ka realizuar Bordi i KEK-ut, por në këtë rast, edhe në bazë të këtyre rekomandimeve, kërkoj që Bordi i KEK-ut të shkojë bashkë me Arben Gjukën. Jo vetëm, por bashkë, të dytë.

Në rast se e shohim rekomandimin 2, Zyra e Rregullatorit duhet të bëjë një rishqyrtim të strukturës së tarifave dhe sidomos të blloqeve tarifore. Ne e kemi Ligjin për Zyrën e Rregullatorit të energjisë, i cila ia jep strikt mundësitë çka duhet të bëjë Zyra e Rregullatorit dhe Zyra e Rregullatorit është ajo e cila edhe bën ngritjen e tarifave dhe bën çështjen e shqyrtimit të tarifave, kur është nevoja po nga KEK-u.

Rekomandohet që Zyra e Rregullatorit të diskutojë, të rishqyrtojë me KEDS-in planin e investimeve, në mënyrë që investimet e zotuar nga “Çalik&Limak” të bëhen në një dinamikë të përshpejtuar.

Kjo ka qenë ndoshta në kontratën, të cilën e ka bërë Qeveria me operatorin e ri dhe këta janë të obliguar. E dinë çka duhet të investojnë në bazë të kontratës.

Rekomandohet të rishikohet në mënyrë kritike nga ZRRE-ja i tërë projekti i furnizimit me orë elektronike nga aspekti i fizibilitetit të tyre teknologjik dhe ekonomiko-financiar dhe nevoja e zgjedhjes që ta lehtësojmë liberalizimin dhe konkurrencën e tregut të furnizimit.

Deputetë të nderuar,

Fatbardhësisht, ne nuk kemi pas liberalizim të tregut në sektorin e energjisë, kur dihet mjaft mirë se Kosova tash gjendet në bisedime teknike me Serbinë dhe në rast se do të ishte liberalizuar tregu i energjisë tash, cili operator i ri do të vinte në veri të Kosovës. Fatbardhësisht, me ligje, deri në vitin 2015 nuk ka liberalizim të tregut të energjisë.

Dhe, rekomandimi për kryeministrin e Republikës së Kosovës, besoj që ai i ka të përshkruara detyrat dhe për çdo gjë që ngarkohet politikisht në Qeverinë e Kosovës ai e di që përgjegjësia ngel mi to. Ndërsa unë nuk kam qenë as atë ditë e pajtimit që të bëhet komisioni hetimor, ngase kam kërkuar që raportet vijnë nga ZRRE-ja, nga Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe edhe sot kërkoj që në këtë rast bordi i KEK-ut dhe Arben Gjuka të shkojnë në shtëpi, se të gjitha këto humbje të mëdha në dëm të Kosovës i ka shkaktuar vetë menaxhmenti i KEK-ut. Faleminderit!

KRYETARI: Kuvendi nuk e ka për detyrë ta dërgojë në shtëpi askënd. Në emër të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” je pažljivo razmatrala izveštaj anketne Komisije, i mislimo da je Komisija radila veoma dobar posao, i da je radila veoma ozbiljno.

Komisija u svom radu je pozivala i mnoge svedoke, aktere, koji su direktno bili angažovani, i koji su pomenuti u izveštaju.

Od svih pozvanih svedoka koji je Parlamentarna komisija pozivala došli smo do zaključaka da nije bilo direktno kršenja prava potrošača, već da je to dosta zbog toga zbog tehničkih problema na terenu, i to najviše zbog ljudskih grešaka.

Ali kao što su i moje kolege pre mene rekli, u prethodnim godinama imali smo veliki broj žalbi, upravo na rad radnika koji čitaju brojeva, i zbog toga je taj deo problema treba rešavati veoma ozbiljno.

Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” je mišljenja da izveštaj veoma dobar i da prenosi realno sliku stanja za fakturisanje januarskih računa, i podržaću usvajanje istog. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Fadil Ismajli.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë së pari i kërkoj falje Visarit që e ndërpreva, besoj që s’ta kam zhvendosur renditjen e fakteve që ke pasur ndërmend, por ndoshta desha t’i fitua këta dy minuta sa për të sqaruar diçka.

Sa për raportin, shkurt: Unë mendoj që raporti nëse ka qenë qëllimi për të zbardhur një të vërtetë për çka edhe shkruan në titull për faturimin e KEK-ut, atëherë e kemi huq totalisht. Në qoftë se kemi pasur të bëjmë raport edhe në aspektin e kemi huq për t’ua sqaruar qytetarëve dhe konsumatorëve prej asaj çka kam lexuar dhe prej saj çka po themi këtu, çfarë kanë kuptuar qytetarët? Pse? Sepse në këtë raport trajtohen tema të cilat fare s’kanë lidhje me atë për çka është formuar komisioni. Nuk do të thotë se ato tema nuk duhet të trajtohen. Më besoni që secila temë që përmendet aty meriton nga një hetim të posaçëm, por shumë profesional, siç tha deputeti Gjini. Plotësisht pajtohem me atë, sepse duhet një ekspertizë shumë më të nevojshme.

17,9 milionë euro i kthehen konsumatorit, nuk i epen as KEDS-it, as KEK-ut, sepse janë para të cilat nuk janë shfrytëzuar vitin e kaluar dhe me agjustimet të cilat bëhen, me rregullat që i ka çdo rregullator në botë, i kthehen konsumatorit. Konsumatorit nuk i dërgohen në shtëpi, por zvogëlohet tarifa për aq, ose nuk rritet për aq. Këtë, unë kam durim, nëse ka nevojë e sqarojmë edhe më gjatë, por kjo qëndron kështu dhe unë besoni se aq jam kompetent për ta ditur këtë.

Për deputeten Sahatqija, nëse më lejohet,

Mund të ju them se ka jokonsistencë kur flitni se njehsorët nuk janë në rregull, nuk janë adekuatë, se nuk i shërbejnë hapjes së tregut në vitin 2012, ndërsa menjëherë, tri fjali më vonë, thoni se ndoshta kjo është nevojitur për ta bërë për atë që po e privatizon, por atëherë kjo është në kundërshtim me atë që po themi. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputetja Teuta Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Diku pajtohem me ministrin. Pajtohem plotësisht që duhet një ekspertizë më e madhe, prandaj edhe ne po kërkojmë ekspertizë dhe auditim. Në gjithë këtë punë kërkohet një ekspertizë, dhe një auditim dhe një raport shumë më detal. Prandaj, edhe po më vjen mirë që ky komision hetimor e nxori në pah atë.

Sa i përket inkonsistencës, mendoj që është shumë konsistente, në qoftë se njehsorët të cilët janë blerë nuk janë plotësisht të pajisur për ta eliminuar mundësinë e gabimit njerëzor, në qoftë se njehsorët e thjeshtë elektronikë nuk e kanë mundësinë e shtimit të tarifave të reja, përveç të ridërgimit edhe një herë në fabrikë, e kthimit prej fabrikës, që përsëri e shton koston, në qoftë se ajo është gjysmake dhe kërkon edhe një herë të blihen, e gjithë ajo shkon në kurriz të konsumatorit. Prandaj, kjo është konsistente. Konsistente është që në secilin prej rasteve, nga kjo vuan dhe shkon në kurriz të konsumatorit.

KRYETARI: Replikë, deputeti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Për çështjen që e ngriti ministri reagim ndaj asaj që e thash unë, e që e thotë edhe raporti në njëfarë mënyre, por që e ka thënë edhe ZRRE-ja, po dua vetëm t'ia përkujtoj një situatë, që të gjithë e dini, pra situatën që e ka pasur CEZI në Shqipëri me Rregullatorin atje.

E dini që në një moment, nuk po më kujtohet tash viti, me gjasë është viti 2009, CEZ-i insistonte të rritej çmimi i energjisë elektrike për shkak se i kishte planifikuar paratë e nevojshme për operim, siç i quante ai, dhe Qeveria e Shqipërisë, atëbotë kryeministri Sali Berisha, insistonte që të mos ngrihej ky çmim i energjisë elektrike për shkak se tashmë ishte ngritur shumë dhe i bëhej i papërbalueshëm për ekonominë e Shqipërisë dhe pastaj CEZ-i tha: 'Në rregull, nëse nuk e rritni çmimin e energjisë elektrike, atëherë ma paguani këtë dallim në para nga buxheti i shtetit'.

Pra, kjo i bie ose më le t'i rrjep qytetarët drejtpërdrejt, ose po i rrjep qytetarët nëpërmjet buxhetit në mënyrë indirekte dhe e njëjta çështje po na ndodh këtu. Pra, këtu nuk po rritet çmimi i energjisë elektrike, por po themi mos i rrjep qytetarët sivjet, se po i japim ne të gatshme prej kompanisë publike. Kjo është ajo që po e quani ju që po u kthehen paratë qytetarëve, ajo që në fakt që po blihet për një vit mosshtrënjtimit i energjisë elektrike, gjë që do të kishte ndodhur por të mos kishte me qenë ky 17,9 milionë euro, sepse a i është kërkuar ndonjëherë KEDS-it, për shembull, që ta ulë mazhën e fitimit për të mos ia shtrënjtuar energjinë elektrike. KEDS-it privat, po flas. Jo.

Pra, po i thuhet ja po t'i japim ne paratë e gatshme nga kompania publike vetëm mos kërko dhe mos insisto në shtrënjtim të energjisë elektrike, sepse ekonomia nuk mund ta përballojë. Kjo është çfarë është duke ndodhur në terma realë. Ndërkohë që po, ministri mund ta shpjegojë këtë me terma teknologjikë të ekspertizës, që vërtet do të ishte e pakuptimtë për qytetarët, por kjo shumë e kuptimtë për qytetarin.

Edhe çështja e dytë, mos e përzini, ministër, edhe në aspektin profesional fjalën 'liberalizim i tregut', me fjalën 'privatizim'. Pra, privatizimi dhe liberalizimi jo domosdoshmërisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministri, kundër-replikë!

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, kryetar!

Nuk kisha dëshirë të bëj replikë vërtet, por në esencë unë si duket i ri dhe nuk po i kuptoj gjërat, a po flasim për publikun, apo për flasim për të vërtetën. Domethënë, në qoftë se flasim për publikun, atëherë po ju kuptoj plotësisht se ne duhet dërguar mesazhin e keq para publikut. Nëse flasim për të vërtetën, e vërteta është që këto para, dhe nuk krahasohet kjo me rastin e Shqipërisë dhe këtë që e përmendi, është fjala për mjetet të cilat i kthehen konsumatorit. Ekziston formula me të cilën kthehen. Në gjithë botën rregullatorët veprojnë njëjtë. 17,9 milionë janë më pak në tarifën e konsumit për shkak se janë shpenzuar vitin e kaluar dhe nuk guxon të merren domethënë të njëjtat mjete dy herë nga konsumatori. Kjo është një. Thashë edhe më herët, mund të ulemi dhe ta sqarojmë.

Ndërsa, nuk po e di prej nga e krijove përshtypjen që unë bëra...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Visar, një minutë!

VISAR YMERI: Ministër!

A po ulet çmimi i energjisë elektrike, meqenëse po ua kthyeka qytetarit? Jo. Pra, çmimi i energjisë elektrike do të jetë i njëjti, por nuk po rritet, edhe nëse këtë e quani që po u kthehet qytetarëve, atëherë kjo i bie që në fakt po blihet moshtrenjtimi i energjisë elektrike.

(Ndërhyrje)

Jo, jo! Po them për ty, se s'je duke e kuptuar. Domethënë s'është qesharake hiç. A do të jetë sivjet çmimi i energjisë elektrike më i ulët se vitin e kaluar, meqenëse po u kthyekan paratë qytetarëve? Jo, pra, nuk do të shtrenjtohet dhe këtë po e quani që do t'u kthehet qytetarëve, e unë po them kjo është blerje e mos shtrenjtimit, po e përsëris prapë. Pra, e përzjeve liberalizimin me privatizim, sepse duke iu referuar deputetes Sahatqija the që orët nuk janë të përshtatshme për liberalizim dhe pastaj the, pas tri-katër fjalive, që kjo është bërë për privatizim. Po, për privatizim është bërë kundër liberalizimit. Dhe kjo është mundshme dhe është duke ndodhur.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Replikat u kryen. Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,
Ministra, zëvendëskryeministër,
Deputetë,

Duke dëgjuar prononcimin e disa kolegëve të mi të grupeve parlamentare këtu jepet përshtypja e këtij politizimi që ne qytetarët nuk jemi duke ua qarë hallin, por jemi duke e afirmuar vetveten. Pra, po ua qajmë hallin dhe de fakto po investojmë për vetveten, sepse s'është as ajo që po deklarojnë grupet. Unë nuk desha të flas, por në grupin tonë në Komisionin për Zhvillimin Ekonomik, ne kemi marrë sqarime të mjaftueshme edhe nga

ZRRE-ja, ndërsa disa deputetë për shembull, kolegja jonë Sahatqija që thotë është çmimi më i lirë në Maqedoni edhe pse s'prodhon Maqedonia, ajo i ka dy termocentrale, një në Negotin dhe një në Kërçovë dhe prodhon. Nuk i ka mbyllur, por ju keni informata të tilla.

Dhe për njohuri të juaja, çmimi i produktit energji në regjion sa unë kam informacione dhe sa kemi edhe nga ZRRE-ja që na ka sqaruar neve, ne kemi çmimin më të ulët në çmimit të energjisë. Se ku janë duke rrjedhur problemet është problemi edhe te standardi në ekonomi, ndërsa shtoja këtë problemin politik të shoqërisë civile që dëshiron politizuar çdo gjë nën emrin se po del si mbrojtës i interesave qytetare, kjo lexohet sheshazi për rrugë. Unë jam munduar edhe te Grupi Parlamentar, edhe te ZRRE-ja të flas për metrologjinë që e udhëheq Ministria e Industrisë, për ta parë një kalibrim të orëve nga kush bëhet kalibrimi. Mendoj që Qeveria duhet për t'i hapë liberalizim kompanive të certifikuar që të bëjnë kalibrimin dhe në atë mënyrë t'i heqë dilemat e orëve, jo hipotetikusht faktori njeri do ta marrë këtë ose do ta bëjë këtë, por do ta marrë kompania e cila do ta certifikojë dhe do ta ketë mundësinë e monitorimit permanent, prandaj janë disa çështje të cilat më shumë po politizohen se sa po çojnë mesazh në këto.

Ne duhet të flasim në këto tema të zhvillimit të energjisë, sepse është një produkt jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe shoqëror duke prekur temat edhe pse është duke ngecur tek afirmimi i produkteve tjera të energjisë alternative, të energjisë së gjelbër e shumë e shumë tjera që ne ta ulim çmimin. Por nëse ne i krahasojmë me Evropën dhe me rajonin jemi më të shtrenjtë, nëse bëjmë krahasime në CEZ-in, me Shqipërinë, nuk është e ndershme ajo që qytetarëve mos u tregohet që në Shqipëri e kalon mbi 40% nuk paguajnë rrymën dhe CEZ-i kur e ka marrë kontratën e ka pasur një limit të caktuar sa për qind, derisa do të jetë e tolerueshme në heshtje. Prandaj, edhe këtu, kuptohet është e qartë sa nuk paguajnë dhe sa vidhet rryma dhe sa është i vjetruar distribuimi.

Ju e përzini privatizimin e kësaj kompanisë që e ka privatizuar distribuimin me një problem që është politizuar dhe i cili mund të jetë faktik, por ne mund ta eliminojmë me ato rekomandimet të cilat janë bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Për replikë, Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Doktori po më duket i ka pak të paqarta do sende, nuk e fajësoj, por kalibrimi i njehsorëve elektronikë apo çfarëdo nuk ka qenë asnjëherë në pyetje kalibrimi. Asnjëherë nuk e kemi kontestuar se njehsorët elektrikë a elektronikë a çfarëdo, nuk matin mirë. Ajo s'ka qenë asnjëherë diskutim.

Diskutimi ka qenë që këta njehsorë të cilët kanë mundësi të kenë deri në katër tarifa i kanë të blombuara vetëm dy dhe mundësia e çblombimit të tyre qëndron në atë se duhet të dërgohet prapa në fabrikë, të kthehet këtu, gjë e cila e rrit çmimin.

Kontestuese është që këta njehsorë nuk e mundësojnë liberalizimin e tregut. Këta njehsorë ia mundësojnë që nesër të vazhdojë monopoli bashkë me këtë operatorin e ri.

Sa i përket vjedhjes së rrymës, po normal që ka vjedhje të rrymës, por ajo që nuk është normale është që ata që e paguajnë blok-tarifën 3, janë ata të cilët i amnistojnë edhe vjedhjet edhe të gjitha, prandaj në rekomandime ka qenë ngritja e përgjegjësisë dhe e eliminimit të këtyre.

Sa i përket Maqedonisë a prodhon apo nuk prodhon a e ka energjinë e gjelbër, a të pemëve, a të verdhë, mjafton të shikohet Eurostat. E keni në raport, ata që e kanë lexuar, është në faqen 10 dhe shihet që çmimi i energjisë në Kosovë është bukur më i lartë se në shumicën e vendeve, duke pasur parasysh që Kosova prodhon, atëherë pritet që të ndërmerren masa, prandaj është edhe ky Komision Hetimor me rekomandime që të eliminojë ato mungesa edhe të vjedhjes, edhe të gjenerimit, edhe kudo që në secilën hallkë që të ketë probleme që të rregullohen...

KRYETARI: Kundër-replikë, një minutë, Shaipe.

SHAIP MUJA: Dy minuta, zoti kryetar!

Unë mendoj që deputetja është duke konsumuar dezinformime. Unë thashë për prodhimin në Maqedoni dhe Euro-Statin është duke e interpretuar sipas dëshirës së vet. Nuk është e tillë ajo çka thotë, dihen, janë edhe në internet ato, ndërsa sa i përket orëve, nuk i kemi kundërshtuar, por kam propozuar, thashë dhe ndoshta do të jetë ajo një pjesë që do ta eliminoj, ndërsa përzierja tek liberalizimi dhe tek çështja e dhimbjes pse është bërë privatizimi, këto janë çështje të cilat ne duhet t'i diskutojmë në momente tjera, por jo t'i politizojmë për interes të publikut sa për të dalë në televizor. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Nuk e pata në plan të flas, jam pajtuar komplet me raportin dhe të gjeturat e Komisionit Hetimor, mirëpo më nxiti diskutimi i ministrit.

Në fakt çështja e fryrjes së faturave, i nderuar ministër i Zhvillimit Ekonomik se po ju bie ta merrni barrën në kohën kur nuk keni qenë në detyrë, nuk mund të trajtohet asnjëherë e veçuar nga çështja e shtrenjtimit të tantumës për qymyrin dhe nga çështja e privatizimit të KEDS-it, të distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike, sepse nga të gjitha diskutimet, edhe nga raporti, vërehet se këto janë të ndërlidhura shumë.

Andaj, ministër ju bëj me dije se ne jemi të zgjedhurit e popullit dhe për dallim prej juve që jeni të emëruar nga dikush tjetër, ne e kemi për detyrë që të vërtetën ta flasim në mënyrën që e kupton populli. Por, megjithatë, ju me të gjithë ekspertizën e juaj prapë po dështoni të na shpjegoni 17.9 milionë që ZRRE-ja me trysni të Qeverisë po i jap, do të thotë kompanisë "Limak-Çalik".

Andaj, ju lutem e thoni të vërtetën, por me gjuhën që e kuptojmë edhe ne, edhe qytetarët e Kosovës, ta arsyetoni 17,9-milionëshin që jepet, sepse ne e kemi pasur në komision

Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe ata na kanë treguar që këto para i barten distributorit. Mirëpo, kur i kemi pyetur a e vërejmë ne, ata kanë thënë që distributorit i barten për t'iu kthyer konsumatorëve.

Besoj se këtu pajtoheni, i barten distributorit dhe në këtë formë i kthehen konsumatorit. Kur e kemi pyetur, a lirohet çmimi i energjisë elektrike, a shihet në faturë ajo që i kthehet konsumatorit, ata kanë thënë që ajo nuk faturohet?

I nderuar ministër, ajo që nuk faturohet shkon në xhepat e dikujt dhe ju jeni përgjegjës të na tregoni se në xhepat e kujt shkojnë ato para?

KRYETARI: Ministër e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Po mundohem me fjalorin më të thjeshtë, ta them. Në qoftë se tarifa përmbledhëse për konsumatorët e Kosovës është 200 milionë dhe operatorët të cilët konkurrojnë për tarifë, secili pjesën e vet, transmisioni, gjenerimi e kështu me radhë, kur të mbledhen të gjitha, bëjnë 200 milionë. Në qoftë se janë aprovuar 200 milionë si të nevojshme, atëherë gjatë vitit këto 200 milionë shpërndahen nëpër faktura te secili konsumator. Kështu, projektohet, do të thotë, tarifa.

Në qoftë se vitin e kaluar, njëri nga operatorët ka shpenzuar, siç është rasti 17.9 ose ka shpenzuar 10 milionë, respektivisht nuk i ka shpenzuar 10 milionë që kanë qenë të parapara, janë si mbetje, atëherë bëhet agjystimi dhe nuk do të jenë 200 milionë për këtë vit Rregullatori, por thotë do të jenë 190. Domethënë zbritet në tarifën kumulative që nënkupton zbritet edhe në faturën e secilit prej neve që na vjen, sa i bie në përqindje të shpenzimit. Sepse nuk ka mënyrë tjetër, zonja deputete, qysh as furnizuesi as distribucioni që po thua ti të shkojë te dera t'ia kthejë parat konsumatorit. Ia kthen nëpërmjet agjustimit në totalin që ajo vlerë nuk shtohet në të hyrat e lejuara maksimale.

Me fjalë tjera, nëse ka nevojë e bëjmë edhe ndryshe. Në qoftë se u janë dhënë për një kujdes çfarëdo qoftë juve një shumë e parave, por kanë qenë të dedikuara për çka janë dhënë dhe në fund të vitit tash duhet ta kryeni të njëjtën detyrë dhe tash shihet që ju i keni shpenzuar ndoshta paratë ose i keni edhe ato, sepse nuk i keni shpenzuar për atë, është dashur të blini bukë, tani nuk do t'ju jepen përsëri për të njëjtën arsye. S'po di tjetër fjalor, ose ulemi dhe ju sqaroj më qartë.

Paratë domethënë nuk i ka marrë as KEDS-i as KEK-u, këtë ju garantoj.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Përshëndetje jo vetëm për të, por për të gjithë, edhe për juve personalisht, edhe për të nderuarën që ma tërhoqi vërejtjen që duhet kompetencë për ta trajtuar energjetikën dhe sikur që e perceptoj, jo vetëm si deputete, por gjithmonë edhe si sinonim të mbretëreshës sonë, si kur vishet bardh, sikur vishet kuq e zi, por në këtë rast unë dhe për disa tema kam

disa nga deputetët që i kam inspirim, më inspirojnë, m'i zgjojnë muzat, ma prishin përgjumjen dhe më sensibilizojnë për të trajtuar ndonjë nga temat për të cilën nuk kam disponim për ta trajtuar.

Unë për veten time e kam përcjell me mjaft shqetësim Komisionin Hetimor se si i ka evidentuar dhe i ka prezantuar hetimet që i ka bërë për pakënaqësitë e qytetarëve dhe i kam përcjell me shumë shqetësim shprehjen e pakënaqësive të qytetarëve për administrimin e shpenzimeve të tyre nga zyrtarët e KEK-ut, të cilët me shumë të drejtë i kanë manifestuar pakënaqësitë e tyre dhe në rrugë.

Për këtë arsye, gjithmonë inspirim, gjithmonë motivim, gjithmonë busull për ta trajtuar këtë temë duhet ta kemi shqetësimin e qytetarëve, padrejtësitë që u janë bërë atyre në administrimin e shpenzimeve nga orët elektrike.

Qytetarët kanë pasur të drejtë kur kanë reaguar për të gjitha parregullsitë e administrimit të shpenzimeve të rrymës. Për këtë kam pasur kontakte me disa prej tyre që vërtet të bindnin se nuk i kanë bërë ato shpenzime.

Rekomandimet duhet t'i reflektojnë këto shqetësime të qytetarëve dhe të bëjnë natyrisht edhe apelimin që të bëhet zgjidhja e gjithë këtij ngërçi, këtij konflikti dhe këtyre pakënaqësive.

Praktika e ndërprerjes bëhet me kritere shumë të ndryshme. Këtu i kam marrë të dhënat të cilat vërtet më kanë bindur se dikush që është i interesuar për të rritur pakënaqësi të qytetarëve, bëjnë veprime nga më të papërgjegjshmet me qëllim që këto pakënaqësi të rriten, të fryhen dhe numri i të pakënaqurve të bëhet sa më i madh, të krijohet mundësisht një fond i të pakënaqurve.

Meqenëse në këtë kohë kemi adresa që kanë skenar, këtu në Prishtinë kemi adresa, që kanë skenar për anarki në këtë vend, çdo pakënaqësi e qytetarëve është e mirëseardhur për ta dhe kur i shoh duke i trajtuar në publik, kur i shoh në media, në rrugë duke i trajtuar me megafon, nuk e vërej, nuk më bindin që vërtet motiv kryesor e kanë pakënaqësinë e qytetarit, por pakënaqësitë e qytetarëve ata i shfrytëzojnë për ta tundur tokën dhe për ta dridhur qiellin me gjithë zërin e megafonit për ta sharë Qeverinë, për të thënë se ky shtet nuk bëhet me hajna, se këtu po sundojnë hajnat, se tash edhe për një faturë atje që me qëllim ndoshta një administrator e lidhin me performancën e Qeverisë, e lidhin me qasjen e ministrit, e lidhin me programin e Qeverisë dhe të kryeministrit, e lidhin edhe me ne në Kuvend që s'kemi kurrfarë faji absolutisht.

(Reagim)

Absolutisht, i nderuar, nëse ti e ndjen veten fajtor edhe mund të dalësh këtu para qytetarëve, edhe para neve të na bindësh se ti je pjesë e fajit dhe ti ndihesh fajtor. Në rast se ti vërtet e ndien veten fajtor, është mirë t'u thuash njerëzve: unë jam fajtor, sepse kam bërë këtë tolerim dhe unë e kam bërë këtë lëshim dhe unë kam bërë obstrukcion ose kam bërë këtë hapësirë të lirë për të vjedhur të tjerët. Domethënë, këtu nuk do të duhej të

veprojmë si Komision i Ligjeve, të bëjë instruksion në procedimin e ligjeve dhe t'u bëjmë pengesa edhe kolegëve tanë në foltore këtu duke i dezorientuar dhe duke ua prishur koncentrimin, se ndonjëri prej tyre edhe mund ta prishë koncentrimin, por kësaj radhe unë nuk kam dal për të polemizuar me asnjërin prej jush, nuk kam dalë për ta trajtuar aspektin profesional të këtij fenomeni, por kam dal ta trajtoj një fenomen i cili është duke ndodhur, pakënaqësi nga institucionet, nga zyrtarë, po mbillen te qytetarët. Këto pakënaqësi trajtohen në rrugë jo për t'i zgjidhur ato, por për ta arritur qëllimin e tyre në skenë, për të bërë anarki në këtë vend.

Kjo nuk do të duhej të tolerohej dhe më së paku me pakënaqësitë e qytetarëve për administrimin e tyre në mënyrë të parregullt për shpenzimet e rrymës dhe për fryrjen e faturave të orëve të tyre, çfarëdo qofshin ato. Faleminderit!

KRYETARI: Raportin e kemi në debat, nuk i kemi protestat. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritet për ju, për Kabinetin qeveritar,

Dhe deputetë të nderuar,

Mendoj se raporti është i hartuar në mënyrë shumë profesionale dhe në kuadër të mandatit të përgjegjësive që janë dhënë. A e ka trajtuar temën për çka krejt janë të shqetësuar opinioni dhe njerëzit, unë them jo, sepse mandati ka qenë i limituar dhe Komisioni ka vepruar vetëm në kuadër të përgjegjësive që i ka ngarkuar paraprakisht në Kuvend.

Është mirë që në Komision është punuar në mënyrë konstruktive dhe raporti është miratuar në mënyrë unanime, do të thotë që të gjithë e kanë miratuar.

E mora fjalën për t'i cekur disa momente kyçe që kanë ndikuar në gjithë këtë proces. E para është niveli i tarifave që u elaborua këtu dhe u tha se tarifat të cilat i jepen nivelit të konsumit familjar, që mendohet se duhet të jetë brenda 600 megavat, realisht ai e tejkalon dhe shuma është mbi 60% jashtë këtij limiti, që në një mënyrë është bartëse e krejt këtyre dobësive, manipulimeve, lëshimeve që kanë ndodhur dhe mund të ndodhin.

Pra, në Komision ka qenë brengë që do të duhet të hartohet një tarifë për një konsum familjar dhe po e them menjëherë, po më brengos shumë çështja që edhe gjërat e përditshmërisë së jetës të cilat na prekin të gjithëve, politizohen dhe diskutohen në mënyrë të skajshme.

Mendoj se Komisioni e ka dhënë kontributin aty dhe në bazë të atij materiali do të mund të nxirren tarifat të asaj natyre çfarë është sot standardi. Sigurisht ato tarifa kanë qenë dikur kur konsumi i energjisë ka qenë krejt tjetër në raport me nevojat e familjes që sot nuk i përgjigjet asaj.

Element tjetër që unë mendoj se ka hedhur në pah është ky 17,9 milionë euro. Ju lutem, mirë është që incizohet mbledhja, po e përsëris , mirë është që incizohet mbledhja, sepse po jepen informata që nuk qëndrojnë.

Kur flasim për këtë shumë kemi parasysh shumën maksimale të lejuar që ZRRE -ja planifikon KEK-ut për vjelje. Aty mund të ndikojnë edhe faktorët e tjerë në nivelin e konsumimit të asaj mase maksimale të lejuar. Në vend të importit ai ka mund ta shtojë prodhimin, ka mund që dimri ka qenë më i butë, dhe konsumi ka qenë më i vogël, ka disa shkaqe të saj. Por, ajo çka mua më ka interesuar, KEK-u me vendosmëri e mbron tezën se unë nuk i kam inkasuar ato para e nëse nuk i ka inkasuar, në bazë të cilës barrë po ia ngarkojmë tash? Ju lutem, në bazë të cilës barrë, ma thoni?

KEK-u thotë se nuk i ka inkasuar. ZRRE- ja thotë i ka inkasuar. Në pyetjen kur unë i shtroj - nga e dini ju që i ka inkasuar? Thotë, ne e kemi bërë planin, këtë e këtë. Ju lutem, kjo çështje mund të verifikohet përmes Thesarit. Dhe këtu unë mendoj se plotësisht ka të drejtë Komisioni në një klauzolë atje që ka thënë se duhet të ndodhë një auditim i performansës në kuptimin që do t'i hedhë në sipërfaqe edhe këto çështje.

Dhe, çështja e tretë që i ka diskutuar ose i ka nxjerrë në diskutim sipërfaqësisht për shkak të kufizimit të mandatit, po them prapë, është rasti i investimeve të freskëta që blerësi i kompanisë “Limak-Çalik” do t'i investojë 300 milionë, është thënë, nëse s'gaboj, unë po ju them se me analizën që e kemi bërë ne në Komision, ai s'do ta investojë asnjë euro. Nuk ka investim të freskët, duhet t'ia themi këtij mleti që mlet jemi ne edhe ju deputetë të nderuar, mos ta luajmë rolin e nënës të keqe kur djalit i jep arsye për gjithçka, se në vend që ta edukojë, ajo e kriminalizon.

Këtu ka çështje që vërtet po i ndërrohet ngjyra dhe po i jepet krejt një fizionomi tjetër që realisht nuk qëndron.

Pra, 17,9 milionë euro janë të imagjinuara dhe do hulumtim ai. Dhe deklarata se do të investohen 300 milionë, po ashtu sipas asaj që ne kemi parë, nuk do të investohet asnjë euro. Do të investohet vetëm nëpërmjet asaj që është bartje e amortizimit nga viti në vit, prej formës të mjetet themelore, gjegjësisht bartjes në kesh.

Këto çështje janë shumë të ditura dhe nuk ka nevojë kurrkush të na jap edukatë, në veçanti neve do që e kemi krejt jetën në financa, prandaj, ju lutem, ta kemi parasysh. Këtu ka nevojë për t'u hulumtuar nga u shpik 17,9. Komisioni e ka arsyetuar shkëlqyeshëm, në momentin kur kërkohet rritja e çmimit, realisht përputhet me këtë shifër. Dhe merrni hapësirat kohore, edhe komunikimet, flasin shumëçka ... dhe të mos paragjykoj. Por, unë mendoj se Komisioni me kompetencë e ka thënë se ka nevojë për një investigim të mëtutjeshëm të tërë kësaj problematike. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, i fundit, pesë minuta i ka, deputeti, kryetari i Komisionit Hetimor, Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Unë e kam kuptuar gabimisht se i kam 15 minuta në fillim dhe ju kërkoj juve dhe deputetëve falje, i paskam pasur 5 plus 5, po nuk është esenca aty.

Ajo që dua të them unë, përshtypja ime është se raporti nuk është lexuar ashtu qysh duhet. Nëse lexohet raporti do të shihet se ne u kemi përgjigjur të gjitha çështjeve – katër çështjeve të cilat na i ka obliguar Kuvendi, secilës dhe në mënyrë profesionale, tejet profesionale dhe brenda kompetencave tona i kemi dhënë edhe rekomandimet.

Çka do të ndodhë a çka do të bëhet, e përmendi këtu një deputet, çka do të ndodhë dhe çka do të bëhet varet se kush sa i realizon përgjegjësitë, sepse në qoftë se ne sillemi me nonshalancë dhe nuk e zbatojmë ligjin, nuk do të ndodhë kurrëgjë, por situata do të keqësohet.

Çka është esenca e konstatimeve të Komisionit? Esenca është se në aspektin teknik faturimi është bërë sipas rregullave dhe nuk janë shkelur ligjet te faturimi, si proces teknik i faturimit, por esenca është se tarifat, çmimet që ne i paguajmë për energji, problemet rreth tarifave, problemet e menaxhimit janë tejet të ngarkuara me probleme. Prandaj, nëse nuk është shkelur ligji te tarifat, është shkelur shumë herë ligji dhe logjika ekonomike në mënyrën e menaxhimit të këtij sektori dhe këtë e thonë konstatimet e raportit dhe e thonë edhe rekomandimet.

Çështja, ne nuk jemi marrë me privatizimin dhe tash nuk mund ta paragjykojmë a është mirë a qysh është, në qoftë se do Kuvendi mund ta themelojë Komisionin që merret me këtë.

Te tarifat, duhet një reformë e thellë e tarifave. Ju lutem, çmimi që e paguajnë konsumatorët e bllokut tarifar 3, mesatar i fonderuar në janar është 9,3, zoti ministër dhe është shumë më i madh se sa çmimi i konsumatorëve që e kanë paguar gjithë. Dhe në këtë bllok tarifar në janar janë 76% të ardhura të KEK-ut. Ky është problem serioz, ky është deformim i tarifave, kjo është edhe nuk di sa në harmoni me Kushtetutën, për arsye se unë si konsumator që i harxhoj 1 500 kilovatë orë, do të thotë duhet të subvencionoj tarifa tjera, duhet të subvencionoj dobësitë e KEK-ut për t'i mbledhur faturat, duhet të subvencionoj dobësitë teknike, humbjet teknike, duhet të subvencionoj ineficiencën teknike. Domethënë bëhet distribuim i parave prej buxhetit tim te ti dhe ky është problem serioz, po ne e kemi thënë me një gjuhë të ekspertit, me një gjuhë të kulturuar dhe nuk e kemi dramatizuar, prandaj në këtë shoqëri në qoftë se do diçka të marrë dikush seriozisht ose duhet sharë ose duhet me u sjellë disi në mënyrë incidentale. Prandaj, nuk është problemi se nuk ka, ka gjetje shumë serioze dhe ju lutem, edhe juve në Ministri, por edhe ju të gjithë tjerët t'i lexoni me kujdes gjetjet e këtij raporti.

17,9 është i lidhur dhe është problematik, prandaj është shkuar në gjyq. KEK-u e ka nënshkruar, pse është detyruar ta nënshkruajë, po e ka dërguar çështjen në gjyq dhe në qoftë se gjyqi vendos në favor të KEK-ut ose duhet t'i japë buxhetit 17.9 milionë ose duhet rritur çmimin. Kjo është çështje që është në raport, ju lutem, është problem. Konsumatorët nuk kanë transparencë dhe është problem serioz. Dhe mua më duhet tash t'iu them që është problem serioz, ne e kemi thënë në raport. Dhe zoti Gjini thotë nuk ka

problem, qysh nuk ka problem, zoti Gjini? Ka problem, është problem i madh dhe nuk do të bëhet kurrëgjë në qoftë se ne sillemi në noshalancë qysh sillemi vazhdimisht, por në qoftë se lexohet çka ka thënë ky raport, është problemi tejet serioz.

Nuk ka shkelje të ligjit, po ka shkelje të kompetencave dhe shkeljeve të ligjit. Ministri ndërhyr ta caktojë kthimin në ekuitet, i cili është ekskluzivisht kompetencë e Rregullatorit, jo e ministrit.

(Reagim)

Po ju lutem, thoni s'ka shkelje, ka shkelje, dhe është konstatuar e për atë i kemi thënë edhe kryeministrit të ndërmarrë masa t' i dispijnojë ministrat që mos të ndërhyjnë te organet e pavarura. Çka është dashur ne të themi, veç ta fusim në burg ministrin, jo, ne e kemi thënë atë që kryeministri i ka kompetencat, le të shohë çka duhet të bëjë aty.

Orët digjitale, është projekt i udhëhequr, duhet marrë si rast studimor qysh nuk duhet të udhëhiqen investimet. Me dhjetëra miliona, diku në 60 milionë investime hyhet pa studim fizibiliteti. Investohen në këtë kohë me teknologji të tejkaluara. Dhe është problem serioz dhe në qoftë se ministri nuk e sheh këtë si problem serioz, unë nuk di çka është kjo këtu.

A duhet bërë titur, për ta bërë problem serioz këtu?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini, por është fjala përfundimtare, deputet.

(Ndërhyrje)

Po, në fjalën e fundit, përmendet emri, por replikë nuk ka. Urdhëro, Ardian Gjini për replikë.

ARDIAN GJINI: Nëse nuk duhet replikuar pas fjalës përfundimtare, atëherë ata që e marrin fjalën përfundimtare, duhet të jenë më të kujdesshëm çka flasin. Dhe profesori qenka emocionuar shumë, krejt në rregull, ka të drejtë.

Çështja e parë është se i paskan thënë kryeministrit të marrë masa. Shumë mirë keni bërë që i keni thënë, po për atë po flas unë. Keni thënë, bën kështu, bën kështu, bën kështu - priteni rezultatin, ju thashë, për 6 muaj.

Çështja e dytë është, që s'po kam qare pa e thënë. Ora është njësi për ta matur kohën, ato instrumentet që e matin energjinë nuk janë orë, janë njehsorë në shqip. E kam thënë edhe herën e kaluar, me orë koha matet, profesor. Nuk janë orë. Çfarë ore? Me orë është ora në mur. Nuk janë ato orë që e matin energjinë. Faleminderit!

KRYETARI: Konsideroj që kanë përfunduar diskutimet. Po, hajt për një kundër-replikë, por ashtu-kështu duhet ta kesh fjalën e fundit. Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Unë e kam parë që kolegu ynë deputet, me të vërtetë është ekspert për shumë çështje, por që është ekspert edhe për emocione, sot e mora vesh.

E çështja tjetër, sa i përket asaj, ne i kemi kërkuar kryeministrit për të punuar dhe në qoftë se kryeministri nuk punon, kur t'i qesim çështjet këtu duhet për të votuar për ta shkarkuar kryeministrin e jo me u sjell pa përgjegjësi me votën që na e ka dhënë populli. Faleminderit!

KRYETARI: 62 deputetë janë të pranishëm. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash raportin.

Shiko, ligji ka shkuar, por duhet të jenë 61 vota, edhe një herë duhet të votojmë. Votoni të gjithë! I lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Atëherë, 60 për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, mund të konsiderohet se kaloi dhe Kuvendi e miratoi Raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimeve të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët digjitalë dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast.

A vazhdojnë? E kemi edhe Komisionin ad hoc. Besoj se jeni dakord, pasi e kemi numrin e pranishëm.

18. Formimi i Komisionit ad hoc për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit të propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, kryetari Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i propozon Xhevahire Izmakun dhe Ganimete Musliun, anëtare të këtij Komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!
Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon për anëtarë të këtij Komisioni zonjën Lirije Kajtazi dhe zotin Salih Morina.

KRYETARI: Nga “Vetëvendosja”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Albulena Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
Ne e propozojmë deputeten Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e ka fjalën. Kryetarja s'është. Suzan Novobërdaliu, është këtu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!
Ne e propozojmë deputetin Jeton Svirca.

KRYETARI: Mirë! E tash nga Grupi "6+", kryetarja Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA ŞINIK: Teşekkür ederim,
Bu komisyona "6+" Parlamenter Komisyonu Alşbert Kinoli'yi öneriyor.

KRYETARI: Faleminderit! E tash është mirë Grupi i SLS, të bëhet bashkë. A po e caktoni ju dy grupet - SLS dhe "Zajednička Budućnost", një anëtar? Goran, a po merreni vesh me Sashën? Regjia, fjalën deputetit Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče! Nadam se da gospodin iz SLS neće da ima ništa protiv, jer oni imaju dva člana u ad hoc komisijama tako da bi smo sada mi imali svog kandidata, i zato predlažemo Stojanović Milivoje.

KRYETARI: Sasha, a pajtohesh me këtë?

(Ndërhyrje)

Faleminderit! Atëherë, na duhet emri. Goran, emrin na e trego?

GORAN MARINKOVIĆ: Milivoje Stojanović!

KRYETARI: Faleminderit! Tash e kemi votimin formal. I kemi 61 deputetë të pranishëm. Jeni të gjithë dakord. Kundër nuk ka.
Atëherë konstatoj se u formua Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

Edhe një pikë e kemi:

19. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtares në Komisionin për Integritet Evropian

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka propozuar deputetin Glauk Konjufca, anëtar të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, në vend të deputetes Alma Lama.

Kërkoj një votim formal, me ngritjen e dorës.

Faleminderit! Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtares të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Arben, urdhëro, çka ke për rend dite?

ARBEN GASHI: Po, për këtë pikë që na vjen, kryetar, kemi objeksion, vërejtje.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, ne kemi konstatuar se objekti i kërkesës ka ndryshuar pasi që janë mbledhur nënshkrimet, kështu që objekti i diskutimit tash është i paqartë dhe për konkluzion kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të trajtohet, sepse kërkesa kur janë mbledhur 61 nënshkrime, disa prej të cilëve janë edhe deputetë të Lidhjes Demokratike, ka qenë e ndryshme nga rezoluta e cila ka hyrë në rend dite si pikë e kësaj pike, prandaj mendoj që nëse e përdorur fjalën më të fortë, është falsifikim ose nëse përdorur një fjalë më të butë është keqpërdorim i autorizimeve që i kanë dhënë këta 61 deputetë.

Prandaj, ne kërkojmë që kjo pikë të hiqet dhe të kthehet prej fillimit procedura. Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni, kjo pikë ka ardhur në procedurë të rregullt, do të thotë jo pse janë 63 deputetë, sepse 63 deputetë kanë mund të kërkojnë mbledhje të jashtëzakonshme dhe ta caktojnë edhe kohën. Megjithatë, ne e kemi trajtuar këtë çështje

(Reagim)

Jo, jo, aty diku është. Atëherë, le të vendosë seanca. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së që të hiqet nga rendi i ditës.

A jeni të qartë? Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Jemi me numrin 58 të deputetëve. Ju lutem, votoni të gjithë, edhe abstenoni, por të votohet.

Pra, edhe një herë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

E kemi numrin e mjaftueshëm? Janë 61...

(Ndërprerje e incizimit)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Vazhdojmë! Fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne tani e dimë të gjithë që e kemi një pikë të rendit të ditës, e cila është shumë e rëndësishme. Për këtë çështje duhet të debatojmë. Është shqetësim i të gjithë deputetëve dhe ne, si grup parlamentar, meqë janë nënshkrues mbi 60 deputetë të grupeve të ndryshme parlamentare, nuk është nismë e veçantë e grupit parlamentar, por e të gjithë deputetëve, ne si grup parlamentar kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, kur do të jenë pjesëmarrës të gjithë deputetët dhe aty të hapet debati, por të hyjë si pikë e parë e rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Visar, urdhëro!

VISAR YMERI: Kryetar,

Ne ishim kundër heqjes së kësaj pike nga rendi i ditës dhe deshëm ta diskutojmë këtë, por tash kjo kërkesë po më duket pak e çuditshme se nuk mund as ta shtyjme. Kush do ta shtyjë? S'kemi deputetë për ta shtyrë! Jemi në një situatë kur duhet lënë seancën të vazhdojë, ta zëmë javën e ardhshme, nëse vijnë deputetët. Përndryshe, s'kemi çfarë të bëjmë. Proceduralisht nuk kemi çfarë të bëjmë.

KRYETARI: Në mungesë të kuorumit mund ta shtyjme, por... Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se këtu thuhet se janë 60 nënshkrime dhe ka deputetë prej të gjitha subjekteve politike, nuk e di kur e kanë vënë logon e nënshkrimit, ku janë tash? Ku janë dhe për çka janë në Kuvendin e Kosovës? Kur të nënshkruash, të ngresh një rezolutë të tillë të kontrabanduar prapa tekstit, ata duhet të jenë këtu në seancë dhe të tregojnë për çka e kanë bërë rezolutën dhe për çka kanë nënshkruar. Këtu s'kemi deputetë as për ta shtyrë, as për ta mbajtur.

KRYETARI: Për ta shtyrë kemi sa të doni, por nuk kemi kuorum. "6+", e doni fjalën? Myfera Shinik, kryetarja e Grupit.

MUFERA ŞINIK: Teşekkür ederim Sayın Başkan.

Zaten durum ortada. Bu sayı ile oturum devam edemiyeceğine göre, biz de aynı şekilde gelecek bir toplantıda bu konuyu görüşelim diyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Në mungesë të kuorumit, e shtyjme mbledhje. Kryesia vendos të hënën se kur do të futet në rend të ditës. Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 18 dhe të vazhduar më 19 korrik 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 18 dhe 19 korrik 2013.

Në sallë janë 41 deputetë, mund t'ia fillojmë debatit.

Për procedura, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne edhe në seancën e kaluar kemi treguar arsyet dhe unë jam sot në emër të Grupit Parlamentar për t'i treguar arsyet pse ne nuk jemi pjesë e këtij debati edhe deputetët që e kanë nënshkruar nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kanë qenë tre, unë flas edhe në emrin e tyre edhe në emrin e Grupit. Në momentin kur është bërë kërkesa dhe arsyetimi, në fund kanë qenë tri rekomandime, i kanë parë edhe deputetët dhe janë nënshkruar, aty dihet janë 61, por tre janë nga LDK-ja.

Ndërkohë, është futur një tekst, pa konsultim me askënd, me të njëjtin nënshkrim që është shkëlqej e procedurës, sepse s'mund të ndryshohen rekomandimet dhe të futet diçka tjetër, ndërkohë, sepse me këtë logjikë e jep një herë nënshkrimin dhe s'do të kesh nevojë asnjëherë për nënshkrim për çfarëdo çështje që ngritët.

Ne si LDK e kemi thënë, nuk është që s'jemi të interesuar dhe s'ka arsye ndoshta për të biseduar edhe për punën e EULEX-it e të tjera, por mënyra se si është bërë, pra sipas nesh janë shkelur procedurat dhe kjo ka qenë arsyeja pse ne s'kemi dëshiruar as herën e kaluar të mbahet seanca. Le të mblidhen nënshkrimet, është punë e atyre që e kanë iniciuar, debati mund të mbahet, por të mos shkelen procedurat. Në këtë mënyrë ne nuk pranojmë, sepse është e qartë ajo që është abuzuar, është keqpërdorur nënshkrimi i deputetëve.

Edhe njëherë për opinionin duhet të jetë e qartë, janë dhënë tri rekomandime në bazë të kërkesës dhe arsyetimit, janë nënshkruar, ndërkohë është futur një tekst dhe tash ne nuk

po dimë a është ajo rezolutë e Qeverisë apo e kujt është, sepse nuk kemi asnjë informacion?

Së këndejmi, ne nuk marrim pjesë në këtë debat parlamentar që ka të bëjë me EULEX-in. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, këtë që po e thotë kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, do të duhej ta thoshin vetë nënshkruesit, sepse ata e mbajnë përgjegjësinë për kërkesën që e kanë bërë.

Megjithatë, është vendim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, që ta mbajnë këtë qëndrim, që të mos marrin pjesë në këtë debat.

Unë, pasi që kjo gjendje është kështu, po e bëj një pyetje, a ka deputetë që e kanë vendosur firmën dhe nuk janë dakord me tekstin e ri, që është për rezolutën e Kuvendit, a ka deputetë që janë nënshkrues?

Jo, jo, njëherë më dëgjoni çka po them, e pastaj ngrini duart. Mësohuni të dëgjoni atë çka unë po kërkoj. Nëse ka deputetë që nuk janë dakord me debatin, pasi është ndryshuar teksti i dokumentit të propozuar.

A ka deputet që është kundër kësaj? Kush e do fjalën? Kemi dy kërkesa, kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën, pastaj Emin Gërbeshi.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për zëvendëskryeministrat, ministrat dhe deputetët!

Duke marrë parasysh se pothuajse të gjithë anëtarët e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, janë nënshkrues të këtij debati, mirëpo gjatë nënshkrimit të debatit ata nuk e kanë pasur këtë rezolutë dhe tash kemi një rezolutë që i është bashkëngjitur formës së debatit dhe për këtë arsye edhe sot nuk janë deputetët nënshkrues të këtij debati në seancë. Dhe, besoj dhe shpresoj që në procedim të procedurave duhet të ketë kujdes dhe ata s'marrin pjesë sot në debat. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Emin Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!
Edhe unë kur e kam nënshkruar këtë listë, ka pasur një tekst tjetër dhe, ka pasur rekomandime tjera ose është menduar për një rezolutë tjetër, tash ka dalë tjetër. Mendoj, se do të ishte mirë të ketë një konsultim paraprak, për arsye se është i nevojshëm një debat për EULEX-in dhe misionin e EULEX-it këtu, sepse ky Parlament i ka vazhduar mandatin dhe i ka dhënë mandatin EULEX-it, por në formë të tillë si është paraparë dhe në bazë të konkluzioneve që janë parashtruar aty, unë mendoj që ky debat është i kotë dhe është shumë i paarsyeshëm. Bile, të paktën të mos humbim kohë kot. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të asaj që dua ta them, ky debat ka ardhur në mënyrë të rregullt. Edhe vetëm me gjashtë deputetë, që i qëndrojnë nënshkrimit të tyre, mund të mbahet debati, e atë e kanë nënshkruar 61.

Fjalën e ka kryetari i Grupit të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne të gjithë e dimë që kemi të bëjmë me një çështje tepër të rëndësishme edhe për momentin edhe për të ardhmen e vendit tonë. Është një kërkesë e shumicës së deputetëve, për të pasur një debat të tillë. Është shumë e vërtetë, dakordohem me kolegët që kemi pasur fillimisht 4 kërkesa, ndërsa është bashkëngjitur një rezolutë.

Por, unë kisha kërkuar edhe si nënshkrues edhe si shef i Grupit Parlamentar, i propozoj iniciuesit që rezolutën ta tërheqë dhe t'u lejojë deputetëve që gjatë debatit, ë fund të debatit, në konsultë me shefat e grupeve parlamentare, të nxjerrë një rezolutë të përbashkët. Pra, edhe njëherë po e qartësoj, për hir edhe të konstruktivitetit edhe të interesit të përbashkët që kemi, që ky debat vërtet të dalë, të japë një rezultat konkret, propozoj, kërkoj nga iniciuesi që ta tërheqë rezolutën që e ka parashtruar me vonesë, ndërsa t'i mbetet seancës dhe shefave të grupeve parlamentare të nxjerrin një rezolutë të përbashkët pas konsultave të nevojshme në mes vete. Faleminderit!

KRYETARI: Falën e ka iniciuesi i këtij debati, deputeti Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Më në fund po më jepet rasti për ta sqaruar këtë kërkesë, sepse është bërë shumë zhurmë rreth saj, ka afër një muaj që është dorëzuar kjo kërkesë në Kuvend. Unë besoj që i ka plotësuar të gjitha procedurat dhe çdo gjë, çdo nënshkrim është bërë në bazën e këtyre pikave, që kemi diskutuar.

Nuk jam veç unë iniciues i këtij debati, por janë shumë deputetë dhe, disa i kanë mbledhur nënshkrimet diku tjetër, dikush diku. Por, në vendet ku unë i kam mbledhur nënshkrimet me të gjithë ata që kanë dëshiruar, kemi diskutuar në bazën e këtyre pikave, që është bërë rezolutë. Është e vërtetë, që s'është shkruar fjala "rezolutë", por kanë qenë pikat që kemi diskutuar.

Bile-bile, një ndër iniciuesit dhe i dyte në rend është edhe deputeti Lutfi Haziri, që po më vjen keq, por shefi i Grupit Parlamentar, m'i kanë treguar edhe SMS-ët, që ka bërë presion të vazhdueshëm mbi ta, për të mos e nënshkruar. E kanë nënshkruar disa, ende pa e kryer të tjerët janë dalë.

Kemi biseduar me të gjitha grupet parlamentare, po unë jam i gatshëm dhe e kam shkruar qysh në fillim të debatit, bashkërisht me të tjerët, që pas debatit të zhvilluar në

bashkëpunim edhe me subjektet tjera politike, do të dalin edhe konkluzionet përkatëse, që do të votohen nga Kuvendi i Kosovës.

Do të thotë, kjo rezolutë nuk është rigjide dhe mund të ndryshohet, por jam i gatshëm me propozimin e shefit të grupit parlamentar, të tërhiqem që mos ta lexoj rezolutën dhe rekomandimet, apo rezoluta siç vendos seanca dhe grupet parlamentare atëherë të dakordohen në Kuvend.

KRYETARI: Gjithnjë për sqarim, debati mund të zhvillohet edhe me më pak se 40 deputetë, kështu që është pastaj përgjegjësia dhe vullneti e secilit deputet të marrë ose të mos marrë pjesë në debat.

Unë fjalën ia kisha dhënë në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, kryetarit të grupit, deputetit Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Sa për ta qartësuar në fillim, deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk e kanë nënshkruar këtë kërkesë as me rekomandimet e as me rezolutën. Pra, s’kam çka të them aty në atë se nëse është falsifikuar apo jo kjo rezolutë, nëse është kontrabanduar kjo rezolutë, siç po thonë të tjerët, për shkak se nuk e di se si ka shkuar procesi.

Por, dua t’i ngre dy çështje që kanë të bëjnë me këtë debat dhe këtë si të them, situatë në të cilën ndodhemi. Edhe në dokumentin e ri, që na është dorëzuar neve si deputet e kemi një rekomandim, pra të përbërë nga tri pika dhe pastaj e kemi një rezolutë që përbëhet nga gjashtë pika.

Rezoluta dhe rekomandimi janë në shpërputhje me njëra-tjetrën, pra nuk janë të njëjta, të cilat supozohet të jenë domethënë dokumente që do të votoheshin në fund të debatit dhe kjo e bën pak situatën më të paqartë.

Për sa i përket rezolutës, ne mendojmë që është tekst është shumë më i mirë se sa rekomandimet dhe rezoluta që ka qenë, pra ajo që na ka shtyrë javën e kaluar ta kërkojmë mbajtjen e debatit, për shkak se edhe pse nuk pajtohemi 100% me të, mendojmë që është një bazë e mirë për ta zhvilluar një debat për këtë çështje. Ndërkohë që rekomandimi dhe tri pikat janë të kota, pra ato nuk thonë asgjë dhe rrjedhimisht nuk ka kurrfarë nevojë për të debatuar, për shembull që t’i thuhet në fund Qeverisë që të raportojë në Kuvend për punën dhe raportin në mes të institucioneve të Kosovës dhe EULEX-it dhe pastaj pika e tretë, që thotë: institucionet e Kosovës shprehen të përkushtuara për forcimin e rendit dhe ligjit në vendin tonë.

S’kemi nevojë ta bëjmë këtë debat fare, për shkak se është i kotë. Arsyeja, njëra prej arsyeve pse nuk e kemi nënshkruar këtë kërkesë kur na është ofruar nga iniciuesi, është e vërtetë, kanë qenë dy në fakt, që i kam përmendur disa herë në publik. Njëra ka qenë, që nuk kemi qenë dakord me mënyrën se si po trajtohet kjo çështje, për shkak se është nisur një debat për EULEX-in, e pastaj është shndërruar në njëfarë debati të kotë, siç e përmenda pra, me këto rekomandime edhe arsyeja e dytë që ka qenë po aq e fortë, ka

qenë që ne nuk i besojmë këtyre personave që kanë nisur këtë debat. Edhe kjo po na dëshmohej që sot, pra po tërhiqen sikur në rastin “Kiçina”. Kanë folur fjalë të mëdha në fillim dhe pastaj po tërhiqen në fund, po reduktohen në një diçka, që ta bëjmë debatin vetëm sa për ta shpëtuar fytyrën tonë, për shkak se e dimë paraprakisht që nuk do të bëjmë asgjë me këtë debat.

Rrjedhimisht, ne nuk kemi nënshkruar për shkak se nuk duam të bashkëpunojmë me kësi njerëz, që nuk mund ta mbajnë fjalën e vet as një orë, e lëre më për një periudhë pak më gjatë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti i Grupit Parlamentar të Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se shumë çka u tha e ka njëfarë logjike, po është thënë disa herë këtu që nëse ka të bëjë edhe vetëm me një fjali në Kuvend, duhet të kemi kujdes që nënshkrimet e deputetëve, pasi që të hidhen në letër, teksti nuk guxon të ndryshojë, për shkak se në seancën e fundit ju keni thënë, që me 63 deputetë mund t’i shpallim zgjedhjet edhe ta caktojmë datën, me Kushtetutë.

Domethënë, pesha e 63 nënshkrimeve, po thonë që nuk janë 63, janë më pak se 61, se dikush ka nënshkruar dy herë, s’është hiç me rëndësi, por pesha e atyre nënshkrimeve në letër është tepër e madhe, për të ndërruar, qoftë edhe një fjali në tekst.

Sidoqoftë, proceduralisht keni të drejtë për ta vazhduar debatin, por cili është qëllimi, çka ndodh nëse ne vazhdojmë debatin dhe e kemi një numër tepër të madh të deputetëve, që nuk po duan të marrin pjesë, për shkak të kësaj arsyeje, patën e s’patën të drejtë? Kjo nuk është temë hiç, a kanë të drejtë a s’kanë të drejtë ata, por unë mendoj që propozuesit e debatit bashkë edhe zoti Kajtazi, do të ishte mirë sot, të kërkojnë të ndërpritet ky debat, ta sjellin për së dyti, për shkak se nuk i ndihmon as debatit, as Kosovës, as kurrkujt, të mos i kemi 70% të deputetëve në sallë edhe ne të diskutojmë për diçka tepër serioze.

Qëndrimet e Aleancës nuk ndërrojnë, ato që i dini janë të mëhershmet. Ne do të provojmë të jemi konstruktivë në sallë, të japim mendimin tonë për krejt këto tema, po unë po kërkoj edhe njëherë dhe është njëfarë mocioni kjo që po kërkoj që të ndërpritet ky debat sot, për shkak se nuk i bën mirë as propozuesit, as debatit, as Kosovës, me një sallë kësioj të vazhdojmë të debatojmë për një temë kaq të rëndësishme. Ka mundësi për t’i marrë prapë nënshkrimet, ta sjellim prapë debatin në Kuvend, është e nevojshme ta mbajmë këtë debat, është e vërtetë, po është e nevojshme, që kur ta mbajmë këtë debat të kemi me të vërtetë debat të krejt politikës së Kosovës, e jo me kësi probleme çfarë po na paraqiten sot. Shumë deputetë që e kanë nënshkruar mocionin nuk po duan të vijnë, për shkak se iu ka ndryshuar, edhe të Aleancës edhe të partive tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Po, veç deputetët që e kanë nënshkruar e kanë një obligim, nëse jo ligjor, moral, për të treguar se përse nuk duan të jenë pjesë e debatit. Adem Grabovci, pastaj Ismet Beqiri.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë për hir edhe të konstruktivitetit dhe për hir të rëndësisë që ka çështja, për të cilën po duam të debatojmë, unë e dhashë një propozim që të tërhiqet rezoluta e cila ka ardhur me vonesë, iu ka bashkëngjitur, edhe pse është si rezultat i atyre katër rekomandimeve, që kanë qenë, megjithatë unë prapë po insistoј që të tërhiqet rezoluta dhe të mbetet dokumenti ashtu siç është dorëzuar në fazën fillestare.

Ndërsa, sa i përket asaj se e mbajmë apo s'e mbajmë fjalën, besim e mosbesim, njerëzit të cilët nuk i besojnë asnjë institucioni dhe njerëzit të cilët shprehin mosbesim mbi 50% të deputetëve, të cilët janë nënshkrues të asaj kërkesë, unë nuk dua as të komentoј, se s'meritoјnë me të vërtetë, s'jam marrë asnjëherë e as sot nuk merrem me komentimet e qëndrimeve të tyre. Po, unë jam që ne të gjejmë gjuhën e përbashkët, ashtu siç kemi ditur ta gjejmë gjuhën e përbashkët kur kanë qenë në pyetje interesat nacionale. Edhe në rastin konkret është një iniciativë, të cilën e kanë marrë mbi 60 deputetë të Parlamentit të Kosovës. Për hir të korrektësisë, po e përsëris, duhet të tërhiqet dokumenti i dytë, rezoluta dhe të mbetet dokumenti i fillimit, kur është dorëzuar në fazën fillestare. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Kryetar, më vjen keq, por unë kam obligim, sepse flas në emër të 27 deputetëve, vetëm dua të them se po shihet se ka jo korrektësi, shihet edhe nga deklarimi i zotit Kurtan Kajtazi. Vetëm nëse e argumenton veç një mesazh, se besoj që ka metodë që unë i kam thënë dikujt mos nënshkruaj, unë bart përgjegjësi. Unë jam shef i Grupit Parlamentar dhe ne e koordinojmë, po të ishte kështu, ai asnjë nënshkrim s'do ta merrte. Prandaj, kjo është e pavërtetë. E pavërtetë dhe nuk është mirë për të shpifur. Dhe, pikërisht me vend është të thuhet, që po tentohet të gjendet rrugëzgjidhje, ai mundohet të arsyetohet. Fundi i fundit, ne jemi tre deputetë të LDK-së dhe proceduralisht ne nuk pajtohemi se si është bërë, tash mund të heqësh e të shtosh çka të duash. Çka i është dashur për të futur rezoluta, kur ka mundur me tri rekomandime si rezultat i debatit, pastaj për të dalë edhe pikat tjera?

Prandaj, na është ngushtuar hapësira dhe thjeshtë ka qenë manipulim. Nuk mund të japish ti një nënshkrim, të cilin mund ta përdorësh pastaj një vit atë nënshkrim për tekste të ndryshme. Prandaj, nuk është mirë për të thënë diçka që është e pavërtetë, sepse unë po e them publikisht, tre deputetë e kanë nënshkruar, të cilët tash s'pajtohen. Edhe s'pajtohet i gjithë grupi, të jetë dhe të marrë pjesë në debat. Debat i nuk është ndonjë problem, le ta iniciojnë rishtazi me gjashtë nënshkrime, le të bëhet kjo punë, shumë lehtë bëhet, kurrkush nuk është kundër, por kjo seancë e thirrur kështu për ne është me nënshkrime, realisht të falsifikuara në kuptimin e ndërrimit e të futjes së diçka që s'ka qenë në momentin kur janë nënshkruar deputetët tanë, në këtë rast të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë desha, e pash të arsyeshme të jap një sqarim rreth mbledhjes së nënshkrimeve dhe të bëhet e qartë për opinionin publik.

Në momentin kur ne kemi marrë iniciativën dhe kemi kërkuar nga deputetët që të nënshkruajnë iniciativën për debat, është e vërtetë që vetëm pjesën e parë që në fletë e ka secili, është arsyetimi dhe nëse është e nevojshme, unë ta lexoj arsyetimin, me të cilin iu është ofruar deputetëve për të nënshkruar. Dhe, në fund që mos bëhem e tepërt po e lexoj, veç presim që pas debatit të zhvilluar, në bashkëpunim edhe me subjektet tjera politike, të dalin edhe konkluzionet përkatëse që do të votohen nga Kuvendi i Kosovës.

Asnjë rekomandim i shkruar në letër dhe asnjë rezolutë nuk ka qenë e bashkëngjitur në këtë pjesë. Dhe, kjo ka qenë vetëm arsyetimi dhe duhet t'i sqarohet opinionit, sepse nuk ka pasur manipulim me nënshkrime, siç po pretendohet këtu. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: E ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Po më duket që isha shumë i qartë, kryetar.

Ajo që foli unë ishte një mocion, jo vetëm lutje, se ne këtu nuk jemi në konferencë për shtyp nuk jemi, për hir të opinionit. Kërkesë pata që ky debat të hiqet sot nga rendi i ditës, ky ishte mocion i pastër, nuk ka dilemë dhe një mocion duhet të hidhet në votë. Të hiqet nga rendi i ditës, të rishkruhet dhe të vijë edhe njëherë. Ky ishte mocioni, këtë e kërkonte unë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Visar Ymeri ka kërkuar fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë e bëra një kundër replikë me atë që e tha shefi i Grupit parlamentar, për shkak se po i keqinterpretonte fjalët qëllimisht. Unë thashë që ne kemi mosbesim dhe nuk i besojmë iniciuesit të debatit, jo të gjithë deputetëve. Sa për atë se a i besojmë institucioneve a jo, kjo është një çështje tjetër, po mendoj që edhe ky para debat këtu që ne na ndodhi flet shumë qartë se një debat i tillë është i rëndësishëm. Pra, të debatojmë jo vetëm për çështjen, por edhe për ata që e kanë thërritur çështjen, për shkak se po shihet që në njëfarë mënyre këta e kanë bërë njëloj keqpërdorimi të nënshkruesve, ose të paktën ashtu po e thonë deputetët që e kanë nënshkruar, që ua kanë ndërruar dokumentet.

Dhe rrjedhimisht, një çështje e tillë, ose njerëzve të tillë, që i keqpërdorin nënshkrimet e deputetëve, nuk di se si t'u besohet.

Çështja e dytë është, prapë po e përsëris, nuk ju besojmë për shkak se rastin “Kiçina” e latë në gjysmë, u tërhoqët. Çka ndodhi me atë debat? Pra, kemi pasur ta votojmë një rezolutë prej së cilës u tërhoqët ju. Prandaj, edhe nuk i besojmë. Edhe po, është e vërtetë,

që ty Adem Grabovci edhe shokëve tu nuk u besoj fare. Pra, ty të besoj vetëm kur flet italisht, se vetëm atëherë ti je i vërteti, përndryshe, në këto rastet tjera nuk të besoj.

KRYETARI: Çështja është e seancës, por dua të tregoj se esenca e çështjes që është kërkuar, si në dokumentin e parë, rekomandime, si në dokumentin e dytë, rezolutë, është e njëjtë.

Në rekomandime, pika e dytë shkruan: “të bëhen përgatitjet ligjore që pas përfundimit të mandatit të EULEX-it, janar 2014, të jetë e gatshme për themelimin e Gjykatës vendore për krime lufte”. Kjo është në rekomandime.

Në rezolutë, që janë gjashtë pikë, në pikën e katërt që gjithashtu është esenca e këtij debati, shkruan: “Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t’i hartojë ligjet dhe të ndërtojë strukturën e domosdoshme në fushën e rendit dhe ligjit, ngjashëm me vendet tjera”.

Do të thotë, përafërsisht është e njëjta kërkesë. Dhe, unë mendoj që nuk ka dallim mes rekomandimeve që janë krijuar fillimisht dhe rezolutës që ka ardhur si pjesë. Por, e vërteta është se si rekomandimet si rezolutat, mund të ndryshohen në përfundim të debatit dhe të jetë një tekst i përbashkët i grupeve parlamentare ose i atyre që e kanë bërë kërkesën për debat.

Këtu në fakt nuk ka shumë ndryshime, prandaj edhe ata që e tërheqin, edhe pse personalisht asnjë nga ata s’mund të themi që e kërkoi tërheqjen e nënshkrimit, pse është bërë ky ndryshim, konsideroj se kushtet për debat janë.

Megjithatë, e kemi një mocion nga kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës Ardian Gjini, që të shtyhet debati. Këtu kemi 63 deputetë me elektronike, 58 janë kështu. Është mirë t’i bihet ziles që të vijnë deputetët dhe të votojmë, nëse votohet për shtyrjen e debatit.

Ju njoftoj se këtu janë të vendosura 64 kartela. Një pa kartelë, a? Mirë, pa kartelë është Fatmir Xhelili. Tash, sa kemi? 61.

Mund të votojmë për mocionin, për ta shtyrë debatin, rregulla 50, pika e dytë thotë: “mocioni për të shtyrë debatin, për ta shtyrë mbledhjen, për ta kaluar një çështje në Komision, ose për ta mbyllur debatin, duhet të ketë mbështetjen e së paku një grupi parlamentar”.

Këtu në fakt e kemi kërkesën e një grupi parlamentar dhe, mund të votojmë.

Kush është për shtyrjen e debatit, sipas kërkesës së kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputetit Ardian Gjini?

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 15 vota për, 40 kundër, 2 abstenime, megjithatë s'janë duhet të votojnë të gjithë, 58 me Fatmirin që merr pjesë në votim, por na duhen edhe më shumë. Edhe njëherë po përsërisim votimin. Lus të gjithë deputetët prezentë, ta shprehin vullnetin e tyre, pasi jemi në këtë numër që jemi, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim.

Edhe njëherë votojmë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! Regjia, edhe njëherë. Lus deputetët, që të marrin pjesë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Tash votimi është i suksesshëm. Me 15 vota për, 42 kundër, 5 abstenime, do të thotë nuk miratohet shtyrja e debatit. Kemi edhe Fatmir Xhelilin, kundër, do të thotë 43 vota janë kundër mocionit të ngritur nga kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës. Do të thotë, debati vazhdon.

- Debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, sipas kërkesës së deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues

Deputeti Kurtan Kajtazi, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, rolin e EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudhën e tranzicionit.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 15 korrik 2013, vendosi që këtë pikë të rendit të ditës ta radhisë për mbledhjen e sotme plenare.

Radha e diskutimeve. Fjalën e ka deputeti Kurtan Kajtazi, në cilësinë e propozuesit të çështjes.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Unë para se të fillojë debati edhe njëherë, në emër të Grupit Parlamentar dhe në emër të kërkesës së shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, po tërhiqemi nga rezoluta, në mënyrë që të gjitha grupet parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet dhe të dalim me një rekomandime apo rezolutë të përbashkët.

Trajtimi i krimeve të luftës ishte dhe mbetet një ndër testet më të rënda dhe më kritike të besueshmërisë dhe kompetence në sistemin gjyqësor në Kosovë.

Askush në Kosovë nuk është në gjendje të mbyllë këtë kapitull, derisa rastet e krimeve të luftës të mos trajtohen si duhet nga sistemi gjyqësor. Mos adresimi i plotë dhe përfundimtar i krimeve të luftës do të reflektojë dobësi dhe jo besueshmëri që i është

dhënë sistemit gjyqësor dhe do të ndikojë negativisht në të kaluarën dhe në të ardhmen e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Pas gjithë atyre krimeve që kanë ndodhur në shkallë aq të madhe në Kosovë, shoqëria kosovare ndjehet e viktimizuar dhe ka nevojë të sigurohet se kriminelë të shumë masakrave në Kosovë nuk do të kalohen pa u ndëshkuar. Ky është një hap i madh që duhet të bëhet para se pajtimi në mes popujve mund të ndodhë.

Pas Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të KFOR-it dhe Qeverisë Federale Jugosllave të asaj kohe, më 9 qershor '99, disa raste të krimeve të luftës ishin hetuar nga hetuesit ndërkombëtarë, nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës dhe Policia Civile e UMIK-ut, ndërsa Shërbimi Policor i Kosovës, që u krijua me vonesë nuk mori rol udhëheqës në hetimin e krimeve të luftës.

Që prej fillimit, vënia në prioritet e krimeve të luftës ka qenë vetëm në fokus të diskursit publik, por asnjëherë nuk ka qenë prioritet i vendit.

Asnjëherë nuk janë caktuar resurse të mjaftueshme për këtë qëllim dhe që nga viti '99 faktet flasin se adresimi i krimeve të luftës kurrë nuk ka qenë prioritet dhe më i rëndësishmi.

Qysh në vitin 1999 është paraqitur nevoja për themelimin e një Gjykate për Krime Luftë dhe Etnike në Kosovë, një Gjykatë Speciale në Kosovë, për t'i adresuar rastet e krimeve të luftës dhe rastet e motivuara etnikisht.

Shqetësimet e para ishin nevoja për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë kompetentë dhe të paanshëm, megjithatë, kufizimet buxhetore dhe mosgatishmëria e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare kanë lënë anash themelimin e kësaj Gjykate, gjë që nevojat për themelimin e saj ende ekzistojnë dhe janë të domosdoshme.

Institucionet e Republikës së Kosovës, në momentin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, i kanë bërë ftesë Bashkimit Evropian për vendosjen e misionit të EULEX-it në Kosovë, si mision i specializuar për ndërtimin e shtetit ligjor dhe parimeve të sundimit të ligjit.

Kërkesa për ardhjen e misionit të EULEX-it në Kosovë ka qenë një vullnet politik i përfaqësuesve të popullit të Kosovës, për të ndërtuar një shtet demokratik në fushën e sundimit të ligjit dhe vlerave civilizuese evropiane.

Të nderuar kolegë,

Populli i Kosovës ka pasur pritje dhe ka ushqyer besimin se misioni i EULEX-it do të ndihmojë në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, por do t'i japë edhe një prioritet të lartë rasteve të krimeve të luftës që janë të panumërta në Kosovë, si dhe krimit të përditshëm në veri të vendit. Edhe pas ardhjes së këtij misioni në Kosovë, pritjet e qytetarëve të Kosovës ende nuk po realizohen.

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë mbi 10 mijë qytetarë të pafajshëm civilë.

- Ku janë sot kryerësit e këtij gjenocidi?
- Kush u gjykua dhe u bë përgjegjës për më shumë se 200 masakra anë e kënd Kosovës?
- Kush është përgjegjës për zhdukjen e mijëra qytetarëve të Kosovës?
- Kush u gjykua për djegien dhe plaçkitjen e më shumë se 200 mijë objekteve në Kosovës, shkolla, shtëpi banimi, objekte kulturore e fetare dhe institucione tjera?
- Kush u gjykua për bartjen e kufomave dhe fshehjen e krimit në Batajnicë, Danub, Rashkë, Petrovo Sello, e tjerë?...
- A mund të harrohet masakra e Mejës dhe Korenicës, që u bë në stilin e masakrës së Srebrenicës?
- Kush mund ta harrojë masakrën e Izbicës, Reçakut, familjes Duriçi dhe Bogujevci, në Besianë, familjes Berisha, në Therandë, familjes Ujkani, në Reznik, si dhe familjes Gërxhaliu, në Studime të Vushtrrisë?
- A mund të heshtën masakat e Delijajve dhe a mund të harrohet për qytetarët e Vushtrrisë 22 maji, kur u morën mbi 70 persona të varrezat e qytetit dhe sot po na kthehen në arkivole?
- Pastaj, masakra e Studimes, ku për dy orë vriten mbi 100 persona?
- Janë masakra e Qyshkut, Lubeniqit, Krushës, Prekazit, pastaj masakat në Mitrovicë, Rahovec dhe Malishevë. Kush mund ta harrojë Qirezin dhe Likoshanin?
- A mund të harrohet masakra e Dubravës dhe a mund të pajtohen aktorët e gjallë të përjetimit të kësaj masakre që disa prej tyre sot janë pjesë e Kuvendit, nëse përgjegjësit që dihen me emër dhe mbiemër nuk marrin dënimin e merituar?
- Shtrohet pyetja, kush u dënua për këto krime dhe shumë krime të tjera në Kosovë?
- Kush u dënua për dëbimin me dhunë të afro 1 milion shqiptarëve dhe spastrimin etnik gjatë luftës në Kosovë?
- A është i drejtë perceptimi i gjithanshëm i qytetarëve të Kosovës se personat përgjegjës për krime të luftës, nuk po mbahen përgjegjës dhe drejtësia nuk po merret me ta, ose po merret njëanshëm?

Nëse institucionet gjyqësore dhe policore nuk angazhohen t'i adresojnë këto raste të rënda, atëherë besueshmëria dhe kompetenca e tërë sistemit gjyqësor do të vihet në pikëpyetje, por përgjegjësia do të bjerë edhe mbi Kuvendin, Qeverinë dhe në veçanti bordin e përbashkët për sundimin e ligjit, që asnjëherë gjatë punës së tij nuk u dha prioritet krimeve të luftës në Kosovë.

Në mënyrë që rastet e krimeve të luftës të adresohen në mënyrë të duhur, gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës dhe hetuesit duhet të posedojnë kualifikime të mjaftueshme për t'i trajtuar këto raste të ndërlikuara. Domosdoshmëria për kualifikimin dhe kompetencë të tillë duhet të ishte ndër arsyet parësore për themelimin e një Ode apo Gjykate të specializuar për trajtimin e veprave serioze, siç janë krimet e luftës.

Kjo fushë e ligjit kërkon nivel të lartë të trajnimit dhe përvojës së specializuar, që duhet të kërkohet për ata persona të caktuar, për të ndjekur, mbrojtur dhe gjykuar rastet e tilla.

Megjithatë, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka ofruar një numër trajnimesh lidhur me rastet e krimeve të luftës, si dhe vizita studimi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë. Gjithsesi, akoma ka nevojë për një strategji trajnuese për raste të krimeve të luftës deri në themelimin e kësaj gjykate.

Besojmë se edhe misioni i EULEX-it në Kosovë mund të ndihmojë shumë në këtë drejtim. Një tjetër alternativë do të ishte që gjatë kësaj kohe gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të trajnoheshin edhe nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte në Hagë. Krijimi i një Gjykate apo Ode Speciale do t'u lejonte gjykatësve të përqendrohen ekskluzivisht në rastet e krimeve të luftës, duke ofruar kështu vendosjen në prioritetin e duhur të këtyre rasteve.

Dikush mund të thotë se ka kaluar kohë e gjatë për të ngritur një çështje për themelimin e një gjykate për krime lufte. Në këtë rast, duhet të merret parasysh rasti i themelimit të Odës për Krime Lufte të Gjykatës Shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës, që është formuar 10 vjet pas përfundimit të luftës dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe.

Rekomandojmë që:

- Bordi i përbashkët për sundimin e ligjit të rastet e krimeve të luftës të procedohen nga sistemi gjyqësor si raste me prioritet.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës të ofrojë trajnime të specializuara për krimet e luftës deri në themelimin e Gjykatës së veçantë, të bëjnë teste dhe certifikime të gjyqtarëve, të cilët caktohen t'i trajtojnë rastet e krimeve të luftës.
- Oda e Avokatëve të Kosovës të organizojë trajnime për avokatët mbrojtës për krime lufte.
- Policia e Kosovës të zgjerojë programin e trajnimeve të specializuara dhe të caktojë ekipe për policët që punojnë në Njësitin hetimor për krime lufte.
- Komuniteti ndërkombëtar të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm gjyqësor.
- Rastet e krimeve të luftës do të ndodhen në sistem edhe kur të shkojnë gjyqtarët ndërkombëtarë.
- Akuzat për krime lufte nuk kanë afat ligjor.

Në këtë drejtim, do të ishte mirë që gjatë kësaj kohe në proces të përfshihen më shumë gjykatës dhe prokurorë vendorë, në mënyrë që të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet debatin, i bindur se Kuvendi është me autoritet të plotë Kushtetues dhe politik, prandaj edhe është legjitim që të diskutojë çështje nga më të ndryshmet, e sidomos këto të cilat janë të karakterit sistemor dhe sidomos, këto çështje të cilat kanë qenë javë të tëra shqetësim, preokupim i një numri të konsiderueshëm të qytetarëve.

Kapaciteti dhe mandati ynë përfaqësues na obligon që të merremi me çështje të tilla, aq më parë vizion yni për vendin ku sundon rendi dhe ligji dhe ku funksionon drejtësia.

Ne mendojmë se debati për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, rolin e EULEX-it, rolin dhe përgjegjësinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe proceseve të tranzicionit, mendoj se mund ta zhvillojmë mbi bazën e së paku tri parimeve.

Parimit të parë të besimit në drejtësi, e cila duhet të jetë e pakontestueshme, efikase dhe kredibile.

Për të qenë drejtësia e pakontestueshme, drejtësia duhet të bazohet në fakte dhe prova dhe të jetë drejtësi e drejtë mbi bazën e fakteve dhe provave, para së gjithash dhe mbi të gjitha e jo drejtësi mbi bazën e me çdo kusht dëshmi dëshmitarësh të përzgjedhur dhe të joshur, madje edhe të kërcënuar, për të nxjerrë përfundime të caktuara të drejtësisë. Një drejtësi që bazohet vetëm në dëshmi dëshmitarësh, të cilët dëshmitarë pastaj braktisen në fund, nuk mund të jetë drejtësi e drejtë. Për të qenë drejtësi efikase mendojmë ne, drejtësia duhet të shërbehet me procedura efikase e jo procedura të tejzgjatura, të stërzgjatura, të cilat e vonojnë drejtësinë dhe drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, këtë e dimë të gjithë.

Jo drejtësi e praktikave, në të cilat arrestohesh paradite, lirohesh pasdite e gjatë mbrëmjes sërisht arrestohesh. Kjo drejtësi e kësaj mënyre, e këtij lloji, nuk krijon respekt as besim të atyre, të cilëve drejtësia u shërben.

Për të qenë drejtësi kredibile, mendojmë, drejtësia duhet t'i ndjekë dhe gjykojë të gjitha llojet e krimeve në veri e në jug të Kosovës, t'i ndjekë të gjithë kriminelët, kudo që ata ndodhen, për çfarëdolloj krimi që kanë bërë, duke përfshirë edhe krimet e luftës, nëse edhe ata ndodhen në Beograd apo gjetiu, për arsye se me asgjë nuk pengohet drejtësia, që t'i ndjekë ata që kanë bërë krime në Kosovë, kudo qofshin ata. Asgjë nuk na pengon që të zhvillojmë procedura të ndjekjes, madje jo vetëm në drejtësinë ndërkombëtare, po as drejtësinë vendore. Askush nuk i pengon prokurorët vendorë, që të fillojnë ndjekjen e të gjithë të dyshuarve për krime lufte që ndodhen në Serbi apo diku tjetër që fshihen nëpër Evropë e që kanë bërë krime në Kosovë.

Prandaj, kjo do të duhej të ishte dhe mund të jetë drejtësi kredibile, të cilën ne e përkrahim fuqishëm.

Parimi i dytë që ne mendojmë se duhet të jetë bazë e debatit, është parimi i bashkëpunimit të organeve vendore të sundimit të ligjit me ato ndërkombëtare.

Ne si Kuvend jemi të interesuar që të inkurajojmë bashkëpunim më të fuqishëm, më serioz, më të sinqertë, në mes të këtyre dy institucioneve vendore e ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit, për të gjitha krimet e posaçërisht për krimet për të cilat sot po flasim, natyrisht, për të qenë bashkëpunimi i mirë duhet të jetë bashkëpunim i sinqertë.

Ne si Kuvend na intereson edhe procesi i tranzicionit, fundja, vetë i kemi dhënë mandat vazhdimit të misionit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe na intereson shumë të dimë, se cili është ky lloj bashkëpunimi dhe të forcohet ky lloj bashkëpunimi dhe sidomos, të respektohen prioritetet e vendit tonë dhe ato prioritete janë sundimi i ligjit në kuptimin e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar para së gjithash dhe mbi të gjitha dhe kudo që është ai.

Parimi i tretë, që ne mendojmë se duhet të jetë bazë e debatit sot, është parimi po ashtu i përgjegjësisë politike që e ka ekzekutivi karshi legjislativit.

Ne jemi shumë të interesuar të dimë se sa po punon dhe si po punon misioni ndërkombëtar i sundimit të ligjit. Këtë sigurisht s'mund ta dimë drejtpërsëdrejti nga ata, për arsye se ata nuk i raportojnë organeve tona, megjithatë Qeveria është partner i përditshëm i misionit për sundim të ligjit dhe ne mund të informohemi nga Qeveria për rezultatet e EULEX-it. Natyrisht, kemi konsiderata të larta dhe mbështesim përkrahjen e fuqishme, që misioni po e bën në fushën e sundimit të ligjit, të ndërtimit të kapaciteteve, të forcimit të institucioneve tona në sundimin e ligjit.

Megjithëkëtë, ne kemi të drejtë dhe duhet të dimë se çka dhe si po punohet nga ky mision dhe këtë kërkojmë që ta marrim vesh nga Qeveria, në emër të përgjegjësisë që Qeveria ka karshi Kuvendit.

Krejt në fund, mendoj se ne duhet ta mbështesim debatin, ne do ta mbështesim edhe mocionin e propozuar nga deputeti Kajtazi, të cilin e kemi nënshkruar edhe individualisht anëtarët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe mendoj shumica prej nesh qëndrojmë mbrapa nënshkrimeve tona, të bindur se me këtë po i kontribuojmë një çështjeje e cila është e rëndësishme për vendin.

Procesi i tranzicionit apo i bartjes së përgjegjësisë, mendoj që kërkon një strategji dhe mendoj që Kuvendi duhet të njoftohet për strategjinë e procesit të tranzicionit, i cili tranzicion apo bartje e përgjegjësisë duhet të bazohet në një studim profesional, studim serioz të nevojave e kërkesave tona, por edhe të mundësive dhe pastaj të përcaktohem politikisht për rolin dhe rëndësinë që mund ta ketë misioni ndërkombëtar i sundimit të ligjit në të ardhmen e kryesisht, sugjerojmë që në të ardhmen të jetë mision në mbështetje me kapacitete monitoruese dhe këshillëdhënëse, në mënyrë që të marrim përgjegjësitë e tëra ekzekutive në fushën e luftimit të gjitha llojeve të krimit, sepse nuk jemi më shoqëri e pasluftës, nuk jemi më shoqëri në tranzicion, por jemi shoqëri në zhvillim e sipër në të gjitha aspektet. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Duhet të thuhet që me EULEX-in ekziston një problem fundamental, pavarësisht se cila është puna e tij. Do të thotë, pavarësisht nëse puna e tij mund të vlerësohet e mirë dhe e nevojshme, apo e dëmshme, sepse në fillim të EULEX-it e kemi një problem që ka të bëjë me teorinë e demokracisë.

Ajo që e bën EULEX-in jokompatibil me demokracinë standarde, ma merr mendja se janë pesë karakteristika që e shquajnë këtë mision. E para është që ky mision përbëhet prej njerëzve, të cilët marrin vendime shumë të rëndësishme për Kosovën, por të cilët janë të pazgjedhur prej institucioneve të Republikës së Kosovës.

Së dyti, ata nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe marrin vendime shumë të rëndësishme për ne.

Së treti, kanë imunitet nga ligji vendor dhe nga gabimet që ata mund t'i bëjnë.

Së katërti, nuk japin llogari përpara institucioneve të Republikës së Kosovës për punën që e bëjnë dhe problemi i pestë është që ky mision si i tillë për nga karakteri politik është neutral ndaj statusit të Republikës së Kosovës në kuptimin që është neutral ndaj pavarësisë të Republikës së Kosovës.

Këto janë përpara se të dalim te puna e EULEX-it. Pra, çfarë pune ka bërë EULEX-i deri më tash. Por, nëse dalim te puna, atëherë duhet të thuhet që të dështuarit më të mëdhenj politikë të periudhës pas pavarësisë së Republikës së Kosovës janë pa dyshim Qeveria dhe EULEX-i.

Por, ajo që e dallon EULEX-in nga Qeveria e Kosovës është fakti që përderisa te Qeveria populli i Kosovës nuk kishte shpresa të mëdha, sepse e pa se si kjo Qeveri qeverisi prej vitit 2007 deri në vitin 2010, ardhja e EULEX-it në Kosovë u shoqërua me pritje më të mëdha.

Pjesa dërmuese e njerëzve mendonin se pas shpalljes së pavarësisë, UNMIK-u, si një mision ndërkombëtar zhgënjyes do të zëvendësohej me një mision më të avancuar evropian. Një pjesë e madhe e qytetarëve mendonin se ky mision do të vinte në Kosovë për ta luftuar korrupsionin e qeveritarëve dhe për ta vënë drejtësinë në vend, e për ta vendosur sundimin e ligjit dhe për ta forcuar demokracinë në vendin tonë.

Pesë vjet më pas mund të konkludohet me një siguri të plotë se rezultatet janë dëshpëruese nëse i krahasojmë me premtimet dhe pritjet e njerëzve. Krejt çka po shohim sot është se EULEX-i për pesë vjet me radhë e ka sakrifikuar drejtësinë për hir të stabilitetit të brendshëm të skenës politike, mirëmbajtjes së kryeministrit Thaçi në pushtet, si dhe negociatave me Serbinë.

Cilat janë rezultatet e EULEX-it sa i përket luftës kundër korrupsionit? Mund të themi lirisht se rezultatet janë pothuajse të papërfillshme. Shumicën e super të pasurve të politikës, të cilët janë bërë milionerë falë mundësisë për të qenë në pushtet sot i kemi

ende në qeverisje. Sot ka njerëz të gatshëm të tregojnë si dhe kujt i kanë dhënë ryshfet për ta marrë një tender publik. Ka keqpërdorime marramendëse të parasë publike, zhvatje të paimagjinueshme, humbin miliona nga buxheti i shtetit, sikur ishte rasti i pasaportave biometrike, kurse EULEX-i përpëlitet pa efektivitet duke kalkuluar politikisht vazhdimisht.

Ka një arsye shumë të thjeshtë pse EULEX-i ka dështuar në luftimin e korrupsionit, sepse është pikërisht korrupsioni ai që qeveris sot me Kosovën. Arsyeja është që EULEX-i si mision është kryesisht në shërbim të politikës së jashtme të BE-së dhe aspak në funksion të drejtësisë në Kosovë. Shtrohet pyetja: Pse politika e jashtme e BE-së është në njëfarë kundërthënie me drejtësinë në Kosovë?

Është kështu, sepse agjenda e jashtme e BE-së tash për tash është sidomos e përqendruar në stabilitetin rajonal. E stabiliteti aktual rajonal nuk ka dyshim se mirëmbahet në kurriz të shqiptarëve. Mjafton t'i krahasoni të drejtat e shqiptarëve në Serbi dhe në Maqedoni me të drejtat e serbëve në Kosovë dhe çdo gjë bëhet e qartë.

Thelbi i stabilitetit është rregullimi i të drejtave sipas raportit të forcave dhe kjo është pikërisht mënyra se si stabiliteti e kodifikon padrejtësinë dhe pabarazinë. Sepse, stabiliteti i vërtetë është vetëm barazia e popujve dhe barazia e pakicave.

Ky stabilitet i padrejtësisë bën që Kosova të shërbejë vetëm si mjet për hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian.

Serbisë ia plotësuam pothuajse të gjitha ambiciet e saj në veri të Kosovës, kurse Kosova me të gjitha ato koncesione që i bëri mbetet ende shumë larg në procesin e integrimi. Prandaj, Bashkimi Evropian e lavdëron aq shumë Qeverinë tonë për marrëveshjen që e bëri me Serbinë. Kjo Qeveri është e përkryer për këto punë, sepse nën tavolinën e negociatave janë të gatshme dosjet e korrupsionit.

Shikuar nga ky aspekt, politika e jashtme e Bashkimit Evropian është saktësisht e kundërta e drejtësisë. Drejtësi e vërtetë do të ishte ndjekja e korrupsionit, çrënjësja e krimit të organizuar, pastrimi i politikës nga keqpërdoruesit dhe vendosja e praktikave strikte të përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe sundimit të ligjit, e pastaj me politikanë të përgjegjshëm të arrihet paqja rajonale që buron nga barazia e popujve.

Përkundrazi, ajo që po ndodh sot në Kosovë është e kundërta. Tolerimi i qëllimshëm i korrupsionit ashtu që pushtetarët e shantazhuar të dërgohen nëpër procese negociatore, ku lëshojnë pe për vendin e tyre dhe arrihet marrëveshje në kurriz të shqiptarëve sipas konceptit të stabilitetit rajonal që e ka Bashkimi Evropian.

Pra, politika e jashtme dhe e sigurisë së Bashkimit Evropian, Qeveria Thaçi, marrëveshja me Serbinë, ligji i tmerrshëm i amnistisë, korrupsioni flagrant në Kosovë, stabiliteti rajonal të cilin më së shumti e paguajnë shqiptarët, të gjitha këto po bashkëjetojnë për mrekulli.

E kam dëgjuar me shumë vëmendje fjalimin e Stefan Fules në Kuvend. Ai foli gati 20 minuta dhe askund nuk e përmendi fjalën “korrupsion”. Por, me dhjetëra herë e ka përmendur marrëveshjen me Serbinë dhe Serbinë. Kjo është pra politika e jashtme e Bashkimit Evropian në Kosovë. Me rëndësi është Serbia dhe marrëveshjet me të, me ç’rast ne jemi ata që e bartim barrën e koncesioneve, kurse korrupsioni, keqqueverisja, shkeljet e ligjeve, varfëria etj., as që përbëjnë tema me të cilat zyrtarët e Brukselit e çajnë kokën.

Kjo është me të vërtetë e pikëllueshme dhe aspak kompaktibile me vlerat e vërteta të demokracive nacionale të vendeve evropiane.

Një dështim tjetër kardinal i EULEX-it është veriu i Kosovës.

Kur EULEX-i zbarkoi në Kosovë në dhjetor të vitit 2008, vonesën e vet e arsyetonte me nevojën që autoritetin ta shtrinte në tërë Kosovën, pra edhe në veriun e Kosovës. Dhe, prej asaj kohe kemi dëgjuar me qindra deklarata se çdo shkelës i ligjit në veri do të përballet me drejtësinë dhe me forcën e ligjit. Por, cilat janë rezultatet deri tash? Rezultatet janë zero. EULEX-i absolutisht aspak nuk e ka sfiduar krimin e organizuar në veri, prandaj pikërisht për shkak të këtij dështimi u amnistua tash së fundi i tërë korpusi i strukturave kriminale të Beogradit në veriun e Kosovës.

Dhe, në fund, e kemi edhe një dështim tjetër të EULEX-it sa u përket krimeve të luftës në Kosovë. Në sjelljen e tij ndaj luftës së UÇK-së vërehet qartë se EULEX-i nuk e njeh luftën tonë si luftë të drejtë dhe për çlirim. Kurse, lufta e Serbisë ka qenë e kundërt. Ka qenë luftë kriminale dhe okupatore. Prandaj, politikisht nuk mund të vendoset kurrfarë ekuivalence ndërmjet veprimeve të UÇK-së dhe të Serbisë.

Kurse në politikat e EULEX-it vërehet një tendencë e qartë për barazimin e veprimeve të UÇK-së me ato të kriminelëve paramilitarë, ushtarakë dhe policorë të shtetit të Serbisë. Vendet të cilat u ndodhën në procesin e armatosur dhe të përgjakshëm të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, të cilin e nisi dhe e përfundoi Serbia, të cilat nuk janë gjykuar si raste nga Gjyqi i Hagës, janë trajtuar nga gjykatat vendëse, kurse në Kosovë këto çështje erdhi për të na i zgjidhur një mision i huaj.

Kjo mendoj që është shumë e gabueshme, sepse krejt ky problem po përfundon në kalkulime politike të EULEX-it sa i përket politikës së jashtme evropiane në vend që qëllimi i vërtetë të jetë drejtësia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shefi i grupit, zoti Gjini e ka fjalën

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ju që jeni në sallë, nga 20 a sa, po kam dëshirë ta theksoj për këtë temën tepër të rëndësishme, për të cilën po flasim.

Fillimisht, më duhet ta bëj një pyetje: çka jemi duke bërë? Për shkak se ekziston njëfarë lajthitje këtu, propozuesi i mocionit deklaroi se e tërheq rezolutën prej votimit. Përderisa, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Behar Selimi, tha: “Ne do ta votojmë mocionin”. Tash seriozisht duhet me qenë të saktë çka jemi duke bërë, a është tërhequr mocioni dhe ne veç po flasim tash, se s’kemi materie për ta votuar, në fund të fundit, apo u bë njëfarë mashtrimi, se u deklarua tërheqja e materies përderisa materia ekziston. Kjo është çështja e parë të cilën Kuvendi duhet ta dijë. Nuk është mirë kështu. Nuk është mirë! Duhet qenë pak më konsistentë.

Çështja e dytë, për të cilën kisha dashur të flas është vetë titulli i mocionit. Shihni, titulli i mocionit është si një titull i një teze të magjistraturës. E dini pse po them të magjistraturës? Për shkak se është i gjatë. Ata që bëjnë magjistraturë frikohen të jenë shumë precizë, sesa më preciz që ti je, mundësia e gabimit është më e madhe, kështu që e lëshojnë konopin gjatë, që të përzihet çka të duan aty, të hyjnë brenda çka të duan. Lexojeni titullin, ju lutem, dhe e shihni që titulli e ka karakter të një teze të magjistraturës.

Çështja tjetër për të cilën dua të flas, sepse më erdhi ndërmend tash, e të cilën nuk e kisha përgatitur në emër të grupit më herët, është kjo: Është e vërtetë se EULEX-i duhet të shkojë, se jeni duke u nisur në këtë çështje.

Çështja është kur edhe çështja është pse. E unë po ju them që sot jam bindur edhe më tepër që duhet të shkojë për shkak se nuk ka bërë kurrgjë më tepër ndoshta, përpos tjerave, por ju paska pas dhënë edhe një pretekst të thoni që EULEX-i s’po bën kurrgjë.

Krejt çka dëgjova këtu është duhet luftuar korrupsionin, duhet luftuar krimet e luftës etj., etj. Kush i ka ndalur prokurorët tanë ta bëjnë një gjë të tillë? A ka ndonjë ligj, a ka ndonjë autoritet? A ka ndonjë rregull që e ndalon ndonjë prokuror të Kosovës të ngrejë padi, qoftë për krime të luftës, qoftë për korrupsion, qoftë për vjedhje masive, që u përmend këtu, mbani mend. Është vjedhur fort Kosova. Sidomos në gjashtë vjet e fundit.

Ama, kush i ka ndalur këta? Ndoshta, hipotetikisht po them, dhe është pak kjo edhe cinike kjo që po them, ndoshta i paska ndalur EULEX-i, se kanë thënë “hajt se e bëjnë këta”. Shiko, të thonë politikanët e Kosovës në foltore të Kuvendit që fajet pse nuk po luftohet korrupsioni i ka EULEX-i është kulmi i cinizmit dhe kulmi i tragjedisë në Kosovë.

Duhet t’i vijë marre kujtdo në Kosovë, sidomos atyre që kanë peshë vendimmarrëse ta akuzojnë EULEX-in pse nuk po luftohet korrupsioni, t’i thonë EULEX-it “ti s’po lufton”. Ndoshta krejt në rregull, por ne duhet ta luftojmë korrupsionin, gjyqet tona. Ne.

Domethënë, na paska dhënë një pretekst. Çështja tjetër është kur politikanët e kërkojnë, sidomos politikanët e Qeverisë, të jem më i qartë, të mos e godas dikë anash kështu, kur ata kërkojnë të shkojë EULEX-i, dhe mbajeni mend, nën sfond të kësaj që po diskutohet kjo është, nuk është krimet e luftës etj., etj., e lënë një shije të keqe. Ajo shije është që janë kah fshehin diçka nën tepih. Se sa për prokurorët dhe gjyqtarët tonë kurrë nuk do ta

hapin atë temë, të paktën edhe do vjet derisa të na e rrisë presionin Unioni Evropian edhe të na hedhë dosjet me pluhur në tavolinë.

Domethënë, tash ta heqim EULEX-in shpejt e shpejt, kur vjen prej Qeverisë së Kosovës, të nderuar deputetë, këta çka keni mbetur, nja 20, e lë shijen që dikush është kah fsheh diçka ndër tepih dhe të vetmit që mund pahiri t'u bjerë ndërmend ta ngrenë atë tepih është EULEX-i dhe 'hajde, më mirë t'i heqim sa nuk e ka çelur ndokush se këta tanët nuk guxojnë'.

Domethënë, çështja është kush po e kërkon këtë çështje. Ky është një problem tepër i madh. Ne mendojmë si Aleancë, po kthehem te pjesa kryesore e fjalës sime, se Kosova duhet të jetë vend plotësisht sovran. Kosova duhet të jetë vetë në gjendje të krijojë kushte të sundimit të ligjit të plotë në Kosovë. Kosova duhet të jetë e gatshme, sistemi ynë i drejtësisë duhet të jetë i aftë të merret me krejt temat me të cilat duhet të merret një sistem i drejtësisë në një shtet modern çfarë po tentojmë ta ndërtojmë.

E vërteta është se ky sistem i drejtësisë është larg prej të qenët i tillë në këtë moment dhe ndoshta një pjesë të vogël të fajit e ka edhe EULEX-i për këtë çështje, por mbajeni mend - fajin kryesor e ka pushteti. Fajin absolut, për shkak se në Kosovë sundimin e ligjit e ka pushteti. Edhe nëse i servojmë ne popullit të Kosovës diçka tjetër, nëse i themi që fajet i ka Unioni Evropian shumë i keq, dhe politika e jashtme e keqe e Unionit, EULEX-i, e kush e di kush, ne jemi duke e lajthituar popullin e Kosovës, edhe veten, edhe jemi duke krijuar animozitet të panevojshëm me dikë. Totalisht të panevojshëm.

Këtu janë fajet, të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, këtu janë fajet, te Qeveria e Kosovës që e mban shumicën në Parlament 6 vjet. Këtu është faji. Edhe hiqni këto çështje kush EULEX-i, çka, po EULEX-i.

Ta dëgjojmë Qeverinë duke thënë "është zhgënjyer me EULEX-in", vërtet nuk po mundem as të besoj qysh dikush po i dëgjon dhe s'po reagon. Po qysh, e kanë Ministrinë e Drejtësisë, e kanë buxhetin, e kanë Policinë, krejt mekanizmat për t'i luftuar krimin dhe korrupsionin i kanë vetë në dorë, dhe thonë "EULEX-i na ka zhgënjyer se kemi pritur që ata ta luftojnë". Mosni pashë Zotin, "amon ty jarabi", siç thonë në Gjakovë.

Një çështje tjetër, për të cilën duhet të flasin është çështja e krimeve të luftës dhe kjo është diçka jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën dhe i dedikohet EULEX-it. Shikoni, e meta ose hendikepi i EULEX-it në luftimin e krimeve të luftës, ose në dënimin e krimeve, ose zbardhjen e krimeve të luftës në Kosovë është se e ka vetëm një subjekt për t'u marrë, e ata janë veç shqiptarët. Ky është hendikepi i EULEX-it. Nuk e kemi ndërtuar na këtë hendikepi të EULEX-it, por EULEX-i duhet ta dijë që 14 vjet pas luftës është duke u marrë me krime të luftës në Kosovë, e nuk mund të merret me krimet e luftës që i kanë bërë, shembull ta marrim, serbët që kanë ikur në Serbi, dhe nuk ka njeri në këtë rruzull tokësor që e di që shumica dërmuese e krimeve të luftës janë bërë prej serbëve.

EULEX-i duhet ta rishikojë këtë temë se është shumë e gabuar. Është shumë e gabuar. Mund të mos jetë hendikep i qëllimshëm, por është hendikep. Veç me ne po doni të merren. Veç me shqiptarët. Nuk po mund të merreni me serbët që kanë bërë krime lufte, dhe veç ky fakt po shndërrohet në problem të madh, po shndërrohet në problem politik.

14 vjet pas luftës, të nderuara zonja dhe zotërinj, ne është dashur të ngrihemi në këmbë, të shohim përpara, të ecim përpara, të arrijmë të bëhemi si një shoqëri normale. 14 vjet pas luftës, të mban si llastik, pse i është tekur dikujt. Është gabim! Është gabim! Është gabim!

Nuk bën vazhduar kështu për shkak se nuk është duke iu ndihmuar një shoqërie, nuk është duke i ndihmuar as pajtimin, nuk është duke i ndihmuar as ecjes përpara krejt regjionit. Jo kështu! Kjo është mënyrë e gabuar. A guxojmë ne të themi se duhet ndalur hetimi i krimeve të luftës. Absolutisht jo. Duhet të jemi tepër të qartë. Hetimi i krimeve të luftës mund të vazhdojë edhe 100 vjet, nëse zbardhet dikur. Të dalë e vërteta - kush e ka bërë krimin e luftës, por duhet pasur tepër kujdes se këto krime të luftës për një sekondë shndërrohen në probleme politike, të cilat nuk i ndihmojnë më shoqërisë dhe, fundi i fundit, për çka është drejtësia. A është drejtësia për t'i ndihmuar shoqërisë, apo është drejtësia për të bërë drejtësi për vetvete? Për hir të drejtësisë?

Drejtësia nuk duhet të jetë për hir të drejtësisë. Drejtësia duhet të jetë për t'i bërë njerëzit të ndihen mirë, të ndihen të barabartë dhe, fundi i fundit, për ta ndërtuar një jetë më të mirë. Këto janë ato çështje për të cilat unë desha të flas. Në emër të Grupit Parlamentar, ju tregova, mendojmë se mocioni është tërhequr. Nëse mocioni nuk është tërhequr, nuk mund të votojmë për shkak se është edhe një lajthitje e dytë në Kuvend, dikush të thotë “po e tërheqim” dhe po vazhdojmë, dikush tjetër të thotë “jo, nuk është tërhequr”, e çështja se a do mbetet EULEX-i në Kosovë apo jo nuk mund të vendoset në një debat parlamentar pa mision të pastër, kur gjysma e Kuvendit nuk janë në sallë dhe ku ka bojkot politik të një pjese serioze të deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se u theksua edhe nga parafolësi, diçka këtu nuk është e qartë. Kur thuhet nga vetë iniciuesi i debatit që do të tërhiqet rezoluta, ndërsa grupi parlamentar thotë “do të votohet rezoluta”, unë në emër të grupit do ta jap mendimin tim, por nuk e di çka do të nxirret në fund, pas këtij debati.

Duke marrë parasysh se çështja e debatit parlamentar për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, ndërsa në formën e debatit ku është dhënë arsyetimi, është diçka tjetër, në thelbësi, ku thuhet “duhet të trajtohen krimet e luftës, duhet ta kemi një strategji nga Qeveria për këtë çështje dhe ta kemi një themelimin të një tribunali të një gjykate të veçantë”, besoj që fatbardhësisht këtu sot e kemi zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, i cili është njohës mjaft i

mirë i kësaj çështjeje dhe di çka është më e mira për qytetarët e Kosovës dhe ka vullnet që t'i çojë këto procese përpara.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë gjatë këtyre viteve ka qenë një ndër pengesat kryesore për sundimin e shtetit të së drejtës. Sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të jetë, përkundër përpjekjeve institucionale, shumë pak i besueshëm nga qytetarët e Kosovës dhe kjo për shkak të dështimit për ta ndarë drejtësinë.

Në demokraci pushtetet janë të ndara, prandaj debati në Kuvend nuk duhet të shikohet si ndërhyrje në pushtetet e pavarura, në këtë rast në drejtësi, por interesim i të gjithë deputetëve që ta kemi një drejtësi efikase në pajtim me ligjet dhe me Kushtetutën.

Misioni i EULEX-it në Kosovë dihet mjaft mirë se është votuar. Po nga ky Kuvend i është dhënë mandati me kërkesën e kryeministrit dhe presidentes, mision i cili ka për qëllim dhe ka pasur një përkrahje dhe në mision të vetin që ta ketë një hallkë kryesore të sistemit, jo gjithëherë ka arritur që të jetë efikas dhe i besueshëm nga qytetarët e Kosovës. Në këtë rast, kërkohet nga misioni i EULEX-it që ta tregojë efikasitetin e tij për arsyet që ka ardhur në Kosovë.

Ne si grup parlamentar në një asnjë rast nuk dëshirojmë të kuptohemi se debati në fjalë paraqet ndërhyrje në drejtësi, por duhet kuptuar si shqetësim tonin sa i përket këtij sistemi. Ne e mbështetim misionin e EULEX-it në Kosovë dhe kërkojmë efikasitet në luftimin e krimit të cilitdo lloj natyre qoftë ai. Në këtë rast kërkojmë që EULEX-i ta shtojë efikasitetin dhe të mos ndikohet nga nevojat e kujt do qoftë.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë, me gjithë përparimet, ka pasur dhe vazhdon të jetë akoma i brishtë dhe si rezultat i kësaj ka nevojë për përkrahjen ndërkombëtare. Ne jemi të bindur se drejtësia kosovare mund të përfitojë shumë nga eksperiencia e EULEX-it dhe njëkohësisht në të ardhmen të ketë transformime të kompetencave të plota në institucionet vendore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,
Deputetë,

Mendoj se debati i sotëm do të bëhet produktiv nëse Kuvendi e analizon situatën e krijimit të kushteve në shoqërinë tonë që Gjyqësori, qoftë ai ndërkombëtar, qoftë EULEX-i, por sidomos gjyqtarët e Kosovës ta kenë një efektivitet më të madh në punë, të kenë kushte më të mira në punë dhe të tregojnë rezultate.

Krimet e luftës natyrisht se janë një problem serioz i Kosovës dhe ato duhet të trajtohen dhe duhet të krijohen të gjitha parakushtet organizative. Nuk jam i sigurt që është e vetmja zgjidhje që të krijohet një gjykatë, por mund edhe në kuadër të gjykatave të krijohen seksione të caktuara, të cilat merren me këtë problem. Por, unë gjithashtu pajtohem me atë që e tha kolegu Gjini se vërtet se edhe deri sot askush nuk i ka penguar

njerëzit që ta ndërmarrin një aktivitet më të madh sa u përket ndjekjeve të krimeve të luftës. Ka shumë probleme me krime të luftës.

Unë e kam ngrehur këtu çështjen e helmimit të nxënësve në vitet e '90-ta dhe kam kërkuar prej Qeverisë që të ndërmarrë aktivitete, edhe prej institucioneve gjyqësore. Nuk kam ndonjë informatë që ka ndodhur diçka, por sigurisht që me një pyetje parlamentare do të kërkoj të informohem lidhur me atë problem.

Sa u përket çështjeve tjera të bashkëpunimit me EULEX-in, mendoj se diskutimi i sotëm do të ishte produktiv vetëm nëse e trajtojmë se si ta bëjmë këtë bashkëpunim më efektiv. Është mirë të mendojmë për tranzicion. Sigurisht me marrje graduale të kompetencave nga gjykatësit vendorë. Unë besoj që ata i kanë edhe ato kompetenca, nuk ka problem, por sot për ne brenga kryesore në këtë Kuvend do të duhej të ishte problemi kryesor: pse gjyqtarët dhe prokurorët vendorë ende nuk mund të bëjnë ballë që ta marrin vetë udhëheqjen e një rasti të rëndë? Pse të gjitha rastet e komplikuar, qofshin të luftës, qofshin të korrupsionit, duhet të udhëhiqen ose nga prokurorë ose nga gjyqtarë të EULEX-it? Kjo është çështje që Kuvendi duhet ta shtrojë sot.

Ku është problemi këtu? A nuk po i lë EULEX-i ata t'i marrin ato? Apo këta nuk kanë guxim t'i marrin ato raste? Nuk besoj që EULEX-i e pengon iniciativën e tyre dhe punën e tyre që t'i marrin këto raste. Po, pse nuk i marrin këto raste atëherë? Kuvendi duhet ta shtrojë këtë pyetje: pse gjyqtarët dhe prokurorët kosovarë nuk i ndjekin krimet e rënda, qofshin ato të luftës, qofshin ato politike, qofshin ekonomike? Pse?! Ku është problemi?

A e kemi krijuar në shoqëri një situatë të tillë që ata mos të frikohen, të kenë një kurajë. Ata e kanë dhënë betimin para qytetarëve të Kosovës, në qoftë se nuk kanë kurajë le të thonë para popullit, është e ndershme: "Ne jemi gjyqtarë, ne jemi prokurorë, por ne nuk guxojmë t'i marrim këto raste, sepse frikohemi ose s'kemi kurajë profesionale". Apo, ku është problemi? Ky është një problem shumë i madh për ne dhe në qoftë se ky Kuvend nuk brengoset për këtë situatë nuk e di kush brengoset. Unë pajtohem, EULEX-i duhet gradualisht ta zvogëlojë pranimin dhe të shkojë. Por, kur të shkojë?

Kush do t'i trajtojë këto probleme, ju lutem? Këtë çështje duhet ta shtrojmë dhe mendoj se duhet të shohim pse e kemi një situatë, pse nuk kemi efektivitet më të madh? Këtu e kemi ministrin, të cilin e respektoj, edhe zëvendëskryeministrin, por në qoftë se mjetet transferohen nga një institucion i thirrur për ta luftuar korrupsionin, 1,4 milion transferohen prej llogarisë së tij dhe ende s'mund të gjenden ku kanë shkuar ato mjete tash e gati 1 vit. Ju lutem! Aty është edhe EULEX-i, natyrisht.

Edhe EULEX-it po i shtroj pyetje, por edhe ministrisë, edhe të gjithëve. Atëherë si do të gjenden rastet e tjera të korrupsionit që janë shumë më të komplikuar, shumë më problematike. Prandaj, elementare është gatishmëria jonë politike që ta luftojmë krimin në shoqëri, krimin politik edhe ekonomik, por krimet e luftës janë një kapitull të cilin nuk e kemi trajtuar dhe duhet të trajtojmë.

Edhe Gjini tha se janë probleme shumë të mëdha që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës edhe kryesisht në dëm të shqiptarëve. Prandaj, duhet të shihet që po ndiqen ata që i kanë bërë gjithë ato vrasje, gjithë ato djegie, gjithë ato dhunime. Duhet të shihet që po luftohen. Natyrisht, Gjykata e Hagës i ka dënuar ata që i kanë krijuar politikat e kësaj situatë. Nuk është marrë me ata që i kanë ekzekutuar në terren shumë në Kosovë këto punë. Por, për këto gjëra duhet të organizohemi dhe të gjejmë zgjidhje për to.

Fundi i fundit, zgjidhje duhet të gjejmë. Pse të mos shtrohet ky problem edhe në bisedimet në Bruksel. Kush i bëri gjithë ato djegie? Kush i dërgoi trupat në lumenjtë e Tisës e Savës atje? Edhe Serbia, në qoftë se do të bëhet, duhet të shprehë gatishmërinë për ta luftuar, të shprehë bashkëpunim me Kosovën për t'i sjellë ata kriminelë për t'u gjykuar këtu, ose prej EULEX-it, ose prej gjyqtarëve të Kosovës.

Pse të mos jetë kjo temë e Brukselit? Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Pa dyshim që ky debat që sot është shtruar në Kuvend është një debat shumë serioz, i cili e kërkon një përgjegjësi të debatit dhe një përkushtim. Me pamje në sallë nuk po shihet që ne e kemi marrë seriozisht, sepse me 30 deputetë të zhvillosh një debat kaq të rëndësishëm vërtet është joserioze.

Çështja e parë që dua ta ngre është çështja që misioni i EULEX-it nuk është i imponuar Kosovës, por është një mision i thirrur nga Republika e Kosovës në momentin e shpalljes së pavarësisë dhe një mision i cili ka pasur për detyrë ta ndihmojë Republikën e Kosovës në vitet e para të shtetkrijimit në avancimin dhe ngritjen e standardeve të sundimit të ligjit.

Pritjet e popullit të Kosovës kanë qenë që në periudhën e pasluftës, në kohën kur gjyqësia nuk është rindërtuar, në kohën kur nuk janë zbuluar shumë krime të luftës dhe dukuri negative, ky mision do të vendosë standarde të larta evropiane, të cilat më vonë do të bëhen pronë e Republikës së Kosovës. Pra, kemi pasur tri lloj pritjesh prej këtij misioni:

E para, që ky mision të ndihmojë në luftimin e krimeve të luftës dhe formave të tjera të kriminalitetit derisa të konsolidohet plotësisht sistemi i pavarur gjyqësor i Republikës së Kosovës.

E dyta, të aplikojë dhe të sjellë në Kosovë praktikën më të mira evropiane në sferën e sundimit të ligjit dhe

E treta, ta aftësojë sistemin tonë gjyqësor që t'i marrë në pronësi këto praktika dhe në momentin kur tërhiqet misioni i EULEX-it këto praktika të mira të implementohen nga sistemi i pavarur gjyqësor i Republikës së Kosovës.

Nuk dua tani të flas për të gjitha dimensionet e veprimit të këtij misioni, sepse ky mision e ka pasur një mandat të gjerë, por do të flas vetëm në një segment të luftimit të krimeve të luftës dhe në fund do të ndalem te disa opinione të mia, që mund të shërbejnë edhe si motiv për rekomandimet e kësaj seance.

Ka qenë krejt e natyrshme që ky mision pas ardhjes në Kosovë të merret me gjykimin e krimeve të luftës, duke qenë se ne s'kemi pasur gjyqtarë dhe prokurorë të aftësuar për këtë lëmi. Kosova ka pasur përvojë me çështjet e krimeve të luftës për faktin që ne e kemi treguar një shembull më të mirë të përgjigjes së drejtësisë ndërkombëtare dhe dihet se Kosova ka qenë një rast ndër më të mirët në territorin e ish-Jugosllavisë sa i përket bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës dhe është vërtetuar në Tribunalin e Hagës që lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë dhe është treguar që kjo luftë ka qenë çlirimtare.

Ajo që është brengosëse në veprimet e EULEX-it nuk e ka identifikuar mirë autorësinë e krimeve të luftës dhe shpeshherë proceset e filluara nga ky mision kanë qenë selektive. Është krijuar përshtypja që kemi drejtësi selektive, sepse nuk kemi parë gjykimin dhe luftimin e kriminelëve të luftës, të autorëve të gjenocidit, qoftë të atyre lokalë, qoftë të atyre që kanë qenë pjesë e armatës dhe forcave paramilitare jugosllave.

Kështu që jo rrallë në opinion është krijuar një përshtypje që nëpërmjet disa proceseve dëshirohet të bëhet një ekuilibër, një balancim ndërmjet atyre që kanë shkaktuar krime dhe atyre që kanë qenë viktimë e këtyre krimeve. Natyrisht, Kuvendit nuk i takon që të diskutojë për eset konkrete, sidomos proceset në zhvillim, sepse kjo do të ishte një ndërhyrje kushtetuese në Gygësor, por në opinion publik kritikët e EULEX-it e kanë pikërisht këtë çështje që po gjykohen vetëm shqiptarët, e nuk po gjykohen kriminelët e vërtetë të luftës, as që po hapen procese ndaj tyre.

Momenti i dytë ndoshta dekurajues i këtij misioni ka qenë mosveprimi i këtij niveli dhe tolerimi i gjatë i krimeve shumëdimensionale dhe mosrealizimi i mandatit legal dhe kushtetues që të mundësojë që atje të vendosen rendi dhe ligji dhe të gjitha format e kriminalitetit të luftohen.

Natyrisht, sa u përket dukurive tjera negative që u përmendën me të drejtë këtu, korrupsioni dhe fenomenet tjera, EULEX-i ka bërë disa përpjeke, por këto dukuri negative janë shfaqur në Kosovë dhe do të luftohen nga gjyqtarë dhe prokurorë kosovarë dhe një ditë kur të shkojë, EULEX-i të mund të thotë “ne bëmë përpjekje që të ju lirojmë nga dukuritë negative, ju nuk deshët dhe tani urdhëroni, jetoni me to, sepse në vendin tonë këto gjëra i kemi spastruar”, dhe nuk duhet ta kuptojmë këtë çështje jashtëzakonisht mirë.

Dy momente finale që dua t'i diskutoj: EULEX-i është partner i Kosovës, është partner i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës i ka koordinuar të gjitha aktivitetet në sundimin e ligjit bashkë me EULEX-in edhe nëpërmjet mekanizmave të krijuar, sidomos nëpërmjet bordit të sundimit të ligjit, dhe mendoj se Kuvendit i takonte këtë debat. Kuvendit i takon ta marrë një vendim çfarë e kemi marrë vendimin

për vazhdim. Ndoshta duhet ta marrim vendimin edhe për përfundimin e mandatit. Por, faktori kyç në proceset e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe EULEX-it është Qeveria e Kosovës, e cila duhet t'i koordinojë aktivitetet dhe duhet të arrijë marrëveshje me EULEX-in, qoftë me bordin e sundimit të ligjit, qoftë në format tjera, në mënyrë që të përcaktohet një agjendë e qartë e tranzicionit të këtij misioni, e kalimit të kompetencave, eventualisht e riformatizimit të këtij misioni karshi marrëveshjes së re ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në qoftë se për këtë edhe parashihet.

Sepse, EULEX-i nuk e ka problem që t'i kalojë kompetencat te vendorët, por ne duhet të sigurohemi që institucionet tona të sistemit të drejtësisë janë aftësuar për t'i marrë dhe për t'i menaxhuar këto kompetenca dhe për t'i marrë përgjegjësitë, që deri tash kanë qenë të EULEX-it.

Kështu që unë mendoj që ne duhet të jemi shumë të vetëdijshëm për kapacitetet e këtij debati, ku kishte jashtëzakonisht qasje e mirë e kryetarit të grupit parlamentar, që u tërhoq nga rezoluta, sepse ne nuk duam rekomandime dhe rezoluta që nuk janë konsensuale.

Çështja e EULEX-it është një çështje shtetërore, një çështje e raporteve tona shtetërore, që është e lidhur pak edhe me procesin e integriteteve evropiane. Angazhohem që konkluzionet të jenë jashtëzakonisht racionale, jo emotive dhe t'i reflektojnë interesat e Republikës së Kosovës karshi marrjes së kompetencave nga EULEX-i, përgatitjes dhe aftësimit për menaxhimin e atyre kompetencave.

Unë po dëgjoj këtu debate "...të krijohet një gjykatë për krime të luftës". Kuvendi nuk ka kapacitete ta bëjë këtë. Është detyrë e Qeverisë, e Ministrisë së Drejtësisë që ta shqyrtojë mundësinë e formimit të një kolegji apo paneli brenda sistemit ekzistues të gjykatave, për gjykimin e krimeve të luftës dhe mendoj që kjo përgjegjësi duhet të merret dhe duhet të ushtrohet, sepse praktika ka treguar se vetëm kur institucionet e Kosovës mvëshen me kompetenca, me përgjegjësi, ato janë më efikase dhe më të përgjegjshme në kryerjen e detyrave të tyre.

Kështu që ne duhet të jemi të qartë se duhet të jemi jashtëzakonisht si shtet të përgatitur për këtë drejtësi tranzicionale. Është lehtë të kërkojmë marrjen e kompetencave ekzekutive të EULEX-it, por është sfidë që të krijosh mekanizma të qëndrueshëm, që do të mundësojnë sundimin e ligjit, që do ta krijojnë një sistem të gjyqësisë të pavarur, që do ta krijojnë një sistem me standarde të larta evropiane për shkak se edhe integrimi ynë në Bashkimin Evropian është i lidhur shumë me parimin e sundimit të ligjit, me faktin se sa ne kemi një Gjyqësor efikas të pavarur dhe profesional dhe ne duhet të jemi koshientë se kjo është një sfidë e Republikës së Kosovës, me të cilën duhet të ballafaqohemi.

Thjeshtë, unë mendoj se debati duhet të lirohet nga qasjet emotive dhe emocionale. Kritikë që ne i kemi duhet të shqyrtohen shumë realisht. Është jashtëzakonisht shqetësuese në qoftë se dëgjon që ende ka disa procese gjyqësore, që po zhvillohen me legjislacionin jugosllav. Atëherë, çfarë na duhet legjislacioni jugosllav, në qoftë se ne kemi përshëndetur ligjin aplikativ dhe në qoftë se sot ligj aplikativ është Kodi Penal,

Kodi i Procedurës Penale, konventat evropiane. Pa marrë parasysh se mund të ketë fjalë se “jo, janë nisur proceset në kohën kur s’ka pasur Kod Penal”, në drejtësinë penale ekziston parimi i veprimit retroaktiv të ligjit penal më të favorshëm, kështu që mendoj se këto devijime që ka pasur në veprimin e EULEX-it duhet të diskutohen aty ku është vendi.

Duhet të diskutohen në mekanizmin e Qeverisë së Kosovës, në Bordin e sundimit të ligjit, të ngrihen këto vërejtje, të ngrihen këto çështje dhe eventualisht të kërkohen rishikime, sidomos rishikime sa i përket legjislationit, sepse tani Kosova e ka kodifikuar plotësisht legjislationin penal dhe, në anën tjetër, siç dihet, edhe konventat evropiane në Kosovë kanë zbatim të drejtpërdrejtë dhe nuk ka nevojë për recidivat e së kaluarës, sidomos për proceset të cilat shpeshherë asociohen edhe në motive tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre Çitaku,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fillim të them se do të tentoj t’i paraqes qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë temë të sotme, por po ashtu besoj që të gjithë ne në këtë sallë, po ashtu edhe Qeveria e Kosovës është e bindur, që debati i sotëm nuk do të kontribuojë në ndërhyrje në drejtësi, por si punë dhe obligim që e ka Qeveria e Kosovës si organ ekzekutiv për ta ndihmuar drejtësinë, si punë dhe obligim që ka Kuvendi i Kosovës, si organ legjislativ, për ta ndihmuar drejtësinë, e jo për të penguar apo për të ndërhyrë në institucionet e drejtësisë.

Më lejoni po ashtu të them kur kemi të bëjmë me çështje që ka të bëjnë me EULEX-in dhe me çështje në tërësi që kanë të bëjnë me BE-në, duhet t’i kemi parasysh dy auditoriume. Auditoriumi i parë, pa dilemë që është Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili e ka shprehur vullnetin e vet edhe me shkëmbimin e letrës si vitin e kaluar për misionin e EULEX-it, por natyrisht që e ka shprehur dhe e ka mandatin e plotë që përfaqësuesit e saj të shprehin edhe çështje që kanë të bëjnë me sovranitetin e Republikës së Kosovës, kuptimin e asaj që lidhet me nenin 20 të Kushtetutës së Kosovës.

Por, të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që e kemi edhe një auditorium tjetër, që janë 28 shtete anëtare të BE-së, të cilat tanimë e kanë dhënë pëlqimin për misionin e EULEX-it në Kosovë dhe të cilat tani besoj se jo vetëm që kemi një të kaluar deri më tani të përbashkët, por mbi të gjitha e kemi një aspiratë për anëtarësim dhe për respektim të atyre kritereve, që ne duhet t’i bëjmë për t’u anëtarësuar në BE.

Ne kemi thënë shpeshherë që kahja e këtij debati është në atë drejtim. E drejta sovrane e një shteti sikur është Kosova për ta ushtruar sovranitetin e tij të plotë në të gjitha

segmentet, përfshirë edhe segmentin e rendit dhe ligjit dhe, në anën tjetër, nevoja jonë që ta kemi një mandat, një ekspertizë edhe të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë.

Por, ajo çka dua të them dhe me siguri do ta përfundoj po ashtu me këtë fjali: EULEX-i në Kosovë ka ardhur me marrëveshje me ne dhe EULEX-i nga Kosova duhet të shkojë në marrëveshje me ne. Çka i bie kjo? Që as nuk duhet ata njëanshëm të marrin veprime që na befasojnë ne, por e njëjta duhet të jetë edhe me ne, që të mos i befasojmë ata, ngase nuk do të ishte mirë për veprime të tilla, ku njëra palë pastaj do të ishte palë e kundërshtuar në veprimet që mund t'i bëjmë.

Ne edhe ditën që përfundon mandati i EULEX-it në Kosovë do të jemi prapë në koordinim me Brukselin, prapë do të jemi në takim edhe në çështjet tjera që kërkojnë. Natyrisht debatet nuk duhet të jenë me inercion. Unë e di që kjo nuk u pëlqen shumë njerëzve këtu. Debatet duhet të jenë me një parim dhe shtrirjen e parimeve, që e dëgjova këtu me shumë vëmendje.

Ne kemi nevojë që t'i ngremë kapacitetet për rend dhe ligj. Në këtë drejtim duhet pamohueshëm ta falënderojmë edhe UNMIK-un për një pjesë që w ka ndihmuar Kosovën, po edhe EULEX-in në këtë drejtim. Po, në anën tjetër, edhe vetë qëllimi i atyre që na kanë ndihmuar t'i ngremë kapacitetet për rend dhe ligj, ka qenë që një ditë të jemi të pavarur plotësisht, ta ushtrojmë kompetencën për rend dhe ligj.

Dhe, në këtë drejtim, unë besoj që e kemi ndërtuar një strukturë të mirë institucionale dhe një bazë të fortë legale. Çka kemi nevojë edhe më shumë? Duhet që t'i ngremë kapacitetet njerëzore. U përmend edhe nga profesor Mustafa, edhe profesor Bajrami dhe të tjerët. Unë po them se Qeveria e Kosovës i ka kryer obligimet përballë drejtësisë. Dhe, e them këtë me bindje të plotë. Në çka i ka kryer obligimet?

Tri gjëra:

- E para, e kemi ndërtuar një bazë të fortë legale, gjyqtarët në Republikën e Kosovës asnjëherë me ligje nuk kanë qenë më të fuqishëm se sot, në asnjë kohë.

- E dyta, kemi bërë një strukturim të plotë të organizimit të gjykatave në Kosovë, duke përfshirë që nga niveli i gjykatave apo degëve të gjykatave themelore, e deri te ajo Supreme, dhe e kemi dhënë mundësinë edhe për çështje alternative dhe për zgjidhje të problemeve të tilla.

- Dhe, e treta, kemi ndihmuar procesin që ka të bëjë me fuqizimin e kapaciteteve njerëzore.

Dhe, sot, për herë të parë në Republikën e Kosovës, apo në këtë vend, prejse ka pasur drejtësi gjyqtarët i kanë dy përparësi:

- e para, e kanë pagën në nivel të ministrit dhe më shumë, që s'e kanë pasur në asnjë kohë, dhe

- e dyta, e kanë mandatin e përhershëm, pas mandatit provues prej tre vjetëve, që është një garanci e plotë për pavarësinë e tyre të plotë në punën dhe vendimmarrjen.

Dhe, unë besoj që kjo është fuqia e tyre. Tani, çfarë duhet të bëjmë? Ne duhet t'i ngremë kapacitetet dhe duhet ta bindim paralelisht edhe EULEX-in dhe të tjerët. Me ngritjen e kapaciteteve tona gjërat duhet të shkojnë në mënyrë proporcionale. Ne i ngremë kapacitetet, ata duhet ta zvogëlojnë praninë në Kosovë.

Dhe, fuqizimi ynë i plotë duhet të nënkuptojë përfundimin e mandatit të EULEX-it dhe në këtë drejtim besoj gjithnjë duhet të jemi të orientuar.

Janë dy çështje që ndeshen, e thashë edhe në fillim, çështja e sovranitetit, për të cilën ne jemi shumë të nxituar, jemi të gatshëm, jemi të përkushtuar që ta ushtrojmë në mënyrë të plotë, dhe çështjen e ekspertizës, që na është dashur dhe mund të na duhet edhe për një kohë, por e gjithë kjo mendoj deri në qershorin e vitit 2014.

Shumë shkurt, ta bëjmë në mënyrë praktike për çështjet më praktike. Kjo i bie sikur në spitalet tona. Ne kemi nevojë edhe për mjekë të huaj, jo për mjekë që çelin ordinancat të veta, por për mjekë që punojnë brenda ordinancave tona. Në këtë drejtim, ne kemi nevojë për ekspertë evropianë, që punojnë brenda sistemit tonë.

Ne e kemi sot momentalisht Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, që janë të pavarur plotësisht, edhe nga ju, edhe nga ministria dhe nga Qeveria dhe të gjithë. Por, e kemi EULEX-in që është i pavarur edhe nga ata. Dhe, në këtë duhet ta kemi parasysh, si është çështja e hierarkisë së organizimit të këtyre veprimeve.

U përmend shumë çështja e gjykatave dhe e departamenteve të ndryshme. Qysh në vitin 2011 dhe 2012, edhe tani kemi afruar apo kemi dhënë një plan të përditësuar - po e quaj kështu, i është dorëzuar nga kryeministri edhe zonjës Eshton, natyrisht në konsultim me zotën Mustafa dhe me zotën Haradinaj, dhe besoj që ky plan, unë dje kam pasur takim në Bruksel mu atë, dhe jemi në negociatë, në biseda me përfaqësuesit e BE-së se si të bëjmë një tranzicion të tillë.

Çështja e departamentit të tillë, ne e kemi propozuar një departament, e kemi quajtur për krime serioze. Mund t'i vëmë emrin edhe ndryshe, që duhet t'i ketë 5 kompetenca. E para ka të bëjë me atë që do të themelohet Gjykata Themelore e Prishtinës, e para ka të bëjë me korrupsionin e nivelit të lartë, e dyta me krimin e organizuar, e treta me shpëlarjen parave, e katërta me terrorizmin dhe e pesta me krimet e luftës. Dhe, mendoj që këtu duhet 'i bartim këto kompetenca në një departament të tillë, të përafërt me vendet e tjera.

Ne e dimë se në Kosovë, gjykimi i krimeve të luftës është perceptim i rëndë. Pse? Se te ne po ndodh vetëm ndaj shqiptarëve dhe arsyeja kryesore është kjo: me ligjet tona, gjykimi në mungesë, është i ndaluar, por kjo nuk e pengon prokurorinë tonë që të ngrejë aktakuzë, kjo nuk i pengon qytetarët tanë që të bashkëpunojnë me drejtësi dhe kjo nuk i

pengon institucionet tona, kur kanë dokumente të tilla, të kërkojnë nga Interpoli, pastaj dhe nëpërmjet presionit ndërkombëtar edhe nga Serbia që personat e tillë të gjykohen.

Çdo veprim që e bëjmë ne, duhet ta kemi parasysh që të mos kem hendek në drejtësi dhe nuk do ta bëjmë një lëvizje prej pikës a) në pikën b) pa qenë të sigurt që do t'i plotësojnë. Ka shumë njerëz që shprehën skepticizëm për gjyqtarët dhe prokurorët tanë. Unë besoj te ata dhe e di se të gjithë nuk janë ata që mund ta kryejnë punën me kompetencë, por dhjetë veta, dhjetë gjyqtarë të guximshëm, profesionistë të paanshëm, e jam i bindur se 10 prokurorë do ta ndryshojnë imazhin e drejtësisë në vendin tonë dhe Kosova ka njerëz të tillë. Unë jam i bindur që ka.

Por, tani për çka bëhet pyetja: A duhet t'i mësojmë, fjala popullore thotë, t'i mësojmë not pa hyrë në ujë, apo duhet t'i vëmë pak brenda ujit dhe pastaj të mësohen. Unë jam ithtar i kësaj së dytës. T'u japim përgjegjësi, t'i vëmë në vijën e parë të frontit, të merren me raste të rënda, të merren me përgjegjësitë e tyre, dhe pastaj ta tregojnë guximin e tyre për të marrë përgjegjësi dhe nuk e ndiej veten mirë kur përfaqësuesit e haj më thonë: Shikoni, ne do të jemi të gatshëm të bartim kompetenca, por njerëzit tuaj janë paksa të hezituar. Unë e di që ka prokurorë që mund të bëjnë gjëra të tilla dhe unë i ftoj, u jap mbështetjen e plotë, bashkë me ju besoj, për një guxim të tillë qytetar.

Ata nuk do të bëjnë asgjë tjetër, vetëm do t'i zbatojnë ligjet e Kuvendit të Kosovës, ligjet e popullit të Kosovës. Në këtë drejtim, do ta kenë mbështetje e të gjithë neve.

Natyrisht që ne duhet të kemi parasysh që e kemi një proces bashkë me BE-në, që dialogu i strukturuar për rend dhe ligj, dhe unë jam i bindur që këtë dialog duhet ta shkrijmë - misionin e EULEX-it në këtë dialog. Dialogu i strukturuar për rend dhe ligj nënkupton edhe plotësimin e kushteve në fushën e rendit dhe ligjit me të gjithë ata që ne kemi pasur. Më lejoni, krejt në fund, ta marrë një konstatim nga zoti Ahtisari, që ka thënë për misionet e huaja. Në fillim ka thënë: "Misionet e huaja janë sikur cigarja, ju qetësojnë pak, por i harroni veprimet anësore dëmet që i bëjnë, dhe më vonë bëheni të varur nga ato".

Ne të fillojmë të mendojmë kështu: misionet e huaja janë të përkohshme. Institucionet tona duhet të jenë të përhershme dhe t'i marrin përgjegjësitë që duhet t'i kenë.

Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Kosovës, do t'i kryejë të gjitha obligimet e veta në këtë drejtim. Natyrisht, po e them do ta përfundojmë misionin e EULEX-it dhe duhet ta përfundojmë dhe duhet të jemi sikur të gjitha shtetet tjera sovrane, shtetet tjera përreth nesh. Kemi kapacitete për aq, por gjithë kjo duhet të ndodhë me mirëkuptim, me plotësim të aktiviteteve tona, por mbi të gjitha me një marrëveshje. Sikur e kemi përfunduar pavarësinë e mbikëqyrur me marrëveshje, do ta përfundojmë edhe misionin e EULEX-it me marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zëvendëskryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Domosdoshmëria e mbajtjes së këtij rendi të ditës ose thjesht trajtimi i kësaj çështjeje është më se e domosdoshme dhe duhet të na bëjë të mendojmë seriozisht se çka është duke ndodhur dhe cilat do të jenë pasojat afatgjate për vendin, nëse ne nuk veprojmë me kohë.

Pas arrestimit të 7 pjesëtarëve të UÇK-së nga zona e Drenicës, për më tepër se 2 muaj është spekuluar aq shumë në të gjitha mjetet e mundshme të komunikimit, duke filluar nga bisedat familjare, kafeteritë, forumet e ndryshme, analistë e pseudoanalistë, mediet e varura e të pavarura, personalitet kombëtare ndërkombëtare dhe të gjithë kjo ka krijuar më shumë konfuzion sesa e ka dhënë ndonjë sqarim.

Jo rrallë edhe ne deputetët e këtij Kuvendi u kritikuan deri në fyerje se ne qenkemi fajtorë, sepse ne i dhamë mandat misionit të BE-së, prandaj nuk kemi të drejtë tani as të bëjmë zë. Kjo qasje ndaj nesh nuk është aspak e drejtë. Ne deputetët ia dhamë mandatin, sepse besuam se EULEX-i është me të vërtetë i interesuar ta forcojë Gjyqësorin në vendin tonë, sferë kjo që jo rrallë quhet Thembra e Akilit në sistemin institucional të Kosovës.

Por, është e vërtetë që ne shpesh edhe heshtëm me të gjitha metodat suspekte që përdornin si arrestime mediale, paraqitje tendencioze e provokative e disa zyrtarëve të huaj dhe ndërhyrja e tyre vend e pa vend. Ne heshtëm duke besuar në pastërtinë e veprimeve dhe në disa raste edhe me vetë dëshirën e personave që sulmoheshin. Ne çdoherë jemi të besojmë në rezultatet e mirëfillta. Besonim se ne duhet të jemi në disa raste më tolerantë dhe së bashku t'i tejkalojmë edhe këto kohë akuzash të pavend.

Realiteti po tregon për çdo ditë se toleranca jonë ishte më e dëmshme sesa na solli dobi. Tolerancën tonë shumë nga zyrtarët ndërkombëtarë e kuptuan si dobësi tonën. Mikpritjen tonë e vlerësuan si naivitet, heshtjen tonë si padituri dhe frikë. Asnjëra nga këto nuk qëndron. Ka ardhur koha që këtë ta kuptojnë edhe miqtë tanë evropianë.

Ne shpresuam se vetë dërguesi i EULEX-it, pra Bashkimi Evropian, do të ndërhyjë në disiplinimin e personave si duket jo edhe aq të kualifikuar që dërgonte në Kosovë. Mirëpo, vazhdimi i avazeve të vjetra, për fat të keq, po e përforcon atë klisenë që dëgjohet shpesh nëpër Kosovë, e që thotë: “Po të ishin të zotët në profesionet e veta, do të punonin në vendin e tyre dhe të zotët nuk na i dërgojnë neve”.

Kjo klishe nuk është mirë të bëhet realitet. Këtë duhet ta dijë Bashkimi Evropian. Nëse lejohen lloj-lloj veprimesh, vetëm që ta kenë një arsye për qëndrimin e tyre në vendin tonë, atëherë kjo patjetër do të rezultojë me tensione të natyrave të ndryshme, kurse tensionet e çfarëdo natyre i duhen më së paku këtij vendi dhe këtij populli.

Për ta arsyetuar këtë që e thashë, më lejoni të përmend vetëm disa raste tanimë të njohura për opinionin e gjerë. Rasti “Kiçina” - rrjedha e këtij procesi jo që ishte vetëm

skandaloze, por në shumë raste dhe e kundërligjshme. As sot e kësaj dite nuk është e sigurt nëse dënimin e vuan vrasësi i vërtetë. Këtu thurja e aktakuzës ishte më e fortë se e mbrojtjes dhe kjo mjaftoi ta merrte vendimin. Dikush duhej të dënohej dhe u dënua, por se a ka shkuar këtu drejtësia në vend, mbetet një pikëpyetje shumë e madhe.

Rasti “Klečka” - ky rast filloj me një racia mediatike, me propagandë të tmerrshme mediale. Ndërthurja e krimeve të luftës me krimet e ekonomike shkaktoi një konfuzion të madh te qytetarët e vendit tonë. Pakëm vetë zyrtarët e EULEX-it, të cilët deklarorin se po planifikohej një kurth dhe se prokurorët do të shpiknin fakte, nëse ato do t’u mundonin. Rrjedha e këtij procesi është jo vetëm jashtëligjore, por edhe jo njerëzore. Strategjia e tij është një përpjekje për denigrimin e emrit të një personi të respektuar dhe të çmuar në Kosovë.

Ne të gjithë duhet të jemi për sanksionimin e çdo keqpërdorimi të parasë publike, por fjalët e bujshme të aktakuzës për gjëja keqpërdorimin e 80 milionë eurove, e tani kanë rënë më pak se 280 mijë euro, si arsyetohet një devijim kaq i lartë? Kush është përgjegjës që njeriu të fajësohet për një shumë kaq marramendëse, në një kohë të vështirë sociale për vendin tonë?

Me të drejtë, shtrohet pyetja: Ishte ky një spektakël i qëllimshëm për denigrim, pastaj paralelisht me këtë Fatmir Limaj, i cili nga Gjykata e Hagës është shpallur plotësisht i pafajshëm, akuzohet për krime të luftës apo kundër njerëzimit? Quajeni si të doni. Dhe, kjo bëhet me metoda dhe me dëshmitarë shumë të dyshimtë. Maltretimi i dëshmitarëve, bazuar në raportet mediale, është bërë jo nga të akuzuarit, por nga vetë akuzuesit për atë se si u rekrutuan dhe çfarë ndodhi me dëshmitarët duhet të kërkohet llogari tek ata të cilët e morën përgjegjësinë mbi ta.

Në këtë rast duhet patjetër të formohet një komision i veçantë për të sqaruar se çka ndodhi me dëshmitarin X. Edhe deklarata e dëshmitarit të fundit, i cili vullnetarisht e zbuloi identitetin e tij dhe e akuzoi prokurorin për shantazh, duhet patjetër që të hetohet.

Aktakuzat e tjera, të ngrehura nga Gjykata e Hagës, kanë rezultuar po ashtu si të pabaza. Megjithatë, shumë persona u privuan nga liria me vite të tëra, prandaj shtrohet pyetja: A verifikohet paraprakisht kur dikush raporton për gjoja të bërat e disa personaliteteve në Kosovë, apo mjafton të shkojë dikush dhe të thotë se ai apo ajo e ka bërë këtë apo atë?

Dënimi i pjesëtarëve të UÇK-së nga rajoni i Llapit është edhe një rast tjetër i cili kërkon rishqyrtim. Tani së fundmi arrestimi i të ashtuquajturit ‘Grupi i Drenicës’, themeltarëve të UÇK-së, pa ngritur aktakuzë, vetëm në bazë të dyshimeve të disa personave tendenciozë, të cilët mendojnë se e kanë gjetur formën më të mirë për të jetuar në ndonjë vend tjetër të preferuar evropian dhe të garantuar nga autoritetet e caktuara apo nga personat , si prokurori italian, Mauricio Salustro.

Spekulimet lidhur me këto dyshime, mosdeklarimi konkret i personave përgjegjës dhe lënia e krijimit të një opinionit denigrues në dyshime për gjërat të cilat janë në kundërshtim të plotë me historinë dhe traditën tonë, lënë të dyshojmë se prapa kësaj

qëndron një skenar i caktuar, kurse çdo shprehje e solidarizimit me ta u quajt pa të drejtë ndërhyrje në drejtësi.

Askush nuk ndërhyri në procesin e drejtësisë, askush nuk ishte dhe nuk është kundër drejtësisë. Për çfarë drejtësie bëhet fjalë? Kjo është esenca. Dua të sqaroj për opinionin se asnjëri nga 7 të akuzuarit nuk akuzohet për dhunime apo për krime ekonomike. Personat përgjegjës duhet ta sqarojnë opinionin rreth pikave të aktakuzës, e jo të lejohet që të akuzuarit t'i ofrojnë opinionit për linçim publik, pa u marrë në konsideratë familjet e tyre, të cilave ende nuk u janë shëruar plagët e luftës.

Është e vërtetë se ne e pranuar dhe i dhamë mandat EULEX-it, e toleruam, dhe kjo vetëm për hir të besimit të plotë në pafajësinë e tyre, në pastërtinë e luftës së tyre dhe të besimit në drejtësinë ndërkombëtare. Tani kur çdo ditë jemi dëshmitarë se nga EULEX-i është duke u instaluar, apo duke u zbatuar drejtësia e të fortit, askush, as brenda dhe as jashtë vendit, nuk ka të drejtë të na akuzojë se pse po e ngremë zërin.

Ne i dhamë mandatin dhe ne kemi të drejtë ta ngremë zërin sa herë që gjërat të marrin kah të rrezikshëm për shoqërinë.

Nuk e di pse për dikë është kaq e pakuptueshme që nëse një vendim i Parlamentit rezulton si jo pozitiv, atëherë ekziston mundësia për revidim. Ne ia dhamë mandatin, por ne duhet të shikojmë nëse ky besim nuk po keqpërdoret. Vetë emërtimi që po bëhet në grup, është synim i anonimitetit të personave që po maltreohen tash e 15 vjet. Nuk ka grup, por janë heronj të gjallë, që e rrezikuan jetën e tyre për lirinë tonë. 'Grupi i Drenicës' nuk është diçka abstrakt. Ky grup është: Sylejman Selimi, komandant suprem i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, komandant i TMK-së dhe më vonë i FSK-së, aktualisht ambasador i Republikës të Kosovës në Tiranë;

Sami Lushtaku, bashkëthemelues i UÇK-së, komandant i Zonës së Drenicës, komandant i Zonës së Drenicës, komandant i TMK-së, Zona e Parë, komandant i Zonës së Dytë në Prizren, aktualisht kryetar i Komunës së Skenderajt, kryetari më i votuar në Kosovë;

Sahit Jashari, bashkëthemelues i UÇK-së, anëtar i familjes së gjerë Jashari, duke rezistuar, humbi në pragun e derës 15 anëtarë të familjes nga mosha 20 deri në 65-vjeçare;

Jahir Demaku, gjeneral i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kolonel në FSK, dhe Zeqir Demaku, familje patriotësh, luftëtarë të denjë për liri, i dhanë Kosovës 6 anëtarë të familjes, 4 prej tyre dëshmorë;

Hysni Thaçi, Avni Zabeli, ushtarë të UÇK-së dhe kontribuues të denjë të lirisë, që ne e gëzojmë sot. Të mos ndalem t'i përmend të gjithë emrat e ushtarëve të UÇK-së që sot qëndrojnë nëpër burgjet e Kosovës.

Ndaj të gjithë këtyre që i përmenda deri më tani, por edhe atyre që nuk ua përmenda emrat, deri tani u ngrehën akuza më shumë spekulative se sa faktike dhe u denigruan

udhëheqësit e luftës nga të gjitha zonat e vendit. E gjithë instanca komanduese e Ushtrisë Çlirimtare është në këto hetime të pabaza. Në anën tjetër, bota do t'i harrojë krimet serbe ndaj popullatës shqiptare duke propaganduar pajtim fals.

Mirë, ne jemi për pajtim, por a nuk duhet që kësaj t'i paraprijë kërkim-falja. Ata që na dogjën dhe me shekuj shkelën mbi dinjitetin tonë, nuk kërkojnë falje dhe as që duan t'ia dinë për këtë, por as Evropa nuk dëshiron seriozisht të merret me një gjë të tillë. Po ndodh krejtësisht e kundërta, veprimet e misionit evropian na kthejnë 15 vjet prapa, sepse nuk kemi harruar që deri me kyçjen e SHBA-ve në luftërat e ish-Jugosllavisë, nga Evropa quheshim terroristë.

Ky opinion, si duket, ende frymon në Evropë. Në çdo hap na kushtëzojnë me vlera evropiane, me integritet. Asnjëra dhe as tjetra nuk janë duke ecur me tempon e duhur. Për më tepër, me këto veprime, Evropa rrezikon ta minojë argumentin e saj më të fortë për intervenimet euroatlantike.

Në fund, dua të sqaroj për gjithë opinionin, askush në Kosovë, askush në PDK, dhe as unë personalisht nuk jam kundër ligjit dhe drejtësisë, por e dimë se drejtësia e të fortit nuk është drejtësi. Mbajtja në arrest pa asnjë argument nuk është drejtësi, prandaj kërkojmë që këta burra të mbrohen në liri. Demonstrimi i forcës së këtij misioni nuk guxon të jetë arsye të privohen nga liria. Kjo kërkohet asgjë më tepër, as më pak, e as më shumë.

Nëse me këto veprime Salustro me shokë ka arritur diçka, atëherë kjo e arritur e tyre është humbja e besimit në këtë mision që tatimpaguesve të Evropës është duke u kushtuar shumë dhe, edhe atëherë kur ndoshta do të kenë të drejtë, megjithatë, gjithmonë do të mbizotërojnë dyshimi i fortë për manipulime e shantazhe nga prokurorët prepotentë të këtij misioni.

Salustro me njerëz të llojit të tij i ka ofenduar ata që e paguajnë, i ka ofenduar qytetarët e Evropës. Salustro me njerëz të llojit të tillë e ka ofenduar popullin e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë!

GANIMETE MUSLIU: ...historinë dhe traditën tonë. Për fat të keq, rezulton se EULEX-i nuk është gjë tjetër vetëm kontinuitet i UNMIK-ut, i cili nuk do të hyjë në histori si një sukses i angazhimit ndërkombëtar. Të dyja misionet ishin më të mëdhatë, por kjo është dëshmi e vetëm për nga kuantiteti.

Ne urgjentisht duhet të marrim hapa konkretë që ta themelojmë gjykatën tonë për krimet e llojit të tillë dhe të dëshmojmë se ne jemi në gjendje t'i trajtojmë këto raste. Salustron dhe të gjithë ata që me fodullëk vijnë dhe mundohen ta nëpërkëmbin dinjitetin dhe vlerat tona, e kemi për obligim që t'ua kufijtë dhe ti shpallim persona non grata.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar,
Kolegë deputetë,

Ky debat i nevojshëm, u tha edhe nga ata që kanë mendime të ndryshme për rekomandimet apo rezolutën. Edhe ne themi që ky debat është shumë i nevojshëm. Por, ne tani, edhe si deputetë, por edhe ne si grup parlamentar, e kemi një paqartësi se vërtet për çfarë po zhvillohet ky debat për shkak se nuk kemi rekomandime dhe, rrjedhimisht, ne i kontribuojmë debatit, por nuk mund t'u kontribuojmë rekomandimeve, të cilat nuk e dimë cilat janë. Madje, ndër problemet kryesore të mosnëshkrimit tonë të kësaj iniciative kanë qenë pikërisht këto rekomandime.

Ne i patëm disa rekomandime që qarkulluan këtu dhe që, në fund, u tërhoqën nga thirrësi, rekomandime të cilat, pas një debati të mirë, ne do t'i mbështetnim. Por, do të duhej edhe një herë ta kemi të qartë se kujt ia adresojmë këtë debat. Në fakt, EULEX-in në Kosovë e kanë ftuar kryeministri, rrjedhimisht Qeveria, Presidenti, rrjedhimisht Presidenca. Pra, nuk është Kuvendi i Republikës së Kosovës ai i cili e ka ftuar këtë mision në Kosovë, por këtë mision e kanë ftuar Qeveria dhe Presidenca.

Rrjedhimisht, Kuvendi para se të kërkonte t'ia hiqte mandatin EULEX-it, në këtë rast, gjë që nuk ka të drejtë, nuk po mund ta bëjë një gjë të tillë. Do të ishte mirë sikur të mundte dhe ta bënte, por përderisa nuk mund, Kuvendi e ka një mundësi tjetër - t'ia heqë mandatin atij që e ka ftuar EULEX-in. Pra, ose të paktën kësaj Qeverie që i ka dhënë mandat, t'ia kushtëzonte mandatin e saj me mosbesim ose besim në ndërlidhje me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për heqjen e mandatit të EULEX-it.

Normalisht që ne duam dhe kërkojmë drejtësi, duam dhe kërkojmë dënimin e krimeve të luftës, por ky Kuvend, para se t'i dënojë krimet e vërteta të luftës, e bëri një gabim trashanik se ato, fillimisht, një pjesë shumë të madhe prej tyre të krimeve të vërteta të luftës i amnistoi. I njëjti Kuvend e votoi Ligjin për amnisti dhe i njëjti Kuvend sot kërkon, pas amnistisë, kërkon dënimin e krimeve të luftës. Madje, jo vetëm që i amnistoj, por edhe po i shpërblen njerëzit e caktuar, të përfshirë në këto krime lufte të dëshmuar tashmë, edhe me poste policore në strukturën e Policisë së Republikës së Kosovës.

Por, unë dua të kthehem te fillimi i këtij debati.

Ne si deputetë, secili veç e veç, e kemi marrë një kërkesë nga Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Secili në kutitë tuaja e keni pasur një gjë të tillë, e ka pasur edhe thirrësi i kësaj dhe unë shpresoj që pikërisht kjo ka qenë iniciativa ose burimi i iniciativës për këtë debat. Por, ky debat, duhet ta dimë, nëse është rezultat i kësaj ftese të Organizatës të Veteranëve të Luftës të UÇK-së dhe, nëse po, pse nuk është përfshirë, ose pse akoma nuk përfshihet kërkesa kryesore e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e përshkruar në këtë lëndë-kërkesë që ata ua kanë drejtuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe më lejoni të jua lexoj, sepse është shumë e shkurtër:

Lënda: Kërkesë për shikimin e mandatit të EULEX-it.

Kërkojmë nga ju që sipas Ligjit dhe rregulloreve në fuqi, ta merrni iniciativën që ta thirrni sa më shpejt një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, në të cilën do të rishikohej mandati i EULEX-it.

Pra, ata thonë, ne e kërkojmë që mandati ekzekutiv i EULEX-it të ndërpritet menjëherë. Nëse ky është burimi i saj, së paku do të duhej kjo bazë të merrej dhe të përfshihej në rekomandimet në fund me rekomandimet që dalin nga ky debat.

Edhe një gjë duhet ta kemi parasysh për shkak se kanë qarkulluar edhe këtu në ambientet e Kuvendit, edhe në familjet e të arrestuarve të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantëve, që lidhur me të drejtat e deputetëve për të pasur në Kuvend. Të mos harrojmë që 40 nënshkrime e thërrasin seancën e jashtëzakonshme, e ne sot nuk jemi në seancë të jashtëzakonshme.

Pra, thirrësi, në momentin kur i ka marrë 40 nënshkrime ka pasur mundësi të thërras seancë të jashtëzakonshme, megjithëse ka pasur edhe shumë më shumë se kaq. Pra, i ka pasur 63, respektivisht 61, sepse nuk e kuptova mirë, por për një pikë të rendit të ditës në cilindo seancë kanë mjaftuar 6 nënshkrime të deputetëve. Pra, ne duhet ta dinim që me 6 nënshkrime, respektivisht me 40 nënshkrime do ta kishim një gjë të tillë dhe nuk do të duhej të thuhej që mungesa e nënshkrimit të një grupi të caktuar parlamentar po e pengon këtë debat, gjë që nuk është e vërtetë.

Edhe një herë themi se cilat janë arsyet pse ne nuk e kemi nënshkruar. I rikthehemi edhe një herë arsyes se ne nuk e kemi nënshkruar për shkak se kemi dashur pikërisht që rekomandimet të jenë të qarta, të mos kemi dilema rreth rekomandimeve, dhe po ashtu të mos kemi dilema rreth kërkesave të deputetëve nënshkrues, në këtë rast edhe debutues.

Në fakt, nuk mund, jo nuk mund, por madje rol kyç ka Qeveria e Kosovës në këtë mes, se ajo mund të na nxjerrë prej situatës. Qeveria e Kosovës nuk do të duhej ta linte Parlamentin e Kosovës të debatonte, sepse kishte shumë mundësi që të na nxirrte prej situatës. Por, kjo Qeveri nuk po e bën asnjëherë një gjë të tillë. Madje, me gjithë thirrjet e qytetarëve të Kosovës për drejtësi, me gjithë thirrjet edhe të deputetëve për drejtësi, me gjithë thirrjet dhe insistimet tona për drejtësi, Qeveria e Kosovës nuk po ia vë gjoksin si të thuash padrejtësisë që po ndodh ndaj vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe deri më tani Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk i mbrojt këto vlera. Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk i mbrojt as ushtarët e komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kur ata u akuzuan padrejtësisht, e u gjykuan padrejtësisht dhe në fund rezultoi se shpesh u shpallën të pafajshëm.

Kjo Qeveri nuk i mbrojt as komandantët dhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët u gjykuan në Hagë, dhe të njëjtut u shpallën të pafajshëm. Pra, qytetarët e Kosovës kishin të drejtë kur u thirrshin në pafajësinë e tyre, e Qeveria nuk u thirr as në pafajësinë e tyre, as nuk i mbrojt ata. Por, po ashtu, unë mendoj që sot, Qeveria dhe EULEX-i kanë përgjegjësi shumë të madhe ndaras prej Kuvendit të Kosovës që ta bëjnë një gjë të tillë dhe janë të thirrura që ta bëjnë një gjë të tillë, pra ta sjellin drejtësinë në Kosovë. Prandaj,

edhe një herë e theksojmë se ne jemi të fuqishëm që jo thjesht rishikimi i mandatit të EULEX-it, por mandati i EULEX-it në Kosovë do të duhej të ishte i panevojshëm.

Tash nuk e di se kush ia ka zënë rrugën njëri-tjetrit, Qeveria apo EULEX-i, por duhet të EULEX-i në këtë rast t'i hapte rrugë drejtësisë. Nëse EULEX-i nuk i hap rrugë drejtësisë, atëherë mendoj që pikërisht ikja e kësaj Qeverie do t'i hapë rrugët edhe ikjes së EULEX-it nga Kosova. Përderisa ne ta kemi këtë Qeveri në Kosovë, do të kemi edhe EULEX, përderisa ta kemi këtë nivel të Qeverisë përballë drejtësisë në Kosovë, do ta kemi edhe këtë mision të EULEX-it në Kosovë. Prandaj, për t'ia hapur rrugën e ikjes dhe panevojshmërisë së EULEX-it që të jetë në Kosovë, fillimisht do të duhej të ikte kjo Qeveri. Me këtë Qeveri, vetëm EULEX do të keni.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Për sqarim për atë që e tha zoti Selimi, por më shumë për opinionin publik. Është e vërtetë që mandati i EULEX-it në Kosovë në fillim ka ardhur me bazën e Pakos së presidentit Ahtisari, e votuar në Kuvendin e Kosovës me 2/3, por për sqarimin tjetër mandati që ka vazhduar në shtator të vitit të kaluar, ka ardhur nga letra e Presidentes, së shkëmbyer me zonjën Eshton. Ajo letër është miratuar në Kuvendin e Kosovës me mbi 80 vota. Nuk e di nëse ka votuar "Vetëvendosje", apo jo, por e di se mbi 80 deputetë të Kuvendit të Kosovës. Kështu që, mandati i EULEX-it në Kosovë ka të bëjë me sovranitet. Asnjë qeveri nuk mund t'ia japë mandatin askujt, por duhet t'ia japë Kuvendi me 2/3 e votave. Rrjedhimisht, edhe ky mandat që e ka sot, EULEX-i e ka nga Kuvendi i Kosovës, nuk them që Qeveria është kundër, por e ka nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Po pajtohem zoti Kuçi se vërtet ka pasur vota shumë dhe kjo makineri e votave shpresoj se shpeshherë po ju hyn në punë, por të mos harrojmë që mbi 80 vota ka pasur edhe Ligji për amnistinë, por mos të harrojmë - nuk kanë rëndësi votat, ka rëndësi që ligji është i keq. Edhe në këtë rast, nuk ka rëndësi sa vota i keni ju, i keni pasur për ta mbajtur EULEX-in këtu, ka rëndësi që misioni i EULEX-it nuk ka rezultuar i mirë. Të mos thirremi vetëm numrin e votave, por të thirremi në cilësinë se çka kanë sjellë ato vota në Kosovë. Ato vota, për fat të keq, ju kanë sjellë edhe ju në Qeveri.

KRYESEUSI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës

Të nderuar kolegë, sa i përket themelimit të gjykatës për krime lufte, pothuajse në tërësi jemi dakord që kjo është dashur të themelohet shumë më herët, por për shkak të rrethanave politike dhe shoqërore një gjë e tillë nuk ndodhur deri më tani. Andaj, themelimi i një mekanizmi të tillë duhet të ndodhë, por duhet ta marrë në konsideratë

edhe rolin dhe rëndësinë e EULEX-it, i cili është shumë i rëndësishëm dhe krucial, sidomos në ato pjesë të vendit ku mungon apo është vështirësuar ushtrimi i pushtetit shtetëror i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Roli i EULEX-it është i nevojshëm për shkak të ndjekjes së kriminelëve të mundshëm, të cilët mund të ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës, e në kontekst të kësaj ndihma dhe kontribut i EULEX-it do të ishte shumë domethënës duke i shfrytëzuar bashkëpunimet që i kanë shtetet e tyre me mekanizmat kompetentë që ndihmojnë në ndjekjen, kapjen dhe ekstradimin e të përndjekurve në vendin tonë për të mundësuar që më tutje të zhvillohen procedurat përkatëse ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar.

Themelimi i kësaj gjykate sadopak do të ndikonte që të qetësohen shpirtrat e familjarëve dhe të afërmeve të më se rreth 17 000 personave të vrarë dhe të zhdukur në Kosovë, familjarët e të cilëve kërkojnë nga institucionet tona që të hetohen dhe zbulohen rastet e familjarëve të tyre. Kjo natyrisht do të ishte një lehtësim për ta dhe është obligim i secilit nga ne.

Prandaj, ne kemi obligim të ndërmarrim veprime që ndihmojnë në këtë drejtim për ta zbardhur fatin e familjarëve të tyre. Po ashtu, me rëndësi të veçantë është e edhe bashkëpunimi i këtyre dy institucioneve: Gjykatës për krime lufte dhe EULEX-it, si dhe funksionimi i tyre do të ishte i domosdoshëm si një trup i vetëm.

Unë jam shumë e bindur se nëse veprohet kështu, kjo do të garantonte drejtësi të mirëfilltë për të gjithë dhe, para së gjithash, garanton respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe shtetin e së drejtës apo zbatimin e sundimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lladrovci e ka fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Megjithëse prej kaq viteve jemi të lirë dhe së fundmi edhe shtet i pavarur, megjithëse drejtuesit e lartë të Kosovës kanë marrë përgëzimet më të vyera të diplomacisë botërore, megjithëse kryeministri ynë po cilësohet gjerësisht burrë shteti dhe ka fituar vlerat e një drejtuesi të pranuar denjësisht në hierarkinë e qarqeve ku vendoset për të ardhmen e mëtejshme të vendit tonë, përsëri mjerisht kornizmi i jetës tonë vazhdon të jetë i mbyllur. Ndodhet para një kontradikte, jemi të aftë dhe të pranuar kur vendoset për marrëdhënie të mëdha historike ose jo, për të ardhmen e vendit tonë, por nuk jemi sa duhet të pranuar për të trajtuar, zgjidhur dhe vendosur për sistemin tonë duke shkuar dhe më tej, qëndrojmë jashtë këtij sistemi.

Prej viteve në Kosovë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, saktësisht që nga dita e parë e çlirimit të Kosovës, 14 vjet më parë. Këto institucione ndër vite kanë qenë të domosdoshme, do të thosha se në disa raste ato kanë qenë jetike. Përmasat e tyre kanë rrokur të gjithë sferën e jetës në Kosovë me një

përcaktim të qartë në vendosjen e rendit, ligjit, sigurisë. Mendoj se këtu ata kanë qenë të suksesshëm, megjithëse jo gjithmonë, dhe do të kishte qenë mirë për Kosovën nëse po kaq të suksesshëm do të ishin edhe në fushat tjera.

Tani e kemi EULEX-in. Cila është e ardhmja e tij? Çfarë duhet të ndodhë me te? Do të ndodhë me të? Do të vazhdojë apo do të përfundojë këtu misioni i tij? Është e domosdoshme ajo jo ta kemi ende këtë mision?

Personalisht, mendoj se EULEX-i duhet edhe për disa kohë në Kosovë, por duhet të ndryshojë mentaliteti, qëndrimi dhe struktura e tij. EULEX-i nuk është mbi Qeverinë e Kosovës, nuk është mbi Kuvendin e Kosovës, nuk është mbi gjithçka. Është i pavarur, por nuk është vendosës për të gjitha.

Unë mendoj se ai është një institucion në dobinë tonë, por jo në nëpërkëmbjen tonë. Shpeshherë personalitetet e njohura të EULEX-it kanë bërë deklarata, të cilat na kujtojnë një kohë të shkuar. Ata e kanë ndier veten sikur kanë ardhur për ta nënshtruar Kosovën, sidomos personalitetet e njohura, të dala nga lufta çlirimtare, e jo si një institucion juridik për sundimin e ligjit.

Ligji nuk vendoset me deklarata, në kërkimin e të pamundurës, në presionin mbi dëshmitarët, e sidomos duke futur në strukturat e saj figura që kanë qenë të lidhura ngushtë me gjithçka ndodh në Kosovë. E pamë terrorin dhe shtypjen masive serbe në këtë vend. Nëse dikush nga EULEX-i e sheh Kosovën si një urë për karrierën e tij të mëtejshme, juridike dhe politike, nëse dikush mendon se duke i goditur figurat e luftës çlirimtare, e duke i lënë të lirë kriminelët, ai do ta bëjë të ardhmen e tij, është i gabuar dhe duhet të shkojë.

EULEX-i duhet të heqë dorë nga praktikat përgjuese. Ai duhet të jetë një urë ndërmjet Qeverisë, Parlamentit, institucionit Presidentit dhe vendosjes së ligjit. Askush nuk është më i interesuar se ky Parlament që të vendoset ligji, rregulli, rendi juridik në Kosovë. Këtë nuk e vendos vetëm EULEX-i. Ai është vetëm një hallkë e këtij zinxhiri dhe ka ardhur koha që ai vetë ta kuptojë këtë. Kosova e sotme nuk është Kosova e korrikut të vitit 1999 dhe njëkohësisht edhe EULEX-i nuk duhet të jetë më me atë mentalitet që kishin organet si motra të saj, 14 vjet më parë.

Përveç rekomandimeve që do të dalin nga deputetët, edhe unë kam tri propozime konkrete në rast se grupet parlamentare dakordohen që ato të futen në rezolutë dhe do të isha i lumtur. Rekomandimet që i kam unë janë:

1. EULEX-i duhet ta ndërtojë strukturën e tij juridike në përputhje me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës;
2. EULEX-i duhet ta ketë përparësinë e tij në bashkërenditjen e veprimtarisë së tij, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës.

3. EULEX-i duhet të jetë në lidhje të vazhdueshme me organet dhe strukturat e ngjashme me të në shtetin e Kosovës, të bashkërendojë punën dhe veprimtarinë, duke pasur detyrime në përcaktime të përbashkëta.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Luftimin e krimit të organizuar, të kontrabandës, të korrupsionit të lartë dhe të krimeve të luftës, EULEX-i ia ka nënshtuar stabilitetit afatshkurtër politik, e jo të të drejtave dhe drejtësisë, lirisë dhe demokracisë, apo zhvillimit ekonomik. Kjo është arsyeja pse sundimi i ligjit nën optikën e EULEX-it ushtrohet, jo duke menduar se kush duhet të arrestohet, por kush nuk bën të arrestohet. Në çdo arrestim të kujtdo qoftë, thelbi është dikush që nuk u arrestua. Kësisoj, stabiliteti mirëmbahet kundër kundrejt destabilizimit të mundshëm. Kjo është arsyeja e parë pse në Kosovë nuk mund të ketë sundim të ligjit, e në veçanti sundim të ligjit nga EULEX-i.

Arsyeja e dytë është privatizimi neoliberal në Kosovë, sepse ky privatizim është në garë me sundimin e ligjit për luftimin e korrupsionit. Ne të gjithë e dimë që korrupsionin e lufton edhe sundimi i ligjit, por e lufton edhe privatizimi, ashtu siç është prezantuar këtu në Kosovë. Por, përderisa sundimi i ligjit është përgjithësisht ligjet e mira, por pa zbatim, në anën tjetër e kemi privatizimin i cili është ilegal, sepse është shumë efikas, ndërkohë që nuk ka ligj mbi privatizimin.

Pra, sundimi i ligjit ka dështuar për shkak se është vënë në një konkurrencë jo fer me privatizimin në luftimin e korrupsionit, dhe arsyeja e tretë pse nuk ka sundim të ligjit në Kosovë është Qeveria e Kosovës, e cila e ka kolonizuar sistemin e drejtësisë me militantë e agentë të partisë në pushtet dhe kësisoj e ka ngulfatur mundësinë për të sjellë drejtësi dhe natyrisht që padrejtësia vetëm sa sforcohet kësisoj.

Mos harroni që në institucionet e sistemit të drejtësisë njerëzit po frikësohen më shumë sesa që duken dhe shumë më tepër sesa e pranojnë një gjë të tillë. Ta zëmë kur deputeti i “Vetëvendosjes” Florin Krasniqi e pati paditur kryeministrin dhe partinë në pushtet për një shpifje ndaj tij, ai këtë e bëri nëpërmjet deponimit të kallëzimit penal në gjykatë këtu në Kosovë dhe përgjigjet që mori nga zyrtarët aty ishte se nuk mund ta marrin këtë rast sepse është një rast shumë i ndjeshëm.

Pikërisht se është rast i ndjeshëm, do të duhej të kishim garë të prokurorëve se kush po e merr më parë, e jo kështu abstenim të tyre, apo madje edhe zmbrapsje totale.

Ne kemi xhipa të blinduar dhe truproja për ministrat, qeveritarët, kryeministrin dhe presidenten, ndërkohë që në momentet kur ne po flasim këtu në seancën e Kuvendit, ka shumë gjasa që në kafeteritë në sheshin “Nëna Terezë” janë duke pirë kafe prokurorë e gjykatës të ndryshëm, pa kurrfarë përcjellje, dhe a e dini pse? Sepse kujt keq nuk i kanë

bërë. Domethënë nuk e kanë futur në burg ndonjë mafioz të madh, ndonjë kriminel të shquar, në mënyrë që tash të frikësohen për jetën e tyre.

Pra, në vend se për politikanët e përfaqësues të popullit t'i kemi xhipat e blinduar e truprojat, do të duhej t'i kishim për gjykatësit dhe prokurorët që e luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin e lartë.

Menaxhim i krizës quhet ndërmarrja për rezultatin që duhet të jetë stabiliteti politik. Në korrik të vitit 2006, Javier Solana, pararendësi i baroneshës Eshton, e lanson konceptin e menaxhimit të krizave dhe vetë EULEX-i dihet se e përkufizon vetën e tij si operacion i menaxhimit të krizës. Nga 23 misione të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së Bashkimit Evropian nëpër botë, EULEX-i është misioni më i madh.

Pra, së pari nga EULEX-i ne jemi definuar si krizë, e jo si vend pas konfliktit siç u tha edhe këtu, si vend në tranzicion. Ne më parë jemi vend para konfliktit të ardhshëm që nuk duhet të ndodhë nga pikëpamja e EULEX-it, sesa një vend pas konfliktit, meqenëse po të ishim vend pas konfliktit, pason zhvillimi. Këtu nuk kishim zhvillim. Ne shihemi nga pikëpamja e asaj se si konflikti mund të ripërtërihet, e jo se si konfliktin e kemi lënë prapa vetes dhe tash duhet të kemi zhvillim e demokraci dhe, së dyti, ky është mision për menaxhimin e krizës, pra jo për zgjidhjen e krizës, sepse zgjidhja konsiderohet që duhet të jetë politike dhe në negociata me Serbinë.

Pra, EULEX-i, jo vetëm që na konsideron si krizë dhe na krahason me vendet e krizave të ndryshme nëpër botë, si Afganistani, Palestina, por edhe Bosnja, e nuk na krahason me vendet normale siç duam të bëhemi ne, por në të njëjtën kohë konsiderohet që duhet të menaxhohet kriza, e jo të zgjidhet kriza, sepse problemi shihet si politik. Zgjidhja duhet të jetë politike, në ndërkohë EULEX-i menaxhon dhe zgjidhja natyrisht që është konfiguruar gabimisht, sepse thuhet se do të bëhet me negociata me Serbinë.

Më 10 shkurt të vitit 2008, gazetari i BBC-së, Allan Little pati qenë në Kosovë. Kjo ndodhi saktësisht një javë para se të shpallet pavarësia e Kosovës. Unë i dhashë para tij qëndrimet dhe kundërshtimet ndaj EULEX-it si mision që ka fuqi ekzekutive, imunitet prej ligjit, nuk na e njeh pavarësinë e kështu me radhë, por në të njëjtën ditë ai e ka intervistuar edhe kryeministrin e Kosovës, i cili në përgjigjet e tij, kur gazetari britanik i thotë: 'Po prit pak se ato do të kenë ingerenca sovraniteti, këtu do të jenë shumë të fuqishëm, ata në fakt do të jenë më shtet sesa vetë shteti i Kosovës', kryeministri thotë: 'Po na vetë e kemi ftuar ata'. Dhe, në njëfarë mënyre e bllokoi gazetarin britanik me mazohizmin e tij. Kur ti thua gazetarit britanik, që e ka parlamentarizmin 300-vjeçar, që unë vetë i kam ftuar këta që të jenë më shtet se sa shteti i im këtu, këtu përfundon politika dhe gazetaria dhe fillon mjekësia, sepse ky është qëndrim mazohist dhe natyrisht që ai nuk ka se si të bëjmë më pyetje për kryeministrin tonë.

Por, ajo çka dua të theksoj është që baza e EULEX-it, në thelb nuk është as mandati i Kuvendit. Është dokumenti i veprimit të përbashkët të Këshillit të BE-së më 4 shkurt 2008. Në këtë dokument, në nenin 3 h), gama edhe koha e fuqive ekzekutive mbetet e pakufizuar për EULEX-in. Më 16 shkurt, vetëm 12 ditë pas 4 shkurt, në gazetën zyrtare

botohet ky dokument, pra vetëm një ditë para se të shpallet pavarësia, kështu që juridikisht EULEX-i është me moshë një ditë më i vjetër se pavarësia e Kosovës.

E, a e dini çka shpjegon kjo? Kjo shpjegon pse pavarësia është shtyrë derisa të botohet në gazetën zyrtare ky dokument i veprimit të përbashkët dhe kjo ka qëlluar të dielën, që ka qenë edhe rrethanë lehtësuese për mënyrën se si është bërë, por mendoj se arsyeja kryesore është se EULEX-i të jetë ëmë i vjetër se pavarësia, dhe natyrisht që mandej iu vazhdua mandati edhe këtu në institucionet e Kosovës, por ai ka qenë vazhdim i diçkaje që tashmë u etablua, si në Maqedoni e në Kosovën Lindore, edhe në Kosovë që demilitarizuar e çarmatosur Ushtria Çlirimtare Shqiptare, dhe ju e dini që në asnjërën prej këtyre vendeve nuk u njoh lufta çlirimtare, por u konsiderua si konflikt i armatosur.

Pra, fakti që janë çarmatosur e demilitarizuar ushtritë tona dhe nuk na njihet lufta çlirimtare në asnjërën prej këtyre vendeve, është e njëjta gjë. Perversiteti i kësaj mosnjohjeje konsiston në faktin që nuk pranohet lufta çlirimtare, nuk njihet që pati luftë në Kosovë kundër Serbisë, mirëpo thuhet që kishte krime të luftës. Pra, paradoksalisht, lufta na pranohet vetëm në kuadër të krimeve të luftës. Nëse nuk paska pasur luftë këtu, atëherë pse ka krime të luftës, dhe këtu është perversiteti i mosnjohjes së luftës çlirimtare dhe çarmatosjes së UÇK-së dhe ushtrive tjera, ku ishin shqiptarët dhe bënë luftë.

Le të mos harrojmë që ka shumë kallëzime penale të shumë shqiptarëve ndaj kriminelëve serbë, por ato raste nuk kanë prioritet, meqenëse është pamundësuar gjykimi në mungesë.

Prandaj, edhe një ndër kushtet që Lëvizja “Vetëvendosje” i ka paraqitur që duhet t’i vihen Serbisë para çfarëdo bisedimesh me Kosovën duhet të jetë edhe dorëzimi i këtyre kriminelëve në Kosovë, por ju e dini që Qeveria e Kosovës hyri në bisedime pa kurrfarë kushtesh dhe, përveç kësaj, po merret vesh me kryekriminelin Daçiq, i cili edhe para luftës, edhe gjatë luftës, edhe pas luftës ka qenë zëvendës i partisë së Milosheviqit.

Pra, nuk mund flasësh tash për krime të luftës, në ndërkohë që po ia fal kryekriminelit krimet edhe për më keq po merresh vesh me të për çështje të brendshme të Kosovës.

Dhe, në fund, desha të them që fjala, e cila më së shumti dëgjohet në mediat kosovare nga qeveritarët, por edhe nga politikanë të tjerë, është sundimi i ligjit.

Mirëpo, a e dini ju se sa buxhet ndahet për sektorin e drejtësisë në Kosovë? Është më pak se 2%. Pra, mjetet që ndahen janë më pak se 2% të buxhetit. Ndërkaq për Prokurorinë, mjetet e ndara janë vetëm sa 0,4% të buxhetit të Kosovës. Pra, për çdo ditë shprehen që më së shumti e më së shpeshti dëgjojmë fjalët ‘sundimi i ligjit’, ndërkohë që për Prokurorinë kemi vetëm 0,4% të buxhetit, apo gjysmë kilometri asfalt të autostradës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar ministre,

E mbështes në parim debatin, e dua debatin, por kam tërhequr disa herë vërejtjen se debati për debat nuk është ai që i duhet Kuvendit. Jam për debat, por jo për debat me fjalë kallaballëk. Populli thotë ‘fjalët kallaballëk janë fukarallëk’. Edhe në përvojën tonë është dëshmuar. Ka nevojë për debat, por për debat për çështje të debatueshme së pari dhe së dyti për debat për një çështje të caktuar dhe me një synim të caktuar, me përgatitje të duhura. Jam kundër atyre që thonë se kjo çështje është tabu, se nuk mund të bisedohet.

Në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës janë së paku 3-4 çështje të kësaj natyre në procedurë.

Po, cila është qasja atje, mendoj që ia vlen pak vëmendje.

Së pari, për një çështje që vlerësohet se duhet të jetë e debatueshme bëhet një raport. Angazhohet dikush dhe e bën një raport, një dokument, ai shpërndalet, diskutohet pastaj. Brenda raportit zakonisht bëhen disa përfundime preliminare fillimisht, të cilat pastaj pas shqyrtimit shndërrohen në rekomandime ose draft-rekomandime. Më vonë shndërrohen në një draft-rezolutë. Ajo pastaj diskutohet, votohet, votohen madje edhe nënamendamentet, gjë që te ne s’po ndodh dhe pastaj po na ngatërrohen të gjitha procedurat, dhe ato pastaj votohen bashkë me raportin, por pasi të kalojë disa shqyrtime. Kjo siç po e bëjmë ne bëhet sikur në plenumet e dikurshme. Nuk është trajtim parlamentar, zonja e zotërinj. Prandaj, unë edhe kam hezituuar që ta nënshkruaj dhe më vjen keq që megjithatë koha dëshmoi se kishte një arsye.

Mua më vjen mirë që nismëtarët, i përshëndes, megjithatë, se motivin e mirë të tyre nuk e vë në diskutim, nuk kanë rrëshqitur në gracën e përzierjes në çështjet të papërzishme, do të thotë në çështje të ndarjes së drejtësisë, dhe mirë që e arsyetuan sa e sa herë. Mua më bëri një përshtypje shumë të mirë qasja e zëvendëskryeministrit dhe mendoj që është pikërisht ajo duhet të ketë jo vetëm Qeveria, por edhe Kuvendi dhe të gjitha institucionet tona.

Por, a duhet të debatohet kjo çështje? Mendoj që duhet të debatohet. Kosova është një problem sui generis, është një gjendje sui generis, e ka një tranzicion sui generis, prandaj edhe është normale që ka edhe fenomene të veçanta.

Por, ne na kanë shoqëruar dy skajshmëri në qasjen ndaj pranisë ndërkombëtare pothuajse në vazhdimësi.

Në fillim, një qasje servile tepër e nënshtruar, e dëgjueshme, me një dëshirë të pa fshehur për të lënë përshtypjen se jemi djem të mirë, se jemi kooperativë, se jemi fleksibël.

Dhe, një palë që kanë qenë pothuajse vazhdimisht refuzues dhe skajshmërisht refuzues.

Për më tepër, ka ndodhur shpesh që të ndërrohen rolet. Ata që ishin shumë fleksibël e servilë, ktheheshin pastaj në një periudhë tjetër në shumë radikalë, skajshmërisht radikalë. Ka ndodhur madje që edhe ata që ishin skajshmërisht radikalë, të kthehen pastaj në

skajshmërisht të dëgjueshëm e të tjera. Mendoj që të dyja qasjet janë të gabueshme dhe të dyja qasjet janë dëshmuar në përvojën tonë si të dëmshme. Për fat të keq, mund të evidentohen edhe tani.

Është një anekdotë që e tregon kalorësin që donte t'i hipë atit, por ishte i lodhur, thotë, dhe nuk i hipi dot. U kthye mbrapa dhe po thotë 'e kam harruar të them ndihmo Zot!'. Mori turr, tha 'ndihmo Zot!', dhe ra përtej kalit. I dhembti shpina mirë dhe u kthye dhe tha 'ndihmo Zot!' veç pak më pak. Edhe qasja kritike duhet të jetë me masën e duhur, që të mos na ndodhë që të jemi herë këndeje atit, e herë andej atit, por të jemi në pozicionin e duhur.

Dhe, për mendimin tim, për të qenë në pozicionin e duhur duhet ta kemi parasysh faktin që prania ndërkombëtare në Kosovë ka qenë nevojë jona, nevojë e proceseve në Kosovë. Ne kemi kërkuar dhe mendoj që gjithmonë duhet të jetë, në radhë të parë, mirënjohja për angazhimin ndërkombëtar në Kosovë. Edhe misioni i UNMIK-ut, edhe misionet e mëvonshme, me gjithë mangësitë që kanë pasur dhe s'mund të mos i kishin, ata që i kanë pasur iluzione kanë pas perceptione të gabuara.

Megjithatë, në përvojën e Kosovës janë dëshmuar si suksesshme dhe nuk ka gjë më të mirë për Kosovën sesa në Kosovë të ketë misione ndërkombëtare që janë storie suksesi, sepse janë storie suksesi të Kosovës.

Nëse ka pasur gabime duhen analizuar. Duhet analizuar madje sa u kemi kontribuar ne atyre. Por, pa kaluar prej një skajshmërie në skajshmërinë tjetër, pa lejuar atë që e thotë fjala e popullit "kalova përroin, pështyj kalin". Aq më pak mund të bëhet kjo pa e kaluar përroin, se nuk e kemi kaluar atë.

Dhe, në këtë rast, mendoj që afirmimi pozitiv i asaj që ka qenë përvojë e mirë e bashkëpunimit, e partneritetit, duhet të jetë konstantë e përhershme. Kjo nuk mund edhe nuk duhet ta përjashtojë qasjen kritike e të angazhuar.

Në raportin që unë e theksova në Këshillin e Evropës për përgjegjësinë e organizatave ndërkombëtare, edhe paqebërëse edhe paqeruajtëse, theksohet fakti i pamohueshëm se ato janë bërë faktor i rëndësishëm ndërkombëtar, edhe i sundimit të ligjit, edhe i ruajtjes së paqes, edhe i ndërtimit të paqes. Por, theksohet po ashtu dhe nënvizohet fakti i pamohueshëm se angazhimi i tyre është edhe me konsekuenca të pamohueshme, që shpesh lidhet edhe me fatin e njerëzve, me fatin e komuniteteve e të tjera, dhe theksohet kjo pikërisht për të siguruar funksionimin adekuat dhe nënvizohet fakti se misionet ndërkombëtare, duke qenë pa kontroll demokratik, pa proces të llogaridhënies, shpesh edhe bien pre e motiveve të ndryshme dhe influencave të ndryshme dhe për pasojë nuk e bëjnë më së miri punën e tyre.

Ndoshta, zonja e zotërinj, këtu është edhe qasja që ne nuk e kemi shfrytëzuar sa duhet, që në raport partneriteti me faktorët ndërkombëtarë, edhe me misionet që janë në Kosovë, ne ta korrigjojmë atë që është e korrigjueshme dhe këtë ta bëjmë pa komplekse. Pa kaluar

prej një skaji në skajin tjetër, mangësi ka, mangësi të shumta ka, dhe s'ka asgjë të keqe që ato të theksohen.

Ne të gjithë e dimë që me gjithë të mirat që ka pasur misioni i UNMIK-ut dhe i EULEX-it, ato në angazhimin e tyre kanë lejuar edhe dobësi e mangësi të shumta, madje edhe të dënueshme, të palejueshme. Shikoni çfarë ka ndodhur vetëm vitet e fundit.

A ka pasur qasje të balancuar në zbatimin e ligjit, a ka pasur standarde të dyfishta, a ka pasur qëndrime arbitrare, a ka pasur qasje që nuk janë aspak ligjore? Unë kam qenë në një proces gjyqësor të liderit të opozitës dhe jam tmerruar kur e kam dëgjuar prokurorin e huaj ta kërcënojë, për fat të keq tash i famshëm dhe ende gjithmonë në Kosovë, dhe përkundër asaj përvoje vërtet që ishte debakël juridik, t'i kërcënojë prokurorët e Kosovës, t'i kërcënojë avokatët e Kosovës, të cilëve ua kishin dhënë disa orë më përpara lëndën dhe prokurori i thyente në praninë tonë pse ata thoshin nuk jemi të përgatitur dhe seanca duhet të shtyhet. Ky është sundimi i ligjit, ky është modeli evropian që na sillet? Jo! Unë jam i bindur që në vendin e tij, në Italinë mike, kjo nuk do të lejohej. Pse të mos e themi? Po le ta themi në mënyrën e duhur, le ta themi si një vërejtje që e korrigjon një anomali, por që për shkak të ujit të ndotur nuk e hedh edhe fëmijën prej legeni, siç thotë fjala e popullit. Le të ndahet e keqja prej së mirës, le ta mbështetin të mirën se na duhet ne. Le ta kundërshtojmë të keqen se nuk i duhet askujt, nuk u duhet as partnerëve tanë.

Unë mendoj, prandaj, për të mos zgjatur, se shembuj mund të gjenden shumë, shikoni çka ndodh me kolegun tonë që e kemi ende deputet. Unë e abstraktoj çdo lidhje, çdo simpati, çdo antipati. Dënoj gjithçka që është e dënueshme, por ama mënyra sesi po veprohet ta zëmë me deputetin Limaj është vërtet e pakuptueshme edhe për ata që nuk e duan Fatmir Limajn. Nuk e kuptoj si mund të lejohet një qasje e tillë, herë lirohet, herë dënohet, herë vendoset në burg shtëpiak, herë lirohet prej tij e tjera dhe shkatërrohet një familje e tillë. Kush e ka këtë të drejtë të luajë? Diskreditohet ligji në përgjithësi, diskreditohet edhe misioni ndërkombëtar, i cili...

(Ndërprerje na regjia)

KRYETARI: Mirë, edhe një minutë Hydajet Hysenit.

HYDAJET HYSENI: Për të mos e zgjatur më shumë, faleminderit! Mendoj që ky debat duhet të kthehet në qasje, siç e propozova, që të bëhet një analizë e shkruar, në bazë të saj pastaj të bëhen përfundimet, rekomandimet, rezoluta, dhe ato të shqyrtohen sipas praktikave parlamentare që i shohim edhe në Parlamentin Evropian, edhe në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, edhe në parlamentet demokratike në vendet tjera dhe në këtë mënyrë unë jam i bindur që e evitojmë këtë lojë politike që po na e dëmton edhe kohezionin në çështjet që janë të përbashkëta dhe janë kohezive. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ndërtimi i një organizimi shoqëror, para se të gjithash kërkon një mund dhe sakrificë. Populli shqiptar, duke qenë i vetëdijshëm për identitetin e tij autokton dhe përgjegjësinë historike, e cila e përcolli me shekuj, nuk e la atë të heqë dorë nga organizmi, i cili, para së gjithash, do të ishte në shërbimin e tij në rrugëtimin drejt së ardhmes.

Duke qenë se kjo sakrificë është përcjellë ndër shekuj, është tejet e pakuptueshme se si ne sot ballafaqohemi me rrezikun, i cili na kanos si shoqëri dhe si komb. Lufta e fundit, e cila përcillej me ëndje nga aspiratat e popullit shqiptar kundër kolonizimit të tij nga Serbia, sot është duke u tentuar që të kontrabandohet dhe të shtrembërohet nga rruga e drejtë.

Kontrabandimi i këtij qëllimi, fatkeqësisht, sot është duke u bërë nga individët, të cilët dje, sot dhe nesër, do të thirren në luftën e drejtë të këtij populli, vetëm mbi bazën e propagandimit që i shërben politikës ditore të një grupi politik, i cili sot e mban pushtetin me çdo çmim. Madje, edhe kundër vullnetit të popullit!

Ne jemi dëshmitarë se në mënyrë të padrejtë sot tentohet të njolloset dhe të stigmatizohet lufta e popullit tonë. Kjo luftë speciale nuk është kurdisur sot, në mënyrë që të na gjejë edhe aq të befaseshëm. Ajo u përcoll nga procese serike e të ndërlydhura njëra me tjetrën. Ndërsa tani, efektet janë vetëm pjesë e rezultatit, të cilin e mbollëm dje, për ta korrur sot.

Le ta analizojmë se cila është makineria, e cila sot po e dirigjon këtë operacion me mision të caktuar.

Ne sot, çuditërisht, e kemi një strukturë institucionale, e cila me të vërtetë e bënë Kosovën sui generis. Kosova sot ballafaqohet me një praktikë institucionale, ku në brendinë e saj e ka një strukturë komanduese me cilësi ekzekutive, e cila nuk ia njeh subjektivitetin, ndërsa e obligon këtë "të panjohur" që t'i zbatojë të gjitha direktivat e kësaj krijese komanduese e quajtur EULEX: Mision i BE-së, i instaluar, parafrazoj ME FTESËN e vet Republikës së Kosovës. Shumë e çuditshme, i ftuari nuk e njeh ftuesin!

Ky mision, i cili ka qëndrim neutral ndaj Republikës së Kosovës, sot nga vetë Republika e Kosovës i njihen tre komponentë ekzekutivë më vital; atë nga sektori i Policisë, Doganave dhe më kryesori - komponenti i Gjyqësorit.

Republika e Kosovës shkoi edhe më larg. Ajo e nxori edhe një ligj të veçantë me të cilin ia konkretizoi këtij misioni kompetencat në sektorin e gjyqësisë, konkretisht në gjyqësi dhe prokurori. Ligji për kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it e përcaktoi kompetencën lëndore të gjykatësve dhe prokurorëve, duke ua dhënë të drejtat për udhëheqjen e procedurave gjyqësore sipas detyrës zyrtare dhe sipas vendimmarrjes së brendshme strukturore të EULEX-it.

Ne shkuam edhe më larg. E themeluam edhe Prokurorinë Speciale, e cila kinse do t'i shërbente luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Por, çka përfituam nga kjo

strukturë e specializuar? Asgjë, përpos disa prokurorëve që paguhen gati sa dy herë që kolegët e tyre paguhen nëpër prokuroritë themelore dhe atë të Apelit. Kjo prokurori nuk iu përshtat qëllimit formal për çka është krijuar, por në të kundërtën, ajo shërbeu si institucion shtesë për t'ia garantuar EULEX-it kontrollin ekzekutiv.

Nëse flasim për propozimin për themelimin e një gjykate speciale, është absurde të besosh se ky mision do ta njohë këtë gjykatë, kur e kemi parasysh që ky mision është neutral ndaj statusit. Kërkesa e PDK-së për këtë strukturë gjyqësore i shërben kësaj aparature, e cila sot është duke i zhvilluar këto procese që do të përdoren si mjet i shantazhit në të ardhmen. Propozuesi e ka vetëm një qëllim retorik, t'i gjuajë hi syve popullit, duke ikur nga esenca dhe ajo e domosdoshmja.

Ne kemi edhe kapacitete dhe bazë të mjaftueshme juridiko-ligjore që të gjitha rastet që ndërlidhen me krimet e luftës të gjykohen nga gjykatat vendore dhe nga gjykatësit vendorë. Këto procedura mund të ngrihen edhe nga prokurorët vendorë, ku ka bazë dhe përgatitje profesionale.

Por, mungesa kryesore është përkrahja ndaj sistemit të drejtësisë, të cilin me qëllim e sabotojnë këta që sot e kanë interesin që ta themelojnë një gjykatë të tillë. Në vend të përkrahjes institucionale, këtu është zgjedhur një metodë më ndryshe - metoda e krijimit të rrjetit institucional, me qëllim të dekoncentrimit të sistemit gjyqësor - **alla**, përçaje e sundo!

Pra, këta zotëri dëshirojnë që sistemin gjyqësor ta ristrukturojnë edhe më tej, që duke e ristrukturuar ta dezorientojnë nga pavarësia dhe qëllimi parësor i tij.

EULEX-i duhet ta mbarojë misionin e tij të dështuar, ndërsa ne, në vend të krijimit të strukturave të reja, duhet t'i forcojmë këto ekzistueset, të cilat janë të mjaftueshme, por jo të përkrahura sa duhet. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është mirë që sot po diskutojmë, meqë edhe më herët ka pasur përpjekje që të diskutohet për EULEX-in, mirëpo pa arsye objektive, e ndoshta edhe më shumë subjektive, asnjëherë nuk na është dhënë mundësia ta bëjmë këtë.

Misioni për sundimin e ligjit, u tha edhe disa herë këtu, se misioni për sundim të ligjit apo EULEX-i në Kosovë është me ftesën e institucioneve të Kosovës, përkatësisht me letrën që i është dërguar nga ish-presidenti Sejdiu, me të cilën është formalizuar dhe është legalizuar prania e tij. Ndërkaq mandatin e ka të përcaktuar nga Brukseli, të cilit ky mision i përgjigjet.

Institucionet e Kosovës, sidomos ato që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, kanë pasur dhe kanë edhe sot nevojë për përkrahje të EULEX-it, për çka edhe natyrisht u tha këtu disa herë se ne jemi mirënjohës.

Që nga fillimi i mandatit të tij, ne kemi menduar ta kemi një bashkëpunim interaktiv në formë të një partneriteti dhe në këtë kontekst edhe kemi vepruar.

EULEX-i, duke ruajtur kompetencat ekzekutive, dhe jo vetëm këshillëdhënëse në disa fusha shumë të ndjeshme të profilit të lartë, që janë luftimi i krimit të organizuar, luftimi i korrupsionit, i trafikimit me qenie njerëzore, i mbrojtjes së grupeve të marginalizuara dhe raste ku ka shkelje të rëndë të të drejtës humanitare apo ligjeve të luftës të njohura si krime lufte, që në fillim e pati shpalosur një projekt shumë ambicioz për parandalimin dhe çrrënjosjen e këtyre grupeve, apo individëve, bartës të këtyre aktiviteteve shumë të rrezikshme kriminale që po e rrënojnë shtetin ende të brishtë të Kosovës.

Ky ishte dhe është interes jetik i qytetarëve të Kosovës, përfaqësues të të cilëve jemi ne të zgjedhurit e tyre, përkatësisht subjekti politik që i takoj dhe pa dallim përkatësie etnike, sepse as krimi, sidomos ai i natyrës ekonomike nuk ka ngjyrimet etnike.

Kemi qenë dhe jemi shumë të interesuar që të hetohen dhe të sillen para drejtësisë ata që planifikuan, urdhëruan, nuk e penguan dhe ekzekutuan afro 12 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Kemi kërkuar të hetohen dhe të dënohen dhunuesit e një numri të madh të grave shqiptare gjatë luftës, të cilave edhe u është shkatërruar jeta, duke u hedhur krejtësisht në margjinë.

Deri më tash, të nderuar deputetë janë identifikuar dhe hapur gjithsej 193 varreza masive, sepse një numër ka mbetur ende i paidentifikuar dhe janë bërë gjithsej 186 ekzekutive në masë. Kemi pritur dhe po vazhdojmë të presim të hetohen edhe masakrat në Burgun e Dubravës, ku janë ekzekutuar gjithsej 200 të burgosur dhe qindra të tjerë janë plagosur rëndë dhe lehtë.

Kemi kërkuar dhe vazhdimisht kërkojmë hetimin dhe dënimin e përgjegjësve për masakrat në Prekaz, në Krushë, në Mejë, në Therandë, në Poklek, në Celinë, në Abri, në Rezallë, në Studime, në Sllavi, Reçak, Qyshk e shumë e shumë masakra të tjera me të cilat nuk janë marrë as Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte në Hagë, apo Gjykata e Administruar nga UNMIK-u, dhe tash EULEX-i.

Si përfaqësues të popullit kemi kërkuar dhe kërkojmë të hetohen rastet e bartjes së kufomave apo të pengjeve të luftës, që pastaj janë ekzekutuar në Serbi, dhe varrosjen e tyre kryesisht në lokacionet e ushtrisë serbe, apo aty ku kanë qenë të vendosura njësitet speciale të formacioneve policore dhe paraushtarake serbe.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë,

Edhe sot, shumë familje në Kosovë përballen me mosndriçimin e fatit të personave të pagjetur. Edhe sot i kemi gjithsej 1 743 persona që llogariten të pagjetur. As këtij problemi nuk dua t'i qasem nga këndi etnik, prandaj kam kërkuar dhe kërkoj që të zbardhet fati i gjithë personave të pagjetur, si dhe përgjegjësinë politike, morale dhe penale për ata që janë përgjegjës për këtë veprim.

Si përçues i zërit dhe mbrojtjes së interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe gjithë atyre që na kanë votuar, e kemi detyrim dhe obligim ta bëjmë këtë.

Deputetë të nderuar,

Pas përfundimit të luftës janë organizuar shumë procese, që unë personalisht i konsideroj politike, kryesisht kundër ish-luftëtarëve dhe komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E them këtë për faktin se shumica e tyre e kanë dëshmuar pafajësinë, por janë eliminuar të them krejtësisht nga skena politike dhe shoqërore. U është dëmtuar shumë rëndë reputacioni i tyre dhe familjeve të tyre dhe askush nuk është marrë pastaj me rehabilitimin e tyre.

Këto kanë qenë procese të kurdisura me dëshmitarë të montuar, që janë joshur me shuma të konsiderueshme të parave për dëshmi të rreme.

Ndonëse deklarativisht është thënë se këto gjykime nuk janë drejtuar kundër luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, faktikisht ato janë organizuar për përbaltjen dhe denigrimin e kësaj lufte.

Ne luftën nuk e kemi bërë se kemi pasur dëshirë, por nga shkaku se kemi qenë të detyruar ta bëjmë këtë, ngase kishte përpjekje nga regjimi serb për të na zhbërë totalisht si komb.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë luftë çlirimtare, luftë e drejtë dhe në kuadër të respektimit të zakoneve të luftës. Ne nuk kemi luftuar kundër popullit serb, por kundër formacioneve ushtarake, policore dhe paramilitare të regjimit serb.

Ne asnjëherë nuk e kemi fajësuar dhe nuk e fajësojmë popullin serb për vuajtjet që na janë shkaktuar nga regjimi serb, sepse, në fund të fundit, edhe ata kanë qenë dhe janë viktima të këtij regjimi.

Edhe tash kur është arritur marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, po arrestohen dhe po gjykohen ekskluzivisht ish-ushtarë dhe komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me dyshime dhe akuza për krime lufte. Po bëhen përpjekje të kriminalizohet lufta çlirimtare e popullit shqiptar.

Të nderuar deputetë,

Nëse më parë kemi dyshuar se arrestimi dhe gjykimi i ushtarëve të UÇK-së ka qenë vetëm perceptim, tani këto janë shndërruar në fakt dhe në akt, në veprim konkret të EULEX-it.

Madje, tash është fakt i pamohueshëm se nëpërmjet këtyre arrestimeve, këtyre hetimeve dhe gjykimeve, po bëhen përpjekje të dobësohet edhe subjekti politik që i takoj unë - Partia Demokratike e Kosovës, dhe pikërisht në kohën kur është përcaktuar data e zgjedhjeve lokale në Kosovë, e që reflekton edhe në zgjedhjet parlamentare.

Ky qëndrim imi nuk duhet dhe nuk mund të konsiderohet presion në pavarësinë e Gjyqësorit, por po e praqes një shqetësim real të shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë pasur besim në EULEX-in, e tash po protestojnë kundër tij.

Drejtësia nuk mund të quhet drejtësi nëse zbatohet në mënyrë selektive dhe kur ligji zbatohet për realizimin e projekteve të caktuara politike. Fatkeqësisht, e them fatkeqësisht, kështu po ndodh në Kosovë.

Prandaj, edhe duhet të diskutohet për funksionin e misionit të EULEX-it, të pranohen dhe të përkrahen vendimet e drejta të këtij misioni, por gjithsesi të rishqyrtohen vendimet e gabuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Populli i Kosovës ka përjetuar regjim të egër nga pushtuesi serb me vite të tëra, por kurrë nuk është mposhtur dhe kurrë nuk është dorëzuar. Ka përjetuar vuajtje dhe tortura të cilat e tmerruan botën demokratike.

Populli i Kosovës është dëbuar nga trojet e veta, është masakruar nga paramilitarët serbë, por kur nuk është mposhtur. Nuk është mposhtur për faktin se përballë bishave të egra kanë dalë në mbrojtje djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të mposhten edhe nga veprimet e padrejta të EULEX-it, sepse ne besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre. Pafajësia e tyre do të dëshmohet, siç është dëshmuar edhe në raste tjera, kur luftëtarët e lirisë kanë triumfuar kundër çdo aktakuze për krime lufte të ngrehur ndaj tyre.

Kjo është dëshmuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, e kjo do të dëshmohet edhe në Prishtinë.

Ne jemi për drejtësinë në këtë vend, por edhe 100 herë po të më jepet rasti të diskutoj për arrestimet e luftëtarëve nuk do të ndalem së përmenduri masakrat, të cilat i bëri Serbia mbi popullin e Kosovës, e ato janë të shumta, si masakra e Likoshanit, Çirezit, Izbicës, Abrisë, Poklekut, Mejës, Reçakut, Krushës dhe shumë e shumë masakra të tjera. Prandaj, në këtë rast unë i bëj pyetje EULEX-it: Kush është akuzuar apo dënuar për kryerjen e këtyre masakrave? Ju lutem, kjo është e padrejtë dhe irriton tej mase popullin e Kosovës. EULEX-i duhet t'i hetojë ata të cilët i masakruan shqiptarët nëpër shtëpitë e veta, e jo ata të cilët e mbrojtën pragun e shtëpive të veta.

Duhet t'i hetojë ata të cilët vranë gra, fëmijë e pleq. Duhet t'i hetojë vrasësit e familjes Jashari, Demaku, Deliu, e shumë familjeve tjera kosovare.

EULEX-i duhet t'i hetojë vrasjet në veri të Mitrovicës, që kanë ndodhur para syve të tyre.

Prandaj, të nderuar qytetarë, kjo çfarë po ndodh me EULEX-in në Kosovë është e papranueshme. Është e papranueshme të barazohet vrasësi me viktimën. Është i papranueshëm edhe fakti se EULEX-i po i akuzon luftëtarët e UÇK-së me dosjet e UNMIK-ut, dosje këto të nxitura nga burimet serbe.

Kosova ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale që ta ketë një departament që merret me hetimin dhe dënimin e krimeve të luftës që kanë ndodhur në Kosovë.

Aspak me profesionistë nuk janë as gjykatat apo departamentet e ngjashme në rajon, të cilat merren me këto çështje.

Ne jemi që çdo krim i luftës të dënohet, por jo të vendosen paralele ndërmjet krimeve që ka bërë policia, ushtria dhe paramilitarët serbë ndaj popullatës civile dhe luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo është e papranueshme, sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka zhvilluar luftë të drejtë dhe mbrojtëse.

Prandaj, gjendja në të cilën ka ardhur ky mision na shtyn ta shqyrtojmë seriozisht mandatin e tij të mëtutjeshëm në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

EULEX-i, së pari, pra nuk është këtu që të sjellë drejtësi. Ai përpiqet thjesht të mirëmbajë stabilitet. Dhe, ky fakt e bën atë që t'i nënshtrohet situatës konkrete në terren, të kalkulojë dhe të shënojë të bëjë thjesht njëlloj balance, duke iu nënshkruar presioneve konkrete nga terreni, e jo nga parimet e drejtat. Kësisoj, EULEX-i nuk ndjek krim. EULEX-i thjesht balancon dhe kërkon të ndërtojë kushte për stabilitet.

Dhe, Serbia agresive kësisoj vendos agjendë apo ndikon në agjendën e EULEX-it, dhe jo faktet reale në terren.

EULEX-i i nënshtrohet presionit të Serbisë, por kësisoj ai bëhet i verbër plotësisht edhe nga ato masakrat që po përmenden që kanë ndodhur.

E sidomos fakti që Qeveria jonë takohet me Serbinë, kjo de fakto ia hap rrugën EULEX-it që të jetë i tillë. Prandaj, kur flasim për masakrat, e unë jam dakord që ato duhet të përmenden kudo, por ato së pari duhet të thuhën aty ku duhen të thuhën, dhe nëse ka munguar të thuhën atje ku duhet, pra në takimet me Daçiqin, apo së paku të thuhën para kushtëzimit të negociatave me Serbinë, si arsye për mosshkuarje në negociata tani, ne po

i themi këtu, duke e parë situatën në terren, e cila ka rrjedhur pikërisht dhe nga ky lëshim i madh që ka ndodhur kundër Serbisë.

Mosgatishmëria që lufta të mbrohet politikisht dhe të merret përgjegjësi e qartë politike në mbrojtje të saj, e hap mundësinë që edhe EULEX-i të veprojë kësisoj.

EULEX-i shumë qartë kalkulon. Dhe, me kë kalkulon? Kalkulon me faktorët që është Qeveria këtu dhe me Serbinë. Dhe, kur kalkulon me Qeverinë arreston personat që janë në periferi dhe kësisoj e forcon Qeverinë. Dhe, kur kalkulon me Serbinë, atëherë e akuzon UÇK-në, e akuzon luftën.

Kur kalkulon me Qeverinë, i konvenon, në fund të fundit, të mos akuzojë për korrupsion, sepse korrupsioni, në fund të fundit, do ta prekë edhe Qeverinë, dhe kur kalkulon me Serbinë akuzat bëhen të rënda dhe bëhen totalisht në shënim të denigrimit të luftës, që të cenohet krenaria e qytetarit të Kosovës. Kësisoj, kush e pëson? E pëson shteti i Kosovës, e pësojnë qytetarët, sepse u cenohet e drejta që të jenë krenarë, sepse goditet lufta në fakt.

Dhe, kush përfiton në këtë situatë? Shumë thjesht, përfiton Serbia, por njëkohësisht përfiton edhe Qeveria, e cila kësisoj vazhdon të mbetet në pushtet.

Duke u tërhequr nga mbrojtja politike e drejtpërdrejtë e luftës, kreu i Qeverisë arrin ndoshta sot t'i shpëtojë çfarëdo lloj ndjekje për korrupsion, por për pasojë i kemi goditjet e kësaj natyre që tani po na ndodhin.

Kjo për Lëvizjen “Vetëvendosje” ka qenë e qartë që herët. Po dua ta kujtoj verën e vitit 2009, kur u nënshkrua protokollin ndërmjet EULEX-it dhe Serbisë. Kjo ka qenë njëra ndër simptomat e para që është Serbia ajo e cila do të ndikojë dhe do ta vendosë drejtpërdrejt agjendën e EULEX-it këtu.

Lëvizja “Vetëvendosje” asokohe e pati bërë një aksion. Të gjithë ishin kundër nesh. Na quanin atëherë që jeni antiperëndimorë. Arsyeimi ynë ka qenë shumë i drejtë dhe tejet parimor. Pra, ne e kundërshtonim një mision, i cili nuk u jep llogari qytetarëve të Kosovës dhe si i tillë lidhte marrëveshje dhe nënshkruante protokoll drejtpërdrejt me Serbinë. Dhe, kur e filloi punën, EULEX-i filloi së pari me rastin kundër Albin Kurtit, asokohe. Çka ndodhi atëherë? Qeveria në atë kohë dhe përgjithësisht politikanët e sotëm fërkonin duart dhe madje e nxitnin policinë që të jetë brutale me rastin e arrestimit, apo me rastin e përpjekjeve për arrestim, siç ka ndodhur më 25 prill dhe 10 qershor të vitit 2010.

Me këtë, asokohe Qeveria përpigjej që t'i dëshmojë EULEX-it, fërkonte duart dhe shpresonte se me këtë do t'i lehtësohej puna asaj në të ardhmen, sepse do të eliminohej njëri nga kundërshtarët e saj, që ishte tepër parimor, edhe kundër EULEX-it, edhe kundër Qeverisë.

Prandaj, edhe debati i sotëm duhet të qartësohet, duhet të jetë parimor dhe duhet të shkojë deri në fund dhe rezoluta duhet të jetë parimore, në mënyrë që ne ta votojmë atë. Duhet

t'i qartësojmë pozitat në raport me EULEX-in, edhe me të kaluarën, edhe me përkrahjen e EULEX-it deri më sot që ka ndodhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAHRIE IZMAKI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që fillimisht të shpreh keqardhjen time për ikjen, apo për mungesën e kolegëve të mi deputetë, të cilët së bashku e nënshkruam këtë kërkesë dhe konsideroj që është e padrejtë frika nga paragjykimi se ata mund të mendojnë që do të ndërhyjnë në drejtësi. Mua më së paku kjo më shqetëson. Do të më shqetësojë fakti nëse pas fjalës sime do të ndihen keq vetëm qytetarët serbë, posaçërisht të komunës së Vushtrrisë, pas adresimi im do të jetë konkretisht te krimet e kryera në komunën e Vushtrrisë, te ato krime të cilat ndodhën dhe u dorëzuan me emra dëshmitarë dhe vrasësit e tyre, por EULEX-i, as drejtësia vendore asnjëherë nuk bënë asgjë në këtë drejtim.

Në Kosovë pra ka pasur krime të shumta të luftës dhe ka pasur masakrime të popullatës civile, pastrim etnik, dhunime e dhunë të shfrenuar, por s'ka pasur dhe s'ka ende një drejtësi përballë këtyre veprimeve.

Janë dënuar disa urdhërdhënës të vendimmarrjes politike serbe nga Tribunali i Hagës, por se shumë sish prej tyre kanë mbetur të paprekur, madje të tillët fatkeqësisht vazhdojnë të mbajnë edhe poste të larta udhëheqëse aktualisht në Serbi.

Paqja ndërmjet popujve të një rajoni kur nuk do të arrijë në nivelin e dëshiruar pa u sjellë para organeve të drejtësisë kriminelët, qofshin ata ekzekutorë, apo urdhërdhënës.

E kam shumë të paqartë se si të gjithë këta prokurorë që i ka shteti i Kosovës edhe 14 vjet pas përfundimit të luftës nuk merren fare me dosjet ekzistuese të krimeve serbe, të shkaktuara në vendin tonë.

Për shumëkënd në Kosovë, misioni EULEX-it në këtë drejtim konsiderohet jo i suksesshëm.

Brengë e përbashkët si qytetarë të këtij vendi kemi mosdënimin e krimit dhe kriminelëve.

Janë 14 vjet të kaluara dhe drejtësia ndërkombëtare dhe vendore nuk kanë bërë asgjë në kapjen e ekzekutorëve të këtyre krimeve.

Kjo ndodh në nivel të vendit, por sot më lejoni që unë të paraqes një gjendje të komunës sime, pra komuna e Vushtrrisë, ajo që ishte e para ndër institucionet komunale në vend që ofroi të dhëna në bashkëpunim me familjarët e të vvarëve dhe tregoi gatishmëri maksimale për të afruar dëshmi të bollshme për të gjitha krimet e kryera nga forcat serbe ndaj popullatës civile.

Salustro dhe EULEX-i ka vite që i kanë në dispozicion dosjet për krimet serbe të shkatërruara në komunën e Vushtrrisë.

Dëshmitarët me ato dosje i kanë dhënë emrat e vrasësve, emrat e dhunuesve dhe aktorëve të masakrave të popullatës civile shqiptare.

Pse Salustro nuk merret me ngritjen e akuzës për urdhëruesit dhe ekzekutorët, të cilët më 5 maj '99, në rrugën "Emin Duraku" në Vushtrri vranë familjet Fazliu dhe Rustolli? Dëshmia është për emrin e vrasësit. Pse ky trup i drejtësisë nuk ngre aktakuzë dhe t'i kapë vrasësit e 12-vjeçarit Burim Kunoviku, më 18 prill '99? E është dëshmia për emrin e vrasësit.

Pse ky trup i drejtësisë ndërkombëtare nuk sjell para drejtësisë vrasësit e Muharrem, Fehmi e Ismail Grabanicës, të vrarë në shtëpinë e tyre më 19 maj në Vushtrri, edhe pse edhe të dhënat për vrasjen e tyre pra janë dëshmi në EULEX.

Pse nuk kapen e sjellin para drejtësisë vrasësit e Veli Parduzit, në rrugën e fshatit Begaj, vrasësit e Rifat, Bekim e Agim Aliut, të vrarë më 17 maj, po ashtu në shtëpi. Dihen dhe janë emrat e vrasësve.

Nuk kapen vrasësit e 17-vjeçarit Burim Ademi, Shasivar Ademi dhe 16-vjeçarit Fatmir e Adem e Gani Ademi, të gjithë këta të masakruar, gjersa aktorët dihen, siç dihen vrasësit për gjithë masakrën e Galicës.

Nuk u kapën vrasësit e Fidan e Bekim Makiqit, nga fshati Riznik. Pse nuk kapen kriminelët serbë të cilët në qytetin e Vushtrrisë zhdukën 68 qytetarë, e dihen shumica e aktorëve të atij krimi masiv, më 22 maj '99.

Nuk u kapën asnjëherë kriminelët e masakrës së Studimes, ku u ekzekutuan rreth 100 qytetarë, edhe pse dihen ata që e urdhëruan krimin, por edhe ata që e ekzekutuan atë natë krimin.

Nuk u kapën kriminelët serbë që vranë e dogjën familje 9-anëtarëshe Ujkani në fshatin Reznik, në shtëpinë e tyre, më 6 mars '99.

Po ashtu, as vrasësit e familjes 12-anëtarëshe të Selatin Gërxhaliut, më 31 maj '99.

Në vitet '98-'99, ushtria serbe, e ndihmuar nga policia dhe paramilitarët, e filloj një aksion të gjerë luftarak, nga i cili u vranë 650 qytetarë në një qytet krejt të vogël, siç është Vushtrria. Gjersa gjatë aksioneve të tilla i zhdukuri edhe 116 të tjerë, nga të cilët 48 konsiderohen ende të tillë, pasi nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

Në masakrën e Studimes, vetëm për dy orë u vranë 117 qytetarë, nga të cilët 17 femra. U vra edhe nëna me frytin 8 muajsh në bark, ndërsa plagosi 25 të tjerë, të gjithë civilë.

Më 16 prill u vranë edhe 9 qytetarë të tjerë, duke shkuar në shtëpinë e tyre. Ndërsa më 15 maj, po kjo polici vrau 6 gra të familjes Gërguri.

I vetmi motiv për gjithë këta familjarë të të vranëve është pra liria dhe shteti i Kosovës, por nga këto vrasje, nga kjo luftë, kanë mbetur jetimë gjithsej 1 671 fëmijë. Pra, vetëm në komunën e Vushtrrisë.

Këto pyetje që i bëj në këtë Kuvend, qytetarët e Vushtrrisë dhe këto familje m'i bëjnë mua dhe unë jam e detyruar t'i bëj këtu në këtë vend, në këtë institucion. Po ua drejtoj institucioneve ndërkombëtare, por edhe vendore: pse? Se ka shumë krime të tjera, por që Salustro edhe të tjerët nuk u morën me to. Të gjithë këta të vranë kanë qenë civilë në vendin e tyre, në shtëpitë e tyre. Asnjëherë Salustro dhe EULEX-i nuk ngritën një akuzë për këta kriminelë të vërtetë, por merren ekskluzivisht vetëm me akuza kundër pjesëtarëve dhe liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne të gjithë po insistojmë që ta kemi prokurorinë për krime lufte, të ketë prokurorë të aftë e të guximshëm, dhe jo si këta vendorë që i kemi sot. E kam fjalën konkretisht për prokurorët vendorë, të tillët, veç servilitetit nuk dinë dhe nuk duan, apo edhe s'dinë, të veprojnë vetë dhe të ngrenë akuza për krimet reale të kryera në Kosovë.

Këta prokurorë nuk shohin më larg veç shfrytëzimit maksimal të benificioneve të dhuruara nga shteti, duke harruar se ato i mbajnë falë gjakut të këtyre martirëve civilë, por edhe të gjithë luftëtarëve të rëndë për lirinë e këtij vendi. Prokurorë dhe drejtësi, siç është kjo tani, uroj të mos vazhdojë tutje se e kishim përplot me konstitucione të tilla edhe para lufte.

Salustro dhe EULEX-i përgjithësisht duke ngrehur akuza vërtet banale, siç është edhe kjo e fundit ndaj çlirimtarëve të njohur si 'Grupi i Drenicës', por edhe shumë raste të tjera, akuzat e ngrehura për krime lufte të këtyre pjesëtarëve ndaj pushtuesit dhe argatëve të tyre në kohë lufte janë banale tani. Ta akuzosh viktimën e asaj lufte edhe ta krahasosh me kriminelët e vërtetë, më duket që ky është krim më i madh.

Unë dua të besoj që EULEX-i do ta kthejë besimin e qytetarëve të këtij vendi dhe ky është edhe qëllimi që ne sot debatojmë. Jo ndoshta largimi urgjent i tij.

Drejtësia ndërkombëtare duhet ta kthejë besimin edhe tek institucionet, edhe tek ne deputetë, që vetë e dhamë atë mandat, por përgjithësisht duhet ta kthejë besimin te qytetarët tanë, te ata njerëz që janë viktimat e asaj lufte dhe ëndrrat e të rinjve tanë, që u ndërtuan mbi bazën e drejtësisë së njohur ndërkombëtare dhe respektit, nuk dëshirojmë që të kthehen në një mosbesim total ndaj këtij sistemi aktual të drejtësisë ndërkombëtare dhe vendore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë besoj që debatet në lidhje me misionet ndërkombëtare në Kosovë nuk duhet të jenë temë tabu. Mund të diskutohet për to, por natyrisht që ne nuk mund të marrim përsipër që të diskutojmë vendime gjyqësore, sepse ajo do të ishte ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e drejtësisë, sepse pushteti i drejtësisë është pushtet i ndarë nga pushtetet tjera.

Unë do të doja ta thosha se nëse ia kemi bërë ndonjëherë vetes pyetjen se pse është misioni i EULEX-it në Kosovë? Natyrisht të gjithë flasim: është këtu me ftesë të institucioneve të Kosovës. Në të njëjtën ditë që është shpallur pavarësia e Kosovës është ftuar edhe ky mision. Po pse është këtu?

Unë mendoj që duhet të jemi realistë. Misioni i EULEX-it në Kosovë është për një fakt shumë të thjeshtë, sepse Kosova nuk ka kapacitete për të bërë drejtësi, nuk ka kapacitete të cilat do të dëshmonin që është në gjendje të bëjë drejtësi, jo vetëm në raport me minoritetet, por edhe në raport me vetveten.

Për ditë e më shumë po dëshmohet që Kosova nuk është në gjendje t'i luftojë krimin dhe korrupsionin. Do të duhej të ishin institucionet e drejtësisë që do ta bënin atë.

Duhet ta kemi në konsideratë edhe një fakt tjetër shumë të rëndësishëm. Misioni i EULEX-it është këtu me paratë e taksapaguesve evropianë. Nuk mendoj që kjo gjë duhet të trajtohet me shpërfillje, sepse qytetarët e Bashkimit Evropian paguajnë që ne këtu ta kemi një sistem më të mirë të drejtësisë, të kemi sundim të ligjit.

Pyetja tjetër që duhet të shtrohet këtu lidhet me performansën, por a ia vlen që edhe këta taksapagues paguajnë që Kosova të ketë një sundim më të mirë të ligjit, cila është performansa e EULEX-it, cili është raporti i trajtimit të krimeve edhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme këtu?

Unë këtu kam vërejtje themelore për punën e EULEX-it, mendoj që sa herë që institucionet e drejtësisë marrin parasysh ose marrin në konsideratë zhvillimet politike, atëherë ato vetëm rrëshqasin nga ky mision.

Nuk mendoj që EULEX-i duhet të kritikohet vetëm kur na intereson ne ose kur puna e tij na atakon në interesa personale ose persona të cilët i kemi përreth. Në fakt mendoj se duhet të jemi shumë parimorë, EULEX-i po trajton krime të ndryshme. Unë mendoj që po bën pjesërisht punë të mirë, por pjesërisht edhe punë të kritikueshme, jo të gjitha krimet të cilat kanë ndodhur në Kosovë po trajtohen, veçanërisht krimet e luftës. Dhe nuk e di a është çështje selektive apo është çështje e mungesës së bashkëpunimit, sepse asnjë institucion i drejtësisë nuk mund ta bëjë punën si duhet në rast se popullata nuk bashkëpunon dhe ky është një fakt i vërtetuar kudo. Mirëpo, mendoj se balancat politike janë të pranishme edhe në punën e këtij institucioni.

Tjetra që dua të them është që misioni i EULEX-it është ftuar këtu pikërisht nga këta deputetë të cilët janë prezentë në sallë. Mendoj që kur është bërë ftesa do të duhej të kishim parasysh që drejtësia nuk njeh seleksionim secili, i cili është përgjegjës, secili që

ka kryer krime një ditë në derën e tij do të trokasin. Nuk dua t'i paragjykoj këtu asnjë person, mirëpo kjo është e vërteta. Kështu që e thash, duhet të jemi shumë parimor në raport me misionet ndërkombëtare, të cilat janë në Kosovë, sepse mendoj që nuk janë kundër interesit të Kosovës, mirëpo duhet që ne të jemi të gjithë kritikë për performansën e tyre.

Për shembull, unë një nga gjërat që i kam parë që në fillim të këtij misioni është që është marrë pak a shumë pothuaj se plotësisht eksperiencia e UNMIK-ut ku prokurorë dhe gjykatës vijnë me kontrata gjashtëmujore, e fillojnë një lëndë, e hapin derisa ta mësojnë atë, derisa të përkthehet, deri sa ta marrin vesh se çfarë po bëhet iu përfundon misioni, mund të zgjatej edhe 6 muaj ky mision i tyre, apo mandati, të them, kështu që barten lëndët nga një prokuror tek tjetri, nga një gjykatë te tjetra, dhe misioni asnjëherë s'përfundon dhe prandaj nuk ka drejtësi. Mendoj se kjo është një çështje shumë, shumë e rëndësishme, nuk mund të bëhet kjo me mandate të shkurtuara dhe mendoj që imitimi i përvojës së UNMIK-ut po prodhon të njëjtat efekte, mungesë drejtësie.

Në fakt, kjo është një vërejtje që do të duhej t'i shkonte vetë Bashkimit Evropian në lidhje me organizimin e këtij misioni. Por nga ana tjetër mendoj që duhet që kërkesa e llogarisë të cilën nuk e bëjnë dot institucionet e Kosovës, duhej që të forcohej, të ishte më e madhe edhe nga ana e institucioneve evropiane. E di që ka pasur disa shtete lidere, të cilat kanë kritikuar publikisht hapur punën e misionit. Dhe mendoj se pikërisht ata që kanë kritikuar dhe kanë qenë më të zëshëm në punën e tyre, duhet që sot këtij misioni t'i japin atë performansë që ka ardhur këtu.

Një vërejtje tjetër themelore imja është në lidhje me punën e misionit të EULEX-it, në fakt në veri. Ka pasur shumë arrestime të kriminelëve të ndryshëm dhe lirime të tyre, në marrëveshje me Beogradin. Mendoj që ky është gabimi më i madh që e komprometon misionin e EULEX-it, sepse bashkëpunimi politik për krimin mendoj që prodhon efekt krejtësisht të kundërt me atë të drejtësisë, kështu që edhe kjo pikë është shumë e rëndësishme që misioni i EULEX-it të vetë korrigjohet në këtë proces dhe të mos marrë leje në Beograd në lidhje me vendimet e drejtësisë, pavarësisht se kush janë ata kriminelë.

E kuptoj që duhet të bashkëpunohet, por në fakt duhet të bashkëpunohet në lidhje me faktin që të merren të dhënat apo të shkëmbehen, si të them, kriminelët në kuptimin që ata që kryejnë krime t'i dorëzohen drejtësisë, por jo të merren vendime politike duke parë se cila situatë është më e përshtatshme për të arrestuar apo për të liruar një kriminel.

Mendoj që kjo është gjëja që e ka komprometuar më së shumti këtë mision dhe në rast se nuk vetë korrigjohet përgjatë kësaj kohe do të shkaktojë një gjë shumë negative në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Do të jetë mungesa e besimit të ndërtimit të një sistemi të cilit popullata do të mund t'i besojë, të një sistemi drejtësie. Kjo është shumë e rëndësishme që njerëzit të fillojnë ta kthejnë besimin tek sistemi i drejtësisë, besim i cili sot pothuaj se mungon tërësisht dhe këtë e shohim në të gjitha sondazhet e perceptimit të cilat bëhen. Faleminderit!

KRYETARI: Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,
Ministër,
Ministër i Drejtësisë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jeta para se gjithash, unë mendoj që është një proces i komplikuar dhe e tillë është edhe jeta politike, pra të gjithë ata që sot deklarojnë që ne kemi deklaruar kështu në vitin 2008, për proceset që do të ndodhin në vitin 2013 ose të gjithë ata që thonë ne kemi deklaruar kështu në vitin 2000, për atë që do të ndodhë në vitin 2013, ato janë vetëm profeci, janë dokrra dhe asgjë më tepër.

Fundamentalistët e shohin jetën shumë më thjeshtë dhe përpiqen ta interpretojnë në mënyrë të ngushtë dhe rigjide, ose bardh ose zi, ose ditë ose natë, ose mirë ose keq, ose për ose e kundërt, ose me ne ose kundër nesh, ose mik ose armik.

Jam i bindur se në debatin e sotëm siç edhe dëgjuam, tiradat e pafundme dhe monotone të natyrës se a ju kemi thënë ne në krye të herës, kur ne ishim kundër EULEX-it, ju e kërkonit EULEX-in, tash jeni ngritur kundër EULEX-it se po ju dhemb ju, siç do të mund të na bie të dëgjojmë edhe të tilla, për fat të keq nuk dëgjuam, sepse ata e liruan sallën, se ne po nxitohemi paksa. Për disa po vonohemi, e për disa të tjerë po nxitohemi.

Disa mendojnë se EULEX-in as që është dashur fare ta pranojmë e disa të tjerë mendojnë se jo vetëm që është dashur ta pranojmë, por ne duhet që edhe t'ia vazhdojmë mandatin edhe më tepër, e madje të kemi edhe kujdes për gjuhën që e përdorim ndaj këtij misioni dhe këto dy ekstreme ndihen prej dy partive më të mëdha opozitare. Pra, koalicioni qeverisës duhet ta dëgjojë edhe ata që thonë: ne do t'ia vazhdojmë mandatin edhe ata që thonë ne s'është dashur t'i pranojmë fare këtu.

Të nderuar kolegë deputetë kam qenë njëri prej deputeteve që para disa javësh pata kërkuar që të organizoheshim për të mbajtur një seancë, një debat, ta quani si të doni, ku do të diskutonim për trendin në rritje të arrestimeve për krime të luftës. Personalisht nuk jam i kënaqur me tekstin aktual. Do të doja të ishte shumë më eksplicit në kërkesën tonë dhe kjo nuk është aspak sekret.

Unë personalisht e konsideroj qesharake, nënçmuese, përbuzëse, joserioze, turpëruese, provokative dhe të pandershme, fushatën e misionit të EULEX-it për t'i zbardhur gjoja krimet e luftës, 15 vjet pas luftës. E konsideroj si futje e gishtit në syrin tonë tendencën për t'i arrestuar krerët e UÇK-së, bazuar mbi disa deklarata të dëshmitarëve recidivistë.

Unë, të nderuar kolegë deputetë, sa herë ndërrojnë faktet, i ndërroj mendimet, kurse fundamentalistët në vend që t'i ndërrojnë mendimet, provojnë t'i ndërrojnë faktet. Dhe faktet kanë ndryshuar në rrafshin e hetimit të krimeve të luftës, misioni i EULEX-it po kujdeset për të bindur për çdo ditë në këtë drejtim. Nuk dëshiroj të keqkuptohem, madje as prej këtij misioni, sepse unë besoj fuqishëm në vlerat evropiane, siç besoj edhe në

luftimin e krimeve të luftës, siç besoj dhe siç e respektoj edhe të drejtën e secilit individ, dëshmitar a gazetar për të shprehur dyshimet, për të menduar ndryshe, qoftë edhe duke ngritur pikëpyetje të mëdha për ndershmërinë a korrektësinë e secilit prej individëve të luftës.

Mirëpo, jo Mauricio Salustro, por edhe po të ngritët prej varri vetë Xhovani Fallkone, nuk do të mund të bindë se ngatërresat ndërshtetërore të bazuara kryekëput në Kanunin prapanik të Lekë Dukagjinit, mund të kategorizohen si krime të luftës. Këto ngatërresa mund të jenë krime që janë kryer gjatë luftës, por këto ngatërresa nuk janë krime të luftës dhe këtu ekziston një dallim i madh.

Pa dashur që në asnjë formë t'i rras duart e mia të ngathëta dhe gishtat e mi të trashë në punët e holla të drejtësisë, mirëpo megjithatë dëshiroj të them se jo çdo krim i kryer gjatë luftës është krim i luftës, kurse në anën tjetër të gjitha krimet e luftës janë të tilla vetëm nëse janë kryer gjatë luftës.

Të nderuar deputetë, dëshiroj t'i ndaj me ju, e edhe me EULEX-in, dy krime që kanë ndodhur gjatë luftës në fshatin tim, në Çabiq, dhe ju më tregoni mua se cili prej tyre është krim i luftës. Në prill të vitit 1998, persona të maskuar që flisnin shqip që e kishin edhe emblemën e UÇK-së mbi supe e ndoshta edhe të komanduar prej ndonjë figure eminente, i rrahën pa mëshirë e sidomos pa asnjë motiv lufte nja 30 a 40 burra të fshatit Çabiq, të cilët edhe ashtu po jepnin kontributin e tyre në çlirimin e vendit.

Më ndiqni me vëmendje ju lutem! Saktësisht, një vit më vonë, në prill të vitit 1999, po në fshatin Çabiq, forcat serbe i vranë pa mëshirë, por me motive të forta lufte rreth 20 persona, në mesin e tyre edhe gjyshin e gjyshen time. Dua të nënvizoj se në mesin e të vrarëve prej forcave serbe kishte edhe prej atyre që një vit më herët ishin rrahur pa mëshirë prej personave të uniformuar me emblemën e UÇK-së.

Nëse më keni përcjellë me vëmendje, atëherë dua të them se mungesa e mëshirës në kryerjen e krimit i përbashkon të dy krimet, mirëpo këto dy krime dallohen sikur dita me natën tek motivi i kryerjes së tyre. Në rastin e rrahjes motivi ka qenë hakmarrje primitive farefisnore. Thënë ndryshe, fqinji po e rrihte fqinjin, daja po e rrihte nipin, ose nipi po e rrihte dajën, por jo për shkak të ndonjë qëllimi ose motivi të lidhur me luftën ose për të arritur të ndonjë qëllim lufte.

Ky krim ka qenë, por jo i luftës. Thjesht, ata që ishin veshur më herët po i rrihnin ata që nuk ishin veshur baras me ta. Kurse, në rastin e dytë, atë të vrasjes, vrasësit krimin po e kryenin me një gjakftohtësi tipike. Motivi i kryerjes së këtij krimi ishte i qartë, frikësimi i popullatës dhe dëbimi i tyre prej shtëpive. Pra, ekzistonte komploti dhe konspiracioni. Po i vrisnin pleqtë e plakat, sikur e vranë Gegë dhe Mane Buzhalën, 83, respektivisht 84 vjeç, jo pse ndaj tyre kishin ndonjë urrejtje personale, por sepse duke i vrarë ata synonin t'i frikësonin të gjithë të tjerët që qëndronin në shtëpitë e tyre. Kurse për fshatin Çabiq, prioritet ka qenë, është dhe do të jetë zbardhja e vrasjes së më të dashurve të tyre, si dhe arrestimi i atyre që e nxitën, orkestruan dhe e kryen atë krim të luftës.

Mirëpo, nuk jam i sigurt se çka konsideron prioritet Prokuroria e EULEX-it. Javën e kaluar në hollin e Kuvendit e pata një debat tepër të veçantë me njërin prej kolegëve të një partie rivale, për të cilin kam respekt, e fatkeqësisht e ka liruar sallën. Flisnim hapur nëse duhet të kemi një Tribunal vendor për krimet e luftës, ose jo. Nëse ishim të zotët që të përballeshim me një detyrë kaq të rëndë dhe me kaq përgjegjësi, kolegu im ishte skeptik në këtë drejtim, i kishte rezervat e tij të drejta.

Pa dashur të jam aspak sarkastik, mirëpo kohëve të fundit unë u kam thënë të gjithë miqve e sidomos atyre ndërkombëtarë se nëse qëllimi i Tribunalit të Krimeve të Luftës është luftimi i këtyre krimeve sipas standardeve të shteteve të rajonit, ne do ta bëjmë një gjë të tillë me sukses të shkëlqyeshëm.

Pra, dëshiroj që edhe prej kësaj foltore ta bind kolegun tim skeptik i cili nuk ndodhet këtu, se me një Tribunal tonin të krimeve të luftës, do të bëheshim shembull për rajonin, gjithmonë sipas standardeve aktuale. Ndonëse, kjo është jashtëzakonisht me rëndësi të thuhet, ne kemi qenë viktimë të luftës së fundit, se ne jemi deportuar 1 milion veta me trena e traktorë, duke e lemerisur gjithë civilizimin perëndimor, se ne jemi vrarë si kafshët, bashkë me kafshët në luftën e fundit. Dhe e fundit, por më e rëndësishmja, se në luftën e fundit, Sami Lushtaku, Sylejman Selimi dhe të tjerët, nuk po luftonin në Nish, por po luftonin në Drenicë dhe po luftonin në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj të them se duke përdorur mjetet e gabuara nuk mund të arrihen qëllimet e mira. Çka dua të them është se persekutimi që po i bëhet luftës së fundit, posaçërisht udhëheqësve të saj, analizojeni rastin e Fatmir L, siç do ta quante Kafka, nuk është se po vendos drejtësi në vend. Këta njerëz po hetohen për tjetër gjë prej EULEX-it, kurse po gjykohen për tjetër gjë prej Tribunalit të padukshëm të njohur ndryshe si Tribunali i opinionit publik.

Pra, Sylja, Samiu, Fatmiri, po hetohen prej EULEX-it për krime të luftës, kurse po gjykohen prej gjyqtarëve të pavarur, të pa shpirtë dhe të padukshëm të opinionit publik për krimet eventuale që këta dhe të tjerët mund t'i kenë kryer potencialisht pas luftës. Ne kemi dëgjuar edhe këtu prej që është themeluar ky legjislativ, që ne kemi komandantë që kanë qenë një vit komandantë, 15 vjet biznesmenë, thua se që të jesh biznesmen është krim në veti. Pra prej këtu ka filluar anatemi i komandantëve dhe i atyre që e udhëhoqën luftën, ndërsa, ai që i thotë këto, ka qenë një vit zëdhënës e 15 vjet mashtrues. Ka qenë zëdhënës i UÇK-së në Prishtinë dhe vazhdon të jetë mashtrues që 15 vjet, në Prishtinë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova dhe qytetarët e saj edhe më tutje janë duke kërkuar drejtësi. Ajo nuk është vendosur pas luftës prej nesh e as prej UNMIK-ut, ajo nuk është vendosur pas shpalljes së pavarësisë prej EULEX-it e as prej nesh. Të jeni të bindur se kështu do të jetë edhe tash e tutje, jo pse EULEX-i nuk dëshiron të vendosë drejtësi, por sepse një mision i huaj e ka të pamundur të bëjë një gjë të tillë. Kot ne do të provojmë të fshihemi pas njëri-tjetrit

e të gjithë së bashku, pas një misioni të huaj që ndoshta ata do të na i zgjidhin problemet tona.

Kjo është vetëm një ëndërr e bukur, më falni që po ju zgjoj, që nuk do të bëhet realitet asnjëherë. Drejtësinë në mes nesh dhe drejtësinë me të tjerët do të mund ta vendosim vetëm ne. Për këtë kërkohet profesionalizëm, objektivizëm dhe posaçërisht guxim. Dhe, arritja e këtyre standardeve varet prej nesh, saktësisht prej ne që jemi këtu apo prej atyre që do të vijnë pas nesh.

Ka ardhur koha, të nderuar kolegë deputetë, që misionit të EULEX-it, në formën siç është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Nuk mund të mos shpreh keqardhjen në fillim të fjalës time për trajtimin e kësaj teme që po i bëjmë në këtë seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.

Qëllimi ynë kur kemi kërkuar këtë debat, më së paku ka qenë qëllim ndërhyrja në drejtësi, qëllimi dhe motivi kryesor i thirrjes së këtij debati ka qenë mosndëshkimi i konsumimit të veprave të rënda penale prej vitit 1998, 1999 e deri sot. Mos konsumimi i veprave penale, veprave të rënda penale për mbi 12 000 të vrarët, për vepra penale të rënda për mbi 200 masakra të tmerrshme në përmasa rrëqethëse, të veprave të rënda penale të rrëmbimit – 4 000 të rrëmbyer, 1 800 prej tyre ende të pagjetur dhe nuk dihet çka është bërë me trupat e tyre, për vepra të rënda penale, gjymtim i kufomave në përmasa dhunimi.

Motivi tjetër ka qenë gjithashtu për vepra të rënda penale, për akte dhunimi të mijëra femrave gjatë luftës, për vepra të rënda penale të helmimit dhe të torturës me përmasa vdekjeje, vepra penale të djegies së mbi 200 objekteve të banimit, të cilat nuk janë bërë thjesht për qëllim djegie, por edhe me qëllime dëbimi nga trojet e tyre që qytetarët i kishin ndërtuar për t'i trashëguar në breza.

Unë për veten time kam prezantuar këtu një kallëzim penal në një seancë të kaluar ku një gjyqtar nga Malisheva, Demush Krasniqi, në Prokurorinë e Prizrenit, më 5 janar 2001, ka deponuar në Prokurorinë e Prizrenit për masakrën e 34 vetave në Burim të Malishevës. Këtë gjykatës, tani në pension, e kanë kontaktuar hetues të EULEX-it, tani pas trajtimit në këtë Kuvend. Natyrisht edhe ata kanë qenë shumë të kujdesshëm përgjatë gjithë javës që e kanë marrë në pyetje, duke i thënë se është bërë një ndërhyrje në drejtësi nga institucioni i Kuvendit të Kosovës. Por, tani, më imponohet pyetja, po të mos shtrohej këtu dhe po të mos shfletuhej ky kallëzim penal që kishte kaluar 10 vjet i mbuluar me pluhur, nuk do ta kontaktonin këta hetues të EULEX-it tani këtë gjyqtar në pension.

Gjithashtu, edhe shumë kallëzime të tjera penale nuk janë trajtuar deri në këtë kohë dhe mbrojtja mendimin e gjithë kolegëve të mi deputetë këtu që në asnjë moment nuk po bëjmë ndërhyrje në drejtësi dhe as nuk ka qenë ky motivi ynë për ta trajtuar këtë temë.

Pas trajtimit të krimeve, misionet ndërkombëtare të drejtësisë, së pari i UNMIK-ut dhe tani i EULEX-it, do të kryenin një mision që e kanë pasur për obligim ndëshkimin e krimeve të ndodhura në këto hapësira tona dhe bartjen e përvojës ndërkombëtare të këtij misioni tek juristët, tek gjyqtarët dhe prokurorët tanë.

Tek pastaj, pas trajtimit të këtyre krimeve, edhe mund të mirëprisnim jo shumë me indiferencë edhe trajtimet tjera që i bëhen tani, por, jo kështu, siç ka ndodhur me trajtimin e rastit “Kleçka” me kryeprotagonist Fatmir Limajn, me rastin e trajtimit të kryeprotagonistit nga Dukagjini, Ramush Hajadinajn, për rastin e Llapit me kryeprotagonist të komandantit Rustem Mustafa dhe të zëvendësit të tij Latif Gashi, dhe përsëri të rastit “Kleçka” me deputetin tani Limaj dhe djemtë tjerë të Malishevës në të cilin, që nga trajtimi i parë në publik e deri në procedura tjera aspak serioze dhe gati parodie ku brenda ditës gjykata bie dy vendime të ndryshme për trajtimin e të akuzuarve, për të cilin proces ende besoj se pas aktgjykimit të gjykatës nga shkolla prestigjioze e Britanisë së Madhe, çdo aktgjykim tjetër jo lirues do të jetë i dyshimtë dhe me lëndime serioze në performancën e drejtësisë.

Reforma në drejtësi, që është projekt i Ministrisë së Drejtësisë dhe që është prezantuar nga ministri besoj se do të nënkuptojë edhe formimin e Gjykatës për Krime të Luftës në Kosovë, por kjo nuk do të nënkuptojë gjithashtu mosmirënjohjen ndaj misionit ndërkombëtar të EULEX-it dhe sidomos shtyllës së drejtësisë dhe të sigurisë, për të cilën kemi nevojë që të veprojmë ende në Kosovë në formë konsulence dhe në forma tjera që ata e shohin të arsyeshme.

Unë për veten time nuk mund të jem krejt indiferent dhe nuk mund të jem krejt pa emocion kur trajtohet kjo, por duke qenë nga fundi i diskutimeve dhe duke parë se të gjitha aspektet e kësaj teme janë prekur dhe janë trajtuar me ndjeshmëri dhe përgjegjësi nga shumë kolegë deputetë këtu, unë do ta përmbyll me kaq duke premtuar që fjalën time të zgjeruar do ta deponoj në Sekretari. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Mendoj se falë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ne sot jemi këtu në këto institucione dhe Kosova frymon lirshëm. Mendoj se Ushtria Çlirimtare e Kosovës në atë kohë ishte një kushinetë e vogël që vëri në lëvizje një mekanizëm të madh siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe e vëri në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare që e ndërroi qasjen komplet ndaj Kosovës së asaj kohe.

Prandaj, kjo vlerë duhet të shihet, të ndjehet si një diçka ku kemi hise të gjithë pa dallim partie. Prandaj, kemi hise të gjithë edhe për ta mbrojtur kur ka tendenca që të përbaltonet dhe të hidhet baltë në dinjitetin e saj dhe njerëzve që kanë qenë bartës të kësaj ushtrie.

Për mua është shqetësuese dhe nuk është aspak e arsyeshme ikja e një grupi parlamentar nga Kuvendi në lidhje me këtë debat për arsye tepër periferike dhe kjo është një shqetësim për deri sa ne nuk jemi të bashkuar rreth vlerave të përbashkëta, vlera të cilat asnjëherë koha nuk do t'i zbehë dhe kërkojmë që të na vlerësojnë të tjerët, prandaj është një diçka e kotë, duhet t'ia njohim vlerat vetvetes.

Po i kthehem rendit të ditës. Debati parlamentar për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, të Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit brenda këtij debati, faktikisht i kemi tri shtylla tema të debatit për të cilat duhet një kohë bukur e gjatë për t'i shterë dhe të diskutohet rreth këtyre tri temave.

Të nderuar deputetë,

Lufta popullit të Kosovës iu imponua nga makineria shtetërore e dhunshme e Serbisë së atyre viteve, prandaj duhet ta di EULEX-i, të gjithë ata që u vranë nga ajo makineri ishin civilë, gra, pleq e fëmijë. Doemos duhej të përhapej Ushtria Çlirimtare e Kosovës cep me cep, shtëpi me shtëpi anekënd Kosovës në ballë të së cilës Ushtri ishin bijtë dhe bijat më të devotshme të saj.

Një luftë që të imponohet, s'është asgjë tjetër veç një luftë e drejtë, sepse me anë të saj ruhen: qenia fizike, dinjiteti, identiteti, gjuha, liria e tjera.

Të gjitha këto përpjekje nuk janë krime, por janë obligim dhe patriotizëm. Jam e bindur se të thuash dhe ta mbrosh të vërtetën për popullin tënd, para se gjithash është obligim, assesi nuk duhet kuptuar ndryshe nga askush, madje as nga faktorët ndërkombëtar që janë këtu për të na ndihmuar në shtet ndërtimin e Kosovës.

Mendoj se EULEX duhet ta njohë të vërtetën në këto raste. Pyetje që duhet t'i shtrojmë dhe do t'i shtroj EULEX-it sa herë që të më jepet rasti si ndarës i drejtësisë në Kosovë janë: Kur do të merret me drejtësinë e për t'i zbardhur masakrat që i janë bërë qytetarëve të Kosovës, që deri më sot nuk është gjykuar askush?

Më bie t'i përsëris shumë kolegë këtu të mi deputetë, por nuk është e tepërt të përsëritet se - Kur do të zbardhet masakra e bërë ndaj grave e fëmijëve dhe nënave të familjes Deliu nga Abria? Kur do të zbardhet masakra e Likoshanit? Kur do të zbardhet masakra në Poklek të Ri? Kur do të zbardhet masakra e Poklekit të Vjetër? Kur do të zbardhet masakra e Vërbovcit, e Çirezit, e Izbicës, e Rezallës, e Studimes, e Mejës ku kanë mbetur të vrarë e të masakruar dhjetëra e mijëra gra e fëmijë, dhe t'i përmend 800 fëmijë të moshës nën 12 vjet.

Në fund, do të shtroj pyetje për EULEX-in: Ju prejudikues të drejtësisë dhe demokracisë evropiane, a i keni trajtuar, si i keni trajtuar dhe si po i trajtoni këto tmerre e masakra?

Dhe, të nderuar deputetë,

Jemi dëshmitarë të një ambienti sot që luftën e armatosur në mes të UÇK-së dhe ushtrisë e policisë së Serbisë e quajnë herë konflikt e herë luftë, varësisht nga konteksti. Kur është fjala për arrestimin, njohtimin dhe poshtërimin e ndonjë pjesëtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, këtë e bëjnë me pretekst për pjesëmarrjen në krime të luftës, ndërsa sa herë që ngritët zëri për të kërkuar llogaridhënie nga Serbia për dëmet që ia ka bërë Kosovës dhe popullit të saj gjatë luftës kemi reagime të menjëhershme se nuk ka pasur luftë por konflikt. Dhe, e shihni paradoksin!

Të nderuar, ne këtu, në këtë sallë jemi me vullnetin e popullit, qytetarëve të saj, andaj edhe duhet t'i përcjellim shqetësimet e tyre dhe bindjet e tyre, sepse qytetarët kanë bindjen se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një vlerë historike, kombëtare, e shenjtë dhe e paprekshme për çdo shqiptar. Askush nuk do të pranojë asnjëherë të braktisë sot luftëtarët e saj dhe t'i lë ata në mëshirën e një prokurori të anshëm e qëllimkeq, i cili ndjek një agjendë që nuk ka të bëjë me qëllimet e shpallura të EULEX-it. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë,

I nderuar ministër Mujota,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Populli ynë, bijtë dhe bijat më të mirë të këtij vendi gjatë gjithë luftës kundër sistemit shtetëror represiv të Serbisë dhe Milosheviqit, kanë ëndërruar që vlerat e demokracisë një ditë do të arrijnë edhe në vendin tonë.

Populli ynë, spektri politik këtë synim e ka sublimuar dhe bartur natyrshëm në konceptin e të gjitha partive politike të Kosovës, andaj menjëherë pas shpalljes së pavarësisë Kosova, ftoi misionin e EULEX-it në Kosovë që të ndihmojë përmes këshill dhënies në përmirësimin dhe ngritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Pra, në vitin 2010 u nxorën ligjet që nënkuptuan inkorporimin e misionit të EULEX-it brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës me kompetenca ekzekutive në disa fusha. Ftesa dhe votimi për ligjet që rregullojnë kompetencat ekzekutive të EULEX-it u votuan nga Kuvendi i Kosovës me bindjen se misioni është i domosdoshëm. Për atëherë, jam i bindur se ishte veprim i drejtë, sepse sistemi i drejtësisë së Kosovës ishte futur në një ngërç nga elemente të caktuar që ishin bartës të këtij sistemi në periudhën e UNMIK-ut.

Elementet që në periudhën e UNMIK-ut kishin devijuar në misionin e drejtësisë në Kosovë, arritën që ta dezorientojnë edhe hamendje deri në kohë edhe në pjesë të EULEX-it, sepse trajtimi me prioritet i dosjeve të fabrikuara nga UDB-ja dhe të servuara nga qarqet e brendshme antishqiptare të UNMIK-ut, kishin arritur fillimisht ta largojnë nga binarët e drejtësisë UNMIK-un duke mbrojtur kështu krimin shtetëror të Serbisë dhe duke ngritur një sistem dezinformativ me pseudo informata dhe pseudo dëshmitarë të zinxhirit kriminal të Milosheviqit.

Ky sistem dezinformativ i gatuar në Beograd, për fat të keq u gëlltit në Kosovë nga ata hetues e prokurorë të kohës së UNMIK-ut, andaj u tha ditë më parë se UNMIK-u kishte krijuar me mijëra dosje për krime lufte kundër pjesëtarëve të UÇK-së. Ndërsa, numri i pjesëtarëve të policisë dhe ushtrisë së Millosheviqit që u hetuan apo akuzuan për krime lufte në Kosovë është minor.

Këtu është edhe huqja në drejtësi dhe ndjekje të krimeve të luftës. Prandaj, mbetën të pa hetuara krimet në afër 200 varreza masive të kryera nga policia dhe ushtria serbe, vrasjet e civilëve të moshës nga 1 muaj e deri në 97 vjeç. UNMIK-u i dezorientuar dhe EULEX-i më vonë, harruan se duhet ngritur hetime, aktakuza për zhdukje të kufomave të civilëve të vrarë gjatë luftës, që është krim i dyfishtë, siç është rasti i Batajnicës dhe Petrovosellës.

Askush nuk u përgjigj as për dhunimet e femrave shqiptare gjatë luftës, as për deportimin e dhunshëm të afro 1 milion shqiptarëve.

Politika influencuese e Serbisë në strukturat e UNMIK-ut bëri që hetuesit e asaj kohe të dezorientohen dhe të harrojnë hetimin për masakrën e Çirezit, Likoshanit, të Delijajve, Therandës, Mitrovicës, Mejës, Çyshkut e mijëra e mijëra masakra tjera të kryera në Kosovë.

UNMIK-u dhe EULEX-i u dezorientuan dhe u detyruan në huqje të ndjekjeve për krime të luftës. Sipas ligjit kur mbahet një gjykim apo kur dënohet dikush për një vepër, mbrohet e mira e përgjithshme.

Pyetja themelore shtrohet: Cilat vlera universale, cili interes publik, qytetar u mbrojt në këto procese? Pra, nga dosjet e servuara nga UNMIK-u, një pjesë e tyre u trajtuan nga EULEX-i, sot mund të themi lirisht se në këto veprime u mbrojt sistemi gjenocidal i Serbisë, krimet e shtetit të Milosheviqit, prandaj, po them kur hetuesit e EULEX-it pranuan dosje të UNMIK-ut, këtu është huqja totale e misionit.

Unë jam i bindur ende se nëse misioni i EULEX-it, bashkë me institucionet vendore të angazhoheshin më shumë në sferën e sundimit të ligjit, në veçanti në fushën e krimit të organizuar, korrupsionit, ne sot do të kërkonim vazhdimin e mandatit, por për të shikuar në retrospektivë ky mision në këtë fushë, ka arritur fare pak të dëshmojë veten.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pranimi dhe procedimi i lëndëve të UDB-së dhe MUP-it serb, nëpërmjet UNMIKU-t te EULEX-i gjithçka mund të jetë por drejtësi, trajtim i drejtë i qasjes profesionale nuk mund të quhet, peshore e drejtësisë jo. Nuk pretendoj që unë mund t'i mësoj ekspertët e misionit të EULEX-it, por dosjet e pranuar në bllok nga UNMIK-u nuk nënkuptojnë autorikisht gjykime, por në tema profesionale duhet të konsiderohen material informativ. Kur verifikohet pastaj origjina e tyre nga UDB apo MUP, dëshmitarët e sistemit të sigurimit shtetëror serb brenda Kosovës... do të duhej të mos procedoheshin për shkak të njëanshmërisë, pasaktësisë dhe falsifikimit të së vërtetës.

EULEX-i duhet të pranojë se me këto veprime dëmtoi rënd parimet e drejtësisë nga shtetet që vijnë vetë pjesëtarët e EULEX-it. Gjithashtu, me këto aksione nuk u mbrojt asnjë vlerë universale, përkundrazi, irritoi viktimat e krimeve të luftës, shqetësoi qindra-mijëra familjarë të të zhdukurve, qindra-mijëra qytetarë tanë që kanë të afërm të tyre të masakruar në masakrat më makabre. Pati reagime edhe nga Organizata për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut, e të tjera.

Sikur EULEX-i të merrej me Shtabin e përgjithshëm të ushtrisë dhe policisë serbe, kjo do të kishte logjikë, sepse me Shtabin e përgjithshëm të ushtrisë dhe policisë serbe u dizajnuan krimet më makabre në Ballkan, që nga pas Lufta e dytë botërore.

Peshorja e drejtësisë tashmë më nuk është e balancuar. Ajo është e thyer dhe e rrëzuar në favor të padrejtësisë, në favor të mos gjyqimit të krimeve shtetërore serbe.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që në këtë çështje të mos mendojë askush për interesa politike të ngushta, sepse në vitin 1998, 1999 nuk kishte politikë, kishte luftë dhe përpjekje titanike për t'u përballur me paramilitarët, policët dhe ushtrinë serbe, që kishin synim masakrimin e familjeve shqiptare.

Si Kuvend i Kosovës kërkoj që të ndërmarrim çdo veprim dhe vendim ligjor që kjo situatë të tejkalohet, që përgjegjësinë tonë si organi më i lartë legjislativ ta kryejë në mbrojtje të interesit nacional dhe mbrojtjes së të vërtetës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëndetje për zëvendëskryeministrin, ministrin e Drejtësisë, ministrin e Punëve të Brendshme dhe atë të Infrastrukturës, Kolegë deputetë,

Nuk do ta zgjas shumë se i kanë thënë të gjithë kolegët më herët. Unë do të them që EULEX-i dhe Ministria e Drejtësisë mund të them kanë dështuar në disa masa që është dashur të merren e një nga to është edhe rasti i Dubravës që Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe EULEX-i ... kanë dështuar në këtë angazhim. Kanë dështuar edhe në të tjerat por megjithatë është një çështje që nuk duhet të merret.

Mund të them se ne në Kuvend të Kosovës jemi si rezultat i luftës sonë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa shtetin e Kosovës e kemi si rezultat po ashtu edhe të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të EULEX-it. EULEX-i si sundim i ligjit ka ardhur pikërisht për këtë me marrëveshje dhe me thirrjen ose me ftesën tonë.

Defektet që i ka dhe nuk ka mund t'i realizojë, unë mendoj që po ashtu Kosova ka nevojë për një ndihmë të tillë dhe kjo duhet të vazhdohet ndoshta dhe me këtë debat ia kemi vazhduar edhe më gjatë.

Unë mund të them edhe një tjetër gjë që sot në Kuvend është ndoshta sinjifikative që as analistët nuk kanë mund ta parashikojnë që për herë të parë PDK dhe “Vetëvendosje” bëjnë koalicion për një rezolutë. Kjo është ndoshta e mirëseardhur dhe uroj. Derisa Aleanca me LDK po bën koalicion, PDK-ja është e gatshme tash ta bëjë koalicionin me “Vetëvendosjen” dhe uroj që ky koalicion të ekzistojë. Faleminderit!

Kurtan, e ke fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit kryetar!

Pas dakordimit me shefat e grupeve parlamentare dhe një pjesë të deputetëve që janë prezentë në Kuvend dhe një pjesë shumica e tyre që e kanë nënshkruar këtë kërkesë për debat, u dakorduam që në këtë formë ta lexojmë këtë rezolutë.

Duke u nisur nga neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke u nisur nga konsolidimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e rendit dhe ligjit,

Duke çmuar rolin e EULEX-it që nga viti 2008 në fushën e rendit dhe ligjit,

Duke u nisur nga vendimi i grupit ndërkombëtar të drejtësisë për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur në shtator 2012,

Duke u nisur nga letra e presidentes me zonjën Eshton, e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës,

Duke u nisur nga e drejta dhe vullneti për të ushtruar përgjegjësi të plota shtetërore,

Kuvendi i Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që deri më 1 shtator 2013 të sjellë në Kuvend planin tranzicional drejt përfundimit të mandatit të EULEX-it, më 15 qershor 2014.
2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të propozojë planin për ngritjen dhe plotësimin e strukturave të reja që do t'i zëvendësojnë strukturat e EULEX-it.
3. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të propozojë amendamentimin e ligjeve që lidhen me kompetencat e EULEX-it.
4. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të hartojë ligjet dhe të ndërtojë strukturë të domosdoshme në fushën e rendit dhe ligjit, ngjashëm me vendet tjera të rajonit.
5. Kërkohet nga të gjitha institucionet kompetente që të marrin përgjegjësitë e duhura dhe t'i plotësojnë obligimet për bartje të përgjegjësi të plota, dhe
6. Institucionet e Republikës së Kosovës do të mbeten të përkushtuara në rrugën e integriteteve evropiane duke plotësuar kërkesat që dalin nga ky proces edhe në fushën e rendit dhe ligjit.

KRYETARI: Të pranishëm janë 70 deputetë.

Para se të shkojmë për votimin e rezolutës, votojmë për prezencën. Prandaj lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pra, praninë e kanë shfaqur 67 deputetë. Një është Fatmir Xhelili me ngritje dore. 68, edhe pse në sallë i kemi 70 deputetë.

Tash shkojmë i votojmë rekomandimet. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 60 vota, 1 me ngritje dore - 61 për, 3 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Rezolutën lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeveria e Kosovës dhe periudha e tranzicionit.

Megjithatë, mbet që Qeveria t'i hartojë këto kërkesa, pastaj Kuvendi me siguri do të merret përsëri me të.

Kështu, e përfundojmë këtë seancë dhe vazhdojmë në orën 15:30, me seancë të re. Deri atëherë, mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*